REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I GJ

Nr._____/2025

"PER TREGJET E KRIPTO-ASETEVE"[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

[1] *Ky ligj është i përafruar plotësisht me:*
Regulation (EU) 2023/1114 of the European Parliament and of the Council of 31 May 2023 on markets in crypto-assets, and amending Regulations (EU) No 1093/2010 and (EU) No 1095/2010 and Directives 2013/36/EU and (EU) 2019/1937.

Kreu I:
Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Objekti

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe kërkesave për ofertën ndaj publikut dhe pranimit për tregtim në një platformë tregtimi të kripto-aseteve, si dhe përcaktimi i kërkesave për Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve.

2. Ky ligj përcakton:

(a) kërkesat për transparencë dhe publikimin e informacionit për publikun në lidhje me emetimin, ofertën ndaj publikut dhe pranimin e kripto-aseteve për tregtim në një platforme tregtimi kripto-asetesh;

(b) kërkesat dhe rregullat për autorizim dhe mbikëqyrjen në vazhdimësi të ofruesve të shërbimeve të lidhura me kripto-asetet, emetuesve të tokenave të aseteve the tokenave të parasë elektronike, duke përfshirë këtu kërkesat operacionale, organizative dhe ato të qeverisjes së brendshme;

(c) kërkesat për mbrojtjen e investitorëve gjatë emetimit, ofertës ndaj publikut dhe pranimit për tregtim të kripto-aseteve;

(ç) kërkesat për mbrojtjen e klientëve të ofruesve të shërbimeve të lidhura me kripto-asetet;

(d) masat për parandalimin e tregtimit të brendshëm, përhapjen e informacionit të brendshëm dhe parandalimin e manipulimit të tregut të kripto-aseteve, me qëllim sigurimin e integritetit të tregjeve të kripto-aseteve.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë individëve dhe personave juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e emetimit, ofertës ndaj publikut dhe pranimit për tregtim të kripto-aseteve ose ofrimit të shërbimeve të lidhura me kripto-asetet në Republikën e Shqipërisë.
2. Ky ligj nuk zbatohet ndaj:
    a. subjekteve që ofrojnë shërbime të lidhura me kripto-asetet në mënyrë ekskluzive për shoqëritë e tyre mëmë, për shoqëritë e tyre bija, ose për shoqëritë e tjera bija të shoqërive mëmë;
    b. likuiduesit ose administratorit të likuidimit i cili vepron gjatë procedurës së falimentit,

me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 47;
c. Bankës së Shqipërisë, në rastet kur vepron si autoritet monetar, dhe autoriteteve të tjera publike;
d. Organizatave publike ndërkombëtare;

3. Ky ligj nuk zbatohet ndaj kripto-aseteve që janë unike dhe të pa këmbyeshme me kripto-asete të tjera.
4. Ky ligj nuk zbatohet ndaj kripto-aseteve të cilat përfshihen nën një nga përkufizimet e mëposhtme:
   a. instrumentave financiarë, në përputhje me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit;
   b. depozitave, në përputhje me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për bankat;
   c. depozitave të strukturuara, në përputhje me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit;
   d. fondeve, me përjashtim kur kategorizohen si tokena të parasë elektronike.
   e. produkteve të titullzuara, sipas përcaktimeve të legjislacionit të fushës .
   f. produktet e sigurimit të jo-jetës ose të jetës sipas klasave të sigurimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit, përfshirë kontratat e risigurimit dhe retrocedimit.
   g. fondet e pensionit privat të regulluara sipas legjislacionit në fuqi për fondet e pensioneve private.
   h. produktet individuale të pensionit për të cilat kërkohet një kontribut financiar nga punëdhënësi dhe ku punëdhënësi ose punëmarrësi nuk kanë zgjidhje për produktin ose ofruesin e pensionit;
   i. skemat e sigurimeve shoqërore të mbuluara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 3

Përkufizimet

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Teknologjia e regjistrave të shpërndarë" ose "DLT" është një teknologji që mundëson operimin dhe përdorimin e regjistrave të shpërndarë;
2. "Regjistër i shpërndarë" është një regjistër informacioni i cili ruan të dhënat e transaksioneve, dhe është i shpërndarë në mënyrë të sinkronizuar nëpërmjet një rrjeti të shumëfishtë nyjesh DLT, i cili përdor një mekanizëm të konsensusit;
3. "Mekanizëm i konsensusit" është një set rregullash dhe procedurash përmes të cilit rrjeti i nyjeve DLT dakordëson konfirmimin e transaksionit;
4. "Nyje e rrjetit DLT" është një pajisje ose proces i cili është pjese e një rrjeti që mban kopje te plota ose të pjesshme të të gjitha transaksioneve të regjistrit të shpërndarë;
5. "Kripto-aset" është një përfaqësim digjital i një vlere ose të drejte, i cili mund të transferohet dhe mund të ruhet elektronikisht përmes përdorimit të teknologjisë së regjistrave të

shpërndarë ose teknologjive të ngjashme. Kripto-aset ka të njejtin kuptim me termin “mjet virtual” në legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

6. “Token i lidhur me asetet” (këtu e në vijim “tokeni i aseteve”) është një lloj kripto-aseti, i ndryshëm nga tokeni i parasë elektronike, i cili synon të mbajë një vlerë të qëndrueshme përmes referimit të vlerës së tij pas një vlere ose të drejte tjetër, përfshirë këtu një ose më shumë monedhave që kanë kurs ligjor.
7. “Tokeni i parasë elektronike” është një lloj kripto-aseti i cili përdoret si mjet këmbimi dhe synon të mbajë një vlerë të qëndrueshme përmes refererimit të vlerës së tij pas një monedhe që ka kurs ligjor;
8. “Monedhë Zyrtare” është monedha zyrtare e një shteti e cila emetohet nga banka qendrore ose një autoritet tjetër monetar;
9. “Token utilitar” është një nga llojet e kripto-aseteve i cili synon të mundësojë akses në një mall ose një shërbim i ofruar nga emetuesi i tokenit utilitar;
10. “Emetues” është një individ ose person juridik, i cili emeton kripto-asete;
11. “Aplikuesi për emetim” është një emetues i tokenave të asetit dhe tokenave të parasë elektronike kripto-aseteve i cili kërkon autorizim për të ofruar kripto-asete ndaj publikut ose për t’i pranuar ato për tregtim;
12. “Ofertë ndaj publikut” është një komunikim ndaj çdo personi, në çfarëdolloj forme dhe mjeti, që paraqet informacion të mjaftueshëm për kushtet e ofertës dhe kripto-asetet që do të ofrohen, në mënyrë që t’i mundësojë klientit marrjen e vendimit për blerjen e këtyre kripto-aseteve;
13. “Ofertues” është individi, personi juridik, ose emetuesi, i cili ofron kripto-asete për publikun;
14. “Fonde” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave;
15. “Ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve” është çdo individ ose person juridik i cili ofron ndaj palëve të treta, një ose më shumë shërbime të lidhura me kripto-asetet, në përputhje me nenin 59 të këtij ligji.
16. “Shërbim i lidhur me kripto-asetet” janë shërbimet dhe veprimtaritë si më poshtë:
    a) Kujdestaria dhe administrimi i kripto-aseteve për llogari të palëve të treta;
    b) Operimi i një platforme tregtimi për kripto-asetet;
    c) Këmbimi i kripto-aseteve kundrejt fondeve;
    d) Këmbimi i kripto-aseteve kundrejt kripto-aseteve;
    e) Ekzekutimi i urdhërave të kripto-aseteve për llogari të klientëve;
    f) Hedhja në treg e kripto-aseteve;
    g) Marrja dhe transmetimi i urdhrave të lidhura me kripto-asetet për llogari të klientëve;
    h) Këshillimi në lidhje me kripto-asetet;
    i) Administrimi i portofolit të kripto-aseteve;
    j) Shërbimet e transfertave të kripto-aseteve për llogari të klientëve;
17. “Kujdestaria dhe administrimi i kripto-aseteve për llogari të palëve të treta” është ruajtja ose kontrolli i kripto-aseteve, për llogari të klientëve, ose të mënyrës së aksesimit të kripto-aseteve, në rastet e çelësave kriptografikë privatë.
18. “Operimi i një platforme tregtimi për kripto-asetet" është menaxhimi i një ose më shumë platformave shumëpalëshe të tregtimit, në të cilën interesat e shumëfishta të palëve të treta në

lidhje me blerjen ose shitjen e kripto-aseteve ndërveprojnë në perputhje me rregullat e saj me qëllim lidhjen e kontratave për këmbimin e kripto-aseteve kundrejt fondeve ose këmbimin e kripto-aseteve me kripto-asete te tjera."

19. "Këmbimi i kripto-aseteve kundrejt fondeve" është shërbimi i lidhjes dhe ekzekutimit të kontratave me palë te treta për blerjen ose shitjen e kripto-aseteve kundrejt fondeve, përmes përdorimit të fondeve të veta;
20. "Këmbimi i kripto-aseteve kundrejt kripto-aseteve" është shërbimi i lidhjes të kontratave me palë të treta për blerjen ose shitjen e kripto-aseteve kundrejt kripto-aseteve, përmes përdorimit të fondeve të veta;
21. "Ekzekutimi i urdhrave të kripto-aseteve për llogari të klientëve" është shërbimi i lidhjes së kontratave, për llogari të palëve të treta, për blerjen ose shitjen e një ose më shumë kripto-aseteve, ose për nënshkrimin e një ose më shumë kripto-aseteve, dhe përfshin lidhjen e kontratave per të shitur kripto-asete në momentin e ofertës ndaj publikut, ose pranimit për tregtim;
22. "Hedhja në treg e kripto-aseteve" është promovimi i kripto-aseteve, për llogari të ofertuesit, ose një pale të lidhur me ofertuesin, tek blerësit;
23. "Marrja dhe transmetimi i urdhrave të lidhura me kripto-asetet për llogari të klientëve" është marrja e një urdhëri për blerjen ose shitjen e një ose më shumë kripto-aseteve, ose për nënshkrimin e një ose më shumë kripto-aseteve, dhe transmetimin e tij tek një palë e tretë për ekzekutim;
24. "Këshillimi në lidhje me kripto-asetet" është shërbimi i ofrimit, dhënies, ose dakordësisë për t'i dhënë klientit rekomandime të personalizuara, me kërkesën e klientit ose nismën e vetë ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve, lidhur me kryerjen e transaksioneve me kripto-asete ose përdorimin e shërbimeve të lidhura me kripto-asetet
25. "Administrimi i portofolit të kripto-aseteve" është administrimi i portofoleve të kripto-aseteve në përputhje me udhëzimet e dhëna nga klientët;
26. "Shërbimet e transfertave të kripto-aseteve për llogari të klientëve" është ofrimi i shërbimeve të transfertave nga një adresë ose llogari e regjistrit të shpërndarë drejt një tjetre, për llogari të individëve ose personave juridikë;
27. "Organ drejtues" është struktura ose strukturat e një emetuesi, ofertuesi ose personi i cili kërkon pranimin për tregtim, ose ofrimin e shërbimeve në lidhje më kripto-asetet, të cilët janë emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe kanë fuqi vendimmarrëse mbi vendosjen e strategjisë, objektivave dhe drejtimit të përgjithshëm të subjektit, dhe të cilët mbikëqyrin vendimmarrjet e administrimit të subjektit dhe përfshijnë personat të cilët efektivisht drejtojnë shoqërinë;
28. "Institucion krediti" është subjekti që ushtron veprimtari bankare dhe financiare sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
29. "Shoqëri komisionere" ka të njëjtin kuptim sipas ligjit që rregullon tregjet e kapitalit.
30. "Klient i kualifikuar" ka të njëjtin kuptim sipas ligjit që rregullon tregjet e kapitalit.
31. "Lidhje të ngushta" ka të njëjtin kuptim sipas ligjit që rregullon tregjet e kapitalit.
32. "Rezerva e aseteve" është shporta rezervë e aseteve e cila garanton pretendimet e klientit kundrejt emetuesit;
33. Shteti i origjinës është:

a) shteti ku ofertuesi ose personi ka regjistruar selinë e tij, në rastin e ofertuesve ose personave që kërkojnë pranim për tregtim të kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni i aseteve dhe tokeni i parasë elektronike;
b) shteti i përzgjedhur nga ofertuesi ose personi që kërkon pranim për tregtim në të cilët ka degë të shoqërisë, në rastin e ofertuesve ose personave që kërkojnë pranim për tregtim të tokenave të ndryshëm nga tokeni i aseteve ose tokeni i parasë elektronike, të cilët nuk kanë një seli të regjistruar por ka një ose më shumë degë në Shqipëri ose në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian;
c) shteti në të cilin kripto-asetet do të ofrohen ndaj publikut për herë të parë ose shteti i përzgjedhur nga ofertuesi ose personi që kërkon pranim për tregtim për të kërkuar për herë të parë pranimin për tregtim, në rastin e ofertuesve ose personave që kërkojnë pranim për tregtim të kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni i aseteve ose tokeni i parasë elektronike të cilët kanë selinë në një vend të tretë dhe nuk kanë degë në Shqipëri ose në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian;
d) shteti në të cilin emetuesi i tokenit të aseteve ka regjistruar selinë e tij;
e) shteti në të cilin emetuesi i tokenit të parasë elektronikë është licencuar ose autorizuar si bankë ose si institucion i parasë elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
f) shteti në të cilin ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve ka regjistruar selinë e tij;

34. Shteti pritës është shteti i ndryshëm nga shteti i origjinës, në të cilën ofertuesi ose personi i cili kërkon pranimin për tregtim ka bërë një ofertë publike të kripto-aseteve ose ka kërkuar prandim për tregtim, ose ofruesi i shërbimeve të kripto aseteve ofron shërbime të kripto-aseteve;
35. "Autoritetet përgjegjëse" janë Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sipas fushës së përgjegjësisë të përcaktuar në nenin 93 të këtij ligji.
36. "Pjesëmarrje influencuese" është çdo pjesëmarrje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në një emetues të tokenit të aseteve ose ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve e të paktën 10% të kapitalit ose të drejtave të votës, duke marrë parasysh kushtet e agregimit sipas legjislacionit për harmonizimin e kërkesave për transparencë, e cila mundëson ushtrimin e një influence të konsiderueshme në administrimin e emetuesit të tokenit të aseteve ose ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve në të cilën mbahet kjo pjesëmarrje;
37. "Klient joprofesionist" është çdo individ i cili vepron për qëllime jashtë veprimtarisë së tij tregtare, biznesit, zanatit ose profesionit.
38. "Ndërfaqja online" është çdo softuer, duke përfshirë këtu edhe një faqe interneti, pjesë të një faqeje interneti ose aplikacioni, i cili operohet nga, ose, për llogari të një ofertuesi ose ofruesi shërbimesh në lidhje me kripto-asetet, dhe e cila shërben për t'u dhënë zotëruesve të kripto-aseteve akses në kripto-asetet e tyre, si dhe t'u mundësojë klientëve akses në shërbime në lidhje me kripto-asetet;
39. "Klient" është çdo person fizik ose juridik të cilit i ofrohen shërbime në lidhje me kripto-asetet nga një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve;
40. "Tregtim i bazuar në parimin e përputhshmërisë" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin që rregullon tregjet e kapitalit
41. "Shërbim pagese" ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për shërbimet e pagesave;

42. “Ofrues i shërbimit të pagesave” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për shërbimet e pagesave”;
43. “Institucion i parasë elektronike” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për bankat
44. “Para elektronike” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për bankat ;
45. “Të dhëna personale” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;
46. “Institucion pagese” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për shërbimet e pagesave”;
47. “Shoqëri administrimi për SIKTT” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për sipërmarrjet e investimeve kolektive;
48. “Administruesi i fondit të investimeve alternative” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për sipërmarrjet e investimeve kolektive;
49. “Instrument financiar” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për tregjet e kapitalit;
50. “Depozitë” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për bankat në Republikën e Shqipërisë;
51. “Depozitë e strukturuar” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për tregjet e kapitalit;
52. ‘*Mark-to-market*’ është vlerësimi i pozicioneve sipas çmimeve më të fundit të disponueshme (*close-out*), të siguruara në mënyrë të pavarur, përfshirë këtu çmimet e bursës, çmimet nga platformat elektronike të tregtimit (*screen prices*) ose kuotimet nga disa ndërmjetës të pavarur me reputacion të mirë.
53. “*Mark-to-model*” është çdo vlerësim që bazohet në krahasim referencë (*benchmark*), ekstrapolohet ose përllogaritet në mënyra të tjera duke u mbështetur në një ose më shumë të dhëna të tregut.
54. “Metoda e kostos së amortizuar” është një metodë vlerësimi që bazohet në koston e blerjes së një aktivi dhe e rregullon atë vlerë duke amortizuar primet ose zbritjet deri në maturim.
55. “Grup” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në legjislacionin për tregjet e kapitalit
56. “ESMA” është Autoriteti Evropian i Tregjeve të Titujve
57. “EBA” është Autoriteti Bankar Evropian
58. “ECB” është Banka Qendrore Evropiane

Kreu II
Kripto-asete të ndryshme nga Tokeni i Aseteve ose Tokeni i parasë elektronike

Neni 4
Oferta ndaj publikut e kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni i aseteve ose token i parasë elektronike

1. Emetuesi i kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni i aseteve ose token i parasë elektronike, mund t'i ofrojë këto kripto-asete ndaj publikut vetëm pas përmbushjes së kushteve të mëposhtme:
    a) të jetë person juridik me seli në Republikën e Shqipërisë, ose në një vend të Bashkimit Evropian;
    b) të hartojë një dokument informues për kripto-asetin, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji;
    c) të njoftojë AMF për publikimin e dokumentit informues në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;
    d) të publikojë dokumentin informues në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;
    e) të hartojë materialet promovuese në lidhje me kripto-asetet në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, në rast se është e aplikueshme
    f) të ketë publikuar materialet promovuese në lidhje me kripto-asetet në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, në rast se është e aplikueshme;
    g) të plotësojë të gjitha detyrimet për ofertuesit, sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji;
2. Ofertat ndaj publikut të kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni i aseteve dhe tokeni i parasë elektronike, të listuara më poshtë, përjashtohen nga zbatimi i detyrimeve të parashikuara në shkronjat b, c, d dhe f të pikës 1 të këtij neni
    a) kripto-asetet që iu ofrohen jo më shumë se 150 personave fizikë ose juridikë, në rastet kur veprojnë për llogari të vetë; dhe
    b) ofertat e kripto-aseteve të cilat kanë vlerë totale të barazvlefshme ose më të ulët se 1 000 000 Euro ose vlerën ekuivalente në lekë, brenda një periudhe 12-mujore që nga fillimi ofertës.
    c) kripto-asetet që iu ofrohen eksluzivisht klientëve profesionistë, të cilat nuk mund të transferohen ose mbahen nga një klientë jo-profesionist.
3. Ky kre nuk zbatohet për ofertat ndaj publikut të kripto-aseteve, të ndryshme nga token aseti ose token i parasë elektronike, në rastet e mëposhtme:
    a) kripto-asetet që shpërndahen falas (*airdrop*);

b) kripto-asetet që përfitohen automatikisht nga nxjerrja e kripto-aseteve si rezultat i mirëmbajtjes së rrjetit DLT ose verifikimit të transaksioneve(*mining)*;
c) kripto-asetet që shërbejnë si token utilitar duke mundësuar qasje në një mall ose shërbim që ekziston ose është funksional.
d) zotëruesi i kripto-asetit ka të drejtën ta përdorë atë vetëm në këmbim të mallrave dhe shërbimeve në një rrjet të kufizuar tregtarësh të cilët kanë marrëveshje kontrakuale me ofertuesin.

4. Për qëllim pikës 3, shkronja (a), një kripto-aset nuk konsiderohet të jetë ofruar falas nëse blerësve u kërkohet të vendosin në dispozicion të ofertuesve, ose të marrin përsipër të vendosin në dispozicion, të dhënat e tyre personale në këmbim të kripto-asetit, ose nëse ofertuesi i një kripto-aseti i ngarkon zotëruesve potencial të atij kripto-aseti tarifa, komisione, ose përfitime monetare ose jo-monetare në këmbim të kripto-asetit.
5. Në rastet kur, për çdo periudhë 12 mujore duke nisur nga data e fillimit të ofertës publike, shuma totale e kripto-asetit të ofruar ndaj publikut sipas pikës 3, shkronja (d) tejkalon 1 000 000 EUR, ofertuesi njofton AMF për ofertën ndaj publikut dhe parashtron arsyet se përse oferta bie nën përjashtimet e pikës 3, shkronja d), të këtij neni.
6. Me marrjen e njoftimit sipas pikës 5 të këtij neni, në rastet kur AMF konsideron që veprimtaria nuk kualifikohet si rast përjashtimor në përputhje me pikën 3, shkronja (d) të këtij neni, autoriteti merr një vendim të arsyetuar të cilin ia komunikon ofertuesit.

7. Përjashtimet e listuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni nuk zbatohen në rastet kur ofertuesi, ose një palë tjetër që vepron për llogari të ofertuesit, bën me dije në çfarëdo forme komunikimi, qëllimet e tij për të kërkuar pranimin për tregtim të një kripto-aseti të ndryshëm nga një token aseti ose token të parasë elektronike.

8. Në rastet kur oferta publike e një kripto-aseti bie nën përjashtimet e përcaktuara në pikën 3 këtij neni, veprimtaria e ofrimit të shërbimeve të kujdestarisë dhe administrimit të kripto-aseteve për llogari të klientëve, si dhe veprimtaria e ofrimit të shërbimeve të transfertave te kripto-aseteve, nuk i nënshtrohen kërkesave për autorizim si ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve në përputhje me nenin 59 të këtij ligji, përveç rasteve kur :

a) ekziston një tjetër ofertë publike e të njëjtit kripto-aset, e cila nuk plotëson kushtet për përjashtim; ose
b) kripto-aseti i ofruar pranohet për tregtim në një platformë tregtimi.

9. Në rastet kur oferta publike e kripto-asetit të ndryshëm nga tokeni i aseteve ose i tokeni i parasë elektronike përfshin një token utilitar cili mundëson akses në mallra dhe shërbime që nuk ekzistojnë ose nuk janë ende funksionale, kohëzgjatja e ofertës drejt publikut nuk tejkalon 12 muaj nga data e publikimit të dokumentit informues.

10. Çdo ofertë tjetër e mëpasshme ë ndaj publikut për kripto-asetin e ndryshëm nga tokeni i asetit ose tokenit të parasë elektronike, trajtohet si një ofertë e veçantë, për të cilën zbatohen të gjitha kërkesat e pikës 1, krahas zbatimit të mundshëm të përjashtimeve të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni. Ofertat e mëpasshme ndaj publikut për kripto-asetin e ndryshëm nga tokeni i

aseteve ose tokeni i parasë elektronike, nuk i nënshtrohen kërkesave për publikimin e një dokumenti informues të ri, për sa kohë që dokumenti informues ekzistues për kripto-asetin është publikuar në përputhje me nenet 9 dhe 12 të këtij ligji, dhe subjekti përgjegjës për hartimin e tij jep pëlqimin me shkrim për përdorim.

11. Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe në rastet kur një ofertë publike për një kripto-aset të ndryshëm nga tokeni asetit ose tokeni i parasë elektronike është e përjashtuar nga detyrimi për të publikuar një Dokument informues sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni, por megjithatë dokumenti informues hartohet vullnetarisht.

Neni 5

Pranimi për tregtim i kripto-aseteve të ndryshëm nga tokenat e asetit ose tokenat e parasë elektronike

1. Çdo emetues i kripto-aseteve të cilat nuk janë token të aseteve ose token i parasë elektronike, mund të kërkojë pranimin e tyre për tregtim në një platformë tregtimi për kripto-asete, vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve të mëposhtme:
   a) Të jetë person juridik me seli në Republikën e Shqipërisë, ose në një vend të Bashkimit Evropian;
   b) të ketë hartuar një dokumenti informues në përputhje me nenin 6 të këtij ligji;
   c) të njoftojë AMF rreth dokumentit informues në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;
   d) të ketë publikuar një Dokument informues në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;
   e) të ketë hartuar materialet promovuese, nëse është e aplikueshme, në lidhje me kripto-asetet në përputhje me nenin 7 të këtij ligji;
   f) të ketë publikuar materialet promovuese nëse është e aplikueshme, në lidhje me kripto-asetet në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;
   g) të plotësojë të gjitha detyrimet e përcaktuara për personat të cilët kërkojnë pranim për tregtim, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

2. Në rastet kur një kripto-aset pranohet për tregtim me nismën e operatorit të një platforme tregtimi dhe dokumenti informues nuk është publikuar në përputhje me nenin 9, të këtij ligji, operatori i platformës së tregtimit për kripto-asete, duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Përjashtimisht, subjekti i cili kërkon pranimin për tregtim të një kripto-aseti të ndryshëm nga tokeni i asetit ose tokeni i parasë elektronike dhe operatori përkatës i platformës së tregtimit, mund të bien dakord me shkrim që do të jetë operatori i platformës së tregtimit i cili do të përmbushë pjesërisht ose plotësisht kërkesat e përcaktuara në shkronjat b,c,d,e,f,g të pikës 1 të këtij neni.

Marrëveshja me shkrim e përcaktuar më sipër përmban dispozita të qarta të cilat specifikojnë detyrimin e subjektit që kërkon pranimin për tregtim të vendosë në dispozicion operatorit të platformës së tregtimit të gjithë infomacionin e nevojshëm në funksion të përmbushjes së kërkesave të gërmave b,c,d,e,f,g, të pikës 1 të këtij neni.

4. Pika 1, shkronja (b), (c) dhe (d) e këtij neni, nuk zbatohen në rastet kur:

(a) kripto-aseti është pranuar për tregtim në një platformë tjetër të licencuar për kripto-asetet në Republikën e Shqipërisë ose Bashkimin Evropian;

(b) Dokumenti informues i kripto-asetit është hartuar në përputhje me nenin 6, është përditësuar në përputhje me nenin 12, dhe personi përgjegjës për hartimin e Dokumentit informues jep pëlqimin më shkrim, për përdorimin e tij.

Neni 6
Forma dhe përmbajtja e dokumentit informues të kripto-asetit

1. Dokumenti informues i një kripto-aseti përmban të gjithë informacionin e përcaktuar më poshtë dhe të detajuar në në Aneksin I të këtij ligji.

a) informacion rreth ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin për tregtim;
b) informacion në lidhje me emetuesin, nëse është i ndryshëm nga ofertuesi ose subjekti që kërkon pranim në treg;
c) informacion për operatorin e platformës së tregtimit në rastet kur ai harton Dokumentin informues të kripto-asetit;
d) informacion në lidhje me projektin e kripto-asetit;
e) informacion në lidhje me ofertën për publikun e kripto-asetit ose pranimin e tij për tregtim;
f) informacion rreth kripto-asetit;
g) informacion mbi të drejtat dhe detyrimet që i bashkëngjiten kripto-asetit;
h) informacion mbi teknologjinë bazë;
i) informacion mbi rreziqet;
j) informacion mbi ndikimet kryesore mjedisore dhe pasoja të tjera negative të lidhura me llojin e mekanizmit të konsensusit të përdorur për emetimin e kripto-asetit.

Në rastet kur dokumenti informues i kripto-asetit nuk është hartuar nga personat e përcaktuar në pikën e parë, shkronjat (a), (b) dhe (c), dokumenti informues përfshin gjithashtu identitetin e subjektit që hartoi atë dhe arsyet përse u përzgjodh ky subjekt.

2. Informacioni i renditur në pikën 1 të këtij neni duhet të jetë i drejtë, i qartë dhe jo keqorientues. Dokumenti informues nuk përmban gabime ose mangësi thelbësore dhe paraqitet në formë koncize dhe të kuptueshme.

3. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban një njoftim për investitorët , të paraqitur në mënyrë të qartë dhe të dukshme në faqen e parë me këtë përmbajtje:

> "*Ky Dokument informues nuk është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Ofertuesi i kripto-asetit është i vetmi subjekt përgjegjës për përmbajtjen e këtij relacioni"*

Në rastet kur dokumenti informues i kripto-asetit hartohet nga subjekti që kërkon pranim për tregtim ose nga një operator i një platforme tregtimi, në këtë rast në vend të "ofertuesit", duhet vendosur një referencë për "subjektin që kërkon pranim në treg" ose "operatorin e platformës se tregtimit", e cila do të përfshihet në deklaratën e përcaktuar në këtë pikë.

4. Dokumenti informues i kripto-asetit nuk duhet të përmbajë asnjë deklaratë ose parashikim në lidhje me vlerën e potenciale të kripto-asetit në të ardhmen, përveç sa parashikohet në pikën 5 të këtij neni.

5. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban informacion të qartë ku të tregohet që:

a) kripto-aseti mund të humbasë vlerën e tij pjesërisht ose plotësisht;
b) kripto-aseti mund të mos jetë gjithmonë i transferueshëm;
c) kripto-aseti mund të mos jetë likuid;
d) kur oferta për publikun ka të bëjë me një token utilitar, ai mund të mos jetë i këmbyeshëm kundrejt mallit ose shërbimit të premtuar në dokumentin informues të kripto-asetit, veçanërisht në rastin e dështimit ose ndërprerjes së projektit të kripto-asetit ;
e) kripto-aseti nuk mbulohet nga skemat e kompensimit të investitorëve sipas ligjit qe rregullon tregun e kapitalit;
f) kripto-aseti nuk mbulohet nga skemat e garancisë së depozitave sipas ligjit ligjit qe rregullon sigurimin e depozitave.

6. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban një deklaratë nga organi drejtues i ofertuesit, ose subjektit që kërkon pranimin për tregtim, ose operatorit të platformës së tregtimit, sipas rastit, e cila vendoset Dokumentin informuespas njoftimit për investitorët hyrëse të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, dhe konfirmon që dokumenti informues i kripto-asetit është në përputhje me këtë ligj dhe, në njohurinë më të mirë të strukturës drejtuese, informacioni i paraqitur në dokumentin informues të kripto-asetit është i drejtë dhe i qartë dhe nuk përmban mangësi që mund të ndikojë në kuptueshmërinë e tij.

7. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban një përmbledhje, e cila vendoset Dokumentin informues pas deklaratës së përcaktuar në pikën 6 të këtij neni, ku ofrohet informacioni thelbësor për ofertën e kripot-asetit ndaj publikut ose për pranimin për tregtim, në mënyrë të shkurtuar dhe në gjuhë jo-teknike. Përmbledhja duhet të jetë lehtësisht e kuptueshme dhe e paraqitur në një format të qartë dhe gjithëpërfshirës, duke përdorur shkronja me madhësi të lexueshme. Përmbledhja e dokumentit informues ofron informacionin e duhur në lidhje me karakteristikat e kripto-asetit në fjalë, në mënyrë që të ndihmojë blerësit dhe zotëruesit e mundshëm të tij të marrin një vendim të informuar.

Informacioni i përmbledhur sipas kësaj pikë, shoqërohet me një paralajmërim i cili:

a) duhet vendosur në hyrjen e Dokumentit informues të kripto-asetit;

b) blerësi potencial bazon çdo vendim për të blerë kripto-asetin në përmbajtjen e dokumentit informues në tërësi dhe jo vetëm në përmbledhje;
c) oferta për publikun e kripto-asetit nuk përbën ofertë ose kërkesë për të blerë instrumente financiare dhe që çdo ofertë ose kërkesë e tillë mund të bëhet vetëm me anë të një prospekti ose një dokumenti tjetër ofertues sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit;
d) Dokumenti informues i kripto-asetit nuk përbën një prospekt në të njëjtin kuptim siç referohet në ligjin që rregullontregun e kapitaleve.

8. Dokumenti informues përmban datën e njoftimit dhe tabelën e përmbajtjes.
9. Dokumenti informues i kripto-asetit hartohet në gjuhën shqipe.
10. Dokumenti informues i kripto-asetit paraqitet në një format digjital, të lexueshëm nga kompjuteri.
11. Për qëllime të pikës 10, standardet teknike të formatit dhe përmbajtjes së Dokumentit informues miratohen me rregullore të AMF
12. Standartet teknike në lidhje me përmbajtjen, metodologjinë dhe paraqitjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1, shkronja j) të këtij neni, të cilat i referohen indikatorëve të qëndrueshmërisë për sa i përket ndikimeve klimaterike negative ose ndikime negative të tjera mjedisore, miratohen me rregullore të AMF.
13. Gjatë hartimit të rregullores të përcaktuar në pikën 12, AMF do të marrë në konsideratë llojet e ndryshme të mekanizmave të konsesusit që përdoren për të dakordësuar transaksionet me kripto-asete, strukturën e incentivave dhe përdorimin e energjisë prej, energjinë e rinovueshme dhe burimet natyrore, prodhimin e mbetjeve dhe emetimeve të gazrave serrë. AMF përditëson rregulloren në raste të zhvillimeve teknologjike dhe rregullatore në Bashkimin Evropian.

Neni 7
Veprimtaritë Promovuese

1. Çdo material promovues në lidhje me ofertën për publikun të një kripto-aseti, të ndryshëm nga një token aseti ose token i parasë elektronike, ose në lidhje me pranimin për tregtim të një kripto-aseti të tillë, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
(a) materialet promovuese duhet të identifikohen qartësisht si të tilla;
(b) informacioni në materialet promovuese duhet të jete i drejtë, i qartë dhe jo konfuz;
(c) informacioni në materialet promovuese duhet të jetë në përputhje me informacionin në dokumentin informues të kripto-asetit, sipas nenin 4 ose 5, të këtij ligji;
(d) materialet promovuese duhet të deklarojnë qartë se dokumenti informues i kripto-asetit është publikuar, të tregojnë qartë adresën e faqes së internetit të ofertuesit, subjektit që kërkon pranimin për tregti, ose operatorit të platformës së tregtimit për kripto-asetin në fjalë, si dhe të mundësojnë një numër telefoni dhe një adresë emaili për të kontaktuar atë subjekt;

(e) materialet promovuese duhet të përmbajnë deklaratën e mëposhtme:

"Ky material promovues nuk është shqyrtuar ose miratuar nga asnjë Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Ofertuesi i kripto-asetit është i vetmi përgjegjës për përmbajtjen e këtij komunikimi.'.

Në rastet kur materialet promovuese përgatiten nga subjekti që kërkon pranim për tregtim të kripto-asetit ose operatori i një platforme tregtare, atëherë, në vend të "ofertuesit", në deklaratën e përcaktuar në pikën e parë, shkronja (e), duhet të përfshihet një referencë për "subjektin që kërkon pranim për tregtim" ose "operatorin e platformës tregtare".

2. Në rastet kur kërkohet dokumenti informues për kripto-asetin në përputhje me nenin 4 ose 5 të këtij ligji, materialet promovuese nuk do të shpërndahen përpara publikimit të tij. Kjo nuk ndikon në mundësitë e ofertuesit, subjektit që kërkon pranimin në tregtim, ose operatorit të një platforme tregtimi, për të kryer sondazhe të tregut.

3. AMF ka të drejtën të vlerësojë përputhshmërinë e materialeve promovuese me përcaktimet e pikës 1 të këtij neni.

Në rastet kur është e nevojshme, AMF asiston autoritetin përgjegjës të shtetit pritës anëtar të BE ku shpërndahen materialet promovuese për të analizuar materialet promovuese me informacionin në dokumentin informues të kripto-asetit.

4. Përdorimi i kompetencave mbikëqyrëse dhe hetimore të përcaktuara në nenin 94 në lidhje me zbatimin e këtij neni nga autoriteti përgjegjës i një shteti tjetër duhet t'i njoftohet pa vonesë AMF-së ofertuesit, subjektit që kërkon pranimin për tregtim ose operatorit të platformës së tregtimit për kripto-asetet.

Neni 8

Njoftimi i dokumentit informues të kripto-asetit dhe i materialeve promovuese

1. Ofertuesit, subjektet që kërkojnë pranim për tregtim, ose operatorët e platformave të tregtimit për kripto-asete të ndryshme nga tokeni i asetit ose parasë elektronike, njofton dhe i përcjell AMF dokumentin informues.
2. Materialet promovuese, sipas kërkesës, do t'i njoftohen AMF dhe autoritetit përgjegjës të shtetit tjetër, anëtar i BE, kur u drejtohen zotëruesve të mundshëm të kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni asetit ose i parasë elektronike në ato shtete.
3. Dokumenti informues si dhe materialet promovuese, përpara publikimit të tyre, nuk i nënshtrohen procedurave të miratimit paraprak nga AMF.
4. Njoftimi i dokumentit informues të kripto-asetit, i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni shoqërohet me një shpjegim se përse kripto-aseti i përshkruar në dokumentin informues nuk

konsiderohet si:
(a) një kripto-aset i përjashtuar nga objekti i këtij ligji në përputhje me nenin 2, pika 4;
(b) një token i parasë elektronike; ose
(c) një token aseti.

5. Informacioni i përcaktuar në pikat 1 dhe 4 të këtij neni, i njoftohen AMF të paktën 20 ditë pune përpara datës së publikimit të dokumentit informues të kripto-asetit.

6. Ofertuesit dhe subjektet që kërkojnë pranim për tregtimin e kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni i asetit ose i parasë elektronike, së bashku me njoftimin e përcaktuar në pikën 1, i përcjellin AMF, një listë të shteteve anëtare të BE, nëse ka, ku ata synojnë të ofrojnë kripto-asetet, ose synojnë të kërkojnë pranim për tregtim. Ofertuesit dhe subjektet që kërkojnë pranim për tregtimin e kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni i asetit ose i parasë elektronike gjithashtu informojnë AMF për datën e synuar të lançimit të ofertës për publikun ose për pranimin për tregtim, si dhe për çdo ndryshim të asaj date.

AMF njofton autoritetin përgjegjës në shtetet pritëse, anëtare të BE për ofertën e synuar për publikun ose pranimin për tregtim dhe i përcjell dokumentin informues të kripto-asetit brenda pesë ditë pune nga marrjes e listës së shteteve pritëse të përcaktuara në pikën 6 të këtij neni.

7. AMF duhet t'i komunikojë ESMA informacionin e listuar në pikat 1, 2 dhe 4, të këtij neni, si dhe datën e fillimit të ofertës së synuar për publikun ose pranimin e synuar në treg dhe çdo ndryshim të asaj date. Autoriteti do ta komunikojë këtë informacion brenda 5 ditëve punë nga marrja e informacionit nga ofertuesi ose subjekti që kërkon pranimin në treg.

AMF publikon në regjistrat e autoritetit, dokumentin informues të kripto-asetit, sipas përcaktimeve të nenit 109, pika 2, nga data e fillimit të ofertës për publikun ose pranimit për tregtim.

Neni 9
Publikimi i dokumentit informues të kripto-asetit dhe i materialeve promovuese

1. Ofertuesit dhe subjektet që kërkojnë pranim për tregtimin të kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni i aseteve ose tokeni parasë elektronike, publikojnë dokumentin informues të kripto-asetit dhe, në rastet kur është e zbatueshme, materialet promovuese në faqen e tyre të internetit, e cila është e aksesueshme për publikun. Dokumenti informues dhe Materialet promovuese publikohen brenda një kohe të arsyeshme përpara datës së fillimit të ofertës për publikun ose pranimit për tregtimin të kripto-asetit, si dhe duhet të mbeten të disponueshme në faqen e internetit të ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin për tregtim për aq kohë sa kripto-aseti është në qarkullim.

2. Dokumenti informues i kripto-asetit dhe, sipas rastit, materialet promovuese, duhet të jenë identike me versionin e njoftuar tek AMF në përputhje me nenin 8 ose, kur është e zbatueshme, me versionin e modifikuar në përputhje me përcaktimet nenin 12.

Neni 10
Rezultati i ofertës ndaj publikut dhe masat mbrojtëse

1. Ofertuesit e kripto-aseteve të ndryshme nga tokenat e aseteve ose tokenat e parasë elektronike, të cilët vendosin një afat kohor për ofertën publike të kripto-asetit, publikojnë në faqen e tyre të internetit rezultatin e ofertës për publikun brenda 20 ditëve pune nga përfundimi i periudhës së ofertës.
2. Ofertuesit e kripto-aseteve, të ndryshme nga tokenat e aseteve ose tokenat e parasë elektronike, të cilët nuk vendosin një afat kohor për ofertën publike të kripto-asetit, publikojnë çdo muaj në faqen e tyre të internetit, numrin e njësive të kripto-aseteve në qarkullim.
3. Ofertuesit e kripto-aseteve të ndryshme nga tokenat e aseteve ose tokenat e parasë elektronike, të cilët vendosin një afat kohor për ofertën publike të kripto-asetit, duhet të kenë marrëveshje për të monitoruar dhe ruajtur fondet ose kripto-asetet e tjera të mbledhura gjatë ofertës për publikun. Për këtë qëllim, ofertuesit sigurohen që fondet ose kripto-asetet e mbledhura gjatë ofertës për publikun të mbahen në kujdestari në një, ose dy mënyrat e mëposhtme:
(a) institucion krediti, ne rastet kur mblidhen fonde gjatë ofertës për publikun;
(b) ofrues shërbimi që mundëson kujdestarinë dhe administrimin e kripto-aseteve për llogari të palëve të treta.
4. Kur oferta për publikun nuk ka afat kohor, ofertuesi respekton detyrimet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni derisa të ketë skaduar e drejta e tërheqjes së klientit jo profesionist nga oferta, sipas nenit 13 të këtij ligji.

Neni 11
Të drejtat e ofertuesve dhe subjekteve që kërkojnë pranim për tregtimin e kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni asetit ose tokeni parasë elektronike

1. Pas publikimit të dokumentit informues të kripto-asetit në përputhje me nenin 9, dhe në rastet kur është e zbatueshme, të dokumentit informues të ndryshuar, në përputhje me nenin 12, ofertuesit mund të ofrojnë kripto-asete të ndryshme nga tokeni asetit ose tokeni i parasë elektronike, të cilat mund të pranohen për tregtim në platforma tregtimi për kripto-asetet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Ofertuesit dhe subjektet që kërkojnë pranim për tregtimin e kripto-aseteve të ndryshme nga tokeni i asetit ose tokeni i parasë elektronike, dhe kanë publikuar dokumentin informues të kripto-asetit në përputhje me nenin 9, të këtij ligji, dhe në rastet kur është e zbatueshme "dokumentin informues të ndryshuar, në përputhje me nenin 12, nuk do t'i nënshtrohen asnjë

kërkese të mëtejshëm për informacion në lidhje me ofertën publike ose pranimin për tregtimin të kripto-asetit.

Neni 12
Miratimi i ndryshimeve të dokumentit informues të kripto-asetit dhe të materialeve promovuese

1. Ofertuesit, subjektet që kërkojnë pranim për tregtim ose operatorët e një platforme tregtimi për kripto-asete të ndryshme nga tokeni asetit ose tokeni parasë elektronike, duhet të ndryshojnë përmbajtjen e dokumentit informues të kripto-asetit, të publikuar, dhe sipas rastit, të materialeve promovuese, sa herë që ka një faktor të ri të rëndësishëm, gabim material ose pasaktësi materiale që mund të ndikojë në vlerësimin e kripto-aseteve. Kjo kërkesë do të zbatohet për kohëzgjatjen e ofertës për publikun ose për aq kohë sa kripto-aseti është i pranuar për tregtim.

2. Ofertuesit, subjektet që kërkojnë pranim për tregtim ose operatorët e një platforme tregtimi për kripto-asete të ndryshme nga tokeni i asetit ose tokeni i parasë elektronike, njoftojnë AMF për përmbajtjen e dokumentit informues të kripto-asetit, të ndryshuar, dhe sipas rastit, materialet promovuese, si dhe datën e synuar të publikimit, të paktën shtatë ditë pune përpara publikimit , duke parashtruar arsyet e ndryshimeve.

3. Në datën e publikimit, ose më herët nëse kërkohet nga AMF, ofertuesi, subjekti që kërkon pranim për tregtim ose operatori i platformës së tregtimit informon menjëherë publikun në faqen e tij të internetit për dokumentin informues të ndryshuar duke dhënë arsyet e këtij ndryshimi.

4. Renditja e informacionit në dokumentin informues të kripto-asetit, të ndryshuar, dhe sipas rastit, në materialet promovuese të ndryshuara, duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 9, të këtij ligji.

5. Brenda pesë ditëve pune nga marrja e dokumentit informues të ndryshuar të kripto-asetit dhe, sipas rastit, të materialet promovuese të ndryshuara, në rastet e përcaktuara në nënin 8, pika 6, AMF njofton autoritetet përgjegjëse të shteteve pritëse si dhe përcjell njoftimin tek ESMA sëbashku me datën e publikimit.

6. Ofertuesit, subjektet që kërkojnë pranim për tregtim ose operatorët e një platforme tregtimi për kripto-asete të ndryshme nga tokeni i asetit ose tokeni i parasë elektronike, publikojnë “dokumentin informues të kripto-asetit, të ndryshuar, dhe sipas rastit, “materialet promovuese të ndryshuara”, duke përfshirë arsyet e ndryshimeve, në faqen e tyre të internetit në përputhje me nenin 9, të këtij ligji.

7. Dokumenti informues i kripto-aseteve, i ndryshuar dhe sipas rastit, materialet promovuese të ndryshuara, duhet të kenë një vulë elektronike me datë. Versioni më i fundit i tyre do të njihet si

versioni i zbatueshëm. Të gjitha dokumentet informuese të kripto-aseteve, të ndryshuara, dhe sipas rastit, materialet promovuese të ndryshuara duhet të jenë të disponueshme për aq kohë sa kripto-asetet janë në qarkullim

8. Kur oferta për publikun lidhet me një token utilitar që ofron akses në mallra dhe shërbime që nuk ekzistojnë ende, ose nuk janë ende funksionalë, ndryshimet e bëra në dokumentin informues të kripto-aseteve dhe, sipas rastit, në materialet promovuese, nuk duhet të tejkalojnë afatin kohor prej 12 muajsh të përcaktuar në nenin 4, pika 9.

9. Versionet më të vjetra të dokumentit informues të kripto-aseteve dhe materialeve promovuese do të mbeten të publikuara në faqen e internetit të ofertuesve, të subjekteve që kërkojnë pranim për tregtim, ose operatorëve të platformave tregtare, të paktën 10 vite pas datës së publikimit të tyre, me një paralajmërim që deklaron se nuk janë më të vlefshëm, si dhe të shoqërohet me një ndërlidhje në seksionin përkatës të faqes së internetit ku është publikuar versioni më i fundit i tyre.

Neni 13
E drejta e tërheqjes nga investimi

1. Klientët jo profesionistë të cilët blejnë kripto-asete të ndryshme nga tokeni i asetit ose tokeni i parasë elektronike, qoftë drejtpërdrejt nga një ofertues ose nga një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve, që liston kripto-asete në emër të atij ofertuesi, kanë të drejtën e tërheqjes nga investimi.

2 Klientët jo profesionistë, brenda 14 ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes, mund të tërhiqen nga marrëveshja për të blerë kripto-asete të ndryshme nga tokeni i asetit ose tokeni i parasë elektronike pa asnjë tarifë ose kosto shtesë, si dhe pa dhënë arsyet e tërheqjes. Kjo periudhë do të fillojë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së klientit jo profesionist për të blerë kripto-asetet në fjalë.

2. Të gjitha pagesat e kryera nga një klient jo profesionist, duke përfshirë çdo tarifë shtesë, nëse është e aplikueshme, rimbursohen jo më vonë se 14 ditë nga data në të cilën ofertuesi ose ofruesi i shërbimit të kripto-aseteve i cili ka hedhur në treg kripto-asetet në emër të atij ofertuesi, informohet për vendimin e klientit jo profesionist për t'u tërhequr nga marrëveshja për blerjen e kripto-aseteve.

Rimbursimi sipas pikës 2 të këtij neni kryhet duke përdorur të njëjtat mjete pagese si ato të përdorura nga klienti jo profesionist për transaksionin fillestar, përveç rastit kur klienti jo profesionist bie dakord ndryshe, me kusht që ky rimbursim të most ketë kosto ose tarifa shtesë.

3. Ofertuesit e kripto-aseteve do të japin informacion mbi të drejtën e tërheqjes nga investimi të

përcaktuar në pikën 1 në dokumentin informues të kripto-asetit.

4. E drejta e tërheqjes nga investimi, e përcaktuar në pikën 1 nuk do të zbatohet kur kripto-asetet janë pranuar për tregtim përpara blerjes së tyre nga klienti jo profesionist.

5. Kur ofertuesit kanë vendosur një afat kohor për ofertën publike të kripto-aseteve, në përputhje me nenin 10, e drejta e tërheqjes nuk do të ushtrohet pas përfundimit të periudhës së ofertës.

Neni 14
Detyrimet e ofertuesve dhe subjekteve që kërkojnë pranim për tregtimin e kripto-aseteve të ndryshme nga tokenat e asetit ose tokenat e parasë elektronike

1. Ofertuesi dhe subjekti që kërkon pranim për tregtimin e kripto-aseteve të ndryshme nga tokenat e asetit ose tokenat e parasë elektronike duhet:

a) të veprojë me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm;
b) të komunikojë me zotëruesit aktualë dhe blerësit e mundshëm të kripto-aseteve në një mënyrë të drejtë, të qartë dhe keqorientues;
c) të identifikojë, parandalojë, menaxhojë dhe zbulojë çdo konflikt interesi që mund të lindë;
d) të administrojë të gjitha sistemet dhe protokollet e sigurisë në përputhje me standardet e duhura të Bashkimit Evropian.

2. Ofertuesit dhe subjektet që kërkojnë pranim për tregtimin e kripto-aseteve të ndryshme nga tokenat e asetit ose tokenat e parasë elektronike, duhet të veprojnë në interesin më të mirë të zotëruesve të kripto-aseteve dhe duhet t'i trajtojnë ato në mënyrë të barabartë, përveç rasteve kur trajtimi preferencial kundrejt zotëruesve specifik, së bashku me arsyet e këtij trajtimi, është përcaktuar në dokumentin informues të kripto-aseteve dhe, kur është e zbatueshme, në materialet promovuese.

3. Në rastet kur oferta publike e një kripto-aseti të ndryshëm nga një tokeni i asetit ose i parasë elektronike anulohet, ofertuesit e këtij kripto-aseti sigurohen që çdo fond i mbledhur t'u kthehet zotëruesve ose blerësve të mundshëm jo më vonë se 25 ditë pas datës së anulimit.

Neni 15
Përgjegjësia për informacionin e dhënë në dokumentin informues

1. Në rastet kur një ofertues, subjekt që kërkon pranim për tregtim ose operator i një platforme tregtimi, në shkelje të nenit 6, përfshin në dokumentin informues të kripto-aseteve, ose në dokumentin informues të kripto-aseteve, të ndryshuar, informacion që nuk është i plotë, i drejtë, i qartë ose keqorientues, ofertuesi, subjekti që kërkon pranim për tregtim ose operatori i një

platforme tregtare dhe anëtarët e organit drejtues, janë përgjegjës kundrejt zotëruesit të kripto asetit për çdo humbje të shkaktuar si rrjedhojë e shkeljeve.

2. Çdo përjashtim kontraktual ose kufizim i përgjegjësisë civile të ofertuesit, subjektit që kërkon pranim për tregtim ose operatorit të një platforme tregtimi, si dhe çdo anëtari të organit drejtues sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij neni është i pavlefshëm dhe nuk ka pasoja ligjore.

3. Në rastet kur dokumenti informues i kripto-aseteve dhe materialet promovueve përgatiten nga operatori i platformës së tregtimit në përputhje me nenin 5, pika 3, subjekti që kërkon pranimin për tregtim mban përgjegjësi për çdo informacion që nuk është i plotë, i drejtë, i qartë ose keqorientues për operatorin e platformës së tregtimit.

4. Blerësi i kripto-asetit duhet të provojë se ofertuesi, subjekti që kërkon pranim në treg, ose operatori i platformës së tregtimit për kripto-asetet të ndryshme nga tokeni i pagesës ose tokeni i parasë elektronike, ka shkelur nenin 6 duke ofruar informacion që nuk është i plotë, i drejtë, i qartë, ose keqorientues, i cili ka ndikuar në vendimin e blerësit për të blerë, shitur ose këmbyer kripto-asetin.

5. Ofertuesi, subjekti që kërkon pranim në treg, ose operatori i platformës së tregtimit dhe anëtarët e organit drejtues nuk mban përgjegjësi ndaj një zotëruesi të një kripto-aseti për humbje të shkaktuara si rezultat i mbështetjes së zotëruesit në informacionin e dhënë në përmbledhjen e dokumentit informues sipas përcaktimeve të nenit 6, pika 7, duke përfshirë çdo përkthim të tij, përveç rasteve kur përmbledhja:

a) është keqorientuese, e pasaktë ose jo koherente kur lexohet së bashku me pjesët e tjera të dokumentit informues të kripto-aseti; ose
b) nuk ofron informacion thelbësor për të ndihmuar zotëruesit e mundshëm të kripto-asetit kur shqyrtojnë nëse do të blejnë një kripto-aset të tillë.

6. Dispozitat e këtij neni nuk përjashtojnë asnjë përgjegjësi tjetër civile të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

KREU III:
TOKENAT E LIDHUR ME ASETET

Seksioni 1:
Autorizimi për ofertën ndaj publikut të tokenave të lidhur me asetet dhe pranimin e tyre për tregtim

Neni 16

Autorizimi

1. Çdo subjekt që kërkon të ofrojë ndaj publikut ose të kërkojë pranimin për tregtim të një tokeni të aseteve në Republikën e Shqipërisë, duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:
    a) të jetë një person juridik, ose një formë tjetër organizimi e shoqërisë, i themeluar në Republikën e Shqipërisë, i cili është autorizuar në përputhje me nenin 21 të këtij ligji nga Banka e Shqipërisë; ose
    b) të jetë një institucion krediti që përmbush kërkesat e nenit 17 të këtij ligji.

Pavarësisht nga kërkesat e pikës 1 të këtij neni, oferta ndaj publikut dhe/ose kërkesa për pranim për tregtim të tokenit të aseteve mund të bëhet edhe nga subjekte të tjera, pas marrjes së dakordësisë me shkrim nga emetuesi i tokenit të asetit,dhe përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në nenet 27, 29 dhe 40 të këtij ligji.

Për qëllime të pikës 1, shkronja a) të këtij neni, subjektet me një formë organizimi të ndryshme nga personi juridik mund të emetojnë tokenat e asetit vetëm në rastet kur forma e tyre e organizimit siguron një nivel mbrojtjeje për interesat e palëve të treta ekuivalent me atë që ofrohet nga personat juridikë, dhe nëse kjo formë organizimi mund t'i nënshtrohet një mbikëqyrjeje të përshtatshme prudenciale.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastet kur:
    a) vlera mesatare e tokenave të asetit të emetuara në Shqipëri dhe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian nga një emetues nuk e kalon 5 000 000 (pesë milionë) Euro, ose vlerën ekuivalente në lekë, gjatë një periudhe 12-mujore, e llogaritur në fund të çdo dite kalendarike, dhe emetuesi nuk është i lidhur me një rrjet të emetuesve të tjerë të përjashtuar; ose
    b) oferta ndaj publikut e tokenit të asetit është e adresuar vetëm ndaj investitorëve të kualifikuar dhe tokeni i asetit mund të mbahet vetëm nga këta investitorë të kualifikuar.

Në këto raste, emetuesit e tokenave të asetit hartojnë një dokument informues për kripto-asetet, sipas përcaktimeve të nenit 19 të këtij ligji dhe të njoftojnë dokumentin informues, dhe sipas kërkesës, materialet promovuese tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

3. Autorizimi i dhënë nga Banka e Shqipërisë për një subjekt sipas përcaktimeve të pikës 1, shkronja a) të këtij neni, është i vlefshëm për territorin e Republikës së Shqipërisë duke i

lejuar emetuesit të tokenave të asetit të ofrojë ndaj publikut ose të kërkojë pranimin për tregtim, të tokenit të asetit për të cilin është autorizuar.

4. Miratimi i dhënë nga AMF për dokumentin informues të një emetuesi, sipas nenit 17, pika 1 ose nenit 21, pika 1 të këtij ligji, ose dokumentin informues të kripto-aseteve, të ndryshuar, sipas nenit 25 të këtij ligji, është i vlefshëm për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Në rastet kur një subjekt me seli jashtë Republikës së Shqipërisë, i cili është i autorizuar si emetues i tokenit të aseteve në përputhje me rregulloren (BE) 2023/1114 "Për tregjet e kripto-aseteve", kërkon të të ofrojë ndaj publikut ose të kërkojë pranimin për tregtim të një tokeni të aseteve në Republikën e Shqipërisë, subjekti do t'i nënshtrohet procedurave të njohjes nga Banka e Shqipërisë.
6. Rregullat më të detajuara në lidhje me procedurat dhe dokumentacionin për njohjen në Republikën e Shqipërisë, të subjekteve të autorizura për ushtrimin e veprimtarisë si emetues të tokenit të aseteve në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, miratohen me rregullore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 17

Kërkesat për institucionet e kreditit

1. Një token i aseteve i emetuar nga një institucion krediti i licencuar nga Banka e Shqipërisë, mund të ofrohet ndaj publikut ose të pranohet për tregtim nëse institucioni i kreditit(procedura njohje):
   a) harton një dokument informues për kripto-asetin, sipas përcaktimeve të nenit 19 të këtij ligji, të cilin ia përcjell Bankës së Shqipërisë për miratim, në përputhje me procedurën e përcaktuar në standardet teknike të miratuara në bazë të pikës 8 të këtij neni; dhe
   b) njofton Bankën e Shqipërisë të paktën 90 ditë pune para se të emetojë për herë të parë tokenin e asetit, duke i përcjellë informacionin e mëposhtëm:

      (i) programin e veprimtarisë, i cili përmban modelin e biznesit që subjekti synon të ndjekë;

      (ii) opinionin ligjor, sipas të cilit-tokeni i asetit nuk kualifikohet si një nga të mëposhtmet:

         — një kripto-aset i përjashtuar nga fusha e zbatimit të këtij ligji, sipas nenit 2, pika 4 të këtij ligji

         — një token i parasë elektronike;

      (iii) përshkrimin e hollësishëm të strukturave të qeverisjes, sipas përcaktimeve të nenit 34, pika 1 të këtij ligji;

      (iv) politikat dhe procedurat e përcaktuara në nenin 34, pika 5, të këtij ligji;

(v) informacion lidhur meNenin 34, pika (5),

(vi) përshkrimin e politikave për vazhdimësinë e biznesit, sipas përcaktimeve të nenit 34 pika 9;

(vii) një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut, sipas përcaktimeve të nenit 34, pika 10 të këtij ligji;

(viii) një përshkrim të sistemeve dhe procedurave të vendosura për të ruajtur disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave, sipas përcaktimeve të nenit 34, pika 11 të këtij ligji.

2. Institucioni i kreditit që ka njoftuar më parë Bankën e Shqipërisë, në përputhje me pikën 1, shkronja b), në rastet kur emeton një tjetër token aseti, nuk është i detyruar të paraqesë përsëri informacionin të cilin e ka paraqitur më parë, nëse ai informacion është ende i njëjtë. Në këtë rast, gjatë dorëzimit të dokumentacionit sipas pikës 1, shkronja b) të këtij neni, subjekti konfirmon se informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë më parë, është ende i vlefshëm dhe i saktë.

3. Brenda 20 ditëve pune nga marrja e dokumentacionit sipas pikës 1, shkronja b) të këtij neni, Banka e Shqipërisë vlerëson nëse dokumentacioni i përcjellë nga subjekti është i plotë. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në rastet kur Banka e Shqipërisë vëren se kërkesa e dorëzuar nuk përmban të gjithë informacionin e plotë, i kërkon subjektit me shkrim, që brenda 20 ditëve pune të plotësojë kërkesën duke specifikuar dokumentet që mungojnë.

Deri në përfundim të këtij afati, periudha e përcaktuar në pikën 1, shkronja b) , do të pezullohet. Çdo kërkesë e mëtejshme nga Banka e Shqipërisë drejt subjektit për plotësim ose qartësim të informacionit do të jetë në diskrecionin e tij, por do të rezultojë në pezullimin e periudhës së përcaktuar në pikën 1,shkronja b) të këtij neni.

Institucioni i kreditit nuk bën ofertë ndaj publikut dhe nuk kërkon pranimin për tregtim të tokenit të asetit për sa kohë që njoftimi nuk është i plotë.

4. Një institucion krediti që emeton tokena aseti, përfshirë tokena aseti me rëndësi të lartë, nuk i nënshtrohet dispozitave të neneve 16, 18, 20, 21, 24, 35, 41 dhe 42 të këtij ligji.
5. Një institucion krediti, i licencuar apo autorizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për institucionet e kreditit në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, i cili kërkon të ofrojë ndaj publikut ose të kërkojë pranimin për tregtim të tokenit të aseteve në Republikën e Shqipërisë, duhet ti nënshtrohet procedurave të njohjes në përputhje me përcaktimet e rregullores së Bankës së Shqipërisë.

Në rastet kur institucioni i kreditit ka selinë në një vend të Bashkimit Evropian, brenda zonës se

euros, ose monedha e referuar në tokenin e asetit është Euro, Banka e Shqipërisë përcjell pa vonesë të gjithë informacionin e marrë sipas pikës 1, shkronja b), të këtij neni tek Banka Qendrore Evropiane. Në rastet kur institucioni i kreditit ka selinë në një vend anëtar të Bashkimit Evropian, jashtë zonës së euros, ose monedha e referuar në tokenin e asetit është në monedhën zyrtare të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian, e ndryshme nga Euro, Banka e Shqipërisë përcjell pa vonesë të gjithë informacionin e kërkuar tek banka qendrore e shtetit përkatës.

Institucioni i Kreditit i themeluar në një vend të Bashkimit Evropian nuk mund të ofrojë ndaj publikut ose të kërkojë pranimin për tregtim të një tokeni asetesh përpara se Banka Qendrore Evropiane, ose sipas rastit, banka qendrore e shteti anëtar të Bashkimit Evropian, të përcjellë pranë Bankes së Shqipërisë opinionin në lidhje me tokenin e asetit.

Në rastet kur Banka Qendrore Evropiane ose sipas rastit, banka qendrore e një vendi anëtar të Bashkimit Evropian përcjell pranë Bankës së Shqipërisë një opinion negativ për shkak të një rreziku që mund të cënojë funksionimin e sistemit të pagesave, transmetimin e politikës monetare ose sovranitetin monetar, Banka e Shqipërisë i kërkon institucionit të kreditit që të ndalojë ofertën ndaj publikut ose të ndalojë kërkesën për pranimin për tregtim të tokenit të asetit.

Në rastet kur institucioni i kreditit është i themeluar në një shtet tjetër i cili nuk është anëtar i Bashkimit Evropian, Banka e Shqipërisë i komunikon bankës qendrore të atij shteti, të gjithë informacionin e marrë sipas pikës 1 të këtij neni.

6. Pas vlerësimit të dokumentacionit të marrë sipas pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë i komunikon AMF-së informacionin e përcaktuar në nenin 109, pika 3 të këtij ligji.

AMF-ja publikon informacionin në regjistër nga data e fillimit të ofertës ndaj publikut ose pranimit për tregtim.

Brenda 2 ditëve pune nga revokimi i licencës së nje institucioni krediti që emeton tokena aseti, Banka e Shqipërisë njofton AMF mbi revokimin e licencës/autorizimit. AMF publikon pa vonesë në regjistër informacionin në lidhje me revokimin, sipas përcaktimeve të nenit 109, pika 3 të këtij ligji.

8. AMF miraton me rregullore procedurat dhe standardet teknike në lidhje me miratimin e dokumentit informues të kripto-aseteve sipas pikës 1, shkronja a) të këtij neni.

Neni 18

Aplikimi për autorizim

1. Personat juridikë ose forma të tjera organizimi të shoqërisë që synojnë të ofrojnë ndaj publikut ose të kërkojnë pranimin për tregtim të tokenave të asetit paraqesin kërkesën e tyre

për autorizim, sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij ligji.

2. Kërkesa sipas pikës 1 të këtij neni përmban të gjithë informacionin e mëposhtëm:

(a) Adresën e subjektit kërkues;

(b) Ekstraktin e regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për regjistrimin e subjektit si person juridik, në të cilin të jetë shprehur objekti i veprimtarisë së shoqërisë;

(c) Statutin e subjektit kërkues,;

(d) Programin e veprimtarisëi cili përmban modelin e biznesit që subjekti–synon të ndjekë;

(e) Opinionin ligjor, sipas të cilit– tokeni i asetit nuk kualifikohet si një nga të mëposhtmet:

(i) një kripto-aset i përjashtuar nga fusha e zbatimit të këtij ligji, sipas nenit 2, pika 4; ose

(ii) një token i parasë elektronike;

(f) Një përshkrim të hollësishëm të strukturave të qeverisjes së subjektit, sipas përcaktimeve të nenit 34, pika 1 të këtij ligji;

(g) Në rastet kur ekzistojnë marrëveshje bashkëpunimi me ofrues të veçantë të shërbimeve të kripto-aseteve, një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm të tyre dhe procedurave për të siguruar pajtueshmërinë me detyrimet në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të shkatërrimit në masë, në përputhje me legjislacionit në fuqi;

(h) Të dhënat identifikuese të anëtarëve të organit drejtues të subjektit

(i) dokumente provuese të cilat vërtetojnë që personat e përcaktuar në shkronjën h) të kësaj pike janë me reputacion të mirë dhe zotërojnë njohuri, aftësi dhe përvojë të përshtatshme;

(j) dokumente provuese të cilat vërtetojnë që çdo aksioner ose anëtar, që zotëron, në mënyrë direkte ose indirekte, një pjesëmarrje influencuese në subjektin kërkues, është me reputacion të mirë;

(k) Dokumentin informues për kripto-asetin, siç referohet në nenin 19, të këtij ligji;

(l) Politikat dhe procedurat e përcaktuara në nenin 34, pika 5 të këtij ligji;

(m) Një përshkrim të marrëveshjeve kontraktuale me entitetet e palës së tretë, siç referohet në nenin 34, pika 5 të këtij ligji;

(n) Një përshkrim të politikës së vazhdimësisë së biznesit të subjekti kërkues, siç referohet në nenin 34, pika 9, të këtij ligji;

(o) Një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut, siç referohet në nenin 34 pika 10, të këtij ligji;

(p) Një përshkrim të sistemeve dhe procedurave të vendosura për të ruajtur disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave, siç referohet në nenin 34, pika 11, të këtij ligji;

(q) Një përshkrim të procedurave për trajtimin e ankesave të subjekti kërkues, siç

referohet në nenin 31, të këtij ligji;

(r) Kur është e zbatueshme, një listë të shteteve pritëse ku subjekti kërkues synon të ofrojë tokenin e asetit ndaj publikut ose synon të kërkojë pranimin për tregtim të tokenit të asetit.

3. Emetuesit që tashmë janë autorizuar për një token aseti nuk janë të detyruar të paraqesin, për qëllimet e autorizimit në lidhje me një token tjetër aseti, informacionin që është dorëzuar më parë tek Banka e Shqipërisë, nëse ai informacion është‐nde i vlefshëm dhe i saktë. Kur paraqet informacionin e listuar në pikën 2, emetuesi konfirmon se informacioni i dhënë më parë është ende i vlefshëm dhe i saktë.

4. Brenda dy ditëve pune nga marrja e një aplikimi sipas pikës 1, Banka e Shqipërisë konfirmon me shkrim marrjen e tij për subjektin kërkues.

5. Për qëllimet e pikës 2, gërmat (i) dhe (j), subjekti kërkues për tokenin e asetit përcjell informacionin e mëposhtëm:

a) dokumente që vërtetojnë se të gjithë anëtarët e organit drejtues nuk janë në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krim ekonomik apo vepra të tjera penale në kundërshtim me legjislacionin për shoqëritë tregtare, falimentin, shërbimet financiare, organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e armëve të shkatërrimit në masë si dhe përgjegjësinë profesionale;

b) dokumente që vertëtojnë se anëtarët e organit drejtues të subjektit që kërkon të emetojë tokenin e asetit, në mënyre kolektive, zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e përshtatshme për të administruar emetuesin e tokenit të asetit dhe që këta anëtarë do të angazhohen me kohë të mjaftueshme për të kryer detyrat e tyre;

c) dokumente që vërtetojnë se të gjithë aksionarët ose anëtarët, që zotëron, në mënyrë direkte ose indirekte, një pjesëmarrje influencuese në subjektin kërkues nuk janë në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krim ekonomik apo vepra të tjera penale në kundërshtim me legjislacionin për shoqëritë tregtare, falimentin, shërbimet financiare, organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e armëve të shkatërrimit në masë si dhe përgjegjësinë profesionale

6. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara lidhur me standardet teknike, formatet, procedurat dhe informacionin që përmban kërkesa për autorizim.

Neni 19

Forma dhe përmbajtja e dokumentit informues për kripto-asetet e tokenave të asetit

1. Dokumenti informues për kripto-asetin e një tokeni aseti përmban të gjithë informacionin e mëposhtëm, siç specifikohet më tej në Aneksin II:

   (a) Informacion për emetuesin e tokenit të asetit;
   (b) Informacion për tokenin e asetit;
   (c) Informacion për ofertën ndaj publikut të tokenit të asetit ose pranimin e tij për tregtim;
   (d) Informacion për të drejtat dhe detyrimet e lidhura me tokenin e asetit;
   (e) Informacion për teknologjinë bazë;
   (f) Informacion për rreziqet;
   (g) Informacion për rezervën e aseteve;
   (h) Informacion për ndikimet kryesore negative në klimë dhe ndikimet e tjera negative mjedisore të shkaktuara nga mekanizmi i konsensusit i përdorur për emetimin e tokenit të asetit.

Dokumenti informues duhet gjithashtu të përfshijë të dhënat identifikuese ose personale të subjektit, të ndryshëm nga emetuesi i cili ofron ndaj publikut ose kërkon pranimin për tregtim, sipas nenit 16, pika 1, dhe një shpjegim lidhur me arsyet e caktimin e këtij subjekti për ofertën ndaj publikut të tokenin e asetit ose pranimit të tij për tregtim. Në rastet kur dokumenti informues nuk është hartuar nga emetuesi, ai përfshin edhe identitetin e personit që e ka hartuar dokumentin informues dhe arsyen pse ai person e ka hartuar atë.

2. Të gjithë informacionet e listuara në pikën 1 duhet të jenë të sakta, të qarta dhe jo keqorientuese. Dokumenti informues duhet të paraqitet në një formë të përmbledhur dhe të kuptueshme dhe pa mangësi thelbësore .
3. Dokumenti informues nuk duhet të përmbajë deklarata mbi vlerën e ardhshme të kripto-aseteve, përveç deklaratës së përcaktuar në pikën 4.
4. Dokumenti informues përmban një deklaratë të qartë që:

   (a) Tokeni i asetit mund të humbasë vlerën e tij pjesërisht ose plotësisht;

   (b) Tokeni i asetit mund të mos jetë gjithmonë i transferueshëm;

   (c) Tokeni i asetit mund të mos jetë likuid;

   (d) Tokeni i asetit nuk mbulohet nga skemat e kompensimit të investitorëve;

   (e) Tokeni i asetit nuk mbulohet nga skemat e garancisë së depozitave.

5. Dokumenti informues përmban një deklaratë nga organi drejtues i emetuesit të tokenit të asetit. Kjo deklaratë konfirmon që dokumenti informues është në përputhje me këtë Kre dhe që, sipas njohurive më të mira të organit drejtues, informacioni i paraqitur në dokumentin informues është i saktë, i qartë, jo keqorientues dhe nuk përmban asnjë mangësi thelbësore.
6. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban një përmbledhje, e cila vendoset pas deklaratës

së përcaktuar në pikën 5, e cila ofron në mënyrë të shkurtuar dhe jo-teknike informacion kyç mbi ofertën ndaj publikut të tokenit të asetit ose pranimin e synuar për tregtim të tokenit të asetit. Përmbledhja është lehtësisht e kuptueshme dhe të paraqitet në një format të qartë dhe gjithëpërfshirës, duke përdorur karaktere me madhësi të lexueshme. Përmbledhja ofron informacionin e duhur mbi karakteristikat e tokenit të asetit, për të ndihmuar zotëruesit e mundshëm të tij të marrin një vendim të informuar. Përmbledhja përmban një paralajmërim i cili:

(a) duhet vendosur në hyrjen e Dokumentit informues të kripto-asetit;

(b) blerësi potencial bazon çdo vendim për të blerë kripto-asetin në përmbajtjen e dokumentit informues në tërësi dhe jo vetëm në përmbledhje;

(c) oferta për publikun e kripto-asetit nuk përbën ofertë ose kërkesë për të blerë instrumente financiare dhe që çdo ofertë ose kërkesë e tillë mund të bëhet vetëm me anë të një prospekti ose një dokumenti tjetër ofertues sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit;

(d) Dokumenti informues i kripto-asetit nuk përbën një prospekt në të njëjtin kuptim siç referohet në ligjin që rregullontregun e kapitaleve.

Përmbledhja parashikon që zotëruesit e tokenave të asetit kanë të drejtë shlyerje në çdo kohë, si dhe parashtron dhe kushtet e shlyerjes.

7. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban datën e njoftimit dhe tabelën e përmbajtjes.
8. Dokumenti informues i kripto-asetit hartohet në gjuhën shqipe.
9. Në rastet kur tokeni i asetit synohet të ofrohet jashtë Republikës së Shqipërisë, dokumenti informues i kripto-asetit hartohet edhe në një gjuhë zyrtare të shtetit ku synohet të ofrohet.
9. Dokumenti informuesi kripto-asetit është i disponueshëm në një format të lexueshëm nga kompjuteri.
10. Për qëllime të pikës 9 të këtij neni, standardet teknike të formatit dhe përmbajtjes së Dokumentit informues miratohen me rregullore të AMF.

11. Standartet teknike në lidhje me përmbajtjen, metodologjinë dhe paraqitjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1, shkronja h) të këtij neni, të cilat i referohen indikatorëve të qëndrueshmërisë për sa i përket ndikimeve klimaterike negative ose ndikime negative të tjera mjedisore, miratohen me rregullore të AMF.

12. Gjatë hartimit të rregullores të përcaktuar në pikën 11, AMF do të marrë në konsideratë llojet e ndryshme të mekanizmave të konsesusit që përdoren për të dakordësuar transaksionet me kripto-asete, strukturën e incentivave dhe përdorimin e energjisë prej, energjinë e rinovueshme dhe burimet natyrore, prodhimin e mbetjeve dhe emetimeve të gazrave serrë. AMF përditëson rregulloren në raste të zhvillimeve teknologjike dhe rregullatore në Bashkimin Evropian.

Neni 20

Shqyrtimi i aplikimit për autorizim

1. Brenda 25 ditëve pune nga marrja e aplikimit në përputhje me nenin 18 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë vlerëson plotësinë e dokumentacionit, përfshirë këtu dokumentin informues sipas përcaktimeve të nenit 19. . Në rastet kur Banka e Shqipërisë vëren se kërkesa e depozituar nuk përmban të gjithë informacionin e kërkuar, i kërkon aplikuesit për emetim me shkrim ose në mënyrë elektronike, që brenda 20 ditëve pune të plotësojë kërkesën për autorizim duke specifikuar dokumentet që mungojnë. Brenda 60 ditëve pune nga marrja e ‑dokumentacionit të plotë, Banka e Shqipërisë vlerëson nëse subjekti kërkues përmbush kërkesat e këtij Kreu dhe harton një projekt-vendim për dhënien ose refuzimin e autorizimit. Gjatë këtyre 60 ditëve, Banka e Shqipërisë mund të kërkojnë nga subjekti kërkues çdo informacion në lidhje me aplikimin, përfshirë dokumentin informues për kripto-asetin të përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji.

Gjatë procesit të vlerësimit, Banka e Shqipërisë mund të bashkëpunojnë me autoritetin përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, ose organe të tjera publike.

3. Afati i vlerësimit sipas pikave 1 dhe 2 do të pezullohet për periudhën ndërmjet datës së kërkesës për informacionin e munguar nga Banka e Shqipërisë dhe marrjes së përgjigjes përkatëse nga aplikuesi për emetim kërkues. Në çdo rast, pezullimi nuk tejkalon 20 ditë pune. Çdo kërkesë e mëtejshme nga Banka e Shqipërisë për plotësim ose saktësim të informacionit do të jetë në diskrecionin e tyre, por nuk ndikon në pezullimin e periudhës së vlerësimit sipas pikave 1 dhe 2.
4. Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për autorizim, në rastet kur tokeni i asetit është denominuar në Euro, Banka e Shqipërisë, pas përfundimit të periudhës së 60 ditëve të përcaktuar në pikën 2, i përcjell projekt-vendimin e saj dhe kërkesën e subjektit për aplikim tek Banka Qendrore Evropiane, Autoriteti i Evropian i Tregut të Titujve dhe Autoriteti Bankar Evropian.
5. Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për autorizim, në rastet kur tokeni i asetit është denominuar në një monedhë zyrtare të një shteti të Bashkimit Evropian, të ndryshme nga euro, Banka e Shqipërisë, pas përfundimit të periudhës së 60 ditëve të përcaktuar në pikën 2, i përcjell projekt-vendimin e saj dhe kërkesën e subjektit për aplikim tek Banka Qendrore e shtetit anëtar përkatës.

6. Autoritetet Evropiane të listuara në pikat 4 dhe 5 të këtij neni, sipas rastit japin opinionin e tyre lidhur me vlerësimin ligjor të përcaktuar në Nenin 18(2), pika (e), si dhe një vlerësim të rreziqeve që tokeni i asetit mund të mbartë në lidhje me stabilitetin financiar, mirëfunksionimin e sistemit të pagesave, transmetimin e politikës monetare dhe sovranitetit monetar, dhe ia përcjellin atë Bankës së Shqipërisë.

7. Opinioni sipas pikës 6 të këtij neni duhet merret në shqyrtim nga Banka e Shqipërisë, por nuk ka karakter detyrues.

Neni 21

Dhënia ose refuzimi i autorizimit

1. Brenda 25 ditëve pune nga marrja e opinioneve të përcaktuara në nenin 20, pika 5 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë merr një vendim të arsyetuar për dhënien ose refuzimin e autorizimit për subjektin kërkues dhe njofton këtë të fundit brenda 5 ditëve pune nga marrja e tij. Kur një subjekt kërkues autorizohet, dokumenti informues tij për kripto-asetin do të konsiderohet i miratuar.
2. Banka e Shqipërisë refuzon autorizimin kur ekzistojnë arsye objektive dhe të vërtetueshme se:

(a) Organi drejtues i subjektit kërkues mund të përbëjë kërcënim në kuadër të administrimit efektiv të tij, vazhdimësisë e biznesit, interesave të klientëve dhe integritetit të tregut;

(b) Anëtarët e organit drejtues nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 34, pika 2 të këtij ligji;

(c) Aksioneret ose Anëtarët e organit drejtues të emetuesit që zotërojnë, në mënyre direkte ose indirekte, pjesëmarrje influencuese nuk plotësojnë kriteret e reputacionit të mirë, të përcaktuara në menin 34, pika 4 të këtij ligji;

(d) Subjekti kërkues nuk përmbush ose ka të ngjarë të mos përmbushë ndonjë nga kërkesat e këtij Kreu;

(e) Modeli i biznesit të subjektit kërkues mund të paraqesë një kërcënim serioz për integritetin e tregut, stabilitetin financiar, funksionimin e sistemit të pagesave, ose ekspozon emetuesin ose sektorin ndaj rreziqeve serioze të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të shkatërrimit në masë.

3. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara, lidhur me vlerësimin e përshtatshmërisë të anëtarëve të organit drejtues të emetuesit të tokenit të asetit dhe aksionerët dhe anëtarët, qoftë direkt ose indirekt, që zotërojnë pjesëmarrje influencuese në emetuesin e tokenit të asetit.
4. Banka e Shqipërisë refuzon autorizimin në rast se Banka Qendrore Evropiane ose, kur është e aplikueshme, banka qendrore e një shteti anëtar te BE, jep një opinion negativ sipas nenit 20, pika 6 të ketij ligji, për shkak të një rreziku që cenon funksionimin e sistemit të pagesave, transmetimin e politikës monetare ose sovranitetin monetar.
5. Banka e Shqipërisë, brenda dy ditëve pune nga dhënia e autorizimit, duhet të komunikojnë tek pika e vetme e kontaktit e shteteve pritëse dhe kur është e aplikueshme, tek banka

qendrore e përcaktuar në nenin 20, pika 4, informacionin e specifikuar në nenin 109, pika 3 e këtij ligji.

AMF publikon një informacion të tillë në regjistrin sipas nenit 109, pika 3, nga data e fillimit të ofertës ndaj publikut ose pranimit për tregtim.

6. Në rastet kur tokenat e asetit janë të denominuara në Euro ose monedha të tjera zyrtare të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, Banka e Shqipërisë informon Bankën Qendrore Evropiane, Autoritetin Evropian të Tregut të Titujve, Autoritetin Bankar Evropian ose sipas rastit, bankën qendrore të shtetit anëtar të BE, për të gjitha kërkesat për autorizim, të refuzuara, si dhe jep arsyetimin për vendimin dhe për çdo devijim nga opinionet sipas përcaktimeve të nenit 20, pika 5, në rastet kur është e aplikueshme.

Neni 22

Raportimi mbi tokenat e asetit

1. Për çdo token të asetit me vlerë emetimi më të lartë se 100 000 000 (njëqind milion) EUR, ose ekuivalentin në lekë, të llogaritur në total nga emetimet dhe/ose ofrimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, emetuesi raporton në baza tremujore tek Banka e Shqipërisë informacionin e mëposhtëm:

(a) Numrin e zotëruesve;

(b) Vlerën e tokenit të asetit të emetuar dhe madhësinë e rezervës së aseteve;

(c) Numrin mesatar dhe vlerën mesatare të totalit të transaksioneve ditore, të tremujorit përkatës;

(d) Një përllogaritje të numrit mesatar dhe vlerës së mesatare totale të transaksioneve ditore gjatë tremujorit përkatës që lidhen me përdorimin e tij si një mjet këmbimi brenda zonës së përbashkët monetare evropiane dhe tregut vendas.

Për qëllimet e shkronjave (c) dhe (d) të pikës 1 të këtij neni, 'transaksion' nënkupton çdo ndryshim i personit fizik ose juridik që ka të drejtë mbi tokenin e asetit si rezultat i transferimit të tij nga një adresë ose llogari regjistri të shpërndarë, në një tjetër.

Transaksionet që lidhen me shkëmbimin për fonde ose kripto-asete të tjera midis emetuesit dhe/ose një ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve nuk do të konsiderohen të lidhura me përdorimin e tokenit të asetit si mjet këmbimi, përveç rasteve kur provohet se tokeni i asetit përdoret për shlyerjen e transaksioneve në kripto-asete të tjera.

2. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë nga emetuesit e tokenave të asetit që të përmbushin detyrimin e raportimit të përcaktuar në pikën 1 edhe për tokenat e asetit të emetuar me një

vlerë më të ulët se 100 000 000 EUR.

3. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë shërbime të lidhura me tokenat e asetit i sigurojnë emetuesit të tokenit të asetit informacionin e nevojshëm për të përgatitur raportin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshirë raportimin e transaksioneve jashtë regjistrit të shpërndarë.
4. Banka e Shqipërisë, kur është e aplikueshme ndan informacionin e marrë me Bankën Qendrore Evropiane dhe/ose me bankën qendrore të shtetit anëtar të BE përcaktuar në Nenin 20, pika 4 të këtij ligji .
5. Në rastet e tokneave të asetit të denominuara në monedha zyrtare të Bashkimit Evropian, Banka Qendrore Evropiane dhe, sipas rastit, banka qendrore e përcaktuar në Nenin 20, pika 4 mund t'i ofrojnë Bankës së Shqipërisë vlerësimet e tyre për numrin mesatar tremujor dhe vlerën e përgjithshme mesatare të transaksioneve për ditë që lidhen me përdorimin e tokenit të asetit si një mjet këmbimi brenda një zone të vetme valutore.
6. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara në lidhje me standardet teknike, formatet, përmbajtjen e raportimeve sipas pikës 1, raportimin e transaksioneve sipas pikës 3 si dhe për përllogaritjen e numrit mesatar dhe vlerës së mesatare totale të transaksioneve ditore gjatë tremujorit përkatës që lidhen me përdorimin e tij si një mjet këmbimi brenda zonës së përbashkët monetare evropiane dhe tregut vendas.

Neni 23

Kufizime për emetimin e tokenave të asetit të përdorur gjerësisht si një mjet këmbimi

1. Në rastet kur numri mesatar tremujor i vlerësuar dhe vlera e përgjithshme mesatare e transaksioneve për ditë, të lidhura me përdorimin e një tokeni të aseteve si mjet këmbimi brenda një zone të vetme valutore është më e lartë se 1 milion transaksione dhe 200 000 000 EUR, ose vlerën ekuivalentë në lekë, emetuesi duhet:
   a) të ndalojë emetimin e atij tokeni të asetit; dhe
   b) brenda 40 ditëve pune nga arritja e këtij pragu, të paraqesë një plan tek Banka e Shqipërise për të siguruar që numri mesatar tremujor i vlerësuar dhe vlera e përgjithshme mesatare e atyre transaksioneve për ditë të mbahet nën 1 milion transaksione dhe 200 000 000 EUR përkatësisht.
2. Gjatë kryerjes së vlerësimit të arritjes së pragut të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë përdor informacionin e siguruar nga emetuesi, vlerësimet e veta, ose vlerësimet e siguruara nga Banka Qendrore Evropiane ose Bankat Qendrore të shteteve anëtare të BE, në rastet kur është e aplikueshme, cilado qoftë më e lartë.
3. Në rastet kur disa emetues emetojnë të njëjtin token aseti, kriteret e përcaktuara në pikën 1 vlerësohen nga Banka e Shqipërisë pas grumbullimit të të dhënave nga të gjithë emetuesit.
4. Emetuesi paraqet planin e përcaktuar në pikën 1, pika (b), për miratim tek Banka e

Shqipërise. Në rastet kur është e nevojshme, Banka e Shqipërisë kërkon ndryshime, të tilla si vendosja e një shume minimale denominimi, për të siguruar reduktimin e përdorimit të tokenit të asetit si mjet këmbimi.

5. Banka e Shqipërisë lejon emetuesin të emetojë përsëri tokenin e asetit vetëm kur povohet se numri mesatar dhe vlera e mesatares totale të transaksioneve ditore gjatë tremujorit përkatës që lidhen me përdorimin e tij si një mjet këmbimi brenda zonës së përbashkët monetare evropiane dhe tregut vendas është më e ulët se 1 milion transaksione dhe 200 000 000 EUR, ose ekuivalentja në lekë.

Neni 24

Revokimi i autorizimit

1. Banka e Shqipërisë revokon autorizimin e një emetuesi të një tokeni të asetit në rrethanat si më poshtë:

   (a) Emetuesi ka ndaluar ushtrimin e aktivitetit për -6 muaj radhazi, ose nuk e ka ushtruar autorizimin për 12 muaj radhazi;
   (b) Emetuesi ka marrë autorizimin sipas nenit 18 ose miratimin e dokumentit informues të ndryshuar sipas nenit 25, mbi bazë të dokumentacionit të rremë, të pasaktë ose mashtrues
   (c) Emetuesi nuk përmbush më kushtet mbi të cilat është dhënë autorizimi;
   (d) Emetuesi ka shkelur rëndë dispozitat e këtij ligji;
   (e) Emetuesi ka qenë subjekt i planit të shlyerjes;
   (f) Emetuesi është tërhequr me kërkesën e tij nga autorizimi-ose ka vendosur të ndërpresë veprimtarinë;
   (g) Veprimtarira e emetuesit paraqet një kërcënim serioz për integritetin e tregut, stabilitetin financiar, funksionimin e sistemit të pagesave ose ekspozon emetuesin ose sektorin ndaj rreziqeve serioze të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të shkatërrimit në masë.
   Emetuesi i tokenit të asetit njofton Bankën e Shqipërisë për një nga situatat e përcaktuara në pikën 1, shkronjat (e) dhe (f) të këtij neni.

2. Në rastet e tokenave të asetit të denominuara në monedha zyrtare të Bashkimit Evropian, Banka e Shqipërisë revokon autorizimin e një emetuesi të një tokeni të asetit kur Banka Qendrore Evropiane ose, kur është e aplikueshme, banka qendrore e përcaktuar në nenin 20, pika 4 e këtij ligji, jep një opinion që tokeni i asetit paraqet një kërcënim serioz për funksionimin e sistemit të pagesave, transmetimin e politikës monetare ose sovranitetin monetar.
3. Banka e Shqipërisë kufizon sasinë e një tokeni të asetit që do të emetohet ose vendos një shumë minimale denominimi në lidhje me tokenin e asetit në rastet kur Banka Qendrore Evropiane, ose sipas rastit, banka qendrore e përcaktuar në nenin 20, pika 4 e këtij ligji, jep

një opinion që tokeni i asetit paraqet një kërcënim për funksionimin e sistemit të pagesave, transmetimin e politikës monetare ose sovranitetin monetar, dhe të specifikojnë kufirin ose shumën minimale të denominimit të zbatueshme.

4. Autoritetet përkatëse përgjegjëse njoftojnë pa vonesë Bankën e Shqipërisë për rrethanat e mëposhtme:
   a) një pale të tretë, në kuptimin e nenit 34, pika 5, shkronja (h), e këtij ligji, të cilit i është revokuar autorizimi si një institucion krediti, ose si një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve, sipas përcaktimeve të nenit 59 të këtij ligji, ose si një institucion pagese, ose si një institucion i parasë elektronike;
   b) anëtarët e organit drejtues të emetuesit ose aksionerët që zotërojnë, në mënyre direkte ose indirekte, pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e emetuesit, kanë shkelur dispozitat e legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
5. Banka e Shqipërisë revokon autorizimin e një emetuesi të një tokeni të asetit kur vlerëson se rrethanat e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni ndikojnë në reputacionin e mirë të anëtarëve të organit drejtues të atij emetuesi ose në reputacionin e mirë të çdo aksioneri ose anëtari, qoftë direkt ose indirekt, që zotëron pjesëmarrje influencuese në emetues, ose nëse ka tregues të mosfunksionimit të strukturave të qeverisjes ose mekanizmave të kontrollit të brendshëm, sipas përcaktimeve të nenit 34.

   Në rastet kur autorizimi revokohet, emetuesi i tokenit të asetit zbaton procedurën sipas nenit 47 të këtij ligji.

   Brenda 2 ditëve pune, Banka e Shqipërisë njofton AMF për marrjen e vendimit të revokimit të autorizimit të emetuesit të tokenit të asetit. Pas këtij njoftimi, autoriteti përditëson regjistrin, në zbatim të nenit 109, të këtij ligji.

Neni 25

Ndryshimi i dokumentit informues të kripto-aseteve të tokenave të asetit

1. Pas autorizimit në përputhje me nenin 21 të këtij ligji ose pas miratimit të dokumentit informues për kripto-asetin në përputhje me nenin 17, si dhe në kuptim të nenit 23 të këtij ligji, emetuesit e tokenave të asetit njoftojnë AMF për çdo ndryshim të synuar në modelin e tyre të biznesit, që mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në vendimin e blerjes së çdo zotëruesi ose zotëruesi të mundshëm të tokenave të asetit, i cili ndodh . Këto ndryshime përfshijnë, ndër të tjera, çdo ndryshim thelbësor në:

   (a) Strukturat e qeverisjes, përfshirë linjat e raportimit tek struktura drejtuese dhe politikat e menaxhimit të rrezikut;
   (b) Asetet rezervë dhe kujdestarinë e tyre;
   (c) Të drejtat e zotëruesve të tokenave të asetit;

(d) Mekanizmin përmes të cilit emetohet dhe shlyhet tokeni i asetit;
(e) Protokollet për dakordësimin e transaksioneve në tokenat e asetit;
(f) Funksionimin e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë në pronësi të emetuesve, ku tokenat e asetit emetohen, transferohen dhe ruhen duke përdorur këtë teknologji;
(g) Mekanizmat për të siguruar likuiditetin e tokenave të asetit, përfshirë politikat e menaxhimit të likuiditetit dhe procedurat për emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë, sipas përcaktimeve të nenit 45 të këtij ligji;
(h) Marrëveshjet me palë stë treta, përfshirë administrimin e rezervës se aseteve dhe investimin e rezervës, kujdestarinë e aseteve rezervë, dhe, kur është e aplikueshme, shpërndarjen e tokenave të asetit tek publiku;
(i) Procedurat për trajtimin e ankesave;
(j) Vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të shkatërrimit në masë si dhe politikat dhe procedurat e përgjithshme të lidhura me to.
Emetuesit e tokenave të asetit njoftojnë AMF të paktën 30 ditë pune përpara se ndryshimet e synuara të hyjnë në fuqi.

2. Në rastet kur ndryshimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni është njoftuar tek AMF, emetuesi i një tokeni të asetit harton një draft të dokumentit informues për kripto-asetin të ndryshuar dhe siguron që renditja e informacionit të jetë në përputhje me atë të dokumentit informues fillestar.

   Emetuesi i tokenit të asetit njofton dhe i përcjell AMF dokumentin informues të kripto-asetit, të ndryshuar.

   AMF njofton marrjen e kërkesës për ndryshimin e dokumentit informues për kripto-asetin, në mënyrë elektronike jo më vonë se 5 ditë pune nga marrja e tij.

   Brenda 30 ditëve pune nga njoftimi i marrjes së kërkesës, AMF miraton ose refuzon ndryshimin e dokumentit informues për kripto-asetin. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për miratimin e ndryshimit të dokumentit informues për kripto-asetin, AMF mund të kërkojë çdo informacion shtesë, shpjegime ose justifikime në lidhje me ndryshimin e dokumentit informues për kripto-asetin. Në këto raste, afati i 30 ditëve pune do të fillojë vetëm kur AMF të ketë marrë informacionin shtesë të kërkuar.
3. Kur AMF vlerëson se ndryshimet në dokumentin informues të kripto-asetit janë të rëndësishme për funksionimin e sistemit të pagesave, transmetimin e politikës monetare dhe sovranitetin monetar, ai konsultohet me Bankën e Shqipërisë. Në rastet e tokenave të asetit të denominuara në monedhat zyrtare të Bashkimit Evropian, AMF konsultohet me Bankën Qendrore Evropiane ose sipas rastit, bankën qendrore të shteti anëtar të BE.
4. Banka e Shqipërisë jep një opinion brenda 20 ditëve pune nga marrja e informacionit të përcaktuar në pikën 3.

5. Në rastet kur AMF miraton ndryshimin e dokumentit informues për kripto-asetin, ai mund të kërkojë nga emetuesi i tokenit të asetit:
   a) Të vendosë mekanizma për të siguruar mbrojtjen e zotëruesve të tokenit të asetit, kur një ndryshim i mundshëm i operacioneve të emetuesit mund të ketë një ndikim thelbësor në vlerën, stabilitetin, ose rreziqet e lidhura me tokenin të asetit ose të aseteve rezervë;
   b) Të marrë çdo masë korrigjuese të përshtatshme për të adresuar shqetësimet që lidhen me integritetin e tregut, stabilitetin financiar ose funksionimin e sistemit të pagesave.
6. Brenda 2 ditëve pune nga miratimi, AMF i përcjell dokumentin informues të kripto-asetit, të ndryshuar, Bankës Shqipërisë, dhe sipas rastit, Bankës Qendrore Evropiane ose bankës qendrore të shtetit anëtar të BE .

   AMF pasqyron dokumentin informues të kripto-asetit të ndryshuar në regjistrin sipas përcaktimeve të nenit 109, të këtij ligji.

Neni 26

Përgjegjësia e emetuesve të tokenave të asetit për informacionin e dhënë në dokumentin informues të kripto-aseteve

1. Në rastet kur një emetues është ne shkelje të nenit 19 të këtij ligji duke dhënë në dokumentin informues të kripto-asetit ose në një relacion të modifikuar informacion që nuk është i plotë, i drejtë ose i qartë, ose që është mashtrues, ai emetues dhe anëtarët e strukturës së tij drejtuese, administrative ose mbikëqyrëse do të jenë përgjegjës ndaj zotëruesit të atij tokeni të asetit për çdo humbje të pësuar nga ky i fundit.
2. Çdo përjashtim ose kufizim kontraktual të përgjegjësisë civile sipas përcaktimeve të pikës 1 konsiderohet si akt absolutisht i pavlefshëm.
3. Zotëruesi i tokenit të asetit mbart përgjegjësinë të provojë se emetuesi i atij tokeni të asetit ka shkelur Nenin 19 të këtij ligji duke publikuar në në dokumentin informues të kripto-asetit, ose në një dokument informues të ndryshuar, informacion që nuk është i plotë, i drejtë ose i qartë, ose është keqorientues, dhe se mbështetja në atë informacion ka ndikuar në vendimin e zotëruesit për të blerë, shitur ose shkëmbyer atë token të asetit.
4. Emetuesi dhe anëtarët e strukturës së tij drejtuese, administrative ose mbikëqyrëse nuk do të jenë përgjegjës për humbje të pësuar si rezultat i mbështetjes në informacionin e dhënë në një përmbledhje sipas Nenit 19, përfshirë çdo përkthim të saj, përveç rasteve kur kur përmbledhja:

   (a) Është keqorientuese, e pasaktë ose e papërputhshme kur lexohet së bashku me pjesët e tjera të dokumentit informues të kripto-asetit; ose

   (b) Në rastet kur lexohet së bashku me pjesët e tjera të dokumentit informues të kripto-asetit, nuk ofron, informacion thelbësor për të ndihmuar zotëruesit e mundshëm në vendimmarrjen për blerjen e tokenit të asetit.

5. Ky nen aplikohet krahas çdo përgjegjësie tjetër civile sipas legjislacionit në fuqi.

Seksioni 2:
Detyrimet e emetuesve të tokenave të asetit

Neni 27

Detyrimi për të vepruar me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm në interesin më të mirë të zotëruesve të tokenave të asetit

1. Emetuesit e tokenave të asetit veprojnë me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm dhe komunikojnë me zotëruesit dhe zotëruesit e mundshëm të tokenave të asetit në mënyrë të drejtë, të qartë dhe jo-keqorientuese .
2. Emetuesit e tokenave të asetit veprojnë në interesin më të mirë të zotëruesve të këtyre tokenave dhe i trajtojnë ata në mënyrë të barabartë, përveç rasteve kur një trajtim preferencial është bërë i ditur në dokumentin informues të kripto-asetit ose në materialet promovuese, në rastet kur është e aplikueshme.

Neni 28

Publikimi i dokumentit informues të kripto-asetit

Emetuesi i një tokeni të asetit publikon në faqen e tij të internetit dokumentin informues të miratuar të kripto-asetit,sipas përcaktimeve të Nenit 17, pika 1 ose nenit 21, pika 1 të këtij ligji dhe dokumentin informues te ndryshuar r të kripto-asetit, sipas përcaktimeve të nenit 25 të këtij ligji, në rastet kur është e aplikueshme. Dokumenti informues i miratuar duhet të jetë i aksesueshëm nga publiku publikisht nga data e fillimit të ofertës ndaj publikut të tokenit të asetit ose pranimit të tij për tregtim. Dokumenti informues i miratuar dhe, kur është e aplikueshme, dokumenti informues i ndryshuar i kripto-asetit mbeten të disponueshme në faqen e internetit të emetuesit për aq kohë sa tokeni i asetit zotërohet nga publiku.

Neni 29

Veprimtaritë promovuese

1. Çdo material promovues që lidhet me një ofertë ndaj publikut të një tokeni të asetit, ose me pranimin për tregtim të atij tokeni të asetit, përmbush të gjitha kërkesat e mëposhtme:
   a) materialet promovuese duhet të jenë qartësisht të identifikueshme si të tilla;
   b) informacioni në materialet promovuese është i drejtë, i qartë dhe jo keqorientues;
   c) informacioni në materialet promovuese është në përputhje me informacionin në

dokumentin informues të kripto-asetit;

d) materialet promovuese deklarojnë qartë se është publikuar një dokument informues i kripto-asetit dhe tregojnë qartë adresën e faqes së internetit të emetuesit të tokenit të asetit, si dhe një numër telefoni dhe adresë emaili për të kontaktuar emetuesin.

2. Materialet promovuese përmbajnë një deklaratë të qartë se zotëruesit e tokenit të asetit kanë të drejtë tërheqjeje nga emetuesi në çdo kohë.
3. Materialet promovuese dhe çdo ndryshim i tyre publikohen në faqen e internetit të emetuesit.
4. Banka e Shqipërisë nuk kërkon miratim paraprak të materialeve promovuese përpara publikimit të tyre.
5. Materialet promovuese njoftohen tek Banka e Shqipërisë, sipas kërkesës.
6. Materialet promovuese nuk shperndahen përpara publikimit të dokumentit informues të kripto-asetit. Ky kufizim nuk ndikon në aftësinë e emetuesit të tokenit të asetit për të kryer testime/sondazhe të tregut.

Neni 30

Informacioni i vazhdueshëm për zotëruesit e tokenave të asetit

1. Emetuesit e tokenave të asetit deklarojnë në mënyrë të qartë, të saktë dhe transparente, në një vend publik dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit, sasinë e tokenave të asetit në qarkullim, si dhe vlerën dhe përbërjen e rezervës së aseteve, sipas përcaktimeve të nenit 36 të këtji ligji. Ky informacion përditësohet të paktën një herë në muaj.
2. Emetuesit e tokenave të asetit publikojnë sa më shpejt që të jetë e mundur, në një vend publik dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit, një përmbledhje të shkurtër, të qartë, të saktë dhe transparente të raportit të auditimit, si dhe raportin e plotë dhe të paredaktuar të auditimit, në lidhje me rezervën e aseteve, sipas përcaktimeve ç përmendet ntë Nenit 36 të këtij ligjit.
3. Krahas Nenit 88, emetuesit e tokenave të asetit deklarojnë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në mënyrë të qartë, të saktë dhe transparente, në një vend publik dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit, çdo ndodhi që ka ose mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në vlerën e tokenave të asetit ose në rezervën e aseteve, sipas përcaktimeve të nenit 36 të këtij ligji.

Neni 31

Procedurat për trajtimin e ankesave

1. Emetuesit e tokenave të asetit hartojnë dhe implementojnë procedura efektive dhe transparente për trajtimin e shpejtë, të drejtë dhe të njëtrajtshëm të ankesave të marra nga zotëruesit e tokenave të asetit dhe palët e tjera të interesuara, përfshirë shoqatat e konsumatorëve që përfaqësojnë zotëruesit e tokenave të asetit, dhe publikojnë përshkrime të këtyre procedurave. Në rastet kur tokenat e asetit shpërndahen, plotësisht ose pjesërisht, nga

palë të treta, sipas përcaktimeve të nenit 34, pika 5,shkronja (h), emetuesit e tokenave të asetit krijojnë procedura për të lehtësuar gjithashtu trajtimin e ankesave midis zotëruesve të tokenave të asetit dhe këtyre palëve të treta.

2. Zotëruesit e tokenave të asetit kanë mundësi të paraqesin ankesa pa pagesë tek emetuesit e tokenave të tyre të asetit ose, kur është e aplikueshme, tek palët e treta sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.
3. Emetuesit e tokenave të asetit dhe, kur është e aplikueshme, palët e treta sipas pikës 1 të këtij neni, hartojnë dhe u vendosin në dispozicion zotëruesve të tokenave të asetit një format për paraqitjen e ankesave dhe mbajnë një regjistër të të gjitha ankesave të depozituara si dhe të çdo mase të ndërmarrë në kuadër të trajtimit të tyre.
4. Emetuesit e tokenave të asetit shqyrtojnë të gjitha ankesat në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë dhe të komunikojnë rezultatet e këtyre hetimeve tek zotëruesit e tokenave të tyre të asetit brenda një periudhe të arsyeshme.
5. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara, lidhur me formatet standardedhe procedurat për trajtimin e ankesave

Neni 32

Identifikimi, parandalimi, menaxhimi dhe publikimi i konfliktit të interesit

1. Emetuesit e tokenave të asetit hartojnë dhe implementojnë politika dhe procedura efektive për të identifikuar, parandaluar, menaxhuar dhe publikuar konfliktet e interesit midis tyre dhe:
   a) aksionerëve ose anëtarëve të tyre;
   b) çdo aksioneri ose anëtari, qoftë direkt ose indirekt, që ka një pjesëmarrje influencuese në emetues;
   c) anëtarëve të organit drejtues;
   d) punonjësve të tyre;
   e) zotëruesve të tokenave të asetit; ose
   f) çdo palë të tretë që ofron një nga funksionet e përcaktuara në Nenin 34, pika 5, shkronja h .
2. Emetuesit e tokenave të asetit duhet, të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të identifikuar, parandaluar, menaxhuar dhe zbuluar konfliktet e interesit që lindin nga menaxhimi dhe investimi i rezervës së aseteve, sipas përcaktimeve të Nenit 36 të këtij ligji.
3. Emetuesit e tokenave të asetit vendosin në një vend të dukshëm në faqen e tyre të internetit, natyrën dhe burimet e përgjithshme të konflikteve të interesit të përcaktuara në pikën 1 dhe hapat e ndërmarra për t'i adresuar ato.
4. Publikimi sipas pikës 3 të këtij neni duhet të jetë mjaftueshëm e saktë për të mundësuar që zotëruesit e mundshëm të tokenave të të asetit të marrin një vendim të informuar për blerjen e tokenave të asetit.
5. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara në lidhje me

përmbajtjen e procedurave dhe politikave të konfliktit të interesit dhe metodologjinë për përmbajtjen e publiikimit të konfliktit të interesit.

Neni 33

Njoftimi i ndryshimeve në organin drejtues

Emetuesit e tokenave të asetit njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim në organin drejtues dhe i pëërcjellin asaj të gjithë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar përputhshmërinë me këërkesat e nenit 34, pika 2 tëë këëtij ligji.

Neni 34

Politikat e qeverisjes

1. Emetuesit e tokenave të asetit kanë struktura të forta qeverisjeje, përfshirë një strukturë të qartë organizative me linja përgjegjësie të mirëpërcaktuara, transparente dhe të qëndrueshme, procese efektive për të identifikuar, menaxhuar, monitoruar dhe raportuar rreziqet ndaj të cilave janë ose mund të jenë të ekspozuar, si dhe mekanizma të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm, përfshirë këtu procedura administrative dhe të kontabilitetit.
2. Anëtarët e organit drejtues të emetuesit të tokenit të asetit janë me reputacion të mirë dhe kanë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e duhur, individualisht dhe në mënyrë kolektive, për të përmbushur detyrat e tyre. Në veçanti, anëtarët e organit drejtues të të emetuesit të tokenit të asetit nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, financimin e armëve të shkatërrimit në masë ose për vepra të tjera që do të ndikonin në reputacionin e tyre të mirë. Ata duhet gjithashtu të dëshmojnë se janë të aftë të angazhohen me kohë të mjaftueshme për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive.
3. Organi drejtues iemetuesve të tokenave të asetit vlerëson dhe rishikon periodikisht efektivitetin e politikave, strukturave dhe procedurave të vendosura për të përmbushur kërkesat e Seksionit II, III, V dhe VI të këtij Kreu dhe merr masa të përshtatshme për të adresuar çdo mangësi në këtë drejtim.
4. Aksionerët ose anëtarët, qoftë direkt ose indirekt, që kanë pjesëmarrje influencuese në emetuesit e tokenave të asetit, kanë reputacion të mirë dhe, në veçanti, nuk janë dënuar për vepra penale që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, financimin e armëve të shkatërrimit në masë, apo për ndonjë vepër tjetër që do të ndikonte në reputacionin e tyre të mirë.
5. Emetuesit e tokenave të asetit miratojnë politika dhe procedura që janë mjaftueshëm efektive për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj. Në veçanti, ata krijojnë, mirëmbajnë dhe zbatojnë politika dhe procedura mbi:

    (a) Rezervën e aseteve, siç përmendet në nenin 36;

(b) Kujdestarinë e aseteve rezervë, përfshirë ndarjen e aseteve, siç specifikohet në nenin 37;

(c) Të drejtat e garantuara për zotëruesit e tokenave të asetit, siç specifikohet në nenin 39;

(d) Mekanizmin përmes të cilit emetohen dhe tërhiqen tokenat e asetit;

(e) Protokollet për dakordësimin e transaksioneve në tokenat e asetit;

(f) Funksionimin e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë në pronësi të emetuesve, kur tokenat e asetit emetohen, transferohen dhe ruhen duke përdorur teknologjinë e tillë të regjistrave të shpërndarë ose teknologji të ngjashme që operohet nga emetuesit ose një palë e tretë që vepron në emër të tyre;

(g) Mekanizmat për të siguruar likuiditetin e tokenave të asetit, përfshirë politikat dhe procedurat e menaxhimit të likuiditetit për emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë, siç përmendet në nenin 45;

(h) Marrëveshjet me entitetet e palës së tretë për operimin e rezervës së aseteve, për investimin e aseteve rezervë, kujdestarinë e aseteve rezervë dhe, kur është e aplikueshme, shpërndarjen e tokenave të asetit tek publiku;

(i) Miratimin me shkrim të emetuesve të tokenave të asetit dhënë personave të tjerë që mund të ofrojnë ose të kërkojnë pranimin për tregtim të tokenave të asetit;

(j) Trajtimin e ankesave, siç specifikohet në nenin 31;

(k) Konfliktet e interesit, siç specifikohet në nenin 32.

Në rastet kur emetuesit e tokenave të asetit hyjnë në marrëveshje të përcaktuara në shkronjën h të kësaj pike, këto marrëveshje materializohen në një kontratë me palët e treta. Marrëveshjet kontraktuale përcaktojnë rolet, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e emetuesve të tokenave të asetit dhe të entiteteve të palës së tretë. Çdo marrëveshje mes këtyre palëve e cila përmban çështje ndër juridiksionale duhet të ketënjë zgjedhje të qartë të ligjit të zbatueshëm.

6. Përveç rasteve kur kanë njoftuar një plan të shlyerjes, sipas përckatimeve të nenit 47, emetuesit e tokenave të asetit përdorin sisteme, burime dhe procedura të përshtatshme dhe proporcionale për të siguruar kryerjen e vazhdueshme dhe të rregullt të shërbimeve dhe aktiviteteve të tyre. Për këtë qëllim, emetuesit e tokenave të asetit mirëmbajnë të gjitha sistemet dhe protokollet e sigurisë së aksesit në përputhje me standardet e përshtatshme të Bashkimit Evropian.
7. Në rastet kur emetuesi i një tokeni të asetit vendos të ndërpresë ofrimin e shërbimeve dhe

veprimtarisë së tij, përfshirë ndalimin e emetimit të tokenit të asetit, ai harton dhe dorëzon planin e ndërprerjes për miratim nga Banka e Shqipërise

8. Emetuesit e tokenave të asetit identifikojnë burimet e rrezikut operacional dheminimizojnë këto rreziqe përmes zhvillimit të sistemeve, kontrolleve dhe procedurave të përshtatshme.
9. Emetuesit e tokenave të asetit krijojnë një politikë dhe plane për vazhdimësinë e biznesit për të siguruar, në rast të një ndërprerjeje të sistemeve dhe procedurave të tyre TIK, ruajtjen e të dhënave dhe funksioneve thelbësore dhe vazhdimin e aktiviteteve të tyre ose, kur kjo nuk është e mundur, rikuperimin e shpejtë të këtyre të dhënave dhe funksioneve dhe rifillimin e shpejtë të veprimtarisë.
10. Emetuesit e tokenave të asetit kanë mekanizma të kontrollit të brendshëm dhe procedura efektive për menaxhimin e rrezikut, përfshirë kontrolle dhe masa mbrojtëse efektive për menaxhimin e sistemeve TIK. Procedurat përfshijnë një vlerësim gjithëpërfshirës lidhur me mbështetjen tek entitetet e palës së tretë, siç përmendet në pikën 5, gërma h) e këtij neni. Emetuesit e tokenave të asetit monitorojnë dhe të vlerësojnë rregullisht përshtatshmërinë dhe efektivitetin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të procedurave të vlerësimit të rrezikut dhe të marrin masa të përshtatshme për të adresuar çdo mangësi në këtë drejtim.
11. Emetuesit e tokenave të asetit kanë sisteme dhe procedura të përshtatshme për të siguruar disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave, në përputhje me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto sisteme regjistrojnë dhe ruajnë të dhënat dhe informacionet përkatëse të mbledhura gjatë aktivitetit të emetuesve.
12. Emetuesit e tokenave të asetit sigurojnë që ata të auditohen rregullisht nga auditues të pavarur. Rezultatet e këtyre auditimeve i komunikohen strukturës drejtuese të emetuesit përkatës dhe janëë të disponueshme përBankën e Shqipërisë.
13. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara në lidhje me standardet dhe përmbajtjen e sistemeve, kontrolleve dhe procedurave për rreziqet operacionale, planin e vazhdimësisë së biznesit, mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe auditit.

Neni 35

Kërkesat për fondet e veta

1. Emetuesit e tokenave të asetit duhet të sigurojnë një nivel të fondeve të veta, të cilat duhet të jetë në çdo kohë jo më të ulëta se vlera më e lartë e cilësdo prej shumave të mëposhtme:

   (a) 350 000 EUR;

   (b) 2% e vlerës mesatare të rezervës së aseteve, sipas përcaktimeve të nenit 36;

   (c) Një çerek i kostove fikse të vitit të kaluar.

   Për qëllimet e shkronjës (b) të kësaj pike, vlera mesatare e rezervës së aseteve nënkupton

vlerën mesatare të aseteve rezervë në fund të çdo dite kalendarike, e llogaritur gjatë gjashtë muajve të mëparshëm.

Në rastet kur një emetues ofron ndaj publikut më shumë se një token aseti, vlera e përcaktuar në shkronjën (b) do të jetë shuma e aseteve rezervë që mbështesin secilin token aseti.

Vlera e përcaktuar në shkronjën (c) të kësaj pike rishikohet çdo vit dhe llogaritet në përputhje me Nenin 67 pika 3 të këtij ligji.

2. Fondet e veta të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni përbëhen nga elementet dhe instrumentet e kapitalit të bazë të nivelit të parë, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të miratuara nga Banka e Shqipërisë, pas zbritjeve nga kapitali bazë i nivelit të parë.
3. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë nga një emetues i një tokeni të asetit të mbajë një shumë të fondeve të veta deri në 20% më të lartë se shuma që rezulton nga zbatimi i pikës 1, shkronja (b) të këtij neni, , në rastet kur vlerësimi i ndonjërit prej elementëve të mëposhtëm rezulton në tregues të një shkalle më të lartë rreziku:

(a) Vlerësimi i proceseve të menaxhimit të rrezikut dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm të emetuesit të tokenit të asetit, sipas përcaktimeve të nenit 34(1), (8) dhe (10);

(b) Cilësia dhe paqëndrueshmëria e rezervës së aseteve, sipas përcaktimeve të nenit 36;

(c) Llojet e të drejtave të garantuara nga emetuesi i tokenit të asetit për zotëruesit e tokenit të asetit, në përputhje me Nenin 39;

(d) Rreziqet e paraqitura nga politika e investimeve për rezervën e aseteve, në rastet kur rezerva e aseteve përfshin investime;

(e) Vlera agregate dhe numri i transaksioneve të përfunduara në tokenin e asetit;

(f) Rëndësia e tregjeve në të cilat ofrohet dhe promovohet tokeni i asetit;

(g) Kapitalizimi i tregut të tokenit të asetit, në rastet kur është e aplikueshme,.

4. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë nga një emetues i një tokeni të asetit që nuk ka rëndësi të lartë të përmbushë çdo kërkesë të përcaktuar në Nenin 45, kur është e nevojshme për të adresuar shkallën më të lartë të rreziqeve të identifikuara në përputhje me pikën 3 të këtij Neni, ose ndonjë rrezik tjetër që synon të adresojë Neni 45, si për shembull rreziqet e likuiditetit.
5. Krahas parashikimeve të pikës 3, emetuesit e tokenave të asetit kryejnë rregullisht testime të rezistencës që marrin parasysh skenarët e stresit financiar, si tronditjet e normave të interesit, dhe skenarët e stresit jo-financiar, si rreziku operacional. Bazuar në rezultatet e këtyre testimeve të rezistencës , Banka e Shqipërisë mund të kërkojë nga emetuesi i

tokenit të asetit të mbajë një shumë të fondeve të veta që është ndërmjet 20% dhe 40% më e lartë se shuma që rezulton nga zbatimi i pikës 1, shkronja (b), në rrethana të caktuara, duke pasur parasysh perspektivën e rrezikut dhe rezultatet e testimit të rezistencës.

6. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara në lidhje me:

(a) procedura dhe afatet për një emetues të tokenit të asetit që të përshtatet me kërkesat më të larta për fondet e veta, siç parashikohet në pikën 3;

(b) kriteret për kërkimin e një shume më të lartë të fondeve të veta, siç parashikohet në pikën 3;

(c) kërkesat minimale për projektimin e programeve të testimit të rezistencës, duke marrë parasysh madhësinë, kompleksitetin dhe natyrën e tokenit të asetit, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

(i) llojet e testimit të rezistencës dhe objektivat e tyre kryesore dhe fushat e zbatimit;

(ii) shpeshtësinë e ushtrimeve të ndryshme të testimit të rezistencës;

(iii) rregullimet e qeverisjes së brendshme;

(iv) infrastrukturën përkatëse të të dhënave;

(v) metodologjinë dhe besueshmërinë e supozimeve;

(vi) zbatimin e parimit të proporcionalitetit për të gjitha kërkesat minimale, qofshin ato sasiore apo cilësore;

(vii) periodicitetin minimal të testeve të rezistencës dhe parametrat e përbashkët referues të skenarëve të testimit të rezistencës.

Seksioni 3:
Rezerva e aseteve

Neni 36

Detyrimi për të pasur një rezervë asetesh, si dhe përbërja dhe menaxhimi i saj

1. Emetuesit e tokenave të asetit krijojnë dhe të mirëmbajnë gjithmonë një rezervë asetesh.

Rezerva e aseteve përbëhet dhe menaxhohet në atë mënyrë që:

(a) Rreziqet e lidhura me asetet e referuara nga tokenat e asetit të jenë të mbuluara; dhe

(b) Rreziqet e likuiditetit të lidhura me të drejtat e përhershme të tërheqjes së zotëruesve të adresohen.

2. Rezerva e aseteve veçohet ligjërisht nga pasuria e emetuesve, si dhe nga rezerva e aseteve të tokenave të tjera të asetit, në interes të zotëruesve të tokenave të asetit në përputhje me ligjin e zbatueshëm, në mënyrë që kreditorët e emetuesve të mos kenë të drejtë të kërkojnë akses në rezervën e aseteve, veçanërisht në rast falimenti.
3. Emetuesit e tokenave të asetit sigurojnë që rezerva e aseteve të veçohet operacionalisht nga pasuria e tyre, si dhe nga rezerva e aseteve të tokenave të tjera.
4. Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara në lidhje me kërkesat për likuiditet, duke marrë në konsideratë madhësinë, kompleksitetin dhe llojin e rezervave të aseteve dhe tokenit të asetit në vetvete. Këto rregulla duhet të përcaktojnë të paktën:
   (a) përqindjen përkatëse e rezervës së aseteve sipas maturimeve ditore, përfshirë përqindjen e marrëveshjeve të riblerjes së kundërt (reverse repo) që mund të zgjidhen me njoftim paraprak prej një dite pune, ose përqindjen e parave të gatshme që mund të tërhiqen me njoftim paraprak prej një dite pune;
   (b) përqindja përkatëse e rezervës së aseteve sipas maturimeve javore, përfshirë përqindjen e marrëveshjeve të riblerjes së kundërt (reverse repo) që mund të zgjidhen me njoftim paraprak prej pesë ditësh pune, ose përqindjen e parave të gatshme që mund të tërhiqen me njoftim paraprak prej pesë ditësh pune;
   (c) maturime të tjera përkatëse dhe teknikat e përgjithshme të administrimit të likuiditetit;
   (d) shumat minimale në secilën valutë të referuar që do të mbahen si depozita në institucione krediti, të cilat nuk mund të jenë më të ulëta se 30 % e shumës së referuar në secilën valutë.

5. Emetuesit që ofrojnë dy ose më shumë tokena të asetit ndaj publikut operojnë dhe të mirëmbajnë rezerva të veçanta për secilin token të asetit, të cilat manaxhohen veçmas.
   Kur emetues të ndryshëm të tokenave të asetit ofrojnë të njëjtin token të asetit ndaj publikut, këta emetues operojnë dhe të mirëmbajnë vetëm një rezervë të aseteve për atë token të asetit.
6. Organet drejtuese të emetuesve të tokenave të asetit sigurojnë menaxhimin efektiv dhe të kujdesshëm të rezervës së aseteve. Emetuesit sigurojnë që emetimi dhe tërheqja e tokenave të asetit gjithmonë të shoqërohet nga një rritje ose ulje përkatëse në rezervën e aseteve.
7. Emetuesi i një tokeni të asetit përcakton vlerën totale të rezervës së aseteve duke përdorur çmimet e tregut. Vlera totale e saj është të paktën e barabartë me vlerën totale të kërkesave kundër emetuesit nga zotëruesit e tokenit të asetit në qarkullim.
8. Emetuesit e tokenave të asetit kanë një politikë të qartë dhe të detajuar që përshkruan mekanizmin e stabilizimit të këtyre tokenave. Kjo politikë përfshin në veçanti:

(a) Listën e aseteve të referuara nga tokenat e asetit dhe përbërjen e atyre aseteve;

(b) Përshkrimin e llojit të aseteve dhe alokimin e saktë të aseteve që përfshihen në rezervën e aseteve;

(c) Një vlerësim të detajuar të rreziqeve, përfshirë rrezikun e kreditit, rrezikun e tregut, rrezikun e përqendrimit dhe rrezikun e likuiditetit që rezulton nga rezerva e aseteve;

(d) Përshkrimin e procedurës me të cilën tokenat e asetit emetohen dhe tërhiqen, si dhe procedurën me të cilën emetimi dhe tërheqja sjell një rritje dhe ulje përkatëse të rezervës së aseteve;

(e) Të specifikojë nëse një pjesë e rezervës së aseteve investohet, siç parashikohet në Nenin 38;

(f) Kur emetuesit e tokenave të asetit investojnë një pjesë të rezervës së aseteve, siç parashikohet në Nenin 38, të përshkruajnë në detaje politikën e investimeve dhe të përmbajë një vlerësim të ndikimit të kësaj politike mbi vlerën e rezervës së aseteve;

(g) Përshkrimin e procedurës për blerjen e tokenave të asetit dhe për tërheqjen e tyre nga rezerva e aseteve, dhe listën e personave ose kategorive të personave që kanë të drejtë ta bëjnë këtë.

9. Krahas Nenit 34(12), emetuesit e tokenave të asetit kryejnë një auditim të pavarur të rezervës së aseteve çdo gjashtë muaj, për të vlerësuar përputhshmërinë me rregullat e këtij Kreu, që nga data e autorizimit të tyre sipas Nenit 21 ose që nga data e miratimit të dokumentit informues të kripto-asetit sipas Nenit 17.
10. Emetuesi njofton Bankën e Shqipërisë për rezultatet e auditimit të përcaktuar në pikën 9 pa vonesa, dhe në çdo rast jo më vonë se gjashtë javë nga data e referimit të vlerësimit. Emetuesi publikon rezultatet e auditimit brenda dy javëve nga data e njoftimit të Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë mund të udhëzojë një emetues të shtyjë publikimin e rezultateve të auditimit nëse:

(a) Emetuesi është urdhëruar të zbatojë një plan rimëkëmbjeje ose masa, sipas Nenit 46(3);

(b) Emetuesi është urdhëruar të zbatojë një plan të tërheqjes, sipas Nenit 47;

(c) Kjo konsiderohet e nevojshme për të mbrojtur interesat ekonomike të zotëruesve të tokenit të asetit;

(d) Kjo konsiderohet e nevojshme për të shmangur një ndikim negativ të rëndësishëm në sistemin financiar të shtetit të origjinës ose të një shteti tjetër.

11. Vlerësimi me çmimet e tregut, siç përmendet në pikën 7 të këtij Neni, bëhet duke përdorur metodën “mark-to-market”, në rastet kur është e mundur.

Kur përdoret vlerësimi “mark-to-market”, rezerva e aseteve vlerësohet në anën më të kujdesshme të ofertës dhe kërkesës, përveç nëse rezervat mund të mbyllen në mes të tregut. Përdoren vetëm të dhëna të cilësisë së mirë të tregut, dhe të dhënat vlerësohen bazuar në faktorët e mëposhtëm:

(a) Numri dhe cilësia e kundërpalëve;

(b) Volumi dhe qarkullimi në treg i rezervës së aseteve;

(c) Madhësia e rezervës së aseteve.

12. Kur përdorimi i "mark-to-market", siç përmendet në pikën 11 të këtij Neni, nuk është i mundur ose të dhënat e tregut nuk janë të cilësisë së mjaftueshme, rezerva e aseteve vlerësohet në mënyrë konservative duke përdorur metodën "mark-to-model".

Modeli vlerëson saktësisht vlerën e brendshme të rezervës së aseteve, bazuar në faktorët kyç të përditësuar si më poshtë:

(a) Volumi dhe qarkullimi në treg i atij aseti rezervë ;

(b) Madhësia e rezervës së aseteve;

(c) Rreziku i tregut, rreziku i normave të interesit dhe rreziku i kreditit i lidhur me rezervën e aseteve.

Në rastet kur përdoret "mark-to-model", metoda e kostos së amortizuar nuk përdoret.

Neni 37

Kujdestaria e rezervës së aseteve

1. Emetuesit e tokenave të asetit hartojnë dhe implementojnë politika, procedura dhe marrëveshje kontraktuale për kujdestarinë të cilat sigurojnë sigurojnë në çdo kohë se:

(a) Asetet rezervë nuk janë të ngarkuara me barrë apo të lëna si kolateral financiar, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për sistemet e pagesave;

(b) Asetet rezervë mbahen në kujdestari, në përputhje me pikën 6 të këtij Neni;

(c) Emetuesit e tokenave të asetit kanë akses të shpejtë në asetet rezervë për të përmbushur çdo kërkesë për tërheqje nga zotëruesit e tokenave të asetit;

(d) Shmanget përqendrimi i kujdestarëve të aseteve rezervë;

(e) Shmanget rreziku i përqendrimit të aseteve rezervë.

2. Emetuesit e tokenave të asetit të cilët emetojnë dy ose më shumë tokena të asetit kanë një politikë të veçantë për kujdestarinë për secilën rezervë të aseteve. Emetues të ndryshëm të

tokenave të asetit që kanë emetuar të njëjtin token aseti mbajnë dhe operojnë një politikë të vetme për kujdestarinë.

3. Asetet rezervë mbahen në kujdestari jo më vonë se pesë ditë pune pas datës së emetimit të tokenit të asetit nga një ose më shumë prej subjekteve të mëposhtme:

(a) Një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve që ofron kujdestarinë dhe administrimin e kripto-aseteve për llogari të klientëve, kur asetet rezervë janë në formë kripto-asetesh;

(b) Një institucion krediti, për të gjitha llojet e aseteve rezervë;

(c) Një shoqëri komisionere që ofron shërbimin ndihmës të ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare për llogari të klientëve, kur asetet rezervë janë në formë instrumentesh financiare.

4. Emetuesit e tokenave të asetit ushtrojnë aftësi, kujdes dhe vëmendje të duhur gjatë përzgjedhjes, emërimit dhe rishikimit të ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit dhe shoqërive komisionere të emëruara si kujdestarë të aseteve rezervë, siç përmendet në pikën 3. Kujdestari është një subjekt juridik i ndryshëm nga emetuesi.

Emetuesit e tokenave të asetit sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, institucionet e kreditit dhe shoqëritë komisionere të emëruara si kujdestarë të aseteve rezervë, siç përmendet në pikën 3, kanë ekspertizën dhe reputacionin e nevojshëm në treg për të vepruar si kujdestarë të këtyre aseteve rezervë, duke marrë parasysh praktikat kontabël, procedurat e ruajtjes dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm të këtyre subjekteve. Marrëveshjet kontraktuale ndërmjet emetuesve të tokenave të asetit dhe kujdestarëve sigurojnë që asetet rezervë të mbajtura në kujdestari të mbrohen kundër kërkesave të kreditorëve të kujdestarëve.

5. Politikat dhe procedurat e kujdestarisë të përcaktuara në pikën 1 përcaktojnë kriteret e përzgjedhjes për emërimin e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit ose shoqërive komisionere si kujdestarë të aseteve rezervë dhe procedurën për rishikimin e këtij emërimi.

Emetuesit e tokenave të asetit rishikojnë rregullisht emërimin e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit ose shoqërive komisionere si kujdestarë të aseteve rezervë. Për qëllime të këtij rishikimi, emetuesit e tokenave të asetit vlerësojnë ekspozimin e tyre ndaj këtyre kujdestarëve, duke marrë parasysh të gjithë spektrin e marrëdhënieve të tyre me ta dhe të monitorojnë kushtet financiare të këtyre kujdestarëve në mënyrë të vazhdueshme.

6. Kujdestarët e aseteve rezervë të përcaktuar në pikën 4 sigurojnë që kujdestaria e këtyre aseteve rezervë të kryhet në mënyrën e mëposhtme:

(a) Institucionet e kreditit mbajnë në kujdestari fondet në një llogari të hapur në regjistrat e tyre;

(b) Për instrumentet financiare që mund të mbahen në kujdestari, institucionet e kreditit ose shoqëritë komisionere mbajnë në kujdestari të gjitha instrumentet financiare që mund të regjistrohen në një llogari të instrumenteve financiare të hapur në regjistrat e tyre ose të dorëzohen fizikisht tek këto institucione krediti ose shoqëri komisionere;

(c) Për kripto-asetet që mund të mbahen në kujdestari, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve mbajnë në kujdestari kripto-asetet e përfshira në rezervën e aseteve, ose kur është e aplikueshme mjetet e aksesit në formën e çelësave kriptografikë privatë në ato kripto-asete;

(d) Për asete të tjera, institucionet e kreditit verifikojnë pronësinë e emetuesve të tokenave të asetit dhe të mbajnë një regjistër të këtyre aseteve rezervë për të cilat janë të bindur se emetuesit e tokenave të asetit zotërojnë këto asete rezervë.

Për qëllime të shkronjës (a) të kësaj pike, institucionet e kreditit sigurojnë që fondet të regjistrohen në regjistrat e tyre në një llogari të veçuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Kjo llogari hapet në emër të emetuesit të tokenave të asetit për qëllimet e administrimit të rezervës së aseteve për çdo token aseti, në mënyrë që fondet e mbajtura në kujdestari të identifikohen qartë si pjesë e secilës rezervë të aseteve.

Për qëllime të shkronjës (b) të kësaj pike, institucionet e kreditit dhe shoqëritë komisionere sigurojnë që të gjitha instrumentet financiare të regjistrohen në regjistrat e tyre në llogari të veçuara, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për tregjet kapitale. Llogaria e instrumenteve financiare hapet në emër të emetuesve të tokenave të asetit për qëllimet e menaxhimit të rezervës së aseteve për çdo token aseti, në mënyrë që instrumentet financiare të mbajtura në kujdestari të identifikohen qartë si pjesë e secilës rezervë të aseteve.

Për qëllime të shkronjës (c) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve hapin një regjistër të pozicioneve në emër të emetuesve të tokenave të asetit për qëllimet e menaxhimit të rezervës së aseteve për çdo token aseti, në mënyrë që kripto-asetet e mbajtura në kujdestari të identifikohen qartë si pjesë e secilës rezervë të aseteve.

Për qëllime të shkronjës (d) të kësaj pike, vlerësimi nëse emetuesit e tokenave të asetit zotërojnë asetet rezervë bazohet në informacionin ose dokumentet e siguruara nga emetuesit e tokenave të asetit dhe, kur janë të disponueshme, në dëshmi të jashtme.

7. Emërimi i ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit ose shoqërive komisionere si kujdestarë të aseteve rezervë, siç përmendet në pikën 4 të këtij Neni, provohet nga një marrëveshje kontraktuale, sipas përcaktimeve të nenit 34, pika 5. Këto marrëveshje kontraktuale rregullojnë ndër të tjera rrjedhën e informacionit të nevojshëm për të mundësuar që emetuesit e tokenave të asetit dhe ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, institucionet e kreditit dhe shoqëritë komisionere të përmbushin funksionet e tyre si kujdestarë.
8. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, institucionet e kreditit dhe shoqëritë komisionere të

emëruara si kujdestarë në përputhje me pikën 4 veprojnë në mënyrë të ndershme, të drejtë, profesionale, të pavarur dhe në interes të emetuesve të tokenave të asetit dhe zotëruesve të tyre.

9. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, institucionet e kreditit dhe shoqëritë komisionere të emëruara si kujdestarë në përputhje me pikën 4 nuk kryejnë veprimtari që mund të krijojnë konflikte interesi mes emetuesve të tokenave të asetit, zotëruesve të tyre dhe vetë tyre, përveç nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, institucionet e kreditit ose shoqëritë komisionere kanë ndarë funksionalisht dhe në mënyrë hierarkike kryerjen e detyrave të kujdestarisë nga detyrat që mund të jenë në konflikt interesi;

(b) Konfliktet e mundshme të interesit janë identifikuar, monitoruar, menaxhuar dhe adresuar siç duhet nga emetuesit e tokenave të asetit për zotëruesit e tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 32.

10. Në rast të humbjes së një instrumenti financiar ose një kripto-aseti të mbajtur në kujdestari, sipas pikës 6 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve, institucioni i kreditit ose shoqëria komisionere që ka humbur atë instrument financiar ose kripto-aset kompenson, ose të bëjë kthimin, te emetuesi i tokenit të asetit me një instrument financiar ose kripto-aset të të njëjtit lloj ose vlerë përkatëse pa vonesa të panevojshme. Ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve, institucioni i kreditit ose shoqëria komisionere përkatëse nuk do të jetë përgjegjës për kompensim ose kthim nëse mund të provojë se humbja ka ndodhur si rezultat i një ngjarjeje të jashtme përtej kontrollit të tij të arsyeshëm, pasojat e së cilës ishin të paevitueshme pavarësisht të gjitha përpjekjeve të arsyeshme.

Neni 38

Investimi i rezervës së aseteve

1. Emetuesit e tokenave të asetit që investojnë një pjesë të rezervës së aseteve, i alokojnë këto asete vetëm në instrumente financiare me likuiditet të lartë, të cilat kanë rrezik minimal tregu, krediti dhe përqendrimi. Investimet janë të afta për t'u likuiduar në mënyrë të shpejtë dhe me një efekt minimal në çmim.
2. Kuotat në një sipërmarrje për investime kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT) do të konsiderohen si asete me rrezik minimal të tregut, kreditit dhe përqendrimit për qëllimet e pikës 1, në rastet kur SIKTT investon vetëm në asete sipas përcaktimeve të Bankës së Shqipërisë në përputhje me pikën 5 të këtij neni dhe në rastet kur emetuesi i tokenit të asetit siguron që rezerva e aseteve investohet në një lloj mënyre që minimizon rrezikun e përqendrimit.
3. Instrumentet financiare në të cilat investohet rezerva e aseteve mbahen në kujdestari në përputhje me Nenin 37.

4. Të gjitha fitimet ose humbjet, duke përfshirë luhatjet në vlerën e instrumenteve financiare të përcaktuara në pikën 1, dhe çdo rrezik i kundërpalës ose rrezik operacional që rezulton nga investimi i rezervës së aseteve do të mbarten nga emetuesi i tokenit të asetit.
5. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara, lidhur me instrumentet financiare të cilat konsiderohen me likuiditet të lartë dhe kanë rrezik minimal tregu, krediti dhe përqëndrimi, sipas përcaktimeve të pikës 1. Gjatë hartimit të këtyre rregullave, Banka e Shqipërisë merr në konsideratë:
    a) llojet e ndryshme të aseteve që mund të referohen nga një token i asetit;
    b) korrelacioni ndërmjet aseteve të referuara nga tokeni i asetit dhe instrumenteve financiare me likuiditet të lartë, në të cilat emetuesi mund të investojë;
    c) kërkesa për mbulim të likuiditetit, duke u bazuar në aktet nënligjore të miratuara nga Banka e Shqipërisë për raportin e mbulimit me likuiditet;
    d) kufizime të përqendrimit që parandalojnë emetuesin nga:
        i. investimi i më shumë se një përqindje e caktuar e rezervës së aseteve në instrumente financiare me likuiditet të lartë dhe me rrezik minimal tregu, krediti dhe përqendrimi, të emetuara nga i njëjti subjekt;
        ii. mbajtja në kujdestari e më shumë se një përqindje e caktuar e kripto-aseteve ose aseteve pranë ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve ose institucioneve të kreditit që i përkasin të njëjtit grup, ose pranë shoqërive komisionere.

Për qëllimet e shkronjës (d), nënpika (i), Banka e Shqipërisë përcakton pragje të përshtatshme për të përcaktuar kërkesat e përqendrimit. Këta kufij marrin në konsideratë, ndër të tjera, pragjet përkatëse të parashikuara në nenin 140 të legjislacionit për sipërmarrjet e investimeve kolektive.

Neni 39

E drejta e shlyerjes

1. Zotëruesit e tokenave të asetit kanë të drejtën e shlyerjes në çdo kohë kundrejt emetuesit dhe rezervës së aseteve, në rastet kur emetuesit e tokenit të aseteve nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre sipas përcaktimeve të seksionit 6 të këtij Kreu. Emetuesit hartojnë dhe implementojnë politika dhe procedura të qarta dhe të detajuara në lidhje me këtë të drejtë të përhershme të shlyerjes.
2. Me kërkesë të zotëruesit të një tokeni të asetit, emetuesi i atij tokeni realizon shlyerjen, ose duke paguar një shumë në fonde, të ndryshme nga paraja elektronike, e cila është e barabartë me vlerën e tregut të aseteve të referuara nga tokeni i asetit në zotërim, ose duke dorëzuar asetet e referuara nga tokeni. Emetuesit hartojnë politika dhe procedura për këtë të drejtë të përhershme të tërheqjes, duke përcaktuar:

(a) Kushtet, duke përfshirë pragjet, periudhat dhe afatet kohore, që zotëruesit e tokenave të asetit të ushtrojnë të drejtën e shlyerjes;

(b) Mekanizmat dhe procedurat për të siguruar shlyerjen e tokenave të asetit, përfshirë edhe në rrethana të luhatshmërisë së tregut, si dhe në kontekstin e zbatimit të planit të rimëkëmbjes të përcaktuar në Nenin 46 ose, në rastin e një shlyerje të rregullt të tokenave të asetit, sipas nenit 47;

(c) Vlerësimin, ose parimet e vlerësimit, të vlerës së tokenave të asetit dhe të aseteve rezervë në rastet kur ushtrohet e drejta e shlyerjes nga blerësi i tokenave të asetit, përfshirë edhe përmes përdorimit të metodologjisë së vlerësimit të përcaktuar në Nenin 36, pika 11 të këtij ligji;

(d) Kushtet për përfundimin e shlyerjes; dhe

(e) Masat që emetuesit marrin për të menaxhuar në mënyrë të përshtatshme rritjet ose uljet në rezervën e aseteve për të shmangur çdo ndikim negativ në tregun e aseteve rezervë.

Kur emetuesit, gjatë shitjes së një tokeni të asetit, pranojnë një pagesë në fonde të ndryshme nga paraja elektronike, të denominuar në një valutë zyrtare, ata ofrojnë gjithmonë një opsion për tërheqjen e tokenit në fonde të ndryshme nga paraja elektronike, të denominuar në të njëjtën valutë zyrtare.

3. Krahas parashikimeve të nenit 46, shlyerja e tokenave të asetit nuk do të jetë subjekt i komisioneve apo tarifave.

Neni 40

Ndalimi i dhënies së interesit

1. Emetuesit e tokenave të asetit nuk japin interes në lidhje me tokenat e asetit.
2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve nuk japin interes kur ofrojnë shërbime të lidhura me tokenat e asetit.
3. Për qëllimet e pikave 1 dhe 2, çdo shpërblim ose përfitim tjetër i lidhur me kohëzgjatjen e mbajtjes së tokenave të asetit nga një zotërues i tillë do të trajtohet si interes. Kjo përfshin kompensimin neto ose zbritjet, me një efekt të barazvlefshëm me atë të interesit të marrë nga zotëruesi i tokenave të asetit, drejtpërdrejt nga emetuesi ose nga palë të treta, dhe drejtpërdrejt të lidhur me tokenat e asetit ose nga shpërblimi apo çmimi i produkteve të tjera.

Seksioni 4:
Blerja e emetuesit të tokenave të asetit

Neni 41

Vlerësimi i blerjes të propozuar të emetuesve të tokenave të asetit

1. Çdo person fizik ose juridik, ose personat fizikë dhe juridikë që veprojnë në marrëveshje të përbashkët, të cilët kanë për qëllim të fitojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi (në vijim 'blerësi i propozuar'), një pjesëmarrje influencuese në një emetues të tokenit të asetit ose të rrisin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një pjesëmarrje të tillë influencuese në mënyrë që përqindja e të drejtave të votës ose e kapitalit të arrijë ose të kalojë 20%, 30% ose 50%, ose që emetuesi i tokenit të asetit të bëhet shoqëri bijë e tyre, njoftojnë me shkrim Bankën e Shqipërisë, duke dhënë informacion mbi madhësinë e pjesëmarrjes së synuar dhe informacionin e kërkuar sipas rregullores së nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në zbatim të nenit 42, pika 4.
2. Çdo person fizik ose juridik që ka marrë një vendim për të transferuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një pjesëmarrje influencuese në një emetues të tokenit të asetit, përpara transferimit të pjesëmarrjes duhet , të njoftojë me shkrim Bankën e Shqipërisë për vendimin e tij duke specifikuar madhësinë e pjesëmarrjes qëë do të transferohet. Ky person duhet gjithashtu të njoftojë Bankën e Shqipërisë nëse ka marrë një vendim për të ulur një pjesëmarrje influencuese në mënyrë që përqindja e të drejtave të votës ose e kapitalit të bjerë nën 10%, 20%, 30% ose 50%, ose që emetuesi i tokenit të asetit të ndalojë së qeni shoqëri bijë e atij subjekti.
3. Brenda dy ditëve punë nga marrja e njoftimit, Banka e Shqipërisë konfirmon marrjen e saj përmes mjeteve elektronike të komunikimit.
4. Brenda 60 ditëve pune nga data e konfirmimit sipas pikës 3 të këtij neni,Banka e Shqipërisë vlerëson blerjen e propozuar të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe informacionin e kërkuar nga standardet teknike rregullatore të miratuara në përputhje me nenin 42, pika 4. Me marrjen e njoftimit, Banka e Shqipërise njofron blerësin e propozuar në lidhje me afatet për përfundimin e periudhës së vlerësimit.
5. Gjatë kryerjes së vlerësimit sipas pikës 4, Banka e Shqipërisë mund të kërkojë nga blerësi i propozuar çdo informacion shtesë që është i nevojshëm për të përfunduar atë vlerësim. Kjo kërkesë bëhet para përfundimit të vlerësimit dhe, në çdo rast, jo më vonë se në ditën e 50-të të punës nga data e informimit tëë pëërmendur në pikën 3. Kërkesat e tilla bëhen me shkrim dhe specifikojnë informacionin shtesë të nevojshëm.

Banka e Shqipërisë pezullon periudhën e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4 derisa të ketë marrë informacionin shtesë të përcaktuar në këtë pikë. Pezullimi nuk tejkalon 20 ditë pune. Çdo kërkesë tjetër nga Banka e Shqipërisë për informacion shtesë ose për sqarimin e informacionit të marrë nuk rezulton në një pezullim shtesë të periudhës së vlerësimit.

Banka e Shqipërisë mund ta zgjasë pezullimin e përcaktuar në këtë pikë deri në 30 ditë pune, nëse blerësi i propozuar ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë ose rregullohet sipas legjislacionit të një vendi të tretë.

6. Në rastet kur Banka e Shqiperisë , pas përfundimit të vlerësimit të përcaktuar në pikën 4, vendos të kundërshtojë blerjen e propozuar të përcaktuar në pikën 1, njofton blerësin e propozuar brenda dy ditëve pune dhe, në çdo rast, pëpara datës së përcaktuar në pikën 4, në përputhje me pikën 5. Njoftimi përmban arsyet për vendimin e marrë.
7. Në rastet kur Banka e Shqipërisë nuk kundërshton blerjen e propozuar të përcaktuar në pikën 1 para datës së përcaktuar në pikën 4,- blerja e propozuar do të konsiderohet e miratuar.
8. Banka e Shqipërisë mund të caktojë një periudhë maksimale për përfundimin e blerjes së propozuar të përcaktuar në pikën 1 dhe ta zgjasë atë periudhë maksimale kur është e përshtatshme.

Neni 42

Përmbajtja e vlerësimit të blerjeve të propozuara të emetuesve të tokenave të asetit

1. Gjatë shqyrtimit sipas nenit 41, pika 4, Banka e Shqipërise vlerëson përshtatshmërinë e blerësit të propozuar dhe qëndrueshmërinë financiare të blerjes së propozuar sipas nenit 41, pika 1, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

(a) Reputacioni i blerësit të propozuar;

(b) Reputacioni, njohuritë, aftësitë dhe përvoja e çdo personi që do të drejtojë veprimtarinë e emetuesit të tokenit të asetit si rezultat i blerjes së propozuar;

(c) Qëndrueshmëria financiare e blerësit të propozuar, veçanërisht në lidhje me llojin e veprimtarisë së parashikuar dhe të ndjekur në lidhje me emetuesin e tokenit të asetit në të cilin propozohet blerja;

(d) Nëse emetuesi i tokenit të asetit do të jetë në gjendje të përmbushë dhe të vazhdojë të përmbushë dispozitat e këtij Kreu;

(e) Nëse ka arsye të arsyeshme për të dyshuar se, në lidhje me blerjen e propozuar, po kryhet, është kryer ose është tentuar pastrim parash, financim i terrorizmit ose financimin e armëve të

shkatërrimit në masë siç përcaktohet përkatësisht në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave, ose se blerja e propozuar mund të rrisë rrezikun e tij.

2. Banka e Shqipërise mund të kundërshtojë blerjen e propozuar vetëm nëse ka dyshime të arsyeshme për ta bërë këtë bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni ose nëse informacioni i ofruar sipas nenit 41, pika 4 është i paplotë ose i rremë.
3. Autoritetet e tjera kombëtare nuk vendosin asnjë kusht paraprak në lidhje me nivelin e pjesëmarrjes influencuese që kërkohet të fitohet sipas këtij ligji dhe Banka e Shqipërisë nuk shqyrton blerjen e propozuar në terma të nevojave ekonomike të tregut.
4. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton regulla më të detajuara lidhur me përmbajtjen e informacionit në funksion të vlerësimit sipas nenit 41 pika 1. Informacioni i kërkuar duhet të jetë i dobishëm në funksion të vlerësimit prudencial, proporcional dhe i përshtatshëm për llojin e blerësit dhe blerjes së propozuar.

Seksioni 5:
Tokenat e asetit me rëndësi të lartë

Neni 43

Klasifikimi i tokenave të asetit si tokena aseti me rëndësi të lartë

1. Kriteret për klasifikimin e tokenave të asetit si tokena me rëndësi të lartë janë si më poshtë, të specifikuara më tej nga aktet e miratuara sipas pikës 11:

(a) Numri i zotëruesve të tokenit të asetit në Republikën e Shqipërisë dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian është më i madh se 10 milionë;

(b) Vlera e tokenit të asetit të emetuar, kapitalizimi i tij në treg ose madhësia e rezervës së aseteve të emetuesit të tokenit të asetit është më e lartë se 5 miliardë euro;

(c) Numri mesatar dhe vlera mesatare e përgjithshme e transaksioneve në ditë, gjatë periudhës përkatëse është më e lartë se 2,5 milionë transaksione dhe 500 milionë euro përkatësisht, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian;

(d) Emetuesi i tokenit të asetit është një ofrues i platformave të shërbimeve bazë i caktuar si portier, në përputhje me legjislacionin për tregjet digjitale.;

(e) Rëndësia e veprimtarisë të emetuesit të tokenit të asetit në shkallë ndërkombëtare, përfshirë përdorimin e tokenit të asetit për pagesa dhe remitanca;

(f) Ndërlidhja e tokenit të asetit ose e emetuesve të tij me sistemin financiar;

(g) Fakti që i njëjti emetues emeton të paktën një tjetër token të asetit ose token të parasë

elektronike dhe ofron të paktën një shërbim të kripto-aseteve sipas nenit 59.

2. Banka e Shqipërisë klasifikon tokenat e asetit si tokena të asetit me rëndësi të lartë kur të paktën tre nga kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij Neni janë përmbushur:

(a) Gjatë periudhës së mbuluar nga raporti i parë i informacionit, siç përmendet në pikën 4 të këtij Neni, pas autorizimit në përputhje me Nenin 21 ose pas miratimit të–dokumentit informuestë kripto-asetit sipas Nenit 17; ose

(b) Gjatë periudhës së mbuluar nga të paktën dy raporte të njëpasnjëshme të informacionit, siç përmendet në pikën 4 të këtij Neni.

3. Kur disa emetues emetojnë të njëjtin token aseti, përmbushja e kritereve të përcaktuara në pikën 1 do të vlerësohet pas agregimit të të dhënave nga këta emetues.

4. Në rastet e tokenave të asetit të denominuara në Euro, Banka e Shqipërisë raporton të paktën 2 herë në vit tek Autoriteti Bankar Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane informacionin e përkatës për vlerësimin e përmbushjes së kritereve të përcaktuara në pikën 1 të këtij Neni, duke përfshirë, në rast se është e aplikueshme , informacionin e marrë sipas Nenit 22, të paktën dy herë në vit.

Në rastet kur emetuesi është i vendosur në një vend të trete Banka e Shqipërisë përcjell informacionin e përcaktuar në nën-pikën e parë gjithashtu edhe tek banka qendrore e atij shteti.

5. Kur Banka e Shqipërisë arrin në përfundimin se një token aseti përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 në përputhje me pikën 2, ajo përgatit një vendim për klasifikimin e tokenit si token aseti me rëndësi të lartë dhe njofton emetuesin eatij tokeni, dhe, në rastet e përcaktuara në pikën 4, nën-pikën e dytë, njofton bankën qendrore të shtetit përkatës.

Emetuesit e tokenave të asetit, do të kenë 20 ditë pune nga data e njoftimit të vendimit të Bankës së Shqipërisë për të paraqitur vëzhgimet dhe komentet me shkrim. Banka e Shqipërisë do t'i shqyrtojë me kujdes këto vëzhgime dhe komente para se të marrë një vendim përfundimtar.

6. Banka e Shqipërisë merr vendimin përfundimtar për klasifikimin e një tokeni të referuar të asetit si token aseti me rëndësi të lartë brenda 60 ditëve pune nga data e njoftimit të përcaktuar në pikën 5 dhe ta njoftojë menjëherë këtë vendim emetuesit të tokenit të asetit.
7. Banka e Shqipërisë rishikon çdo vit klasifikimin e tokenave të asetit me rëndësi të lartë bazuar në informacionin e disponueshëm, duke përfshirë raportet e përcaktuara në pikën 4 ose informacionin e marrë sipas Nenit 22.

Kur Banka e Shqipërisë arrin në përfundimin se disa tokena aseti nuk përmbushin më kriteret e përcaktuara në pikën 1 në përputhje me pikën 2, ajo përgatit një vendim për të mos klasifikuar

më tokenat e asetit si të rëndësishëm dhe njofton emetuesit e atyre tokenave dhe, në rastet e përcaktuara në pikën 4, nën-pikën e dytë, bankën qendrore të shtetit përkatës.

Emetuesit e këtyre tokenave dhe banka qendrore e përcaktuar në pikën 4 do të kenë 20 ditë pune nga data e njoftimit të vendimit për të paraqitur vëzhgimet dhe komentet me shkrim. Banka e Shqipërisë do t'i shqyrtojë me kujdes këto vëzhgime dhe komente para se të marrë një vendim përfundimtar.

9. Banka e Shqipërisë merr vendimin përfundimtar për të mos klasifikuar më një token aseti si të rëndësishëm brenda 60 ditëve pune nga data e njoftimit të përcaktuar në pikën 8 dhe ia njofton menjëherë këtë vendim emetuesit të atij tokeni të asetit.
10. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, mund të miratojnë rregulla më të detajuara, lidhur me kushtet e përgjithshme, kriteret e veçanta, ose kriteret e tjera shtesë.

Neni 44

Klasifikimi vullnetar i tokenave të asetit si tokena të asetit me rëndësi të lartë

1. Subjektet kërkues të tokenave të asetit mund të tregojnë në kërkesën e tyre për autorizim sipas Nenit 18, ose në njoftimin e tyre sipas Nenit 17, që dëshirojnë që tokenat e tyre të asetit të klasifikohen si tokena aseti me rëndësi të lartë.

Që një token aseti të klasifikohet si i rëndësishëm sipas këtij Neni, subjekti kërkues i tokenit të asetit demonstron, përmes një programi të detajuar të veprimtarisë të përcaktuar në Nenin 17(1), pika (b)(i), dhe Nenin 18(2), pika (d), se ka gjasa të përmbushë të paktën tre nga kriteret e përcaktuara në Nenin 43(1).

2. Banka e Shqipërisë duhet, brenda 20 ditëve pune nga njoftimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij Neni, të përgatisë një vendim që përmban opinionin e saj bazuar në programin e veprimtarisë, nëse tokeni i asetit përmbush ose ka gjasa të përmbushë të paktën tre nga kriteret e përcaktuara në Nenin 43(1) dhe ta njoftojë këtë vendim emetuesit kërkues dhe, në rastet e përcaktuara në Nenin 43(4), nën-pikën e dytë, bankës qendrore të shtetit përkatës.

Banka Qendrore dhe, kur është e aplikueshme, banka qendrore e shtetit përkatës, do të kenë 20 ditë pune nga data e njoftimit të vendimit për të paraqitur vëzhgimet dhe komentet me shkrim. Banka e Shqipërisë merr në konsideratë me kujdes këto vëzhgime dhe komente para se të marrë një vendim përfundimtar.

3. Banka e Shqipërisë merr vendimin përfundimtar nëse një token i asetit klasifikohet si

token i asetit me rëndësi të lartë brenda 60 ditëve pune nga njoftimi i përcaktuar në pikën 1 dhe ta njoftojë menjëherë këtë vendim subjektit kërkues të atij tokeni aseti.

4. Kur tokenat e asetit janë klasifikuar si të rëndësishëm sipas një vendimi të Bankës së Shqipërisë të marrë në përputhje me pikën 3 të këtij Neni, përgjegjësitë mbikëqyrëse në lidhje me emetuesit e atyre tokenave të asetit do të transferohen nga Banka e Shqipërise tek Banka e Shqipërisë në datën e vendimit të autoritetit për të dhënë autorizimin e përcaktuar në Nenin 21(1) ose në datën e miratimit të dokumentit informuestë kripto-asetit sipas Nenit 17. E

Neni 45

Detyrimet specifike shtesë për emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë

1. Emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë adoptojnë, zbatojnë dhe mbajnë një politikë shpërblimi që promovon menaxhimin e qëndrueshëm dhe efektiv të rrezikut dhe që nuk krijon stimuj për të ulur standardet e rrezikut.
2. Emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë sigurojnë që këto tokena të mund të mbahen në kujdestari nga ofrues të ndryshëm të shërbimeve të kripto-aseteve të autorizuar për të ofruar kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve, duke përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që nuk i përkasin të njëjtit grup, në mënyrë të drejtë, të arsyeshme dhe jo-diskriminuese.
3. Emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë vlerësojnë dhe monitorojnë nevojat për likuiditet për të përmbushur kërkesat për shlyerje nga zotëruesit e tokenave të asetit. Për këtë qëllim, emetuesit krijojnë, të mbajnë dhe të zbatojnë një politikë dhe procedura të menaxhimit të likuiditetit. Kjo politikë dhe këto procedura sigurojnë që rezervat e aseteve të kenë një profil likuiditeti të qëndrueshëm, që u mundëson emetuesve të tokenave të asetit me rëndësi të lartë të vazhdojnë funksionimin normal, përfshirë edhe skenarët e stresit të likuiditetit.
4. Emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë kryejnë rregullisht testimin e stresit të likuiditetit. Në varësi të rezultateve të këtyre testeve, Banka e Shqipërisë mund të vendosë të forcojë kërkesat për likuiditet të përcaktuara në pikën 7, nën-pikën e parë, pika (b) të këtij Neni dhe në Nenin 36(6).

Kur emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë ofrojnë dy ose më shumë tokena të asetit ose ofrojnë shërbime të kripto-aseteve, këto teste stresi mbulojnë të gjitha këto aktivitete në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe holistike.

5. Përqindja e përcaktuar në Nenin 35(1), nën-pikën e parë, pika (b), do të caktohet në 3 % të shumës mesatare të rezervave të aseteve për emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë.

6. Kur disa emetues ofrojnë të njëjtin token të asetit me rëndësi të lartë, pikat 1 deri në 5 të këtij neni do të zbatohen për secilin emetues.

Kur një emetues ofron dy ose më shumë tokena të asetit në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një nga këta tokena të asetit klasifikohet si i rëndësishëm, do të zbatohen pikat1 deri në 5.

7. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara, në lidhje me:
   (a) përmbajtjen minimale e politikave të qeverisjes lidhur me politikën e shpërblimit, siç i referohet pika 1;
   (b) përmbajtjen minimale e politikës dhe procedurave të administrimit të likuiditetit, siç parashikohet në pika 3, si dhe kërkesat e likuiditetit, përfshirë specifikimin e shumës minimale të depozitave në secilën valutë të referuar, e cila nuk mund të jetë më e ulët se 60 % e shumës së referuar në secilën valutë;
   (c) procedurat dhe afatet kohore për një emetues të një Tokeni aseti me rëndësi të lartë që të përshtatë shumën e fondeve të veta, sipas kërkesave të parashikuara në pikën 5.

   Në rastin e institucioneve të kreditit, Banka e Shqipërisë kalibron standardet teknike duke marrë në konsideratë çdo ndërveprim të mundshëm midis kërkesave rregullatore të përcaktuara nga ky ligj dhe kërkesave rregullatore të përcaktuara nga aktet e tjera legjislative të Republikës së Shqipërisë
   8. Banka e Shqipërisë miraton udhëzime në lidhje me me qëllim përcaktimin e parametrave të përbashkët referues të skenarëve të stress-test që do të përfshihen në testet e rezistencës të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni. Këto udhëzime përditësohen periodikisht, duke marrë në konsideratë zhvillimet më të fundit të tregut.

Seksioni 6:
Planet e rimëkëmbjes dhe shlyerjes

Neni 46

Plani i rimëkëmbjes

1. Emetuesi i një tokeni aseti harton dhe të mbajë një plan rimëkëmbjeje që përmban masat që do të merren nga emetuesi për të rivendosur përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme për rezervën e aseteve në rastet kur emetuesi dështon të përmbushë këto kërkesa.

Plani i rimëkëmbjes përfshin gjithashtu ruajtjen e shërbimeve të emetuesit të lidhura me tokenin e asetit, rikuperimin në kohë të operacioneve dhe përmbushjen e detyrimeve të emetuesit në rastet e ngjarjeve që paraqesin një rrezik të konsiderueshëm të ndërprerjes së operacioneve.

Plani i rimëkëmbjes përfshin kushte dhe procedura të përshtatshme për të siguruar zbatimin në kohë të veprimeve të rimëkëmbjes, si dhe një gamë të gjerë opsionesh rimëkëmbjeje, përfshirë:

(a) tarifat e likuiditetit mbi shlyerjet;

(b) kufizimet mbi shumën e tokenit të asetit që mund të shlyhet në çdo ditë pune;

(c) pezullimin e shlyerjeve.

2. Emetuesi i tokenit të asetit njofton planin e rimëkëmbjes Bankës së Shqipërisë brenda gjashtë muajve nga data e autorizimit sipas Nenit 21 ose brenda gjashtë muajve nga data e miratimit të dokumentit informues të kripto-asetit sipas Nenit 17. Banka e Shqipërise kërkon ndryshime në planin e rimëkëmbjes, kur është e nevojshme për të siguruar zbatimin e tij të duhur, dhe të njoftojë vendimin e tij që kërkon ato ndryshime emetuesit brenda 40 ditëve pune nga data e njoftimit të atij plani. Ky vendim zbatohet nga emetuesi brenda 40 ditëve pune nga data e njoftimit.
3. Në rastet kur emetuesi dështon të përmbushë kërkesat e zbatueshme për rezervën e aseteve siç përmendet në Seksionin 3 të këtij Kreu ose, për shkak të një gjendjeje financiare në përkeqësim të shpejtë, ka gjasa të mos i përmbushë ato kërkesa në të ardhmen e afërt, Banka e Shqipërise, do të kërkojë nga emetuesi të zbatojë një ose më shumë nga masat e përcaktuara në planin e rimëkëmbjes ose të përditësojë një plan të tillë kur rrethanat ndryshojnë nga supozimet e përcaktuara në planin fillestar të rimëkëmbjes dhe të zbatojë një ose më shumë nga masat e përcaktuara në planin e përditësuar brenda një afati të caktuar kohor.
4. Në rrethanat e përcaktuara në pikën 3, Banka e Shqipërise do të ketë fuqinë të pezullojë përkohësisht shlyerjen e tokenave të asetit, me kusht që pezullimi të jetë i justifikuar duke marrë parasysh interesat e zotëruesve të tokenave të asetit dhe stabilitetin financiar.
5. Për qëllime të këtij neni, autoritetet përgjegjëse, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, mund të miratojë rregulla më të detajuara, lidhur me kushtet e përgjithshme, kriteret e veçanta, ose kriteret e tjera shtesë.

Neni 47

Plani i shlyerjes

1. Emetuesi i një tokeni të asetit harton një plan operacional për të mbështetur shlyerjen e rregullt të çdo tokeni aseti, i cili do të zbatohet pas një vendimi nga Banka e Shqipërise që emetuesi nuk është në gjendje ose ka gjasa të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij, përfshirë në rast të falimentimit ose, kur është e aplikueshme, në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. ose në rastet e tërheqjes së autorizimit të emetuesit, krahas masave për parandalimin ose administrimin e krizave sipas legjislacionit në fuqi për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.
2. Plani i shlyerjes demonstron aftësinë e emetuesit për të kryer shlyerjen e tokenit të asetit të

mbetur pa shkaktuar dëme të tepruara ekonomike për zotëruesit e tij ose për stabilitetin e tregjeve të rezervave të aseteve.

Plani i shlyerjes përfshin marrëveshje kontraktuale, procedura dhe sisteme, duke përfshirë caktimin e një administratori të përkohshëm në përputhje me ligjin në fuqi, për të siguruar trajtimin e drejtë të të gjithë zotëruesve të tokenave të asetit dhe për të siguruar që zotëruesit të paguhen në mënyrë të shpejtë me të ardhurat nga shitja e rezervave të mbetura të aseteve.

Plani i shlyerjes siguron vazhdimësinë e çdo veprimtarie kritike që është e nevojshme për shlyerjen e rregullt dhe që kryhet nga emetuesit ose nga ndonjë palë e tretë.

3. Emetuesi i tokenit të asetit njofton planin e shlyerjes tek Banka e Shqipërise brenda gjashtë muajve nga data e autorizimit sipas Nenit 21 ose brenda gjashtë muajve nga data e miratimit të dokumentit informues të kripto-asetit sipas Nenit 17. Banka e Shqipërise kërkon ndryshime në planin e shlyerjes kur është e nevojshme për të siguruar zbatimin e tij të duhur dhe të njoftojë vendimin e tij emetuesit brenda 40 ditëve pune nga data e njoftimit të atij plani. Ky vendim zbatohet nga emetuesi brenda 40 ditëve pune nga data e njoftimit.
5. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara në lidhje me përmbajtjen e planit të shlyerjes dhe periodicitetin e rishikimit të tij, duke marrë në konsideratë madhësinë, kompleksitetin dhe llojin e tokenit të asetit në përputhje me modelin e biznesit të emetuesit të tij dhe pragjet për vënien në zbatim të planit të shlyerjes.

KREU IV:
TOKENAT E PARASË ELEKTRONIKE

Seksioni 1:
Kërkesat që përmbushen nga të gjithë emetuesit e tokenit të parasë elektronike

Neni 48

Kërkesat për ofertën ndaj publikut ose pranimin për tregtim të tokenave të parasë elektronike

1. Çdo subjekt që kërkon të ofrojë ndaj publikut ose të kërkojë pranimin për tregtim të një tokeni të parasë elektronike brenda Republikës së Shqipërisë, duhet të jetë emetues i tokenit të parasë elektronike dhe të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë i licencuar ose autorizuar si bankë, ose institucion krediti ose si institucion i parasë elektronike; dhe
b) të ketë njoftuar një dokument informues të kripto-asetit tek Banka e Shqipërise dhe ta ketë publikuar dokumentin informues në përputhje me përcaktimet e nenit 51 të këtij ligji.

Pavarësisht përcaktimeve të shkronjës a) të kësaj pike, me pëlqimin me shkrim të emetuesit, subjekte të tjerë mund të bëjnë ofertën ndaj publikut ose të kërkojnë pranimin për tregtim të tokenit të parasë elektronike. Këto subjekte përmbushin kërkesat e Neneve 50 dhe 53.

2. Tokenat e parasë elektronike konsiderohen si para elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Përvec rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj, Krerët 2 dhe 3 të legjislacionit për shërbimet e pagesave do të zbatohen edhe për tokenat e parasë elektronike
4. Pika 1 e këtij Neni nuk do të zbatohet për emetuesit e tokenave të parasë elektronike që përjashtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për institucionet e parasë elektronike
5. Me përjashtim të pikës 7 të këtij Neni dhe Nenit 51, ky Kre nuk do të zbatohet për tokenat e parasë elektronike që përjashtohen sipas legjislacionit në fuqi për institucionet e parasë elektronike.
6. Emetuesit e tokenave të parasë elektronike njoftojnë Bankën e Shqipërisë të paktën 40 ditë pune përpara datës së synuar të ofertës ndaj publikut ose kërkesës për pranim në tregtim.
7. Në rastet kur zbatohen pikat 4 ose 5 të këtij neni, emetuesit e tokenave të parasë elektronike hartojnë një dokument informues të kripto-asetit dhe ta njoftojnë atë relacion tek Banka e Shqipërise në përputhje me Nenin 51.
8. Në rastet kur një subjekt me seli jashtë Republikës së Shqipërisë, i cili është licencuar apo autorizuar si bankë, ose institucion krediti ose si institucion i parasë elektronike në një nga shtetet e Bashkimit Evropian, kërkon të ofrojë ndaj publikut ose të kërkojë pranimin për tregtim të tokenit të parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë, subjekti do t'i nënshtrohet procedurave të njohjes nga Banka e Shqipërisë.
9. Rregullat më të detajuara në lidhje me procedurat dhe dokumentacionin për njohjen në Republikën e Shqipërisë, të subjekteve të licencuara apo autorizuara si bankë, ose institucion krediti ose si institucion i parasë elektronike në një nga shtetet e Bashkimit Evropian, miratohen me rregullore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 49

Emetimi dhe shlyerja e tokenave të parasë elektronike

1. Si përjashtim nga dispozitat e nenit 24 të rregullores për mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike, emetuesit e tokenave të parasë elektronike do ti nënshtrohen vetëm kërkesave të përcaktuara në këtë nen në lidhje me emetimin dhe shlyerjen e tokenave të parasë elektronike,
2. Zotëruesit e tokenave të parasë elektronike kanë të drejtën e pretendimeve kundrejt emetuesve të atyre tokenave.
3. Emetuesit e tokenave të parasë elektronike i emetojnë këto tokena në vlerë të barabartë me vlerën e fondeve të mbledhura.
4. Me kërkesë të zotëruesit të një tokeni të parasë elektronike, emetuesi i atij tokeni është i detyruar ta shlyejë atë, në çdo kohë, duke e paguar në fonde të ndryshme nga paraja elektronike, në vlerë të barabartë me vlerën monetare të tokenit të parasë elektronike të mbajtur nga zotëruesi i tokenit.
5. Emetuesit e tokenave të parasë elektronike deklarojnë qartë kushtet për shlyerje në dokumentin informues të kripto-asetit sipas përcaktimeve të nenit 51, pika 1, shkronja d).
6. Krahas përcaktimeve të nenit 46, shlyerja e tokenave të parasë elektronike nuk do të subjekt i ndonjë tarife të ngarkuar nga ana e emetuesit.

Neni 50

Ndalimi i dhënies së interesit

1. Pavarësisht parashikimeve të legjilsacionit në fuqi për institucionet e parasë elektronike, emetuesit e tokenave të parasë elektronike nuk mund të japin interes në lidhje me këto tokena.
2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve nuk mundësojnë interes kur ofrojnë shërbime të lidhura me tokenat e parasë elektronike.
3. Për qëllim të pikave 1 dhe 2, çdo shpërblim ose përfitim tjetër i lidhur me kohëzgjatjen e zotërimit të një tokeni të parasë elektronike nga një zotërues, do të trajtohet si interes. Këtu përfhihet edhe kompensimi neto ose zbritjet, të cilat kanë një efekt të barabartë me atë të interesit të marrë nga zotëruesi i tokenit të parasë elektronike, nga ana e emetuesve ose nga palët e treta, dhe që lidhet drejtpërdrejt me tokenin e parasë elektronike, ose nga shpërblimi apo çmimi i produkteve të tjera.

Neni 51

Përmbajtja dhe forma e dokumentit informues të kripto-asetit për tokenat e parasë elektronike

1. Dokumenti informues i kripto-asetit për një token të parasë elektronike përmban të gjitha informacionet e mëposhtme:

(a) informacion mbi emetuesin e tokenit të parasë elektronike;

(b) informacion mbi tokenin e parasë elektronike;

(c) informacion mbi ofertën ndaj publikut të tokenit të parasë elektronike ose pranimin e tij për tregtim;

(d) informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e lidhura me tokenin e parasë elektronike;

(e) informacion mbi teknologjinë bazë;

(f) informacion mbi rreziqet;

(g) informacion mbi ndikimet kryesore negative mbi klimën dhe ndikimet e tjera negative në mjedis të shkaktuara nga mekanizmi i konsensusit i përdorur për të emetuar tokenin e parasë elektronike.

Dokumenti informues i kripto-asetit duhet gjithashtu të përfshijë të dhëna mbi identitetin e subjektit të ndryshëm nga emetuesi që ofron tokenin e parasë elektronike ndaj publikut ose që kërkon pranimin e tij për tregtim, në përputhje me nenin 48, pika 1, dhe arsyen pse ai subjekt po ofron atë token ndaj publikut ose po kërkon pranimin e tij për tregtim.

2. I gjithë informacioni i listuar në pikën 1 duhet të jetë i drejtë, i qartë dhe jo konfuz. Dokumenti informues i kripto-asetit nuk duhet të përmabjë thelbësore dhe duhet të paraqitet në formë të përmbledhur dhe të kuptueshme.
3. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban deklaratën e mëposhtme, të qartë dhe të dukshme, në faqen e parë:

“Ky dokument informues i kripto-asetit nuk është miratuar nga Banka e Shqipërisë. Emetuesi i kripto-asetit është përgjegjës i vetëm për përmbajtjen e këtij dokumenti.”

4. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban një paralajmërim të qartë që:

(a) tokeni i parasë elektronike nuk mbulohet nga skemat e kompensimit të investitorëve;

(b) tokeni i parasë elektronike nuk mbulohet nga skemat e garancisë së depozitave.

5. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban një deklaratë nga organi drejtues i emetuesit të tokenit të parasë elektronike. Kjo deklaratë, e cila vendoset pas deklaratës së përcaktuar në pikën 3, konfirmon se dokumenti informues i kripto-asetit është në përputhje me këtë Kre dhe se, sipas njohurive më të mira të organit drejtues , informacioni i paraqitur në dokumentin informues është i plotë, i drejtë, i qartë dhe jo keqorientues, dhe se dokumenti informues i kripto-asetit nuk përmban mangësi që mund

të ndikojnë në përmbajtjen e tij.

6. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban një përmbledhje, e cila vendoset pas deklaratës së përcaktuar në pikën 5, e cila, në gjuhë të thjeshtë dhe jo-teknike, ofron informacion kryesor lidhur me ofertën ndaj publikut të tokenit të parasë elektronike ose pranimin e tij të synuar për tregtim. Përmbledhja është lehtësisht e kuptueshme, e paraqitur dhe e strukturuar në një format të qartë dhe gjithëpërfshirës, duke përdorur karaktere me madhësi të lexueshme. Përmbledhja e dokumentit informues të kripto-asetit ofron informacionin e duhur mbi karakteristikat e kripto-aseteve përkatëse, për të ndihmuar mbajtësit e mundshëm të marrin një vendim të informuar.

Përmbledhja përmban një paralajmërim që:

(a) lexohet si hyrje e dokumentit informues të kripto-asetit;

(b) blerësi potencial bazon çdo vendim për të blerë tokenin e parasë elektronike në përmbajtjen e dokumentit informues të kripto-asetit në tërësi dhe jo vetëm në përmbledhje;

(c) oferta ndaj publikut e tokenit të parasë elektronike nuk përbën një ofertë ose kërkesë për të blerë instrumente financiare dhe se çdo ofertë ose kërkesë e tillë mund të bëhet vetëm përmes një prospekti ose dokumenti tjetër ofertues sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit;

(d) dokumenti informues i kripto-asetit nuk përbën një prospekt sipas kuptimit të prospektit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit.

Përmbledhja përmban një deklaratë që zotëruesit e tokenit të parasë elektronike kanë të drejtë për shlyerje në çdo kohë dhe me vlerë të barabartë, si dhe parashtron kushtet e shlyerjes.

7. Dokumenti informues i kripto-asetit përmban datën e njoftimit drejt Bankës së Shqipërisë, si dhe një tabelë përmbajtjeje.
8. Dokumenti informues i kripto-asetit hartohet në gjuhën shqipe.

Në rastet kur tokeni i parasë elektronike ofrohet gjithashtu në një vend të tretë tjetër përveç shtetit të origjinës, dokumenti informues i kripto-asetit hartohet gjithashtu në gjuhën zyrtare të shtetit pritës ose në një gjuhë të zakonshme në fushën e financave ndërkombëtare.

9. Dokumenti informues i kripto-asetit është i disponueshëm në një format të lexueshëm elektronikisht, të përbërë nga të dhëna të strukturuara.
10. Për qëllime të nenit 9, Banka e Shqipërisë miraton rregulla më të detajuara, lidhur me standardet teknike të formatit dhe përmbajtjes së dokumentit informues të kripto-asetit.
11. Emetuesit e tokenave të parasë elektronike njoftojnë dokumentin informues të kripto-asetit tek Banka e Shqipërise të paktën 20 ditë pune përpara datës së publikimit të tij.

Banka e Shqipërisë nuk do të kërkojë miratimin paraprak të dokumentit informues të kripto-asetit përpara publikimit të tij.

12. Çdo faktor i ri i rëndësishëm, gabim thelbësor ose pasaktësi materiale që mund të ndikojë në vlerësimin e tokenit të parasë elektronike përshkruhet në dokumentin informues te ndryshuar të kripto-asetit, të hartuar nga emetuesit, i cili njoftohet tek Banka e Shqipërisë dhe publikohet në faqet e internetit të emetuesve.
13. Përpara ofertës ndaj publikut të tokenit të parasë elektronike në Bashkimin Evropian ose kërkesës për pranim në tregtim të këtij tokeni, emetuesi publikon dokumentin informues të kripto-asetit në faqen e tij të internetit.
14. Emetuesi i tokenit të parasë elektronike, së bashku me njoftimin e dokumentit informues të kripto-asetit sipas pikës 11 të këtij neni, jep tek Banka e Shqipërise informacionin e përcaktuar në Nenin 109, pika 4 të këtij ligji. Banka e Shqipërise do t'i komunikojë AMF-së këtë informacion brenda pesë ditëve pune nga marrja e informacionit nga emetuesi, sipas Nenit 109, pika 4.

Banka e Shqipërise gjithashtu do të komunikojë me AMF-në çdo dokument informues të ndryshuar të kripto-asetit dhe çdo revokim të autorizimit të emetuesit të tokenit të parasë elektronike.

AMF do ta bëjë këtë informacion të disponueshëm në regjistër, sipas Nenit 109 pika 4, në datën e fillimit të ofertës ndaj publikut ose pranimit për tregtim. Në rastet e një relacioni të modifikuar të kripto-asetit apo tërheqjes së autorizimit, publikimi në regjistër do bëhet pa vonesa të panevojshme.

15. Për qëllime të këtij neni, Banka e Shqipërisë, miraton rregulla më të detajuara në lidhje me standartet teknike në lidhje me përmbajtjen, metodologjinë dhe paraqitjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1, shkronja h) të këtij neni, të cilat i referohen indikatorëve të qëndrueshmërisë për sa i përket ndikimeve klimaterike negative ose ndikime negative të tjera mjedisore.

16. Gjatë hartimit të rregullores të përcaktuar në pikën 15, Banka e Shqipërisë do të marrë në konsideratë llojet e ndryshme të mekanizmave të konsesusit që përdoren për të dakordësuar transaksionet me kripto-asete, strukturën e incentivave dhe përdorimin e energjisë prej, energjinë e rinovueshme dhe burimet natyrore, prodhimin e mbetjeve dhe emetimeve të gazrave serrë. Banka e Shqipërisë përditëson rregulloren në raste të zhvillimeve teknologjike dhe rregullatore në Bashkimin Evropian.

Neni 52

Përgjegjësia e emetuesve të tokenave të parasë elektronike për informacionin e dhënë në dokumentin informues të kripto-asetit

1. Në rastet kur një emetues i një tokeni të parasë elektronike është në shkelje të nenit 51 të këtji ligji, duke ofruar në dokumentin informues të kripto-asetit ose në dokumentin informues të ndryshuar të kripto-asetit informacion që nuk është i plotë, i drejtë ose i qartë, ose që është keqorientues, ai emetues dhe anëtarët e organit drejtues do të jenë përgjegjës ndaj zotëruesve të atij tokeni të parasë elektronike për çdo humbje të pësuar si rezultat i asaj shkeljeje.
2. Çdo përjashtim ose kufizim kontraktual i përgjegjësisë civile të përcaktuar në pikën 1 do të konsiderohet akt absolutisht i pavlefshëm.
3. Zotëruesi i tokenit të parasë elektronikë mbart përgjegjësinë të provojë se emetuesi i atij tokeni është në shkelje të nenit 51 të këtij ligji duke publikuar në dokumentin informues ose në një dokument informues të ndryshuar, informacion që nuk është i plotë, i drejtë, i qartë ose është keqorientues, dhe se mbështetja në atë informacion ka ndikuar në vendimin e zotëruesit për të blerë, shitur ose shkëmbyer atë token të parasë elektronike.
4. Emetuesi dhe anëtarët e organit drejtues nuk do të jenë përgjegjës për humbjet e pësuara si rezultat i mbështetjes në informacionin e dhënë në përmbledhjen sipas nenit 51, pika 6, përfshirë çdo përkthim të saj, përveç rasteve kur përmbledhja:

   a) është keqorientuese, e pasaktë ose e papërputhshme kur lexohet së bashku me pjesët e tjera të dokumentit informues të kripto-asetit; ose
   b) nuk ofron, kur lexohet së bashku me pjesët e tjera të dokumentit informues të kripto-asetit, informacion thelbësor për të ndihmuar blerësit e mundshëm në vlerësimin e blerjes së tokenit të parasë elektronike.
5. Ky nen aplikohet krahas çdo përgjegjësie tjetër civile sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 53

Materialet promovuese

1. Materialet promovuese që lidhen me një ofertë ndaj publikut të një tokeni të parasë elektronike ose me pranimin e tij për tregtim përmbushin të gjitha kërkesat e mëposhtme:

(a) materialet promovuese janë të identifikueshme qartë si të tilla;

(b) informacioni në materialet promovuese është i drejtë, i qartë dhe jo keqorientues;

(c) informacioni në materialet promovuese është i përputhshëm me informacionin në dokumentin informues të kripto-asetit;

(d) materialet promovuese deklarojnë qartë se një dokument informues i kripto-asetit është

publikuar dhe tregojnë qartë adresën e faqes së internetit të emetuesit të tokenit të parasë elektronike, si dhe një numër telefoni dhe adresë emaili për të kontaktuar emetuesin.

2. Materialet promovuese përmbajnë një deklaratë të qartë se zotëruesit e tokenit të parasë elektronike kanë të drejtë për shlyerje nga emetuesi në çdo kohë dhe me vlerë të barabartë.
3. Materialet promovuese dhe çdo ndryshim i tyre publikohen në faqen e internetit të emetuesit.
4. Banka e Shqipërisë nuk kërkon miratimin paraprak të komunikimeve të marketingut përpara publikimit të tyre.
5. Materialet promovuese njoftohen tek Banka e Shqipërisë sipas kërkesës.
6. Materialet promovuese nuk shperndahet përpara publikimit të dokumentit informues të kripto-asetit. Ky kufizim nuk ndikon në aftësinë e emetuesit të tokenit të parasë elektronike për të kryer sondazhe tregu.

Neni 54

Investimi i fondeve të marra në këmbim të tokenave të parasë elektronike

Fondet e marra nga emetuesit e tokenave të parasë elektronike në këmbim të tokenave të parasë elektronike dhe të ruajtura në përputhje me legjislacionin në fuqi për institucionet e parasë elektronikë përmbushin kërkesat e mëposhtme:

(a) të paktën 30% e fondeve të marra depozitohen gjithmonë në llogari të veçanta në institucione krediti në Republikën e Shqipërisë;

(b) fondet e mbetura investohen në asete të sigurta, me rrezik të ulët, që kualifikohen si instrumente financiare shumë likuide me rrezik minimal të tregut, kreditit dhe përqendrimit, në përputhje me Nenin 38, pika 1 të këtij ligji, dhe janë të denominuara në të njëjtën valutë zyrtare si ajo që referohet nga tokeni i parasë elektronike.

Neni 55

Planet e rimëkëmbjes dhe shlyerjes

1. Dispozitat e kreut III, seksioni 6 të këtij ligji do të zbatohen edhe për emetuesit e tokenave të parasë elektronike.

2. Si përjashtim nga Neni 46, pika 2 e këtij ligji, emetuesit e tokenit të parasë elektronikë njoftojnë planin e rimëkëmbjes tek Banka e Shqipërisë, brenda gjashtë muajve nga data e ofertës ndaj publikut ose pranimit për tregtim.

3. Si përjashtim nga Neni 47, pika 3 e këtij ligji, data deri në të cilën plani i rimbursimit njoftohet

tek Banka e Shqipërisë, për emetuesit e tokenave të parasë elektronike, do të jetë brenda gjashtë muajve nga data e ofertës ndaj publikut ose pranimit për tregtim.

Seksioni 2:
Tokenat e parasë elektronike me rëndësi të lartë

Neni 56

Klasifikimi i tokenave të parasë elektronike si tokena me rëndësi të lartë

1. Banka e Shqipërisë klasifikon një token të parasë elektronike si token me rëndësi të lartë pasi konstaton përmbushjen e të paktën 3 prej kritereve të përcaktuara në Nenin 43, pika 1 të këtij ligji:

   a) gjatë periudhës së mbuluar nga raporti i parë i informacionit, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, pas ofertës ndaj publikut ose kërkesës për pranim në tregtim të atyre tokenave; ose
   b) gjatë periudhës së mbuluar nga të paktën dy raporte të njëpasnjëshme të informacionit, në përputhje me pikën 3 të këtij Neni.

2. Në rastet kur disa emetues emetojnë të njëjtin token të parasë elektronike, përmbushja e kritereve të përcaktuara në Nenin 43, pika 1 të këtij ligji do të vlerësohet pas agregimit të të gjitha të dhënave nga ata emetues.
3. Banka e Shqipërisë do vlerësojë të paktën dy herë në vit informacionin përkatës për përmbushjen e kritereve të përcaktuara në Nenin 43, pika 1, duke përfshirë, në raastet kur është e zbatueshme, informacionin e marrë sipas Nenit 22.

4. Në rastet kur Banka e Shqipërisë del në përfundim se një token i parasë elektronike përmbush kriteret e përcaktuara në Nenin 43, pika 1 sipas pikës 1 të këtij Neni, ajo harton një vendim për klasifikimin e tokenit të parasë elektronike si një token i rëndësishëm dhe njofton emetuesin e tokenit të parasë elektronike.

   Emetuesit e këtyre tokenave të parasë elektronike kanë 20 ditë pune nga data e njoftimit të vendimit për të paraqitur vërejtje dhe komente me shkrim. Banka e Shqipërisë shqyrton këto vërejtje dhe komente përpara se të marrë një vendim përfundimtar.

5. Banka e Shqipërisë merr vendimin përfundimtar nëse do të klasifikojë një token të parasë elektronike si token të rëndësishëm brenda 60 ditëve të punës nga data e njoftimit të përcaktuar në pikën 4 dhe njofton menjëherë emetuesin e atij tokeni.

6. Në rastet kur një token i parasë elektronike është klasifikuar si i rëndësishëm në bazë të një vendimi të Bankës së Shqipërisë të marrë në përputhje me pikën 5 të këtij neni, përgjegjësitë mbikëqyrëse në lidhje me emetuesin e atij tokeni të parasë elektronike do të transferohen nga Autoriteti Bankar Evropain, në përputhje me nenin 117, pika 4, brenda 20 ditëve të punës nga data e njoftimit të atij vendimi. Kjo pikë hyn në fuqi pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

7. Si përjashtim nga pika 6, përgjegjësitë mbikëqyrëse në lidhje me emetuesit e tokenave të rëndësishëm të parasë elektronike të denominuar në një valutë të ndryshme nga Euro, kur të paktën 80% e numrit të zotëruesve dhe i vëllimit të transaksioneve të këtyre tokenave të rëndësishëm janë të përqendruar në shtetin e origjinës, nuk do të transferohen tek Autoriteti Bankar Evropian.

   Banka e Shqipërise informon Autoritetin Bankar Evropian çdo vit në lidhje me rastet kur aplikohet përjashtimi i përcaktuar në këtë pikë.

   Për qëllimet e nënpikën të parë, një transaksion do të konsiderohet se ndodh në shtetin e origjinës kur paguesi ose përfituesi është i vendosur në atë shtet.

8. Banka e Shqipërisë rivlerëson çdo vit klasifikimin e tokenave të rëndësishëm të parasë elektronike mbi bazën e informacionit të disponueshëm, duke përfshirë raportet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni ose informacionin e marrë sipas Nenit 22.

   Në rastet kur Banka e Shqipërisë arrin në përfundimin se disa tokena të parasë elektronike nuk plotësojnë më kriteret e përcaktuara në Nenin 43, pika 1, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë do të përgatisë një vendim për të mos klasifikuar më tokenin e parasë elektronike si të rëndësishëm dhe do të njoftojë emetuesit e atyre tokenave, dhe në rastet e përcaktuara në nënpikën e dytë të pikës 3 të këtij neni, bankën qendrore të shtetit përkatës.

   Emetuesit e këtyre tokenave të parasë elektronike dhe autoritetet e tyre përgjegjëse kanë 20 ditë pune nga data e njoftimit të projektvendimit për të paraqitur vërejtje dhe komente me shkrim. Banka e Shqipërisë do t'i shqyrtojë me kujdes këto vërejtje dhe komente përpara se të marrë një vendim përfundimtar.

9. Banka e Shqipërisë do të marrë vendimin përfundimtar nëse nuk do klasifikojë më një token të parasë elektronike si të rëndësishëm brenda 60 ditëve të punës nga data e njoftimit të përcaktuar në pikën 8 dhe do ta njoftojë menjëherë vendimin tek emetuesi i atij tokeni dhe Banka e Shqipërise i tij.

Neni 57

Klasifikimi vullnetar i tokenave të parasë elektronike si tokena të rëndësishëm të parasë elektronike

1. Një emetues i një tokeni të parasë elektronike, i autorizuar si institucion krediti ose si institucion i parasë elektronike, ose që po aplikon për një autorizim të tillë, mund të shprehë dëshirën që tokeni i tij i parasë elektronike të klasifikohet si token i rëndësishëm i parasë elektronike. Në atë rast, ai dërgon menjëherë kërkesën Banka e Shqipërisë.

   Për t'u klasifikuar si token i rëndësishëm sipas këtij neni, emetuesi i tokenit të parasë elektronike demonstron, përmes një programi të detajuar të veprimtarisë, se ka gjasa të përmbushë të paktën tre nga kriteret e përcaktuara në Nenin 43, pika 1.

2. Banka e Shqipërisë, brenda 20 ditëve të punës nga data e njoftimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përgatit një vendim që përmban opinionin e saj bazuar në programin e veprimtarisë së emetuesit, nëse tokeni i parasë elektronike përmbush ose ka gjasa të përmbushë të paktën tre nga kriteret e përcaktuara në Nenin 43, pika 1, dhe të njoftojë emetuesin, i cili ka 20 ditë pune nga data e njoftimit për të paraqitur vërejtje dhe komente me shkrim.
3. Banka e Shqipërisë do të marrë vendimin përfundimtar nëse do të klasifikojë një token të parasë elektronike si token të rëndësishëm brenda 60 ditëve të punës nga data e njoftimit të përcaktuar në pikën 1 dhe do të njoftojë menjëherë emetuesin e atij tokeni.
4. Si përjashtim nga pika 4, përgjegjësitë mbikëqyrëse në lidhje me emetuesit e tokenave të rëndësishëm të parasë elektronike të denominuar në një valutë të ndryshmë nuk do të transferohen tek Banka e Shqipërisë, kur të paktën 80% e numrit të zotëruesve dhe vëllimit të transaksioneve të atyre tokenave të rëndësishëm janë ose pritet të jenë të përqendruar në vendin e origjinës.

Neni 58

Detyrime shtesë specifike për emetuesit e tokenave të parasë elektronike

1. Institucionet e parasë elektronike që emetojnë tokena të rëndësishëm të parasë elektronike do t’i nënshtrohen:

(a) kërkesave të përcaktuara në nenin 36, 37, 38 dhe 45, pika 1 deri në pikën 4 të këtij ligji, në vend të kërkesave të nenit 15 të rregullores së nxjerrë nga Banka e Shqipërisë për mbikëqyrjen e institucionet e parasë elektronike;

(b) kërkesave të përcaktuara në nenin 35, pika 2, 3 dhe 5 dhe nenin 45, pika 5 të këtij ligji, në vend të nenit 6 të të rregullores së nxjerrë nga Banka e Shqipërisë për mbikëqyrjen e institucionet e parasë elektronike.

Si përjashtim nga Neni 36(9), auditimi i pavarur, për emetuesit e tokenave të rëndësishëm të

parasë elektronike, do të kërkohet çdo gjashtë muaj nga data e vendimit për klasifikimin e tokenave të parasë elektronike si të rëndësishëm sipas Nenit 56 ose 57, sipas rastit.

2. Banka e Shqipërisë mund t'u kërkojnë institucioneve të parasë elektronike që emetojnë tokena të parasë elektronike që nuk janë të rëndësishëm, të përmbushin çdo kërkesë të përcaktuar në pikën 1, kur është e nevojshme për të adresuar rreziqet që synojnë të adresojnë ato dispozita, si rreziqet e likuiditetit, rreziqet operacionale ose rreziqet që dalin nga mosrespektimi i kërkesave për menaxhimin e rezervës së aseteve.
3. Nenet 22, 23 dhe 24, pika 3 do të zbatohen për tokenat e parasë elektronike të denominuar në një valutë të ndryshme nga ajo vendase.

KREU V:
AUTORIZIMI DHE KUSHTET E OPERIMIT PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE PËR KRIPTO-ASETET

Seksioni 1:
Autorizimi i Ofruesve të Shërbimeve për Kripto-Asetet

Neni 59
Autorizimi

1. çdo subjekt që kërkon të ofrojë shërbime të lidhura me kripto-asetet brenda Republikës së Shqipërisë duhet të jetë::
   a) person juridik ose një subjekt tjetër që është autorizuar si ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve në përputhje me nenin 63, të këtij ligji; os
   b) institucion krediti, depozitar qendror i titujve, shoqëri komisionere, operator tregu, institucion i parasë elektronike, shoqëri administruese e SIKTT, ose shoqëri administruese e fondeve të investimeve alternative që lejohet të ofrojë shërbime të kripto-aseteve sipas nenit 60 të këtij ligji.
2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve të autorizuar në përputhje me nenin 63 duhet të kenë seli ose degë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, të ofrojnë të paktën një pjesë të shërbimeve të tyre, si dhe një nga drejtorët e tyre të jetë rezident në Republikën e Shqipërisë.
3. Për qëllimet e pikës 1, gërma a, subjektet e tjera që nuk janë persona juridikë mund të ofrojnë

shërbime të kripto-aseteve vetëm nëse forma e tyre juridike siguron një nivel mbrojtjeje për interesat e palëve të treta të barasvlershme me atë që ofrojnë personat juridikë dhe nëse janë subjekt i mbikëqyrjes prudenciale të përshtatshme për formën e tyre juridike.

4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve të autorizuar në përputhje me nenin 63 duhet te përmbushin gjate gjithe kohes kushtet për autorizimin e tyre.
5. Subjekti që nuk është i autorizuar për të ofruar shërbime të kripto-aseteve nuk mund të përdorë një emër tregtar , ose të publikojë materiale promovuese apo të ndërmarrë ndonjë proces tjetër që sugjeron se ai është ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve ose që mund të krijojë konfuzion në këtë drejtim.
6. AMF përcakton ne autorizim shërbimet e kripto-aseteve që ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve janë të autorizuar të ofrojnë.
7. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve të autorizuara nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian lejohen të ofrojnë shërbime të kripto-aseteve në Republiken e Shqipërisë në përputhje me përcaktimet e nenit 65 të këtij ligji.
8. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve të cilët kërkojnë të shtojnë shërbime të kripto-aseteve në autorizimin e tyre, sipas përcaktimeve të nenit 63, kërkojnë zgjerim të autorizimit nga AMF, duke plotësuar dhe përditësuar informacionin e përcaktuar në nenin 62. Kërkesa për zgjerim të autorizimit do të shqyrtohet në përputhje me kërkesat e nenit 63.

Neni 60
Ofrimi i shërbimeve për kripto-asete nga subjekte financiare

1. Një institucion krediti mund të ofrojë shërbime për kripto-asete nëse i përcjell AMF informacionin e përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, të paktën 40 ditë pune përpara se t'i ofrojë ato shërbime për herë të parë.
2. Një depozitar qendror i titujve i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e Depozitarit Qendror të Titujve mund të ofrojë vetëm kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve në emër të klientëve, nëse i përcjell AMF informacionin e përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, të paktën 40 ditë pune përpara se të ofrojë këtë shërbim për herë të parë.

Për qëllim të kësaj pike, ofrimi i kujdestarisë dhe administrimit të kripto-aseteve në emër të klientëve, konsiderohet i barazvlefshëm me ofrimin, mirëmbajtjen ose operimin e llogarive të titujve në lidhje me shërbimin e shlyerjes të përcaktuar në ligjin që rregullon tregjet e kapitalit.

3. Një shoqëri komisionere e autorizuar në një shtet pritës anëtar të BE mund të ofrojë shërbime për kripto-asete në Republikën e Shqipërisë në mënyrë të barazvlefshme me shërbimet dhe veprimtaritë e investimeve për të cilat ajo është e autorizuar specifikisht sipas legjislacionit te fushës, nëse i përcjell AMF, informacionin e përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, të paktën 40 ditë pune përpara se t'i ofrojë ato shërbime për herë të parë dhe pasi t’i jetë nënshtruar procedurave të njohjes sipas legjislacionit për tregjet e kapitalit.

Për qëllim te kësaj pike:

(a) ofrimi i kujdestarisë dhe administrimit të kripto-aseteve në emër të klientëve konsiderohet i barazvlefshëm me shërbimin ndihmës sipas përcaktimeve në legjislacionin per tregjet e kapitalit;

(b) operimi i një platforme tregtimi për kripto-asete konsiderohet i barazvlefshëm me operimin e një platforme shumëpalëshe tregtimi dhe operimin e një platforme të organizuar tregtimi sipas përcaktimeve në legjislacionin per tregjet e kapitalit;

(c) këmbimi i kripto-aseteve kundrejt fondeve dhe kripto-aseteve të tjera konsiderohet i barazvlefshëm me tregtimin per llogari personale të përcaktuar në sipas përcaktimeve në legjislacionin per tregjet e kapitalit;

(d) ekzekutimi i urdhrave për kripto-asete në emër të klientëve konsiderohet i barazvlefshëm me ekzekutimin e urdhrave në emër të klientëve sipas përcaktimeve në legjislacionin per tregjet e kapitalit; t

(e) hedhja ne treg i kripto-aseteve konsiderohet i barazvlefshëm me nënshkrimin ose hedhjen ne treg te instrumenteve financiare me ngazhim shitjeje dhehedhjen ne treg te instrumenteve financiare pa angazhim shitje sipas përcaktimeve në legjislacionin per tregjet e kapitalit;

(f) marrja dhe transmetimi i urdhrave për kripto-asete në emër të klientëve konsiderohet i barazvlefshëm me marrjen dhe transmetimin e urdhrave në lidhje me një ose më shumë instrumente financiare sipas përcaktimeve në legjislacionin per tregjet e kapitalit;

(g) këshillimi në lidhje me kripto-asetet konsiderohet i barazvlefshëm me këshillimit për investime sipas përcaktimeve në legjislacionin per tregjet e kapitalit;

(h) administrimi i portofolit të kripto-aseteve konsiderohet i barazvlefshëm me administrimin e portofolitsipas përcaktimeve në legjislacionin per tregjet e kapitalit; Një institucion i parasë elektronike i licencuar nga Banka e Shqipërisë mund të ofrojë vetëm shërbime të kujdestarise dhe administrimit të kripto-aseteve në emër të klientëve dhe shërbime transferimi për kripto-asete në emër të klientëve në lidhje me tokenat e parasë elektronike që ai emeton, nëse i percjell autoritetit përgjegjës të shtetit të origjines anetar i BE-se informacionin e përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, të paktën 40 ditë pune përpara se t'i ofrojë këto shërbime për herë të parë.

5. Një shoqëri administrimi SIKTT ose një shoqëri administruese e fondeve të investimeve alternative mund të ofrojë shërbime për kripto-asete të barasvlershme me administrimin e portofolave të investimeve dhe shërbimeve jo-paresore për të cilat është e licencuar sipas legjislacionit në fuqi, nëse i percjell autoritetit përgjegjës të shtetit të origjines anetar i BE-së informacionin e përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, të paktën 40 ditë pune përpara se te ofrojë shërbimet për herë të parë.

Për qëllim të kësaj pike:

(a) marrja dhe transmetimi i urdhrave për kripto-asete në emër të klientëve konsiderohet i barazvlefshëm me marrjen dhe transmetimin e urdhrave në lidhje me instrumentet financiare sipas legjislacionit ne fuqi

(b) këshillimi në lidhje me kripto-asetet konsiderohet i barazvlefshëm me këshillimin për investime sipas legjislacionit ne fuqi

(c) administrimi i portofolit të kripto-aseteve konsiderohet i barazvlefshëm me shërbimet e përcaktuara sipas legjislacionit ne fuqi;.

6. Një operator tregu i autorizuar sipas legjislacionit ne fuqi për tregjet e kapitalit; mund të operojë një platformë tregtimi për kripto-asete nëse i percjell autoritetit përgjegjës të shtetit te origjines anetar i BE-se tij informacionin e përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, të paktën 40 ditë pune përpara se t'i ofrojë këto shërbime për herë të parë.

7. Për qëllimet e pikave 1 deri në 6 të këtij neni, subjekti i përcjell Autoritetit përgjegjës dokumentet e mëposhtme:

(a) programin e veprimtarive që përcakton llojet e shërbimeve për kripto-asete që ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të ofrojë, duke përfshirë mënyrën se si do të promovohen ato shërbime;

(b) një përshkrim të:

(i) mekanizmave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave për të siguruar pajtueshmërinë me dispozitat e legjislacionit ne fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

(ii) kuadrit të vlerësimit të rrezikut për menaxhimin e rreziqeve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të armëve të shkatërrimit në masë; dhe

(iii) planit të vazhdimësisë së biznesit;

(c) dokumentacionin teknik të sistemeve te teknologjise se informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe marrëveshjeve të sigurisë, dhe një përshkrim i tyre në gjuhë të kuptueshme dhe jo-teknike;

(d) një përshkrim të procedurës për veçimin e kripto-aseteve dhe fondeve të klientëve;

(e) një përshkrim të politikës së kujdestarisë dhe administrimit, kur synohet të ofrohet kujdestaria dhe administrimi i kripto-aseteve në emër të klientëve;

(f) një përshkrim i rregullave të veprimtarisë të platformës së tregtimit dhe i procedurave dhe sistemit për zbulimin e abuzimit të tregut, kur synohet të operohet një platformë tregtimi për kripto-asete;

(g) një përshkrim të politikës tregtare jo-diskriminuese që rregullon marrëdhëniet me klientët si dhe një përshkrim i metodologjisë për përcaktimin e çmimit të kripto-aseteve që synohet të këmbehen kundrejt fondeve osekripto-aseteve të tjera, kur synohet të këmbehen kripto-asete kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera;

(h) një përshkrim të politikës së ekzekutimit, kur synohet të ekzekutohen urdhra për kripto-asete në emër të klientëve;

(i) dokument provues që individëët që japin sherbimin e keshillimit në emër të ofruesit të shërbimeve për kripto-asete ose që administrojne portofolat në emër të ofruesit të shërbimeve për kripto-asete kanë njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të përmbushur detyrimet e tyre, kur synohet të ofrohet sherbimi i keshillimit për kripto-asete ose të ofrohet administrimi i portofolit të kripto-aseteve;

(j) informacion nëse shërbimi për kripto-asete ka të bëjë me tokenat e aseteve, tokenat e parasë elektronike ose kripto-asete të tjera;

(k) informacion përmënyrën se si do të ofrohen shërbimet e transferimit, kur synohet të ofrohen shërbime transferimi për kripto-asete në emër të klientëve.

8. Brenda 20 ditëve pune nga marrja e njoftimit sipas pikave 1 deri në 6 të këtij neni, AMF vlerëson nëse informacioni i kerkuar është i plotë. Nëse AMF konstaton se informacioni nuk është i plotë, informon menjëherë subjektin dhe cakton një afat brenda në të cilit subjekti plotëson informacionin e munguar.

Afati për plotesimin e çdo informacioni të munguar nuk kalon 20 ditë pune nga data e kërkesës. Deri në perfundimin e ketij afati, çdo periudhë e përcaktuar në pikat 1 deri në 6 pezullohet. Çdo kërkesë shtesë nga AMF për plotësim ose sqarim të informacionit është në gjykimin e tij, por nuk do të rezultojë në pezullimin e ndonjë periudhe të përcaktuar në pikat 1 deri në 6 të këtij neni.

Gjatë kësaj periudhe, ofruesi i shërbimeve për kripto-asete nuk mund të fillojë ofrimin e shërbimeve për kripto-asete për aq kohë sa njoftimi së bashku me informacionin nuk është i plotë.

9. Subjektet e përcaktuara në pikat 1 deri në 6 të këtij neni nuk kane detyrimin të paraqesin informacionin e përcaktuar në pikën 7 nëse ky informacion është i njëjtë me informacionin e dorëzuar më parë tek AMF. Në këtë rast, subjektet e përcaktuara në pikat 1 deri në 6 të këtij neni, deklarojnë shprehimisht se çdo informacion i dorëzuar më parë është ende i vlefshëm dhe i saktë.

10.Subjektet e përcaktuara në pika 1 deri në 6 të këtij neni kur ofrojnë shërbime pë kripto-asete, nuk i nënshtrohen kerkesave te neneve 62, 63, 64, 67, 83 dhe 84 të këtij ligji.

11. E drejta për të ofruar shërbime për kripto-asete të përcaktuara në pikat 1 deri në 6 të këtij neni revokohet me heqjen e licencës ose autorizimit përkatës që i mundësoi subjektit përkatës të

ofrojë shërbime për kripto-asete pa qenë i detyruar të marrë një autorizim sipas nenit 59.

12. Pas verifikimit të plotësisë së informacionit të listuar në pikën 7 të këtij neni, AMF publikon informacionin e plotë në regjistrin e mbajtur sipas nenit 109, pika 5 i këtij ligji.

13. AMF miraton rregulla më të detajuara në lidhje me standardet teknike, formatet e aplikimit, procedurat dhe detajimin e informacionit dhe dokumenteve të përcaktuara në pikën 7 të këtij neni.

Neni 61
Ofrimi i shërbimeve për kripto-asete me nismë ekskluzive të klientit

1. Në rastet kur një klient i themeluar apo me vendndodhje në Republikën e Shqipërisë inicion me nismë ekskluzive të tij ofrimin e shërbimit të kripto-aseteve nga një subjekt i një shteti tjetër jashtë Republikës së Shqipërisë, kërkesa për autorizim sipas Nenit 59 nuk zbatohet për ofrimin e atij shërbimi ose veprimtarie të lidhur me kripto-asete nga subjekti i shtetit tjetër duke përfshirë këtu edhe marrëdhënien ndërmjet tyre që i referohet specifikisht ofrimit të atij shërbimi ose veprimtarie të lidhur me kripto-asete.
   Në rastet kur Kur një subjekt i nje vendi te trete apo në Bashkimin Europian , ndërvepron në mënyrë aktive per te tërhequrklientët apo klientë potencialë në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së komunikimit të përdorur për terheqjen e klienteve, promovimin apo reklamimin nuk do të konsiderohet se po ofron nje sherbim me nisme ekskluzive te klientit , Dispozitat e kësaj pike zbatohen edhe për subjektet që veprojnë për llogari të subjektit që ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë ose që kanë lidhje të ngushta me të, si dhe çdo person që vepron në emër dhe për llogari të subjektit që ndodhet jashtë Republikës sëShqipërisë.
   Dispozitat e pikës 2 të këtij neni zbatohen pavarësisht klauzolave kontraktuale ose njoftimeve që pretendojnë ndryshe, përfshirë këtu klauzola që pretendojnë se ofrimi i shërbimeve nga subjekti i ndodhur jashtë Republikës së Shqipërisë apo Bashkimit EuropiOfrimi i sherbimit me nisme ekskluzive të klientit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk i jep të drejtë një subjektit jashtë Republikës së Shqipërisë apo Bashkimit Europian t'i promovoje këtij klienti kripto-asete të tjera apo sherbime të tjera të lidhura me kripto-asetet.

2. Për qëllime të këtij neni, AMF miraton rregulla të detajuara në lidhje me specifikimin e rrethanave në të cilat subjekt i vendeve të treta konsidorohet që ndërvepron në mënyrë aktive brenda Republikës së Shqipërisë.

Neni 62
Aplikimi për autorizim si ofrues shërbimesh për kripto-asete

1. Personat juridikë ose subjektet e tjera që synojnë të ofrojnë shërbime për kripto-asete

paraqesin kërkesën e tyre për autorizim si ofrues shërbimesh për kripto-asete pranë AMF.

2. Kërkesa për autorizim sipas pikës 1 të këtij neni përmban informacionin e mëposhtëm:

(a) emrin, duke përfshirë emrin ligjor dhe çdo emër tjetër tregtar të përdorur, numrin identifikues te personit të tatueshëm të subjektit ofrues të shërbimeve për kripto-asete, faqen e internetit të subjektit, adresën e e-mail, numrin e telefonit, dhe vendndodhjen e selisë;

(b) Ekstraktin e regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për regjistrimin e subjektit si person juridik, në të cilin të jetë shprehur objekti i veprimtarisë së shoqërisë;

(c) statutin e subjektit kërkues për ofrues të shërbimeve për kripto-asete;

(d) programin e veprimtarisë që përcakton llojet e shërbimeve për kripto-asete që ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të ofrojë, duke përfshirë se ku dhe mënyrën se si do të promovohen dhe reklamohen ato shërbime;

(e) dokumente që vertetojnë se ofruesi i shërbimeve për kripto-asete plotëson kërkesat për mbrojtjen prudenciale të përcaktuara në nenin 67;

(f) një përshkrim të strukturave të organizimit tëtë brendshëm tëshoqërisë sëofruesit të shërbimeve për kripto-asete;

(g) dokumente që vertetojnë se anëtarët e organit drejtues të ofruesit të shërbimeve për kripto-asete janë me reputacion të mjaftueshëm dhe kanë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e duhur për të drejtuar e administruar veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve për kripto-asetet. ;

(h) strukturën aksionare, përfshirë te dhena personale te çdo aksionari dhe anëtari, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që zotërojnë pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e ofruesit të shërbimeve për kripto-asete, si dhe dokumente që vertetojnë se këta janë veçmas dhe bashkërisht të aftë dhe të përshtatshëm për të ofruar shërbimin për kripto-asete;

(i) një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të ofruesit të shërbimeve për kripto-asete për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet, duke përfshirë rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe planin e vazhdimësisë së biznesit;

(j) dokumentacionin teknik të sistemeve TIK dhe masave të sigurisë, dhe një përshkrim të tyre në gjuhë të kuptueshme dhe jo-teknike;

(k) një përshkrim të procedurës për veçimin e kripto-aseteve dhe fondeve të klientëve të tyre;

(l) një përshkrim të procedurave për trajtimin e ankesave të ofruesit të shërbimeve për kripto-asete ;

(m) një përshkrim të politikave të kujdestarisë dhe administrimit, në rastet kur ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të ofrojë shërbimin e kujdestarisë dhe administrimit të kripto-aseteve në emër dhe për llogari të klientëve;

(n) një përshkrim të rregullave operacionale të platformës së tregtimit dhe të procedurave dhe sistemit për zbulimin e abuzimit të tregut, kur ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të operojë një platformë tregtimi për kripto-asete;

(o) një përshkrim të politikës tregtare, e cila është jo-diskriminuese, që rregullon marrëdhëniet me klientët, si dhe një përshkrim të metodologjisë për përcaktimin e çmimit të kripto-aseteve që ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të këmbejë kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera, në rastet kur ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të këmbejë kripto-asete kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera;

(p) një përshkrim të politikës së ekzekutimit në rastet kur ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të ekzekutojë urdhra për kripto-asete në emër të klientëve;

(q) dokumente që vërtetojnë se individët që ofrojne keshillim në emër të ofruesit të shërbimeve për kripto-asete ose që administrojne portofole në emër të ofruesit të shërbimeve për kripto-asete kanë njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të përmbushur detyrimet e tyre, në rastet kur ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të ofrojë këshillim në lidhje me kripto-asete ose administrimin e portofolit të kripto-aseteve;

(r) informacion mbi mënyrën se si do të ofrohen shërbimet e transferimit, në rastet kur ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të ofrojë shërbime transferimi për kripto-asete në emër të klientëve;

(s) llojin e kripto-asetit me të cilin lidhet shërbimi për kripto-asete.

3. Për qëllimet e pikës 2, shkronja g) dhe h) të këtij neni, subjekti që kërkon të autorizohet për ofrimin e shërbimeve për kripto-asete duhet te përcjelle dokumentacionin qe verteton se:

   (a) dokumente që vërtetojnë se të gjithë anëtarët e organit drejtues nuk janë në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krim ekonomik apo vepra të tjera penale në kundërshtim me legjislacionin për shoqëritë tregtare, falimentin, shërbimet financiare, organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, financimin e armëve të shkatërrimit në masë si dhe përgjegjësinë profesionale;

   (b) dokumente që vertëtojnë se anëtarët e organit drejtues të subjektit që kërkon të emetojë tokenin e asetit, në mënyre kolektive, zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e përshtatshme për të administruar emetuesin e tokenit të asetit dhe që këta anëtarë do të

angazhohen me kohë të mjaftueshme për të kryer detyrat e tyre;

(c) dokumente që vërtetojnë se të gjithë aksionarët ose anëtarët, që zotërojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, një pjesëmarrje influencuese në subjektin kërkues nuk janë në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krim ekonomik apo vepra të tjera penale në kundërshtim me legjislacionin për shoqëritë tregtare, falimentin, shërbimet financiare, organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, financimin e armëve të shkatërrimit në masë si dhe përgjegjësinë profesionale

4. Për subjektet që janë licencuar, autorizuar ose njohur nga AMF në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi, nuk do të kërkohen informacionet e listuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, të cilat janë shqyrtuar nga Autoriteti gjatë procedurave të mëparshme të licencimit, autorizimi apo njohjes së tyre, për aq kohë sa këto informacione janë ende në fuqi.

4. Për qëllime të këtij neni, AMF miraton rregulla më të detajuara, lidhur me standartet teknike rregullatore të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni si dhe formatet, formularet e aplikimit dhe procedurat e hollësishme të autorizimit si ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve .

Neni 63
Shqyrtimi i kërkesës për autorizim dhe dhënia ose refuzimi i autorizimit

1. Brenda 5 ditëve pune nga marrja e kërkesës, AMF njofton , ofruesit e shërbimeve për kripto-asete, marrjen e kërkesës së tyre, sipas nenit 62, pika 1

2. Brenda 25 ditëve pune nga marrja e kërkesës, AMF shqyrton kërkesën dhe listën e dokumenteve të depozituara sipasnenit 62, pika 2 të këtij ligji.

Në rastet kur Autoriteti, konstaton se kërkesa e dorëzuar nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, i kërkon subjektit , që brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti, të plotësojë kërkesën duke specifikuar dokumentet që mungojnë.

3. Nëse subjekti kërkues nuk dorëzon dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, Autoriteti refuzon kërkesën dhe njofton subjektin kërkues për refuzimin e kërkesës, duke dhënë argumentet përkatëse.

4. AMF njofton pa vonesa subjektin aplikues për ofrues të shërbimeve për kripto-asete sapo konstaton që aplikimi është i plotë. .

5. Përpara se të miratojnë ose refuzojnë autorizimin si ofrues shërbimesh për kripto-asete, AMF

konsultohet paraprakisht me autoritetet përgjegjëse të një shteti tjetër kur aplikuesi si ofruesi i shërbimeve për kripto-asete ndodhet në një nga pozicionet e mëposhtme në raport me një institucion krediti, një depozitar qendror të titujve, një shoqëri komisionere, një operator tregu, një shoqëri administruese SIKTT, një shoqëri administruese efondeve të investimeve alternative , një institucion pagese, një shoqëri sigurimi, një institucion paraje elektronike ose një institucion për ofrimin e pensioneve profesionale, të licencuar ose autorizuar në atë shtet:

(a) është shoqëri bijë ;ose
(b) është shoqëri bijë e shoqërisë mëmë të atij subjekti; ose
(c) kontrollohet nga të njëjtët persona fizikë/juridikë apo individë që kontrollojnë atë subjekt.

6. Përpara se të miratojnë ose refuzojnë autorizimin si ofrues shërbimesh për kripto-asete, AMF:

(a) konsultohet me autoritetin përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për të verifikuar që ofruesi i shërbimeve për kripto-asete që aplikon nuk ka qenë subjekt i një hetimi për veprime që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e armëve të shkatërrimit në masë;

(b) sigurohet që subjekti aplikues për ofrues i shërbimeve për kripto-asete , i cili operon në seli ose mbështetet në palë të treta të vendosura në vende të treta me rrezik të lartë, respekton dispozitat e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

(c) sigurohet që aplikuesi për ofrues të shërbimeve për kripto-asete, ka procedura të përshtatshme për të zbatuar vigjilencën e zgjeruar në përputhje dispozitat e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në rastet kur është e aplikueshme.

7. Në rastet kur ekzistojnë lidhje të ngushta midis aplikuesit për ofrues të shërbimeve për kripto-asete dhe personave të tjerë fizikë/juridikë apo individë, AMF do lëshon autorizimin vetëm në rastet kur ato lidhje nuk pengojnë ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

8. AMF refuzon autorizimin nëse ligjet, aktet nënligjore ose dispozitat administrative të një vendi të tretë që rregullojnë një ose më shumë persona fizikë/juridikë apo individë me të cilët ofruesi i shërbimeve për kripto-asete që aplikon ka lidhje të ngushta, ose vështirësitë që lidhen me zbatimin e tyre, pengojnë ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

9. Brenda 40 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës së plotë AMF do të vlerësojë nëse subjekti aplikuesi për ofrues të shërbimeve për kripto-asete që aplikon është në përputhje me kërkesat e këtij Kreu, duke marrë parasysh natyrën, madhësinë dhe kompleksitetin e shërbimeve për kripto-asete që aplikuesi synon të ofrojë.. Autoritetet përgjegjëse marrë një vendim të argumentuar për miratimin ose refuzimin e autorizimit si ofrues shërbimesh për

kripto-asete dhe e njoftojnë aplikantin për vendimin e tyre brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së tij .

10. AMF refuzon autorizimin si ofrues shërbimesh për kripto-asete, kur ka arsye objektive dhe të justifikuara se:

(a) organi drejtues i ofruesit të shërbimeve për kripto-asete që aplikon paraqet një kërcënim (ose rrezik) për menaxhimin efektiv, të qëndrueshëm dhe të kujdesshëm, vazhdimësinë e biznesit dhe marrjen e konsideratës së duhur për interesat e klientëve të tij dhe integritetin e tregut, ose e ekspozon ofruesin e shërbimeve për kripto-asete që aplikon ndaj një rreziku serioz të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose financimit të armëve të shkatërrimit në masë;

(b) anëtarët e organit drejtues të ofruesit të shërbimeve për kripto-asete që aplikon nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 68, pika 1 e këtij ligji;
(c) aksionarët ose anëtarët, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që kanë pjesëmarrje influencuese në ofruesin e shërbimeve për kripto-asete që aplikon, nuk plotësojnë kriteret e reputacionit të mjaftueshëm të përcaktuara në nenin 68, pika 2;
(d) ofruesi i shërbimeve për kripto-asete që aplikon nuk arrin të përmbushë ose ka gjasa të mos përmbushë ndonjë nga kërkesat e këtij Kreu.

11. Për qëllime të këtij neni, AMF, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, mund të miratojë rregulla më të detajuara, lidhur me vlerësimin e përshtatshmërisë së anëtarëve të organit drejtues të ofruesit të shërbimeve për kripto-asete që aplikon dhe të aksionarëve ose anëtarëve, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që kanë pjesëmarrje influencuese në ofruesin e shërbimeve për kripto-asete që aplikon.

12. AMF , gjatë periudhës së vlerësimit të parashikuar në pikën 9, dhe jo më vonë se në ditën e 20-të të punës , mund të kërkojnë çdo informacion shtesë që është i nevojshëm për të përfunduar vlerësimin. Kjo kërkesë bëhet me shkrim për ofruesin e shërbimeve për kripto-asete që aplikon dhe specifikon informacionin shtesë të kërkuar.

Periudha e vlerësimit sipas pikës 9 do të pezullohet për periudhën midis datës së kërkesës për informacion të munguar nga autoritetet përgjegjëse dhe marrjes së një përgjigjeje nga ofruesi i shërbimeve për kripto-asete që aplikon. Pezullimi nuk kalon 20 ditë pune. Çdo kërkesë shtesë nga autoritetet përgjegjëse për plotësim ose sqarim të informacionit është në diskrecionin e tyre, por nuk do të rezultojë në pezullimin e periudhës së vlerësimit sipas pikës 9 të këtij neni.

12. Brenda dy ditëve pune nga dhënia e autorizimit, AMF përditëson në regjistër informacionin e specifikuar në Nenin 109, pika 5. AMF e bën informacionin e përcaktuar në Nenin 109, pika 5 të disponueshëm në regjistër deri në datën e fillimit të ofrimit të

shërbimeve për kripto-asete.

Neni 64
Revokimi i autorizimit ndaj një ofruesi të shërbimeve për kripto-asete

1. AMF do të revokojnë autorizimin e një ofruesi të shërbimeve për kripto-asete nëse ai:

(a) nuk ka nisur veprimtarinë për të cilën është autorizuar brenda 12 muajve nga data e dhënies së autorizimit;

(b) ka hequr dorë me kërkesën e tij nga autorizimi i tij;

(c) nuk ka ofruar shërbime për kripto-asete për 9 muaj rradhazi;

(d) ka marrë autorizimin si ofrues i shërbimeve për kripto-asete përmes mënyrave të parregullta, siç është dhënia e deklaratave ose dokumenteve të rreme gjatë kërkesës për autorizim;

(e) nuk përmbush më kushtet në bazë mbi të cilat është dhënë autorizimi dhe nuk ka ndërmarrë veprimet korrigjuese të kërkuara nga AMF brenda afatit të përcaktuar;

(f) nuk arrin të vendosë sisteme, procedura dhe masa efektive për të zbuluar dhe parandaluar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit ose financimin e armëve të shkatërrimit në masë në përputhje me legjislacionin në fuqi

(g) ka shkelur rëndë këtë ligj, duke përfshirë dispozitat që lidhen me mbrojtjen e mbajtësve të kripto-aseteve ose të klientëve të ofruesve të shërbimeve për kripto-asete, ose integritetin e tregut.

2. Autoritetet përgjegjëse mund të revokojnë autorizimin si ofrues i shërbimeve për kripto-asete në një nga situatat e mëposhtme:

   (a) ofruesi i shërbimeve për kripto-asete ka shkelur dispozitat e legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
   (b) ofruesit të shërbimeve për kripto-asete i është hequr autorizimi isi institucion pagese ose autorizimi si institucion parash elektronike, dhe ai ofrues i shërbimeve për kripto-asete nuk të korrigjojë situatën brenda 40 ditëve.

3. Autoritetet përgjegjëse mund ta kufizojnë heqjen e autorizimit vetëm për një shërbim të veçantë për kripto-asete.
4. Përpara heqjes së një autorizimi si ofrues i shërbimeve për kripto-asete, AMF konsultohen me autoritetin përgjegjës të një shteti tjetër, kur ofruesi i shërbimeve për kripto-asete përkatës është:

(a) është shoqëri bijë ;ose
(b) është shoqëri bijë e shoqërisë mëmë të atij subjekti; ose
(c) kontrollohet nga të njëjtët persona fizikë/juridikë apo individë që kontrollojnë atë subjekt.

5. Përpara heqjes së autorizimit si ofrues i shërbimeve për kripto-asete, autoritetet përgjegjëse mund të konsultohen me autoritetin përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.
6. Në rast se ka dyshime të arsyeshme, AMF mund të kërkojë në çdo kohë informacion në nga autoritetet mbikëqyrëse të shtetit të origjinës, për të verifikuar nëse ofruesi i shërbimeve për kripto-asete është ende në përputhje me kushtet në bazë të të cilave i është dhënë autorizimi.
7. Ofruesit e shërbimeve për kripto-asete hartojnë dhe implementojnë procedura të përshtatshme që sigurojnë transferimin pa vonesa dhe në mënyrë të rregullt të kripto-aseteve dhe fondeve të klientëve të tyre tek një ofrues tjetër i shërbimeve për kripto-asete, në rastet kur hiqet autorizimi.

Neni 65
Ofrimi ndërkufitar i shërbimeve për kripto-asete

1. Një ofrues i shërbimeve për kripto-asete, që synon të ofrojë shërbime për kripto-asete jashtë Republikës së Shqipërisë, dorëzon informacionin e mëposhtëm tek AMF:

(a) një listë të shteteve në të cilat ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të ofrojë shërbime për kripto-asete;

(b) shërbimet për kripto-asete që ofruesi i shërbimeve për kripto-asete synon të ofrojë në bazë ndërkufitare;

(c) datën e fillimit të ofrimit të synuar të shërbimeve për kripto-asete;

(d) një listë të të gjitha aktiviteteve të tjera të ofruara nga ofruesi i shërbimeve për kripto-asete që nuk janë të mbuluara nga ky ligj.

2. Brenda 10 ditëve pune nga marrja e informacionit të përcaktuar në pikën 1, AMF ja përcjell atë autoriteteve përgjegjëse të shteteve pritëse dhe njofton pa vonesë ofruesin e shërbimeve të kripto-aseteve në lidhje me këtë komunikim.

3. Ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve fillon të ushtrojë veprimtarinë e shërbimeve të kripto-aseteve vetëm pasi ti nënshtrohet procedurave përkatëse të licencimit, autorizmit apo njohjes në përputhje me legjislacionin në fuqi të juridiksionit përkatës.

4. Në rastet kur një subjekt me seli jashtë Republikës së Shqipërisë, i cili është autorizuar si ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve në Bashkimin Evropian në përputhje me rregulloren (BE) 2023/1114 “Për tregjet e kripto-aseteve", kërkon të ushtrojë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, subjekti do t’i nënshtrohet procedurave të njohjes nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

5. Rregullat më të detajuara në lidhje me procedurat dhe dokumentacionin për njohjen në Republikën e Shqipërisë, të subjekteve të autorizura për ushtrimin e veprimtarisë si ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, miratohen me rregullore të AMF.

Seksioni 2:
Kushtet e autorizimit për ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve

Neni 66
Detyrimi për të vepruar me ndershmëri, integritet dhe profesionalizëm në interesin më të mirë të klientit

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve veprojnë me ndershmëri, integritet dhe në mënyrë profesionale, në përputhje me interesin më të mirë të klientëve ekzistues apo potencialë të tyre.
2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve u ofrojnë klientëve të tyre informacione të drejta, të qarta dhe jo keqorientuese, duke përfshirë këtu edhe materialet promovuese, të cilat duhet të identifikohen si të tilla. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve nuk duhet, qoftë në mënyrë të qëllimshme apo nga pakujdesia, të keqorientojnë një klient lidhur me avantazhet reale ose të perceptuara të ndonjë kripto-aseti.
3. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve paralajmërojnë klientët për rreziqet që lidhen me transaksionet në kripto-asete.

Në rastet kur ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete, këmbejnë kripto-asete me fonde ose me kripto-asete të tjera, japin këshilla në lidhje me kripto-asetet ose administrojnë portofole kripto-asetesh, ata vendosin në dispozicion klientëve të faqet e internetit përkatëse ku gjenden dokumentet informuese të kripto-aseteve për të cilat ofrojnë këto shërbime.

4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve publikojnë informacionin në lidhje me çmimet, kostot dhe tarifat, në një vend të dukshëm në faqen e tyre të internetit.

5. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve publikojnë, në një vend të dukshëm në faqen e tyre të internetit, informacionin lidhur me ndikimet kryesore negative në klimë dhe ndikimet e tjera negative lidhur me mjedisin të shkaktuara nga mekanizmi i konsensusit që përdoret për emetimin e secilit kripto-aset për të cilin ata ofrojnë shërbime. Ky informacion mund të merret nga dokumentet informuesee të kripto-aseteve.
6. Për qëllime të këtij neni, autoritetet përgjegjëse, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, mund të miratojë rregulla më të detajuara, lidhur me kushtet e përgjithshme, kriteret e veçanta, ose kriteret e tjera shtesë, në lidhje me treguesit e qëndrueshmërisë për ndikimet negative në klimë.

Neni 67
Kërkesat prudenciale

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve duhet të sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të kapitalit, i cili duhet të jetë në çdo kohë jo më i ulët se vlera më e lartë e cilësdo prej shumave të mëposhtme:

    a. Niveli minimal të kapitalit i përcaktuar në aneksin IV t këtij ligji; ose

    b. Një e katërta e shpenzimeve të përgjithshme fikse të vitit paraardhës, të rishikuara çdo vit.

2. Për efekt të përllogaritjes sipas pikës 1, shkronja b), Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve të cilët nuk kanë ushtruar aktivitet për një vit të plotë nga data e fillimit të ofrimit të shërbimeve përdorin shpenzimet fikse të parashikuara për 12 muajt e parë të ofrimit të shërbimeve, të përfshira në projeksionet e tyre, siç paraq në kërkesën e tyre për autorizim.

3. Për qëllimet e pikës 1, shkronja (b), ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve llogarisin shpenzimet fikse të vitit të kaluar, përmes të dhënave që rezultojnë nga pasqyrave financiare, duke zbritur zërat e mëposhtëm nga shpenzimet totale, pas shpërndarjes së fitimit tek aksionarët ose anëtarët, në pasqyrat e tyre financiare vjetore të audituara, ose, në pasqyrat financiare vjetore të përcjella tek AMF, në rastet kur nuk janë në dispozicion pasqyrat e audituara:

(a) bonuse dhe shpërblime të tjera për personelin, në masën që ato bonuse dhe shpërblime janë të lidhura me fitimin neto të ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve në vitin përkatës;

(b) pjesa e fitimit e punonjësve, drejtorëve dhe ortakëve në fitimet e llogaritura;

(c) ndarjet e tjera të fitimeve dhe shpërblimeve të tjera variabël, në masën që ato janë plotësisht

diskrecionale

(d) shpenzime të papërsëritshme që rrjedhin nga veprimtari të tjera jo të zakonshme.

4. Kriteri i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përmbushet nga subjektet në një nga format e mëposhtme ose përmes një kombinimi të tyre:

   (a) Fondeve të veta, të përbërë nga zërat dhe instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë, pas zbritjeve, në përputhje me rregulloren e nxjerrë nga AMF për kapitalin rregullator; ose
   (b) Një policë sigurimi që mbulon territoret e Republikës së Shqipërisë ku ofrohen shërbimet e kripto-aseteve.

5. Polica e sigurimit sipas pikës 4, shkronja b) të këtji neni përmban elementët e mëposhtëm:

   a. ka një afat fillestar jo më pak se një vit;
   b. ka një periudhë njoftimi për anulimin e saj prej të paktën 90 ditësh;
   c. është marrë nga një shoqëri sigurimi e licencuar për këtë klasë sigurimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë e sigurimit, ose nga një shoqëri sigurimi e licencuar në një nga vendet e Bashkimit Evropian;
   d. Ofrohet nga një palë e tretë.

1. Polica e sigurimit e përcaktuar në këtë pikë, duhet të përfshijë mbulimin kundrejt rrezikut të:
   a. humbjes së dokumenteve;
   b. paraqitjes së informacionit të rremë apo mashtrues;
   c. Veprimeve, gabimeve ose mosveprimeve që rezultojnë në shkelje të:

i. detyrimeve ligjore dhe rregullatore;
ii. detyrimit për të vepruar në mënyrë të drejtë, të ndershme,të paanshme dhe profesionale kundrejt klientëve të tyre;;
iii. detyrimet në kuadër të konfidencialitetit;

   d. Mungesës së implementimit të procedurave të përshtatshmë për shmangien e konfliktit të interesit;
   e. humbjeve që vijnë si rezultat i ndërprerjes së veprimtarisë së shoqërisë ose dështimet e sistemit;
   f. Mosveprimeve neglizhente kundrejt ruajtjes së kripto-aseteve dhe fondeve të klientëve,.
   g. Përgjegjësisë së ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve ndaj klientëve në përputhje me nenin 75, pika 8.

Neni 68
Politikat e qeverisjes

1. Anëtarët e organit drejtues të ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve janë me reputacion të mirë dhe kanë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e duhur, individualisht dhe në mënyrë

kolektive, për të përmbushur detyrat e tyre. Në veçanti, anëtarët e organit drejtues të ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, financimin e armëve të shkatërrimit në masë, ose për vepra të tjera që do të ndikonin në reputacionin e tyre të mirë. Ata duhet gjithashtu të dëshmojnë se janë të aftë të angazhohen me kohë të mjaftueshme për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive.

2. Aksionarët dhe anëtarët me pjesëmarrje influencuese, qoftë në mënyrë direkte ose jo direkte, të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve, kanë reputacion të mirë dhe, në veçanti, nuk janë dënuar për vepra penale që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, financimin e armëve të shkatërrimit në masë, ose për vepra të tjera që do të ndikonin në reputacionin e tyre të mirë.
3. Në rastet kur ndikimi i ushtruar nga aksionarët ose anëtarët që zotërojnë, në mënyre direkte ose indirekte, pjesëmarrje influencuese në një ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve, është i tillë që mund të dëmtojë administrimin e shëndetshëm dhe të kujdesshëm të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve, AMF ndërmerr masat e duhura për të adresuar rreziqet e lidhura.

Masat e ndërmara nga AMF mund të përfshijnë kërkesa drejt organeve gjyqësore ose vendosjen e gjobave ndaj drejtorëve dhe/ose personave përgjegjës për administrimin e shoqërisë, ose pezullimin e ushtrimit të të drejtës së votimit që lidhen me aksionet e mbajtura nga aksionarët ose anëtarët që zotërojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve.

4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve hartojnë dhe implementojnë politika dhe procedura efektive për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj.
5. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve punësojnë personel të përshtatshëm, të cilët zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe ekspertizën e nevojshme për kryerjen e detyrave të ngarkuara ndaj tyre, duke marrë në konsideratë madhësinë, natyrën dhe gamën e shërbimeve të kripto-aseteve të ofruara.
6. Organi drejtues i ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve vlerëson dhe rishikon periodikisht efektivitetin e politikave, rregulloreve dhe procedurave të implementuara për të siguruar përputhshmërinë me seksionet 2 dhe 3 të këtij Kreu, si dhe ndërmerr masa të duhura për të adresuar çdo mangësi në këtë drejtim.
7. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshme për të siguruar vazhdimësinë dhe rregullsinë e ofrimit të shërbimeve të kripto-aseteve. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve sigurojnë burime dhe procedura të përshtatshme dhe proporcionale, duke përfshirë sisteme të qëndrueshme dhe të sigurta të teknologjisë së informacionit, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve hartojnë politika në lidhje me vazhdimësinë e biznesit, të cilat duhet të përfshijnë planin e vazhdimësisë së TIK, menaxhimin e vazhdimësisë së shoqërisë

si dhe plane për rimëkëmbje ndaj katastrofave, të cilat duhet të sigurojnë ruajtjen e sigurt të të dhënave dhe funksioneve thelbësore si dhe vjimin e ofrimit të shërbimeve në mënyrë të rregullt.

8. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve vendosin mekanizma, sisteme dhe procedura efektive për vlerësimin e riskut, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat i nënshtrohen vlerësimeve periodike për të siguruar efektivitetin e tyre, duke marrë në konsideratë madhësinë, natyrën dhe gamën e shërbimeve të kripto-aseteve të ofruara. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve marrin masa të përshtatshme për të adresuar çdo mangësi në këtë drejtim.

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve vendosin sisteme dhe procedura për të mbrojtur disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

9. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve sigurojnë ruajtjen e të dhënave të të gjitha shërbimeve të kripto-aseteve, veprimtarive, urdhrave dhe transaksioneve të kryera prej tyre. Këto të dhëna duhet të jenë mjaftueshëm të detajuara për t'i mundësuar AMF përmbushjen e funksioneve të saj të mbikëqyrjes dhe zbatueshmërisë, veçanërisht për të konstatuar nëse ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve kanë përmbushur të gjitha detyrimet ligjore, përfshirë ato në lidhje me klientët ekzistues ose potencial, si dhe në kuadër të integritetit të tregut.

Të dhënat e ruajtura në përputhje me pikën 9 të këtij neni iu vendosen në dispozicion klientëve, me kërkesë, dhe ruhen për një periudhë prej të paktën 5 vitesh, ose në rastet kur kërkohet nga AMF, përpara përfundimit të përiudhës 5-vjeçare, deri në 7 vjet.

10. Për qëllime të këtij neni, AMF miraton rregulla më të detajuara, lidhur me:

    (a) masat që sigurojnë vazhdimësinë dhe rregullsinë në kryerjen e shërbimeve të kripto-aseteve të përcaktuara në pikën 7;

    (b) të dhënat që ruhen për të gjitha shërbimet, veprimtaritë, urdhrat dhe transaksionet e kryera, të përcaktuara në pikën 9.

Neni 69
Ndryshimi i organit drejtues

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve njoftojnë pa vonesë AMF për çdo ndryshim në organin e tyre drejtues, përpara se anëtarët e rinj të fillojnë ushtrimin e detyrave, dhe i përcjellin autoritetit të gjithë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat e nenit 68, të këtij ligji.

Neni 70

Ruajtja e kripto-aseteve dhe fondeve të klientëve

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që mbajnë, ose që mundësojnë mjetet e aksesit të kripto-aseteve që u përkasin klientëve ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të garantuar sigurimin e të drejtave të pronësisë së klientëve për të cilët ofron shërbimin e kujdestarisë, përfshirë këtu rastet e paaftësisë paguese, likujdimit dhe falimentit, dhe parandaluar përdorimin e këtyre kripto-aseteve për llogari të vetë.
2. Në rastet kur modeli i biznesit ose shërbimet e kripto-aseteve kërkon mbajtjen e fondeve të klientëve, të ndryshëm nga tokenat e parasë elektronike, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të garantuar të drejtat e pronësisë të klientëve dhe për të parandaluar përdorimin e fondeve të klientëve për llogari të vetë.

3. Brenda 1 ditë pune nga marrja e fondeve të klientëve të ndryshme nga tokeni i parasë elektronike, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve depozitojnë fondet e klientëve të ndryshme nga tokeni i parasë elektronike, në një institucion krediti ose në një bankë qendrore, në rast se është e aplikueshme.

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fondet e klientëve, të ndryshëm nga tokenat e parasë elektronike, të mbajtura në një institucion krediti ose bankë qendrore, të jenë në llogari të ndara veçmas nga çdo llogari e përdorur për të mbajtur fondet e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve.

4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve mund të ofrojnë, vetë ose përmes një pale të tretë, shërbime të pagesave të lidhura me shërbimin e kripto-aseteve që ofrojnë, me kusht që ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve, ose pala e tretë, të jetë e licencuar për të ofruar këto shërbime në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimet dhe institucionet e pagesave.

Në rastet kur ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve ofrojnë edhe shërbime të pagesave, ata informojnë klientët e tyre në lidhje me:

(a) natyrën dhe kushtet e atyre shërbimeve, duke përfshirë bazën ligjore dhe të drejtat e klientëve;

(b) informacion nëse këto shërbime ofrohen nga ata drejtpërdrejt ose nga një palë e tretë.

5. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve të cilët janë institucione të parasë elektronike, institucion pagesash, ose institucione krediti përjashtohen nga zbatimi i pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 71

Procedurat për trajtimin e ankesave

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve hartojnë dhe implementojnë politika efektive dhe transparente për trajtimin e shpejtë, të drejtë dhe të njëtrajtshëm të ankesave të marra nga klientët, të cilat pasqyrohen në faqen e tij internetit
2. Procedura e trajtimit të ankesave të klientëve nga ana e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve duhet të jetë pa pagesë
3. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve informojnë klientët në lidhje me mundësinë e paraqitjes së një ankese. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve vendosin në dispozicion të klientëve një model formati për paraqitjen e ankesave dhe mbajnë një regjistër të të gjitha ankesave të marra, ku pasqyrohet edhe mënyra e trajtimit të tyre.
4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve hetojnë të gjitha ankesat në një mënyrë të drejtë dhe të shpejtë dhe të komunikojnë rezultatin e këtyre hetimeve klientëve të tyre brenda një periudhe të arsyeshme.
5. Për qëllime të këtij neni, autoritetet përgjegjëse, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, mund të miratojë rregulla më të detajuara, për të përcaktuar më tej kërkesat, modelet dhe procedurat për trajtimin e ankesave.

Neni 72

Identifikimi, parandalimi, menaxhimi dhe publikimi i konflikteve të interesit

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve hartojnë dhe implementojnë politika dhe procedura efektive, në përputhje me madhësinë, natyrën dhe gamën e shërbimeve të kripto-aseteve të ofruara, për identifikimin parandalimin menaxhimin dhe publikimin e konfliktit të interesit ndërmjet:

(a) Ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve dhe:

(i) aksionarëve ose anëtarëve të tyre;

(ii) çdo personi të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve ose aksionarët apo anëtarët e tyre përmes kontrollit;

(iii) anëtarëve të organit të tyre drejtues;

(iv) punonjësve të tyre; ose

(v) klientëve të tyre; ose

(b) dy ose më shumë klientëve, interesat e ndërsjella të të cilëve janë në konflikt.

2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve publikojnë në një vend të dukshëm në faqen e tyre të internetit, natyrën e përgjithshme dhe burimet e konflikteve të interesit të referuara në pikën 1, si dhe hapat e ndërmarrë për t'i adresuar ato.
3. Publikimi sipas pikës 2 të këtij neni bëhet në format elektronik dhe përfshin të dhëna të mjaftueshme, duke marrë parasysh natyrën e çdo klienti, me qëllim që t'i mundësojë këtij të fundit të marrë një vendim të informuar lidhur me shërbimin e kripto-aseteve në kontekstin e të cilit lind konflikti i interesit.
4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve vlerësojnë dhe rishikojnë periodikisht, të paktën një herë në vit, politikën e tyre për konfliktet e interesit dhe ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të adresuar çdo mangësi në këtë drejtim.
5. Për qëllime të këtij neni, AMF miraton rregulla më të detajuara, lidhur me:
   (a) kërkesat për politikat dhe procedurat e referuara në pikën 1, duke marrë parasysh madhësinë, natyrën dhe gamën e shërbimeve të kripto-aseteve të ofruara;
   (b) detajet dhe metodologjinë për përmbajtjen e deklarimit të referuar në pikën 2.

Neni 73

1. Në rastet kur ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve delegon një pjesë të funksioneve ose detyrave të tij tek një palë e tretë, ai duhet të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të shmangur rreziqet operacionale si dhe për të ruajtur një nivel të përshtatshëm të ofrimit të shërbimit ndaj klientëve të tij.
   Ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve është përgjegjës për cilësinë e shërbimit të ofruar dhe për të gjitha dëmet ose pasojat që mund te shkaktohen si rrjedhojë e delegimit të detyrave të saj tek një palë e tretë dhe siguron përmbushjen e kushteve të mëposhtme:

(a) delegimi nuk shkarkon nga përgjegjësia ligjore ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve;

(b) delegimi nuk ndikon në marrëdhënien e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve me klientët e tij, duke përfshirë këtu detyrimet e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve kundrejt tyre;

(c) delegimi nuk ndikon në kushtet e autorizimit të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve;

(d) palët e treta të cilëve i delegohen një ose më shumë funksione apo detyra do të veprojnë gjithnjë në mënyrë bashkëpunuese me AMF dhe delegimi i funksioneve nuk duhet të cënojë veprimtarinë mbikëqyrëse të AMF kundrejt ofruesit të shërbimeve , përfshirë këtu aksesin e Autoritetit në selitë e palëve të treta për të ushtruar funksionet mbikqëyrëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.

(e) ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve ka ekspertizën e duhur për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara nga pala e tretë dhe për të mbikëqyrur në mënyrë efektive shërbimet e deleguara.

(f) ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve ka qasje të menjëhershme në informacionin përkatës në lidhje me shërbimet e deleguara.

(g) palëve të treta të cilave i delegohen një ose më shumë shërbime janë në përputhje me standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për qëllimet e pikës 1, shkronja (g), ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve janë përgjegjës për sigurimin që standardet e mbrojtjes së të dhënave të përcaktohen në marrëveshjet me shkrim të sipas pikës 3 të këtij neni.

2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve hartojnë dhe implementojnë politika mbi delegimin e funksioneve dhe detyrave, duke përfshirë planet e kontigjencës dhe strategjitë e tërheqjes, duke marrë parasysh madhësinë, natyrën dhe gamën e shërbimeve të kripto-aseteve të ofruara.
3. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve përcaktojnë në një marrëveshje me shkrim të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe të palëve të treta të cilave u nënkontraktojnë shërbime ose aktivitete. Marrëveshjet e nënkontraktimit u japin të drejtën ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve të ndërpresin këto marrëveshje.
4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve dhe palët e treta duhet, me kërkesë, t'i vënë në dispozicion autoriteteve përgjegjëse dhe autoriteteve të tjera përkatëse të gjithë informacionin e nevojshëm për t'i mundësuar atyre të vlerësojnë përputhshmërinë e aktiviteteve të nënkontraktuara me kërkesat e këtij Kreu.

Neni 74

Likuidimi vullnetar i ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë shërbimet e referuara në nenet 75 deri 79 hartojnë një plan të përshtatshëm për të siguruar likuidimin vullnetar të veprimtarive të tyre sipas legjislacionin në fuqi, duke përfshirë vazhdimësinë ose rikuperimin e çdo aktiviteti kritik të kryer nga këta ofrues shërbimesh. Ky plan demonstron aftësinë e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve për të kryer procedurat e likuidimit vullnetar pa shkaktuar dëme ekonomike të panevojshme për klientët e tyre.

Seksioni 3:
Detyrimet në lidhje me shërbimet specifike të kripto-aseteve

Neni 75

Kujdestaria dhe administrimi i kripto-aseteve për llogari të klientëve

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë kujdestari dhe administrim të kripto-

aseteve për llogari të klientëve lidhin një marrëveshje me klientët e tyre për të specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Një marrëveshje e tillë përfshin të paktën sa vijon:

(a) identitetin e palëve në marrëveshje;

(b) natyrën e shërbimit të kripto-aseteve të ofruar dhe një përshkrim të tij;

(c) politikën e kujdestarisë;

(d) mënyrat e komunikimit ndërmjet ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve dhe klientit, duke përfshirë sistemin e autentifikimit të klientit;

(e) një përshkrim të sistemeve të sigurisë të përdorura nga ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve;

(f) tarifat, kostot dhe pagesat që aplikohen nga ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve;

(g) ligjin e zbatueshëm.

2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve mbajnë një regjistër të pozicioneve, i cili hapet në emrin e çdo klienti, dhe që përfaqëson të drejtat e çdo klienti mbi kripto-asetet. Në rastet kur është e zbatueshme, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve regjistrojnë sa më shpejt që të jetë e mundur çdo lëvizje që udhëzohet nga klientët e tyre. Në raste të tilla, procedurat e tyre të brendshme sigurojnë që këto lëvizje të vërtetohen nga një transaksion i regjistruar në regjistrin e pozicioneve të klientit.

3. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve krijojnë një politikë kujdestarie e cila përmban rregulla dhe procedura të brendshme për të siguruar ruajtjen, kontrollin, ose mjetet e aksesit në këto kripto-asete. Politika e kujdestarisë duhet të minimizojë rrezikun e humbjes së kripto-aseteve të klienteve, si dhe të drejtave ose mjeteve të aksesit në kripto-asete për shkak të mashtrimit, kërcënimeve kibernetike ose neglizhencës. Një përmbledhje e politikës së kujdestarisë vihet në dispozicion të klientëve sipas kërkesës në format elektronik.

4. Në rastet kur është e zbatueshme, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve lehtësojnë ushtrimin e të drejtave që lidhen me kripto-asetet. Çdo ngjarje që ka gjasa të krijojë ose modifikojë të drejtat e një klienti regjistrohet menjëherë në regjistrin e pozicioneve të klientit.

Në rastet kur ka ndryshime në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë të kripto-aseteve ose ndonjë ngjarje tjetër që ka gjasa të krijojë ose modifikojë të drejtat e një klienti, klienti ka të drejta për çdo kripto-aset të ri mbi bazën dhe në masën e pozicioneve të klientit në kohën e ndodhjes së ndryshimit ose ngjarjes, përveç rastit kur një marrëveshje e nënshkruar përpara

ndryshimit ose ngjarjes me ofruesin e shërbimeve të kripto-aseteve që ofron kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve, sipas pikës 1, parashikon ndryshe.

5. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve ofrojnë për klientët e tyre, të paktën një herë çdo tre muaj dhe sipas kërkesës së klientit të interesuar, një përmbledhje të pozicionit të kripto-aseteve të regjistruara në emrin e tyre. Kjo përmbledhje bëhet në format elektronik. Përmbledhja e pozicionit identifikon kripto-asetet përkatëse, balancën e tyre, vlerën e tyre dhe transferimet e kripto-aseteve të kryera gjatë periudhës përkatëse.

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve u ofrojnë klientëve të tyre sa më shpejt që të jetë e mundur çdo informacion rreth operacioneve me kripto-asete që kërkojnë një përgjigje nga ata klientë.

6. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve të cilët ofrojnë shërbimin e kujdestarisë dhe administrimit të kripto-aseteve për llogari të klientëve hartojnë dhe implementojnë procedura të brendshme të cilat mundësojnë kthimin tek klientët të kripto-aseteve të mbajtura për llogari të tyre ose mjetet e aksesit të këtyre kripto-aseteve, pa vonesa.
7. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve veçojnë kripto-aseteve për llogari të klientëve të tyre nga zotërimet e tyre personale dhe sigurojnë që mjetet e aksesit në kripto-asetet e klientëve të jenë qartësisht të identifikuara si të tilla. Ofruesit sigurohen që kripto-asetet e klientëve mbahen të ndara veçmas nga kripto-asetet e tyre në regjistrin e shpërndarë.

Kripto-asetet e mbajtura në kujdestari për llogari të klientëve veçohen ligjërisht nga pasuritë e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që kreditorët e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve të mos kenë mundësi të kenë pretendime mbi kripto-asetet e mbajtura në kujdestari nga ai ofrues, veçanërisht në rastin e falimentimit.

Ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve sigurohet që kripto-asetet e mbajtura në kujdestari të veçohen operacionalisht nga pasuritë e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve.

8. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve të cilët ofrojnë shërbimin e kujdestarisë dhe administrimit të kripto-aseteve për llogari të klientëve janë përgjegjës ndaj klientëve të tyre për humbjen e çdo kripto-aseti ose të mjeteve të aksesit të kripto-asetit si rezultat i një incidenti për faj të tyre. Përgjegjësia e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve do të kufizohet në vlerën e tregut të kripto-asetit të humbur, në kohën kur ndodhi humbja.

Incidentet për të cilat ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve vërteton se nuk janë të lidhura me ofrimin e shërbimit përkatës, ose me veprimtaritë operacionale të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve, sikundër një problem në funksionimin e regjistrit të shpërndarë, i cili nuk kontrollohet nga ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve, nuk do të konsiderohen si incidente për

faj të tij.

9. Në rastet kur ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve të cilët ofrojnë shërbimin e kujdestarisë dhe administrimit të kripto-aseteve për llogari të klientëve përdorin ofrues të tjerë shërbimi për kripto-asete për të ofruar të njëjtin shërbim, ata mund të përdorin vetëm ofrues shërbimi për kripto-asete të autorizuar në përputhje me Nenin 59 të këtij ligji.

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve, i njoftojnë klientët e tyre për kontraktimin e një ofruesi tjetër të këtij shërbimi.

Neni 76

Operimi i një platforme tregtimi për kripto-asetet

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-asetetev të cilët operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete përcaktojnë hartojnë dhe implementojnë rregulla të qarta dhe transparente për operimin e platformës së tregtimit, të cilat përfshijnë të paktën:

(a) procedurat e pranimit për tregtim të kripto-aseteve në platformën e tregtimit, përfshirë këtu kërkesa për vigjilencën e duhur ose të zgjeruar, në përputhje me profilin e rrezikut të kërkuesit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

(b) përcaktimin e kategorive të përjashtimit të llojeve të kripto-aseteve që nuk do të pranohen për tregtim, në rastet kur është e aplikueshme;

(c) përcaktimin e politikave, procedurave dhe niveleve të tarifave, për pranimin në tregtim, në rastet kur është e aplikueshme;

(d) përcaktimin e rregullave të paanshme, jo-diskriminuese dhe kritereve proporcionale për pjesëmarrje në aktivitetet e tregtimit, të cilat promovojnë qasje të ndershme dhe të hapur në platformën e tregtimit për klientët që dëshirojnë të tregtojnë;

(e) përcaktimin e rregullave dhe procedurave të detyrueshme për të siguruar tregtimin e drejtë dhe të rregullt, si dhe kritereve objektive për ekzekutimin efikas të urdhërave;

(f) përcaktimin e kushteve për të siguruar mbajtjen e kripto-aseteve të disponueshme për tregtim, përfshirë këtu pragun e likuiditetit dhe kërkesat për raportim periodik;

(g) përcaktimin e kushteve për pezullimin e tregtimit të kripto-aseteve;

(h) përcaktimin e procedurave për të siguruar shlyerjen efikase të transaksioneve të kripto-

aseteve dhe fondeve.

Për qëllime të shkronjës (a) të pikës 1 të këtij neni, rregullat e operimit duhet të specifikojnë qartë se një kripto-aset nuk mund të pranohet për tregtim nëse nuk është publikuar një dokument informues i tij, në rastet e kërkuara nga ky ligj.

2. Para se të pranojnë një kripto-aset për tregtim, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete sigurojnë që kripto-aseti është në përputhje me rregullat e operimit të platformës së tregtimit dhe të vlerësojnë përshtatshmërinë e kripto-asetit në fjalë. Gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së një kripto-aseti, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi shqyrtojnë në mënyrë të veçantë, qëndrueshmërinë e zgjidhjeve teknike të përdorura dhe mundësinë e lidhjes së tij me veprimtari të paligjshme ose mashtruese, duke marrë parasysh përvojën, historikun dhe reputacionin e emetuesit të kripto-aseteve, si dhe ekipin e tij zhvillues. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi duhet gjithashtu të vlerësojnë përshtatshmërinë e kripto-aseteve që nuk janë tokena të aseteve ose tokena të parasë elektronike të përcaktuar në nenin 4, pika 3, nën pika 1, shkronja (a) deri në (d).
3. Rregullat e operimit të platformës së tregtimit për kripto-asete ndalojnë pranimin për tregtim të kripto-aseteve që kanë një funksion anonimiteti të integruar brenda tyre, përveç rasteve kur ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë platformën e tregtimit mund të identifikojnë zotëruesit e atyre kripto-aseteve dhe historikun e transaksioneve të tyre.

4. Rregullat e operimit të përcaktuara në pikën 1 hartohen në gjuhën shqipe.

1. Nëse operimi i një platforme tregtimi për kripto-asete ofrohet në një shtet tjetër anëtar të BE, rregullat e operimit të përcaktuara në pikën 1 hartohen në një gjuhë zyrtare të shtetit pritës, ose në një gjuhë të përdorur zakonisht në financat ndërkombëtare.

5. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete nuk kryejnë tregti për llogari të vetë në platformën e tregtimit për kripto-asete që ata operojnë, përfshirë rastet kur ofrojnë këmbimin e kripto-aseteve kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera.
6. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete do të lejohen të përfshihen në tregtimin e bazuar në parimin e përputhshmërisë vetëm kur klienti ka dhënë pëlqimin për këtë proces. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve përcjellin informacionin përkatës AMF në lidhje me veprimtarinë e tregtimit të bazuar në parimin e përputhshmërisë. AMF monitoron veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve në tregtimin e bazuar në parimin e përputhshmërisë dhe sigurohet që kjo veprimtari vijon të jetë në përputhje me përkufizimin e tregtimit të tillë dhe nuk rezulton në lindjen e konflikteve të interesit midis ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve dhe klientëve të tyre.
7. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete hartojnë dhe implementojnë sisteme, procedura dhe marrëveshje efektive për të siguruar që sistemet e tyre të tregtimit:

(a) janë të qëndrueshme;

(b) kanë kapacitet të mjaftueshëm për të përballuar pikun e vëllimit të urdhrave dhe mesazheve;

(c) janë të afta për të garantuar tregtim të rregullt edhe në kushtet e luhatshmërisë së lartë të tregjeve;

(d) janë të afta të refuzojë urdhra tregtimit në rastet kur tejkalojnë pragjet e paracaktuara në lidhje me vëllimin dhe çmimin, ose në rastet kur këto urdhra janë dukshëm të pasaktë.

(e) janë testuar plotësisht për të siguruar që janë përmbushur kushtet e shkronjave (a) deri në (d);

(f) janë subjekt i marrëveshjeve efektive për vazhdueshmërinë e biznesit për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të tyre në rastet e mosfunksionimit ose ndërprerjes së sistemit të tregtimit;

(g) janë në gjendje të parandalojnë ose zbulojnë abuzimin me tregun;

(h) kanë kapacitete të mjaftueshme për të parandaluar keqpërdorimin e tyre për qëllime të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose financimit të armëve të shkatërrimit në masë.

8. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete informojnë AMF në rastet kur identifikojnë raste të abuzimit me tregun ose tentativa për abuzim me tregun që ndodhin në, ose përmes, sistemeve të tyre të tregtimit.
9. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete publikojnë çmimet e ofertave dhe kërkesave, si dhe thellësinë e interesave të tregtimit sipas çmimeve të kripto-aseteve që reklamohen përmes platformave të tyre të tregtimit. Ky informacion duhet të jetë i disponueshëm për publikun në mënyrë të vazhdueshme gjatë orareve të tregtimit.
10. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete publikojnë çmimin, vëllimin dhe kohën e transaksioneve të ekzekutuara në lidhje me kripto-asetet që tregtohen në platformat e tyre të tregtimit. Detajet e këtyre transaksioneve duhet të publikohen menjëhere në kohë reale, për aq sa është teknikisht e mundur.
11. Informacioni i publikuar nga ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve në përputhje me pikat 9 dhe 10 të këtij neni duhet të jetë i disponueshëm për publikun në baza të arsyeshme tregtare dhe të sigurojnë qasje jo-diskriminuese në atë informacion. Në çdo rast, ky informacion duhet të jetë i disponueshëm pa pagesë 15 minuta pas publikimit në një format të lexueshëm nga kompjuteri dhe duhet të mbetet i publikuar për të paktën dy vjet.
12. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete iniciojnë shlyerjen përfundimtare të një transaksioni të kripto-aseteve në regjistrin e shpërndarë brenda 24 orëve nga ekzekutimi i transaksionit në platformën e tregtimit ose, në rastet kur transaksionet shlyhet jashtë regjistrit të shpërndarë, deri në fundin e ditës që është ekzekutuar transaksioni.
13. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete sigurojnë që strukturat e tarifave të tyre janë transparente, të drejta dhe jo-diskriminuese, dhe

që nuk krijojnë stimuj për vendosjen, modifikimin ose anulimin e urdhërave ose për ekzekutimin e transaksioneve në mënyrë që kontribuon në kushte të parregullta tregtimi ose abuzim me tregun sipas përacktimeve të Kreut VI.

14. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi për kripto-asete mbajnë burime dhe pajisje rezervë për të siguruar raportimin e rregullt tek AMF në çdo kohë.
15. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që operojnë një platformë tregtimi vendosin në dispozicion të AMF të dhënat përkatëse në lidhje me të gjitha urdhërat për kripto-asete që reklamohen përmes sistemeve të tyre, për të paktën pesë vjet, ose i japin AMF qasje në librin e urdhërave, në mënyrë që autoriteti të ketë mundësinë të monitorojë veprimtarinë e tregtimit. Të dhënat përkatëse sipas kësaj pike përmbajnë karakteristikat e urdhrit, përfshirë ato që lidhin një urdhër me transaksionet e ekzekutuara që rrjedhin nga ai urdhër.
16. Për qëllime të këtij neni, AMF miraton më të detajuara, lidhur:

(a) mënyrën e prezantimit të të se si të dhënat e transparencës, përfshirë nivelin e detajimit të të dhënave që janë të disponueshme për publikun siç përmendet në pikat 1, 9 dhe 10, do të prezantohen;

(b) përmbajtjen dhe formatin e të dhënave të librave të urdhërave që mbahen siç specifikohet në pikiën 15.

Neni 77

Këmbimi i kripto-aseteve kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera

1. Ofruesit e shërbimeve t kripto-asetet që kryejnë këmbimin e kripto-aseteve kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera hartojnë dhe implementojnë një politikë tregtare të jo-diskriminuese që specifikon, në veçanti, llojin e klientëve me të cilët ata synojnë të ndërveprojnë dhe kushtet që duhet të përmbushin këta klientë.
2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që kryejnë këmbimin e kripto-aseteve kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera publikojnë një çmim të caktuar të kripto-aseteve ose një metodë për përcaktimin e çmimit të kripto-aseteve që ata propozojnë të këmbejnë kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera, si dhe çdo kufizim të zbatueshëm të përcaktuar nga ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve mbi shumën që do të këmbehet.
3. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që kryejnë këmbimin e kripto-aseteve kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera ekzekutojnë urdhërat e klientëve me çmimet e shfaqura në momentin kur urdhri për këmbim është përfundimtar. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve informojnë klientët e tyre në lidhje me kushtet kur një urdhër konsiderohet si përfundimtar.
4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që kryejnë këmbimin e kripto-aseteve kundrejt fondeve ose kripto-aseteve të tjera publikojnë informacione në lidhje me çmimin dhe vëllimin e transaksioneve të përfunduara nga ata.

Neni 78

Ekzekutimi i urdhërave për kripto-asete për llogari të klientëve

1. Gjatë ekzekutimit të urdhrave, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ekzekutojnë urdhrat për kripto-asete për llogari të klientëve ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm për klientët e tyre, duke marrë parasysh faktorët e çmimit, kostot, shpejtësinë, mundësinë e ekzekutimit dhe shlyerjes së transaksioneve, madhësinë, natyrën, kushtet e kujdestarisë së kripto-aseteve ose çdo konsideratë tjetër e aplikueshme për ekzekutimin e urdhërit.

Pavarësisht parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ekzekutojnë urdhërat për kripto-asete për llogari të klientëve nuk janë të detyruar të ndërmarrin hapat e nevojshëm të përcaktuar në nën pikën 1 në rastet kur ata ekzekutojnë urdhra për kripto-asete sipas udhëzimeve specifike të dhëna nga klientët e tyre.

2. Për të siguruar përputhshmërisë me pikën 1 të këtij neni, Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ekzekutojnë urdhërat për kripto-asete për llogari të klientëve hartojnë dhe implementojnë politika dhe masa të përshtatshme për ekzekutimin e urdhërave. Politika e ekzekutimit të urdhërave duhet, ndër të tjera, të parashikojë ekzekutimin e menjëhershëm, të drejtë dhe të shpejtë të urdhrave të klientëve dhe të parandalojë keqpërdorimin e çdo informacioni në lidhje me to nga punonjësit e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve.
3. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ekzekutojnë urdhërat për kripto-asete për llogari të klientëve informojnë klientët e tyre në mënyrë të qartë dhe të përshtatshme për për politikën e ekzekutimit të urdhërave të përcaktuar në pikën 2, si dhe për çdo ndryshim të rëndësishëm pasues. Ky informacion duhet të shpjegojë qartë dhe në mënyrë të kuptueshme për klientët, mënyrën e ekzekutimit të urdhërave të klientëve nga ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve duhet të marrin pëlqimin paraprak nga secili klient në lidhje me politikën e ekzekutimit të urdhrave.
4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ekzekutojnë urdhrat për kripto-asete për llogari të klientëve duhet të jenë në gjendje t'ju vërtetojnë klientëve të tyre, sipas kërkesës, që urdhrat janë ekzekutuar në përputhje me politikën e tyre të ekzekutimit të urdhrave dhe t'i vërtetojnë, AMF, në rast kërkese, përputhshmërinë e tyre me dispozitat e këtij neni.
5. Kur politika e ekzekutimit të urdhërave parashikon mundësinë që urdhërat e klientëve të ekzekutohen jashtë një platforme tregtimi, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ekzekutojnë këto urdhra informojnë klientët dhe marrin pëlqimin e tyre paraprak, qoftë në formën e një marrëveshjeje të përgjithshme ose për transaksione të veçanta, përpara se të vazhdojnë me ekzekutimin e urdhërave jashtë një platforme tregtimi,
6. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ekzekutojnë urdhëra për llogari të klientëve monitorojnë efektivitetin dhe politikën e masave të tyre për ekzekutimin e urdhërave për të identifikuar, dhe, në rast se është e nevojshme, për të korrigjuar çdo mangësi në këtë aspekt. Në veçanti, ata vlerësojnë, në mënyrë të vazhdueshme, nëse tregjet e ekzekutimit të përfshira në politikën e ekzekutimit të urdhërave ofrojnë ekzekutimin më të mirë të

mundshëm për klientët ose nëse duhen bëre ndryshime në politikat dhe masat e tyre për ekzekutimin e urdhrave. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ekzekutojnë urdhrat për llogari të klientëve njoftojnë klientët me të cilët kanë një marrëdhënie të vazhdueshme për çdo ndryshim thelbësor në masat ose politikat e tyre për ekzekutimin e urdhërave.

Neni 79

Hedhja në treg e kripto-aseteve

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që hedhin në treg kripto-asete i komunikojnë informacionin e mëposhtëm ofertuesit, personit që kërkon pranimin për tregtim, ose ndonjë pale të tretë që vepron në emër të tyre, përpara se të lidhin një marrëveshje me ta:

(a) llojin e hedhjes në treg që po konsiderohet, duke përfshirë informacionin nëse një shumë minimale blerjeje është e garantuar;

(b) informacion rreth shumës së komisioneve të transaksionit që lidhen me hedhjen në treg të propozuar;

(c) informacion në lidhje me afatet, procesin dhe çmimin për veprimtarinë e propozuar;

(d) informacion në lidhje me blerësit e synuar.

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që hedhin në treg kripto-asete duhet të marrin pëlqimin e emetuesve të atyre kripto-aseteve ose të ndonjë pale të tretë që vepron në emër të tyre në lidhje me informacionin e përcaktuar në shkronjat a, b, c, d, përpara hedhjes në treg të kripto-aseteve.

2. Politikat e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve mbi konfliktet e interesit të përcaktuara në nenin 72, pika 1 kanë procedura specifike dhe të përshtatshme për të identifikuar, parandaluar, administuar dhe publikuar çdo konflikt interesi që lind në një nga situatat e mëposhtme:

(a) Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve hedhin në treg kripto-asete për klientët e tyre;

(b) çmimi i propozuar për hedhjen në treg të kripto-aseteve është i mbivlerësuar ose i nënvlerësuar;

(c) Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve iu ofrohen incentive, përfshirë këtu edhe incentiva jo-monetare, nga ana e ofertuesit.

Neni 80

Marrja dhe transmetimi i urdhërave për kripto-asete për llogari të klientëve

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që marrin dhe transmetojnë urdhërat për kripto-asete për llogari të klientëve, hartojnë dhe implementojnë procedura dhe marrëveshje të cilat parashikojnë transmetimin e menjëhershëm dhe të saktë të urdhërave të klientëve, për ekzekutim në një platformë tregtimi për kripto-asete, ose tek një tjetër ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve.
2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që marrin dhe transmetojnë urdhërat për kripto-asete për llogari të klientëve nuk mund të marrin pagesa, shpërblime, zbritje ose përfitime jo-monetare në këmbim të drejtimit/orientimit të urdhërave të marra nga klientët në një platformë të veçantë tregtimi për kripto-asete ose tek një tjetër ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve.
3. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që marrin dhe transmetojnë urdhërat për kripto-asete për llogari të klientëve nuk duhet të keqpërdorin informacionin që lidhet me urdhrat e klientëve në pritje dhe ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të parandaluar keqpërdorimin e këtij informacioni nga punonjësit e tyre.

Neni 81

Këshillimi në lidhje me kripto-asetet dhe administrimi i portofolit të kripto-aseteve

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshilla në lidhje me kripto-asetet ose administrimin e portofolit të kripto-aseteve duhet të vlerësojnë nëse shërbimet e kripto-aseteve ose kripto-asetet janë të përshtatshme për klientët e tyre ekzistues ose potencialë, duke marrë në konsideratë njohuritë dhe përvojën e klientëve në investimin në kripto-asete, objektivat e tyre të investimit, përfshirë këtu tolerancën ndaj rrezikut, si dhe situatën e tyre financiare, përfshirë aftësinë e tyre për të përballuar humbje.
2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshilla në lidhje me kripto-asetet informojnë paraprakisht, klientët potencialë, në çdo rast, përpara dhënies së këshillave mbi kripto-asetet, nëse këshillat:

(a) janë dhënë në mënyrë të pavarur;

(b) janë mbështetur në një analizë të gjerë ose më të kufizuar të kripto-aseteve të ndryshme, duke përfshirë informacion nëse këshillat janë kufizuar në kripto-asete të emetuara ose të ofruara nga subjektet që kanë lidhje të ngushta me ofruesin e shërbimeve të kripto-aseteve ose ndonjë marrëdhënie tjetër ligjore ose ekonomike, sikundër janë marrëdhënie kontraktuale, të cilat rrezikojnë të dëmtojnë objektivitetin e këshillave të ofruara.

3. Në rastet kur një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve që ofron këshilla në lidhje me kripto-asetet informon klientin potencial se këshillimi është ofruar në mënyrë të pavarur, ai duhet:

(a) të vlerësojë një gamë të mjaftueshme të kripto-aseteve të disponueshme në treg, të cilat janë mjaftueshëm të divesifikuara, me qëllim sigurimin e përmbushjes së përshtatshme të objektivave të investimit të klientit dhe moskufizimin vetëm tek kripto-asetet e emetuara, ose të ofruara nga:

(i) i njëjti ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve;

(ii) subjekte që kanë lidhje të ngushta me të njëjtin ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve; ose

(iii) subjekte të tjera me të cilat i njëjti ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve ka marrëdhënie të ngushta ligjore ose ekonomike, si marrëdhënie kontraktuale, që rrezikojnë të dëmtojnë objektivitetin e këshillave të ofruara;

(b) të mos pranojë dhe të mbajë tarifa, komisione ose ndonjë përfitim monetar ose jo-monetar të paguar ose të ofruar nga ndonjë palë e tretë ose person që vepron në emër të një pale të tretë në lidhje me ofrimin e shërbimit për klientët.

Pavarësisht parashikimeve të shkronjës (b), përfitimet jo-monetare të vogla, që mund të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të kripto-aseteve të ofruara për një klient dhe që janë të një shkalle dhe natyre të tillë që nuk dëmtojnë përputhshmërinë me detyrimin e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve për të vepruar në interesin më të mirë të klientit të tij, do të lejohen në rastet kur ato i janë komunikuar qartësisht klientit.

4. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshillim në lidhje me kripto-asetet duhet t'u ofrojnë klientëve potencialë informacion mbi të gjitha kostot dhe tarifat e lidhura, duke përfshirë koston e këshillimit, dhe kur është e zbatueshme, koston e kripto-aseteve të rekomanduara ose të promovuara për klientin, si dhe mënyrën se si klienti mund paguajë për kripto-asetet, duke përfshirë çdo pagesë kundrejt palëve të treta.
5. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë administrimin e portofolit të kripto-aseteve nuk duhet të pranojnë dhe të mbajnë tarifa, komisione ose ndonjë përfitim monetar ose jo-monetar të paguar ose të ofruar nga një emetues, ofertues, person që kërkon pranimin për tregtim, ose ndonjë palë e tretë, ose një person që vepron në emër të një pale të tretë, në lidhje me shërbimin e ofrimit të administrimit të portofolit të kripto-aseteve për klientët e tyre.
6. Në rastet kur një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve informon një klient potencial se këshillimi i tij nuk ofrohet në mënyrë pavarur, ai mund të pranojë stimuj monetarë me kusht që që pagesa ose përfitimi:

(a) është e tillë që ndihmon për të përmirësuar cilësinë e shërbimit përkatës ndaj klientit; dhe
(b) nuk cënon përputhshmërinë me detyrimet e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve për të vepruar ndershmërisht, drejt dhe profesionalisht në përputhje me interesat më të mira të klientëve të tij.

Ekzistenca, natyra dhe shuma e pagesës ose përfitimit të përcaktuar në pikën 4, së bashku me metodën e llogaritjes së asaj shume kur ajo nuk mund të përcaktohet në fillim, i bëhet e qartë klientit në një mënyrë tërësore, të saktë dhe të kuptueshme, përpara se të ofrohet shërbimi përkatës i kripto-aseteve.

7. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshillim në lidhje me kripto-asetet sigurojnë që individët të cilët ofrojnë këshilla ose informacion në lidhje me kripto-asetet, ose

një shërbim të lidhur me kripto-asetet për llogari të ofruesve, zotërojnë njohuritë dhe aftësitë duhura për të përmbushur detyrimet e tyre. AMF përcakton me rregullore kriteret që do të përdoren për të vlerësuar njohuri dhe kompetenca.

8. Për qëllimet e vlerësimit të përshtatshmërisë të përcaktuar në pikën 1, Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshillim në lidhje me kripto-asetet ose administrimin e portofolit të kripto-aseteve marrin nga klientët ose klientët potencialë te gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me njohuritë dhe përvojën e tyre në investime, përfshirë njohuritë në tregjet e kripto-aseteve, objektivat e tyre të investimit, përfshirë këtu tolerancën ndaj rrezikut, situatën e tyre financiare, përfshirë aftësinë e tyre për të përballuar humbje, dhe kuptueshmërinë e tyre mbi rreziqet bazë të lidhura me blerjen e kripto-aseteve, në mënyrë që ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve t'u rekomandojnë klientëve ekzistues ose potencialë nëse kripto-asetet janë të përshtatshme për ta dhe veçanërisht nëse janë në përputhje me tolerancën e tyre ndaj rrezikut dhe aftësinë e tyre për të përballuar humbje.
9. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshillim në lidhje me kripto-asetet ose administrimin e portofolit të kripto-aseteve paralajmërojnë klientët ekzistues ose potencialë se:

(a) vlera e kripto-aseteve mund të luhatet;
(b) kripto-asetet mund t'i nënshtrohen humbjeve të plota ose të pjesshme;
(c) kripto-asetet mund të mos jenë likuide;
(d) kripto-asetet nuk janë të mbuluara nga skemat e kompensimit të investitorëve sipas legjislacionit për tregjet e kapitalit
(e) kripto-asetet nuk janë të mbuluara nga skemat e garancisë së depozitave sipas legjislacionit për sigurimin e depozitave

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshillim në lidhje me kripto-asetet ose administrimin e portofolit të kripto-aseteve hartojnë dhe implementojnë politika dhe procedura të cilat i mundësojnë mbledhjen dhe vlerësimin e të gjitha informacioneve të nevojshme për të kryer vlerësimin e përshtatshmërisë të përcaktuar në pikën 1 për secilin klient. Ata ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar që informacioni i mbledhur në lidhje me klientët e tyre ekzistues ose potencialë të jetë i besueshëm.

10. Në rastet kur klientët nuk ofrojnë informacionin e kërkuar në përputhje me pikën 8 të këtij neni, ose kur ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshillim në lidhje me kripto-asetet ose administrimin e portofolit të kripto-aseteve konsiderojnë se shërbimet e kripto-aseteve ose kripto-asetet nuk janë të përshtatshme për klientët e tyre, ata nuk ofrojnë shërbimet e këshillimit ose administrimit të portofolit të kripto-aseteve për këto klientë.
11. Pas vlerësimit fillestar të përshtatshmërisë për çdo klient, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshillim në lidhje me kripto-asetet ose administrimin e portofolit të kripto-aseteve e rishikojnë atë periodikisht, të paktën çdo dy vjet
12. Paskryerjes së vlerësimit të përshtatshmërisë sipas pikës 1 ose rishikimit të tij sipas pikës 12, Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë këshillim në lidhje me kripto-asetet u ofrojnë klientëve një raport mbi përshtatshmërinë, duke specifikuar këshillën e dhënë dhe se si ajo këshillë përputhet me preferencat, objektivat dhe karakteristikat e tjera të klientëve. Ky

raport hartohet dhe komunikohet me klientët në format elektronik. Ky raport duhet të përfshijë të paktën

(a) informacion të përditësuar mbi vlerësimin e përcaktuar në pikën 1; dhe

(b) përmbledhje të këshillave të dhëna.

Raporti mbi përshtatshmërinë specifikon se këshilla bazohet në njohuritë dhe përvojën e klientit në investimin në kripto-asete, objektivat e investimit të klientit, tolerancën tij të rrezikut, situatën financiare dhe aftësinë e tij për të përballuar humbjet.

13. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë administrimin e portofolit të kripto-aseteve u ofrojnë klientëve të tyre, në format elektronik, vërtetime periodike të veprimtarisë së administrimit të portofolit të kryer për llogari të tyre. Këto vërtetime periodike përmbajnë një shqyrtim të drejtë dhe të balancuar të aktiviteteve të ndërmarra dhe të performancës së portofolit gjatë periudhës së raportimit, një deklaratë të përditësuar për mënyrën se si aktivitetet e ndërmarra përputhen me preferencat, objektivat dhe karakteristikat e tjera të klientit, si dhe informacion të përditësuar mbi vlerësimin e përshtatshmërisë të përcaktuar në pikën 1 ose rishikimin e tij sipas pikës 12.

Vërtetimi periodik i përcaktuar në këtë pikë vendosen në dispozicion të klientit në baza tremujore, përveç rasteve kur një klient ka qasje në një sistem online ku ofrohen vlerësimet e përditësuara të portofolit të klientit dhe informacioni i përditësuar mbi vlerësimin e përshtatshmërisë të përcaktuar në pikën 1 , dhe ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve mund të provojëqë klienti ka aksesuar vlerësimin të paktën një herë gjatë tremujorit përkatës. Ky sistem online konsiderohet si format elektronik.

14. Për qëllime të këtij neni, AMF miraton rregulla më të detajuara, lidhur mekriteret për vlerësimin e njohurive dhe kompetencës së klientit në përputhje me pikën 2,

(b) informacionin e përcaktuar në pikën 8,dhe(c) formatin e deklaratës periodike të përcaktuar në pikën 14.

Neni 82

Ofrimi i shërbimeve të transfertave të kripto-aseteve për llogari të klientëve

1. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë shërbimet e transfertave të kripto-aseteve për llogari të klientëve lidhin një marrëveshje me klientët për të përcaktuar detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre. Kjo marrëveshje përfshin të paktën:

(a) identitetin e palëve të përfshira në marrëveshje;

(b) një përshkrim të procedurës së shërbimit të transfertës së ofruar;

(c) një përshkrim të sistemeve të sigurisë që përdoren nga ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve;

(d) tarifat e aplikuara nga ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve;

(e) ligjin e zbatueshëm.

2. Për qëllime të këtij neni,AMF miraton rregulla më të detajuara në lidhje me procedurat dhe politikat, përfshirë të drejtat e klientëve, në kontekstin e shërbimeve të transfertave të kripto-aseteve.

Seksioni 4:
Blerja e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve

Neni 83

Vlerësimi i blerjeve të propozuara të ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve

1. Çdo person fizik/juridik ose individ, ose grupe të tilla personash (i quajtur 'blerësi i propozuar') që kanë marrë vendimin për të blerë, drejtpërdrejt ose tërthorazi një pjesëmarrje influencuese në një ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve ose për të rritur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një pjesëmarrje të tillë, në mënyrë që përqindja e të drejtave të votimit ose e kapitalit të arrijë ose të kalojë 20%, 30% ose 50%, ose në mënyrë që ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve të bëhet filail i tij, njofton me shkrim AMF, duke dhënë informacion mbi sasinë/madhësinë e pjesëmarrjes së synuar dhe informacionin e kërkuar sipas rregullores së miratuar nga AMF në përputhje me nenin 84, pika 4 të këtij ligji
2. Çdo person fizik/juridik ose individ që ka marrë vendimin për të hequr dorë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga një pjesëmarrje influencuese në një ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve, përpara se të heqë dorë nga ajo pjesëmarrje, duhet të njoftojë me shkrim AMF për vendimin e tij dhe të jaë informacion në lidhje me madhësinë e pjesëmarrjes. Ky person gjithashtu njofton AMF kur ka marrë vendimin për të ulur pjesëmarrjen influencuese, në mënyrë që përqindja e të drejtave të votimit ose e kapitalit të bjerë nën 10 %, 20 %, 30 % ose 50 %, ose që ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve të ndalojë së qeni filial i atij subjekti.
3. Brenda 2 ditëve pune nga marrja e njoftimit në përputhje me pikën 1 të këtij neni, AMF,konfirmon me shkrim marrjen e tij
4. AMF vlerëson blerjen e propozuar të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe brenda 60 ditëve pune nga data e konfirmimit të marrjes së njoftimit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni. Kur konfirmon marrjen e njoftimit,AMF informon blerësin e propozuar për datën e përfundimit të periudhës së vlerësimit.
5. Për qëllimet e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4, AMF mund të konsultohet me autoritetin përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit
6. Gjatë kryerjes së vlerësimit të përcaktuar në pikën 4, AMF mund të kërkojë nga blerësi i propozuar çdo informacion shtesë që është i nevojshëm për të kryer vlerësimin. Kjo kërkesë bëhet me shkrim ose në mënyrë elektronike, përpara përfundimit të vlerësimit dhe në çdo rast jo më vonë se në ditën e 50-të të punës nga data e konfirmimit të marrjes së njoftimit, të përcaktuar në pikën 3, dukespecifikuar informacionin shtesë që kërkohet.

AMF pezullon periudhën e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4, deri sa të ketë marrë informacionin shtesë të përcaktuar në këtë pikë. Pezullimi i afatit nuk tejkalon 20 ditë pune. Çdo kërkesë tjetër nga AMF për informacion shtesë ose për sqarime të informacionit të marrë, nuk rezulton në një pezullim shtesë të afatit të periudhës së vlerësimit.
Nëse blerësi i propozuar është rezident jashtë Republikës së Shqipërisë ose rregullohet sipas ligjeve të një vendi të tretë, AMF mund të zgjasë pezullimin e përcaktuar në këtë pikë .

7. Në rast se pas përfundimit të vlerësimit sipas pikës 4 të këtij neni, AMF vendos të refuzojë blerjen e propozuar, autoriteti njofton blerësin e propozuar brenda 2ditëve pune dhe në çdo rast përpara afatit të përcaktuarnë pikën 4, kur është e zbatueshme, në përputhje me pikën 6. . Njoftimi i AMF për refuzimin e blerjes duhet të jetë i arsyetuar.

8. Në rastet kur AMF nuk e kundërshton blerjen e propozuar të përcaktuar në pikën 1 përpara afatit të përcaktuar në pikën 4, ose kur është e zbatueshme, në pikën 6, blerja e propozuar do të konsiderohet e miratuar në heshtje.
9. AMFs mund të caktojë një periudhë maksimale për përfundimin e blerjes së propozuar të përcaktuar në pikën 1 dhe ta zgjasë atë nëse është e nevojshme.

Neni 84

Përmbajtja e vlerësimit të blerjeve të propozuara të ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve

1. Gjatë kryerjes së vlerësimit në përputhje menenin 83AMF vlerëson përshtatshmërinë e blerësit të propozuar dhe qëndrueshmërinë financiare të blerjes së propozuar, duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

(a) reputacioni i blerësit të propozuar;

(b) reputacioni, njohuritë, aftësitë dhe përvoja e çdo personi që do të drejtojë veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve si rezultat i blerjes së propozuar;

(c) qëndrueshmëria financiare e blerësit të propozuar, në veçanti në lidhje me llojin e biznesit të parashikuar në lidhje me ofruesin e shërbimeve të kripto-aseteve për të cilin propozohet blerja;

(d) nëse ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve do të jetë në gjendje të përmbushë, fillimisht edhe në vazhdimësi, dispozitat e këtij Kreu;

(e) nëse ka të dhëna të arsyeshme për të dyshuar se, në lidhje me blerjen e propozuar, është kryer ose është tentuar pastrim parash,financim i terrorizmit, financim i armëve të shkatërrimit në masë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, ose nëse blerja e propozuar mund të rrisë rrezikun e tyre.

2. AMF mund të kundërshtojë blerjen e propozuar vetëm kur ka dyshim të arsyeshëm bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni ose kur informacioni i dhënë në përputhje me nenin 83, pika 4 është i paplotë ose i rremë.
3. Vendet e treta nuk vendosin asnjë kusht paraprak në lidhje me nivelin e pjesëmarrjes influencuese që blihet sipas kësaj ligji dhe as të lejojnë që autoritetet e tyre përgjegjëse të shqyrtojnë blerjen e propozuar në lidhje me nevojat ekonomike të tregut.
4. AMF miraton rregulla më të detajuara në lidhje me përmbajtjen e informacionit të nevojshëm në funksion të kryerjes së vlerësimit sipas nenit 83, i cili duhet të jetë i dobishëm për vlerësimin, proporcional dhe i përshtatur sipas llojit të blerësit të propozuar.

Seksioni 5:
Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve me rëndësi të veçantë

Neni 85

Identifikimi i ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve me rëndësi të veçantë

1. Një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve do të konsiderohet me rëndësi të veçantë nëse ka mesatarisht të paktën 15 milionë përdorues aktivë në Republikën e Shqipërisë dhe Bashkimin Evropian, përgjatë një viti kalendarik, ku mesatarja llogaritet si mesatarja e numrit ditor të përdoruesve aktivë gjatë vitit të kaluar kalendarik.
2. Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve njoftojnë AMF brenda dy muajve nga arritja e numrit të përdoruesve aktivë të përcaktuar në pikën 1. Në rastet kur ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve është me seli qendrore në një shtet të Bashkimit Evropian, AMF, pas konfirmimit të arritjes së pragut të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, njofton ESMA.
3. Për ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve me seli qendrore në Bashkimin Evropian, AMF i përcjell ESMA përditësime vjetore mbi zhvillimet mbikëqyrëse në lidhje me ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve me rëndësi të veçantë, të cilat përmbajnë:

(a) autorizimet në vazhdim ose të përfunduara, sipas përcaktimeve të nenit 59;

(b) proceset në vazhdim ose të përfunduara të tërheqjes së autorizimeve, sipas përcaktimeve të nenit 64;

(c) ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse të përcaktuara në nenin 94(1), nënpikën e parë, shkronjat (b), (c), (e), (f), (g), (y) dhe (aa).

AMF mund t'i vendosë në dispozicion përditësime më të shpeshta ESMA-s ose ta njoftojë atë përpara çdo vendimi të marrë nga AMF në lidhje me shkronjat (a), (b) ose (c) të kësaj pike.

Kreu VI:
NDALIMI I ABUZIMIT TË TREGJEVE QË PËRFSHIN KRIPTO-ASETET

Neni 86

Fusha e zbatimit të rregullave për abuzimin në treg

1. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për veprime të kryera nga çdo person fizik/juridik ose individ në lidhje me kripto-asetet që janë pranuar për tregtim ose për të cilat është bërë një kërkesë për pranimin e tyre për tregtim.
2. Dispozitat e këtij kreu zbatohen gjithashtu për çdo transaksion, urdhër ose sjellje në lidhje me kripto-asetet sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni , pavarësisht faktit nëse një transaksion, urdhër ose sjellje e tillë ndodh në një platformë tregtimi.
3. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për veprime dhe mosveprime, brenda Republikës së Shqipërisë në lidhje me kripto-asetet sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni. .

Neni 87

Informacioni i brendshëm

1. Në kuptim të këtij ligji, informacioni i brendshëm përfshin llojet e mëposhtme të informacionit:

(a) informacion me natyrë të precize, i cili nuk është bërë publik, që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë emetues, ofertues ose subjekte që kërkojnë pranimin në tregtim, ose me një ose më shumë kripto-asete, i cili, nëse do të ishte bërë publik, mund të kishte një ndikim të rëndësishëm në çmimin e këtyre kripto-aseteve ose në çmimin e një kripto-aseti të lidhur;

(b) për personat fizikë/juridikë ose individët që janë ngarkuar me ekzekutimin e urdhërave të kripto-aseteve për llogari të klientëve, nënkupton gjithashtu informacion me natyrë precize, të transmetuar nga një klient dhe që lidhet me urdhërat në pritje të klientit në lidhje me kripto-asetet, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë emetues, ofertues ose subjekte që kërkojnë pranimin në tregtim ose me një ose më shumë kripto-asete, dhe që, nëse do të ishte bërë publik, mund të kishte një ndikim të rëndësishëm në çmimin e këtyre kripto-aseteve ose në çmimin e një kripto-aseti të lidhur.

2. Për qëllimet e pikës 1, informacioni do të konsiderohet se ka natyrëprecize nëse tregon një grup rrethanash që ekzistojnë, ose që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të krijohen, ose një ngjarje që ka ndodhur ose që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndodhë, kur është mjaftueshëm specifike për të mundësuar nxjerrjen e një konkluzioni si për efektin e

mundshëm të atij grupi rrethanash ose ngjarjesh në çmimet e kripto-aseteve. Në kuptim të kësaj pike, në rastin e një procesi të zgjatur që synon të sjellë ose që rezulton në rrethana të veçanta ose një ngjarje të caktuar, ato rrethana të ardhshme ose ajo ngjarje e ardhshme dhe gjithashtu hapat e ndërmjetëm të atij procesi që lidhen me sjelljen ose që rezultojnë në ato rrethana të ardhshme ose atë ngjarje të ardhshme, mund të konsiderohen si informacion preciz

3. Hapi i ndërmjetëm në një proces të zgjatur do të konsiderohet si informacion i brendshëm nëse, në vetvete, plotëson kriteret e informacionit të brendshëm sipas përcaktimeve të këtij neni.
4. Për qëllimet e pikës 1, informacioni i cili, nëse do të bëhej publik, mund të kishte një ndikim të rëndësishëm në çmimet e kripto-aseteve do të thotë informacion që një zotërues i arsyeshëm i kripto-aseteve ka të ngjarë ta përdorte si pjesë të bazës për vendimet e tij të investimit.

Neni 88

Publikimi i informacionit të brendshëm

1. Emetuesit, ofertuesit dhe subjektet që kërkojnë pranimin në tregtim informojnë publikun sa më shpejt të jetë e mundur për informacionin e brendshëm sipas përcaktimeve të nenin 87 që ka lidhje në mënyrë të drejtëpërdrejtë me ta, në një mënyrë që mundëson qasje të shpejtë dhe vlerësim të plotë, të saktë dhe në kohë të këtij informacioni nga publiku. Emetuesit, ofertuesit dhe subjektet që kërkojnë pranimin në tregtim nuk lejohet të kombinojnë deklaratën publike të informacionit të brendshëm me promovimin e veprimtarisë së tyre. Emetuesit, ofertuesit dhe subjektet që kërkojnë pranimin në tregtim afishojnë dhe mbajnë në faqen e tyre të internetit të gjithë informacionin e brendshëm që ata janë të detyruar ta zbulojnë publikishtpër një periudhë prej të paktën pesë vitesh .
2. Emetuesit, ofertuesit dhe subjektet që kërkojnë pranimin në tregtim mund të shtyjnë në kohë, nën përgjegjësinë e tyre të plotë ligjore, publikimin e informacionit të brendshëm sipas nenit 87, vetëm në rastet kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) publikimi i menjëhershëm ka të ngjarë të dëmtojë interesat legjitime të emetuesve, ofertuesve ose subjekteve që kërkojnë pranimin në tregtim;

(b) vonesa e publikimit nuk ka gjasa të keqorientojë publikun;

(c) emetuesit, ofertuesit ose subjektet që kërkojnë pranimin në tregtim janë të aftë të sigurojnë konfidencialitetin e atij informacioni.

3. Në rastet kur një emetues, ofertues ose subjekt që kërkon pranimin në tregtim ka shtyrë në kohë publikimin e informacionit të brendshëm në përputhje me pikën 2, ai informon autoritetin përgjegjës për shtyrjen dhe paraqet një shpjegim me shkrim mbi mënyrën se si janë përmbushur kushtet e përcaktuara në pikën 2, menjëherë pasi informacioni të jetë publikuar.

4. Për qëllime të këtij neni, AMF miraton rregulla më të detajuara, lidhur me deklaratën publike të informacionit të brendshëm dhe shtyrjen në kohë të publikimit të informacionit të brendshëm.

Neni 89

Ndalimi i tregtimit të brendshëm

1. Në kuptim të këtij ligji, tregtimi i brendshëm do të konsiderohet të ndodhë kur një person fizik/juridik ose individ zotëron informacion të brendshëm dhe e përdor atë duke blerë ose shitur, për llogari të vetë ose për llogari të një pale të tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kripto-asete të cilat lidhen me atë informacion. Përdorimi i informacionit të brendshëm duke anuluar ose ndryshuar një urdhër në lidhje me një kripto-aset për të cilin lidhet informacioni, kur urdhri është vendosur përpara se personi përkatës të zotëronte informacionin e brendshëm, gjithashtu do të konsiderohet si tregtim i brendshëm. Përdorimi i informacionit të brendshëm përfshin gjithashtu dorëzimin, modifikimin ose tërheqjen e një oferte blerje ose shitje nga një person,për llogari të vetë, ose për llogari të një pale të tretë.
2. Përdorimi i informacionit të brendshëm në lidhje me kripto-asetet nga ana e personave fizikë/juridikë ose individë t për të blerë ose shitur ato kripto-asete, drejtpërdrejt ose tërthorazi, qoftë për llogari të vet ose për llogari të një pale të tretë është i ndaluar. Rekomandimi apo nxitja nga një person fizik/juridik apo individ e një personi tjetër fizik/juridik apo individi për të tregtuar bazuar në informacion të brendshëm është e ndaluar.
3. Asnjë person fizik/juridik ose individ që zotëron informacion të brendshëm në lidhje me kripto-asetet nuk duhet bazuar në informacionin e brendshëm, të rekomandojë ose të nxisë një person fizik/juridik apo individ tjetër:

(a) për të blerë ose shitur ato kripto-asete; ose

(b) për të anuluar ose ndryshuar një urdhër në lidhje me ato kripto-asete.

4. Përdorimi i një rekomandimi ose nxitjeje sipas pikës 3 përbën tregtim të brendshëm në kuptim të këtij neni në rastet kur subjekti që përdor atë rekomandim ose nxitje është në dijeni ose duhet të jetë në dijeni se rekomandimi ose nxitja bazohet në informacion të brendshëm.
5. Ky nen zbatohet për çdo person që zotëron informacion të brendshëm si rezultat i:

(a) të qenit anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit, ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim;

(b) zotëron pjesëmarrje në kapitalin e emetuesit, ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim;

(c) të pasurit qasje në informacion përmes punësimit, ushtrimit të profesionit ose detyrave ose në lidhje me rolin e tij në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë ose teknologji të ngjashme; ose

(d) përfshirjes në veprimtari kriminale.

Ky nen zbatohet gjithashtu për çdo subjekt që zotëron informacion të brendshëm në rrethana të ndryshme nga ato të përcaktuara në nënpikën e parë, kur subjekti ka dijeni ose duhet të ketë dijeni se është informacion i brendshëm.

6. Në rastet kur personi i përcaktuar në pikën 1 është një person juridik, ky nen do të zbatohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndaj individëve që marrin pjesë në vendimmarrje për blerjen, shitjen, anulimin ose ndryshimin e një urdhri për llogari të personit juridik përkatës.

Neni 90

Ndalimi i zbulimit të paligjshëm i informacionit të brendshëm

1. Në kuptim të këtij ligji, zbulimi i paligjshëm i informacionit të brendshëm ndodh kur një person zotëron informacion të privilegjuar dhe ia njofton atë informacion kujtdo personi tjetër, përveç rasteve kur njoftimi bëhet në kuadër të ushtrimit normal të një veprimtarie, profesioni apo detyre.
2. Zbulimi i mëtejshëm i rekomandimeve ose nxitjeve të përcaktuara në nenin 89(4) përbën zbulim të paligjshëm të informacionit të brendshëm në rastet kur subjekti që zbulon rekomandimin ose nxitjen është në dijeni ose duhet të ishte në dijeni se ato bazoheshin në informacion të brendshëm.

Neni 91

Ndalimi i manipulimi të tregut

1. Asnjë subjekt nuk angazhohet ose të përpiqet të angazhohet në manipulimin e tregut.
2. Për qëllimet e këtij ligji, manipulimi i tregut përfshin çdo nga veprimtaritë e mëposhtme:

(a) përveç nëse kryhet për arsye legjitime, hyrja në një transaksion, vendosja e një urdhri për të tregtuar ose angazhimi në çdo sjellje tjetër që:

(i) jep, ose ka të ngjarë të japë, sinjale të rreme ose mashtruese në lidhje me sasinë në treg, kërkesën ose çmimin e një kripto-aseti;

(ii) siguron, ose ka të ngjarë të sigurojë, çmimin e një ose disa kripto-aseteve në një nivel jonormal ose artificial;

(b) hyrja në një transaksion, vendosja e një urdhri për të tregtuar ose ndonjë veprimtari tjetër që ndikon ose ka të ngjarë të ndikojë në çmimin e një ose disa kripto-aseteve, duke përdorur një pajisje fiktive ose ndonjë formë tjetër mashtrimi ose mashtrimi të qëllimshëm;

(c) shpërndarja e informacionit përmes mediave, duke përfshirë internetin, ose përmes çdo mjeti tjetër, që jep ose ka të ngjarë të japë sinjale të rreme ose mashtruese në lidhje me sasinë në treg, kërkesën ose çmimin e një ose disa kripto-aseteve, ose siguron ose ka të ngjarë të sigurojë

çmimin e një ose disa kripto-aseteve në një nivel jonormal ose artificial, duke përfshirë përhapjen e thashethemeve, kur subjekti që është angazhuar në shpërndarjen e tyre e dinte ose duhet ta dinte se informacioni ishte i rremë ose mashtrues.

3. Sjelljet e mëposhtme, ndër të tjera, do të konsiderohen si manipulim tregu:

(a) sigurimi i një pozicioni dominues mbi sasinë në treg ose kërkesën për një kripto-aset, që ka për synim, ose ka të ngjarë të ketë, efektin e fiksimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çmimeve të blerjes ose shitjes, ose që krijon, ose ka të ngjarë të krijojë, kushte të tjera të padrejta tregtimi;

(b) vendosja e urdhrave në një platformë tregtimi për kripto-asete, duke përfshirë çdo anulim ose modifikim të tyre, me çdo mjet të disponueshëm të tregtimit, dhe që ka një nga efektet e përcaktuara në pikën 2, shkronja (a), duke:

(i) ndërprerë ose vonuar funksionimin e platformës së tregtimit për kripto-asetet ose duke u angazhuar në çdo veprimtari që ka të ngjarë të ketë atë efekt;

(ii) e bërë më të vështirë për subjektet e tjera të identifikojnë urdhra të vërtetë në platformën e tregtimit për kripto-asete ose duke u angazhuar në ndonjë veprimtari që ka të ngjarë të ketë atë efekt, duke përfshirë vendosjen e urdhrave që rezultojnë në destabilizimin e funksionimit normal të platformës së tregtimit për kripto-asetet;

(iii) krijuar një sinjal të rremë ose mashtrues për sasinë në treg, kërkesën ose çmimin e një kripto-aseti, në veçanti duke vendosur urdhra për të nisur ose përkeqësuar një trend, ose duke u angazhuar në ndonjë veprimtari që ka të ngjarë të ketë atë efekt;

(c) përfitimi nga qasja e rastësishme ose e rregullt në media tradicionale ose elektronike duke shprehur një mendim për një kripto-aset, ndërkohë që më parë kanë marrë pozicione tregtie mbi atë kripto-aset, duke përfituar nga ndikimi i mendimeve të shprehura mbi çmimin e atij kripto-aseti, pa zbuluar në të njëjtën kohë konfliktin e interesit në publik në mënyrën e duhur dhe efektive.

Neni 92

Parandalimi dhe identifikimi i abuzimit të tregut

1. Çdo person juridik ose individ që organizon ose ekzekuton profesionalisht transaksione në kripto-asete vendos masa, sisteme dhe procedura efektive për të parandaluar dhe identifikuar abuzimin me tregun. Subjekti raporton pa vonesë në AMF çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me një urdhër ose transaksion, duke përfshirë çdo anulim ose modifikim të tij, si dhe aspekte të tjera të funksionimit të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë të tilla si mekanizmi i konsensusit, në rastet kur ekzistojnë rrethana dhe indikatorë që tregojnë se abuzimi në treg është kryer, është duke u kryer ose ka të ngjarë të kryhet.

2. Për qëllime të këtij neni, AMF miraton rregulla më të detajuara, lidhur me masat, sistemet dhe procedurat e përshtatshme për të parandaluar abuzimin me tregun, modelin që do të përdoret nga subjektet për të përmbushur pikën 1, dhe procedurat e koordinimit midis autoriteteve përkatëse përgjegjëse për zbulimin dhe sanksionimin e abuzimit në treg, në rastet ndërkufitare të abuzimit të tregut.

KREU VII:
AUTORITETET PËRGJEGJËSE

Seksioni 1:
Kompetencat e autoriteteve përgjegjëse dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre

Neni 93

Autoritetet Përgjegjëse

1. Autoritetet Përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, janë:
    a) **Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,** i cili është përgjegjës për:
        i. mbikëqyrjen dhe kontrollin e ofertës ndaj publikut të kripto-aseteve dhe të dokumentit informues, sipas Kreut II të këtij ligji;
        ii. autorizimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, sipas Kreut V të këtij ligji, duke përfshirë:
        - operimin e platformave të tregtimit të kripto-aseteve;
        - kujdestarinë dhe administrimin e kripto-aseteve për llogari të klientëve;
        - këmbimin e kripto-aseteve kundrejt fondeve;
        - këmbimin e kripto-aseteve kundrejt kripto-aseteve;
        - ekzekutimin e urdhërave të kripto-aseteve për llogari të klientëve;
        - hedhjen në treg të kripto-aseteve;
        - marrjen dhe transmetimin e urdhrave të lidhura me kripto-asetet për llogari të klientëve;
        - këshillimin në lidhje me kripto-asetet;
        - administrimin e portofolit të kripto-aseteve;
        - shërbimet e transfertave të kripto-aseteve për llogari të klientëve;
        iii. mbikëqyrjen dhe parandalimin e abuzimeve të tregut që përfshijnë kripto-asete, sipas Kreut VI të këtij ligji;
        iv. për tokenat e asetit, pavarësisht nëse janë ose jo të klasifikuara si me rëndësi të lartë, AMF është përgjegjëse për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit informues dhe mbajtjen e regjistrit të tokenave të aseteve;

b) **Banka e Shqipërisë**, e cila është përgjegjëse për:
   i. autorizimin dhe mbikëqyrjen e emetuesve të tokenave të parasë elektronike, pavarësisht nëse janë ose jo të klasifikuara si me rëndësi të lartë;
   ii. autorizimin dhe mbikëqyrjen e emetuesve të tokenave të asetit, pavarësisht nëse janë ose jo të klasifikuara si me rëndësi të lartë;

2. Banka e Shqipërisë dhe AMF, përmes marrëveshjes ndërinstitucionale:
   a) përcaktojnë në menyrë më të detajuar ndarjen e kompetencave dhe detyrave;
   b) vendosin procedurat e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit;
   c) ndërmarrin veprime të koordinuara në rast rreziku për stabilitetin financiar, mbrojtjen e investitorëve ose integritetin e tregut.

3. Autoritetet përgjegjëse mund të bashkëpunojnë me autoritete mbikëqyrëse të huaja ose organizata ndërkombëtare, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe me respektimin e parimeve të sekretit profesional dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

4. AMF shërben si pika e vetme e kontaktit në kuadër të bashkëpunimit administrativ ndërkufitar me autoritetet mbikëqyrëse të huaja.

Neni 94

Kompetencat e autoriteteve përgjegjëse

1. Për të përmbushur detyrat e tyre sipas Kreut II deri në VI të këtij ligji, AMF dhe Banka e Shqipërisë do të kenë kompetencat mbikëqyrëse dhe të hetimit administrativ si vijon:

   a. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ushtron kompetencat e mëposhtme:

   (a) kërkon nga çdo subjekt informacion dhe dokumente që i konsideron të rëndësishme për përmbushjen e detyrave të tyre;

   (b) pezullon, ose të kërkon nga një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve të pezullojë, ofrimin e shërbimeve të kripto-aseteve për një periudhë maksimale prej 30 ditë pune të njëpasnjëshme në çdo rast të vetëm kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme për shkeljen e këtij ligji;

   (c) ndalon ofrimin e shërbimeve të kripto-aseteve nëse konstaton se ky ligj është shkelur;

   (ç) publikon, ose të kërkon nga një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve të publikojë, të gjitha informacionet thelbësore që mund të kenë ndikim në ofrimin e shërbimeve të kripto-aseteve përkatëse, për të siguruar mbrojtjen e interesave të klientëve, në veçanti

klientëve joprofesionistë, ose mbarëvajtjen e tregut;

(d) publikon faktin që një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve nuk përmbush detyrimet e tij;

(dh) pezullon, ose të kërkon nga një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve të pezullojë, ofrimin e shërbimeve nëse AMF konsiderojnë se situata e ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve është e tillë që ofrimi i shërbimit të kripto-aseteve do të ishte në dëm të interesave të klientëve, veçanërisht klientëve joprofesionistë;

(e) kërkon transferimin e kontratave ekzistuese te një ofrues tjetër i shërbimeve të kripto-aseteve në rastet kur autorizimi i një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve tërhiqet në përputhje me nenin 64, me kusht që të marrë pëlqimin e klientëve dhe të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve te të cilët do të transferohen kontratat;

(ë) urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të aktivitetit pa paralajmërim paraprak ose vendosje të një afati kur ekzistojë arsye për të supozuar se një subjekt po ofron shërbime të kripto-aseteve pa autorizim, të urdhërojnë ;

(f) kërkon nga ofertuesit, personat që kërkojnë pranimin në tregtim të kripto-aseteve, ose emetuesit e tokenëve të aseteve ose tokenëve të parasë elektronike, të ndryshojnë dokumentin informues të kripto-asetit ose të ndryshojnë më tej dokumentin informues të modifikuar të kripto-asetit, kur konstatojnë se dokumenti informues nuk përmban informacionin e kërkuar sipas nenit 6, 19 ose 51;

(g) kërkon nga ofertuesit, personat që kërkojnë pranimin në tregtim të kripto-aseteve, ose emetuesit e tokenëve të aseteve ose tokenëve të parasë elektronike, të ndryshojnë materialet e tyre promovuese, në rastet kur konstatojnë se nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 7, 29 ose 53 të këtij ligji;

(gj) kërkon nga ofertuesit, personat që kërkojnë pranimin në tregtim të kripto-aseteve, ose emetuesit e tokenëve të aseteve ose tokenëve të parasë elektronike, të përfshijnë informacion shtesë në dokumentet informuesee të tyre të kripto-aseteve, kur është e nevojshme për stabilitetin financiar ose për mbrojtjen e interesave të mbajtësve të kripto-aseteve, në veçanti klientëve joprofesionistë;

(h) pezullon një ofertë ndaj publikut ose një pranim në tregtim të kripto-aseteve për një periudhë maksimale prej 30 ditë pune të njëpasnjëshme në çdo rast të vetëm, kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ky ligj është shkelur;

(i) ndalon një ofertë ndaj publikut ose një pranim në tregtim të kripto-aseteve kur konstatojnë se ky ligj është shkelur ose kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se do të shkelet;

(j) pezullon, ose kërkon nga një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve që operon një

platformë tregtimi për kripto-asete që të pezullojë tregtimin e kripto-aseteve për një periudhë maksimale prej 30 ditë pune të njëpasnjëshme në çdo rast të vetëm kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ky ligj është shkelur;

(k) ndalon tregtimin e kripto-aseteve në një platformë tregtimi për kripto-asete kur konstatojnë se ky ligj është shkelur ose kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se do të shkelet;

(l) pezullon ose ndalojnë materialet promovuese kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ky ligj është shkelur;

(ll) merr çdo lloj mase për të siguruar që një ofertues ose një subjekt që kërkon pranimin në tregtim të kripto-aseteve, një emetues i një tokeni të aseteve ose një tokeni të parasë elektronike ose një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve të respektojnë këtë ligj, duke përfshirë kërkesën për ndërprerjen e çdo praktike ose sjelljeje që autoritetet përgjegjëse e konsiderojnë në kundërshtim me këtë ligj;

(m) kryen inspektime fizike ose hetime në ambiente të tjera, përveç banesave private të personave fizikë, për të aksesuar dokumente dhe të dhëna të tjera në çdo formë;

(n) kontrakton palë të treta me qëllim kryerjen e verifikimeve ose hetimeve ;

(nj) kërkon largimin e një individi nga organi drejtues i një emetuesi të një tokeni të aseteve ose të një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve;

(o) kërkon nga çdo subjekt të marrë masa për të zvogëluar madhësinë e pozicionit ose ekspozimit të tij ndaj kripto-aseteve;

(p) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë kërkesën ndaj një pale të tretë ose një autoriteti publik për të zbatuar këto masa kur nuk ka mjete të tjera efektive të disponueshme për të ndaluar shkeljen e këtij ligji dhe për të shmangur rrezikun e dëmit serioz ndaj interesave të klientëve ose mbajtësve të kripto-aseteve, për të:
(i) hequr përmbajtjen ose kufizuar aksesin në një ndërfaqe online ose për të urdhëruar shfaqjen e qartë të një paralajmërimi për klientët dhe mbajtësit e kripto-aseteve kur ata aksesojnë një ndërfaqe online;

(ii) urdhëruar një ofrues hostimi të heqë, çaktivizojë ose kufizojë aksesin në një ndërfaqe online;
(iii) urdhëruar regjistruesit e domenëve të fshijnë një emër domeni dhe t'i lejojnë autoritetit përgjegjës përkatës ta regjistrojë atë;

Banka e Shqipërisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

(a) kërkon nga çdo subjekt informacion dhe dokumente që autoritetet përgjegjëse i konsiderojnë të rëndësishme për përmbushjen e detyrave të tyre;

(b) kërkon nga ofertuesit, personat që kërkojnë pranimin në tregtim të kripto-aseteve, ose emetuesit e tokenëve të aseteve ose tokenëve të parasë elektronike, të ndryshojnë materialet e tyre promovuese, në rastet kur konstatojnë se nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 7, 29 ose 53 të këtij ligji;

(c) kërkon nga ofertuesit, personat që kërkojnë pranimin në tregtim të kripto-aseteve, ose emetuesit e tokenëve të aseteve ose tokenëve të parasë elektronike, të përfshijnë informacion shtesë në dokumentet informuesee të tyre të kripto-aseteve, kur është e nevojshme për stabilitetin financiar ose për mbrojtjen e interesave të mbajtësve të kripto-aseteve, në veçanti klientëve joprofesionistë;

(ç) kërkon nga ofertuesit, personat që kërkojnë pranimin në tregtim të kripto-aseteve, emetuesit e tokenëve të aseteve ose tokenëve të parasë elektronike ose ofruesit përkatës të shërbimeve të kripto-aseteve të ndalojnë ose pezullojnë materialet e tyre promovuese për një periudhë maksimale prej 30 ditë pune të njëpasnjëshme në çdo rast të vetëm kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ky ligj është shkelur;

(d) publikon faktin që një ofertues, një person që kërkon pranimin në tregtim të një kripto-aseti ose një emetues i një tokeni të aseteve ose tokeni të parasë elektronike, nuk përmbush detyrimet e tij sipas këtij ligji;

(dh) publikon, ose kërkon nga ofertuesi, subjekti që kërkon pranimin në tregtim të një kripto-aseti ose emetuesi i një tokeni të aseteve ose një tokeni të parasë elektronike, që të publikojë të gjitha informacionet thelbesore që mund të ndikojnë në vlerësimin e kripto-asetit të ofruar ndaj publikut ose të pranuar në tregtim, për të siguruar mbrojtjen e interesave të mbajtësve të kripto-aseteve, në veçanti klientëve joprofesionistë, ose mbarëvajtjen e tregut;

(e) pezullon, ose kërkon nga ofruesi përkatës i shërbimeve të kripto-aseteve që operon platformën e tregtimit për kripto-asete të pezullojë kripto-asetet nga tregtimi kur konsiderojnë se situata e ofertuesit, subjektit që kërkon pranimin në tregtim të një kripto-aseti ose emetuesit të një tokeni të aseteve ose tokeni të parasë elektronike është e tillë që tregtimi do të ishte në dëm të interesave të mbajtësve të kripto-aseteve, veçanërisht klientëve joprofesionistë;

(ë) urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarisë pa paralajmërim paraprak ose vendosje të një afati, në rastet kur ekzistojnë arsye për të supozuar se një subjekt po emeton tokenë të aseteve ose tokenë të parasë elektronike pa autorizim ose se një subjekt po ofron ose kërkon pranimin në tregtim të kripto-aseteve të tjera përveç tokenëve të aseteve ose tokenëve të parasë elektronike pa një dokument informues në përputhje me nenin 8;

(f) merr çdo lloj mase për të siguruar që një ofertues ose një subjekt që kërkon pranimin në tregtim të kripto-aseteve, një emetues i një tokeni të aseteve ose një tokeni të parasë

elektronike ose një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve të respektojnë këtë ligj, duke përfshirë kërkesën për ndërprerjen e çdo praktike ose sjelljeje që autoritetet përgjegjëse e konsiderojnë në kundërshtim me këtë ligj;

(g) kryen inspektime fizike ose hetime në ambiente të tjera, përveç banesave private të personave fizikë, për të aksesuar dokumente dhe të dhëna të tjera në çdo formë;

(gj) kontrakton palë të treta me qëllim kryerjen e verifikimeve ose hetimeve ;

(h) kërkon largimin e një individi nga organi drejtues i një emetuesi të një tokeni të aseteve;

(i) kërkon nga çdo subjekt të marrë masa për të zvogëluar madhësinë e pozicionit ose ekspozimit të tij ndaj kripto-aseteve;

(j) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë kërkesën ndaj një pale të tretë ose një autoriteti publik për të zbatuar këto masa kur nuk ka mjete të tjera efektive të disponueshme për të ndaluar shkeljen e këtij ligji dhe për të shmangur rrezikun e dëmit serioz ndaj interesave të klientëve ose mbajtësve të kripto-aseteve, për të:
(i) hequr përmbajtjen ose kufizuar aksesin në një ndërfaqe online ose për të urdhëruar shfaqjen e qartë të një paralajmërimi për klientët dhe mbajtësit e kripto-aseteve kur ata aksesojnë një ndërfaqe online;

(ii) urdhëruar një ofrues hostimi të heqë, çaktivizojë ose kufizojë aksesin në një ndërfaqe online;
(iii) urdhëruar regjistruesit e domenëve të fshijnë një emër domeni dhe t'i lejojnë autoritetit përgjegjës përkatës ta regjistrojë atë;

(k) kërkon nga një emetues i një tokeni të aseteve ose një tokeni të parasë elektronike, në përputhje me nenin 23 pika 4, 24 pika 3 ose 58 pika 3, të prezantojë një sasi minimale të emetimit ose të kufizojë sasinë e emetuar.

2. Ushtrimi i kompetencave mbikëqyrëse dhe të hetimit administrativ ndaj ofertuesve, subjekteve që kërkojnë pranimin në tregtim, emetuesve dhe ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, nuk bie ndesh me kompetencat e përcaktuara për autoritetet mbikëqyrëse në lidhje me këto subjekte në përputhje me legjislacionin për bankat.

3. Krahas kompetencave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, me qëllim përmbushjen e detyrave e tyre sipas Kreut VI, AMF ushtron edhe kompetencat mbikëqyrëse dhe hetimore të mëposhtme:
(a) të ketë akses në çdo dokument dhe të dhënë në çdo formë dhe të marrin ose të bëjnë një kopje të tyre;
(b) të kërkojë dhe marrin informacion nga çdo subjekt si dhe drejtuesit e tyre, përfshirë ato që janë të angazhuar njëri pas tjetrit në transmetimin e urdhërave ose kryerjen e veprimeve operacionale;

(c) të ketë akses në ambientet e personave fizikë dhe juridikë për të sekuestruar dokumente dhe të dhëna në çdo formë, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm se dokumentet ose të dhënat që lidhen me çështjen e inspektimit ose hetimit mund të jenë të rëndësishme për të provuar një rast të tregtimit të brendshëm ose manipulimit të tregut;
(d) të referojë çështje për ndjekje penale;
(e) të kërkojë, për aq sa lejohet nga legjislacioni në fuqi, të dhënat ekzistuese të trafikut të mbajtura nga një operator telekomunikacioni, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm për një shkelje dhe kur këto të dhëna mund të jenë të rëndësishme për hetimin e një shkeljeje të neneve 88 deri 91;
(f)të kërkojë ngrirjen dhe/ose sekuestrimin e aseteve;
(g) të vendosë një ndalim të përkohshëm për ushtrimin e një aktiviteti profesional;
(h) të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që publiku të informohet saktë, ndër të tjera, duke korrigjuar informacionet e rreme ose mashtruese të zbuluara, përfshirë kërkesën për të publikuar një deklaratë korrigjuese nga një ofertues, subjekt që kërkon pranimin në tregtim ose emetues apo çdo subjekt tjetër që ka publikuar ose shpërndarë informacione të rreme ose mashtruese.

4. Në rastet kur është e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi, autoritetet përgjegjëse mund ti drejtohen gjykatës për të vendosur mbi përdorimin e kompetencave të listuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.
5. Autoritetet përgjegjëse do të ushtrojnë kompetencat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni sipas mënyrave të mëposhtme:
(a) drejtpërdrejt;
(b) në bashkëpunim me autoritete të tjera, përfshirë autoritetet përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
(c) nën përgjegjësinë e tyre, me delegim te autoritetet e përcaktuara në pikën (b);
(d) me kërkesë në gjykatë.

6. Një subjekt që vendos në dispozicion të Autoritetit Përgjegjës informacion në përputhje me këtë ligj, nuk konsiderohet në shkelje kontraktuale ose të një dispozite ligjore lidhur me dhënien e informacionit , dhe nuk mban përgjegjësi ligjore.

Neni 95

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar

1. Autoritetet përgjegjëse bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për qëllimet e këtij ligji. Autoritetet përgjegjëse japin ndihmë autoriteteve përgjegjëse të shteteve të tjera dhe shkëmbejnë informacion pa vonesa të pajustifikuara, duke bashkëpunuar në veprimtari hetimore, mbikëqyrëse dhe zbatueshmërie.

Nëse Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon dënime penale për shkeljet e përcaktuara

në pikën 1 të nenit 111 këtij ligji, autoritetet përgjegjëse sigurojnë që:

a) të bashkëpunojnë me organet gjyqësore, prokurorinë, policinë ose organe te tjera ligjzbatuese brenda juridiksionit të tyre;
b) të marrin informacione specifike në lidhje me hetime penale ose procedura penale të nisura për shkeljet e këtij ligji;
c) të vendosin në dispozicion, sipas nevojës, këto informacione edhe për autoritetet e tjera përgjegjëse brenda vendit dhe, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, për autoritetet homologe jashtë vendit, për qëllime të mbikëqyrjes dhe bashkëpunimit në zbatim të këtij ligji.

2. Një autoritet përgjegjës mund të refuzojë të veprojë mbi një kërkesë për informacion ose një kërkesë për të bashkëpunuar në një hetim vetëm në rastet e mëposhtme:

a) kur komunikimi i informacionit mund të ndikojë negativisht në sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me luftën kundër terrorizmit dhe krimeve të tjera të rënda;
b) kur përmbushja e kërkesës ka gjasa të ndikojë negativisht në hetimin e tij, në aktivitetet zbatuese ose në një hetim penal;
c) kur janë ndërmarrë tashmë procedura në lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër të njëjtëve persona fizikë ose juridikë para gjykatave të Republikës së Shqipërisë;

ç) kur është dhënë tashmë një vendim përfundimtar në lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër të njëjtit person fizik ose juridik në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet përgjegjëse, me kërkesë, japin pa vonesë çdo informacion të nevojshëm për qëllimet e këtij ligji.

4. Një autoritet përgjegjës mund të kërkojë ndihmë nga autoriteti përgjegjës i një shteti tjetër në lidhje me inspektime në terren ose hetime.

Kur një autoritet përgjegjës paraqet një kërkesë për bashkëpunim ose merr një kërkesë nga një autoritet homolog jashtë vendit, ai njofton edhe autoritetet e tjera përgjegjëse brenda Republikës së Shqipërisë, nëse kjo është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre sipas këtij ligji.

Kur një autoritet përgjegjës merr një kërkesë nga një autoritet tjetër kompetent i një shteti tjetër për të kryer një inspektim në terren ose një hetim, ai mund të:

(a) kryejë vetë inspektimin ose hetimin në terren;

(b) lejojë autoritetin kompetent që ka paraqitur kërkesën të marrë pjesë në inspektimin ose hetimin në terren;

(c) lejojë autoritetin kompetent që ka paraqitur kërkesën të kryejë vetë inspektimin ose hetimin në terren;

(d) shpërndajë detyra specifike që lidhen me aktivitetet mbikëqyrëse me autoritete të tjera kompetente.

5. Në rastin e një inspektimi ose hetimi në terren sipas pikës 4:

a) AMF-ja koordinon inspektimin ose hetimin, kur i kërkohet ta bëjë këtë nga një prej autoriteteve përgjegjëse, kur objekt i inspektimit apo hetimit janë çështje që lidhen me:

   i. ofertat ndaj publikut të kripto-aseteve;

   ii. dokumentet informuesee të kripto-aseteve;

   iii. shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve;

   iv. transparencën dhe integritetin e tregut të kripto-aseteve.

b) Banka e Shqipërisë koordinon inspektimin ose hetimin, kur i kërkohet ta bëjë këtë nga një prej autoriteteve përgjegjëse, kur inspektimi ose hetimi lidhet me:

   i. emetuesit e tokenëve të parasë elektronike ose të tokenëve të aseteve;

   ii. rezervat e aseteve në të cilat mbështeten këto tokena;

   iii. çdo aspekt prudencial që ka ndikim në stabilitetin financiar, politikën monetare, ose në sistemin e pagesave.

6. Në rastet kur një kërkesë për bashkëpunim refuzohet ose nuk trajtohet brenda një kohe të arsyeshme, autoritetet përgjegjëse mund të kërkojnë ndërmjetësimin e një organi koordinues të përcaktuar me akt nënligjor.
7. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 6, autoritetet përgjegjëse, në rastet kur një kërkesë pë bashkëpunim është refuzuar ose nuk është trajtuar brenda një kohe të arsyeshme mund ta sjellin çështjen në vëmendjen e Bankës së Shqipërisë, në rastet kur një kërkesë për bashkëpunim, veçanërisht për informacion në lidhje me:
   a) një emetues të një tokeni të aseteve ose një tokeni të parasë elektronike;

   b) shërbime të kripto-aseteve që lidhen me tokenët e aseteve ose tokenët e parasë elektronike;
   .

8. Autoritetet përgjegjëse koordinojnë mbikëqyrjen e tyre për:

   a) identifikimin dhe adresimin e shkeljeve të këtij ligji;

   b) zhvillimin dhe promovimin e praktikave më të mira;

c) Mundësimin e bashkëpunimit;

d) Konsolodimin e qasjes mbikëqyrëse;

e) ofrimin e vlerësimeve ndër-juridiksionale në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje.

Për qëllimet e pikës 8, Banka e Shqipërisë dhe AMF-ja luajnë një rol koordinues ndërmjet autoriteteve përgjegjëse dhe kolegjeve mbikëqyrëse të përcaktuara në nenin 119, me synimin për të ndërtuar një kulturë të përbashkët mbikëqyrëse, praktika mbikëqyrëse konsistente si dhe për të siguruar njëtrajtshmërinë e procedurave.

9. Kur një autoritet përgjegjës konstaton se ndonjë nga kërkesat e këtij ligji nuk është përmbushur, ai informon autoritetin përgjegjës të subjektit ose subjekteve të dyshuara për një shkeljet e tilla në mënyrë të mjaftueshme dhe të detajuar.

10. Për qëllime të këtij neni, autoritetet përgjegjëse, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë sipas këtij ligji, mund të miratojnë rregulla më të detajuara lidhur me format standarde, modelet dhe procedurat për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse.

Neni 96

Bashkëpunimi me autoritetet ndërkombëtare dhe të huaja

1. Autoritetet përgjegjëse do të bashkëpunojnë me Autoritetin Evropian të Mbikëqyrjes Bankare (EBA) dhe Autoritetin Evropian të Mbikëqyrjes së Tregjeve të Letrave me Vlerë (ESMA), dhe autoritetet përgjegjëse te huaja, në rastet kur është e aplikueshme, për qëllime të mbikëqyrjes, shkëmbimit të informacionit dhe zbatimit të këtij ligji.

2. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë, secili brenda fushës së vet të kompetencës, ngarkohen të hartojnë dhe miratojnë aktet nënligjore që përcaktojnë format standarde, modelet dhe procedurat për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe autoriteteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 97

Klasifikimi i kripto-aseteve

1. AMF miraton rregullore për formën dhe përmbajtjen e relacionit shpjegues që shoqëron dokumentin informues të kripto-asetit, sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 4, si dhe të opinionit ligjor në lidhje me kualifikimin e tokenave të aseteve, sipas përcaktimeve të

nenit 17 pika 1, shkronja (b)(ii) dhe në nenin 18 pika 2, shkronja (e). Kjo rregullore përcakton edhe formatin dhe përmbajtjen e testit të standardizuar për klasifikimin e kripto-aseteve.

2. Autoritetet përgjegjëse të shtetit të origjinës ose të shtetit pritës mund të kërkojnë nga Autoritetet Mbikëqyrëse një opinion mbi klasifikimin e kripto-aseteve, përfshirë ato që janë përjashtuar nga fusha e këtij ligji në bazë të nenit 2 pika 3. Autoritetet përgjegjëse mundësojnë një opinion të tillë brenda 15 ditëve të punës nga marrja e kërkesës.

Neni 98

Bashkëpunimi me autoritetet e tjera kombëtare

Kur një ofertues, një subjekt që kërkon pranim për tregtim, një emetues i një tokeni aseti, i një tokeni të parasë elektronike, ose një ofrues i shërbimeve për kripto-asete kryen veprimtari të tjera përveç atyre që mbulohen nga ky ligj, autoritetet përgjegjëse bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e aktiviteteve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë autoritetet tatimore dhe autoritetet mbikëqyrëse përkatëse.

Neni 99

Detyrimi i njoftimit

Autoritetet Përgjegjëse informojnë Komisionin Evropian mbi miratimin e ligjeve, rregulloreve ,dispozitave administrative, dispozitave të kodit penal në zbatim të këtij Kreu, përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm në to.

Neni 100

Sekreti profesional

1. Të gjitha informacionet e shkëmbyera ndërmjet autoriteteve përgjegjëse sipas këtij ligji, që kanë të bëjnë me kushtet e biznesit ose ato operacionale dhe çështje të tjera ekonomike ose personale, konsiderohen konfidenciale dhe i nënshtrohen kërkesave të sekretit profesional, përveç në rastet kur autoriteti përgjegjës, në momentin e komunikimit, deklaron se informacioni mund të bëhet publik ose kur një zbulim i tillë është i nevojshëm për procedurat ligjore ose për raste të mbuluara nga legjislacioni tatimor ose legjislacioni penal.

2. Detyrimi i sekretit profesional zbatohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që punojnë ose kanë punuar për autoritetet përgjegjëse. Informacioni që mbulohet nga sekreti profesional nuk mund të zbulohet asnjë personi fizik ose juridik tjetër, ose autoriteti tjetër, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

Neni 101

Mbrojtja e të dhënave

Autoritetet Përgjegjëse, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, zbatojnë të gjitha detyrimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 102

Masat paraprake

1. Në rastet kur AMF ka dyshime të arsyeshme për parregullsi në veprimtarinë e një ofertuesi, një subjekti që kërkon pranim për tregtim të kripto-aseteve, një emetuesi të një tokeni aseti ose të një tokeni të parasë elektronike, ose një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve, me seli në një shtet tjetër ai njofton autoritetin përgjegjës të atij shteti në lidhje me këto dyshime.

Nëse parregullsitë e përcaktuara në pikën e parë kanë të bëjnë me një emetues të një tokeni aseti ose të një tokeni të parasë elektronike, ose një shërbim të kripto-aseteve që lidhet me tokenat e asetit ose tokenat e parasë elektronike, Banka e Shqipërise njofton Autoritetin Përgjegjës të mbikëqyrjes bankare të atij shteti.

2. Në rastet kur, pavarësisht masave të marra nga autoriteti përgjegjës i shtetit tjetër, parregullsitë e përcaktuara në pikën 1 vijojnë dhe rezultojnë në shkelje të këtij ligji, AMF ose sipas rastit Banka e Shqipërisë, pasi të ketë informojë autoritetin përgjegjës të shtetit tjetër, merr masa të përshtatshme për të mbrojtur klientët e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve dhe zotëruesit e kripto-aseteve, veçanërisht klientët joprofesionistë. Këto masa përfshijnë ndalimin e ofertuesit, subjektit që kërkon pranim për tregtim, emetuesit të tokenave të asetit ose të tokenave të parasë elektronike ose ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve nga kryerja e veprimtarive të mëtejshme në Republikën e Shqipërisë.

3. I pa aplikueshem.

Neni 103

Fuqitë ndërhyrëse të përkohshme të Autoriteti Evropian i Tregjeve të Titujve (ESMA)

1. Në rastet kur përmbushen kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, ESMA mund të ndalojë ose kufizojë përkohësisht:

(a) materialet promovuese, shpërndarjen ose shitjen e disa kripto-aseteve përveç tokenave të asetit ose tokenave të parasë elektronike, ose kripto-aseteve përveç tokenave të asetit ose tokenave të parasë elektronike me disa veçori të specifikuara; ose

(b) një lloj aktiviteti ose praktike të lidhur me kripto-asetet përveç tokenave të asetit ose tokenave të parasë elektronike.

Një ndalim ose kufizim i tillë mund të zbatohet në rrethana të caktuara, ose të jetë subjekt i rasteve përjashtimore, sipas specifikimeve të ESMA.

2. ESMA do të marrë një masë në përputhje me pikën 1 vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) ndalimi ose kufizimi i propozuar trajton një shqetësim të rëndësishëm për mbrojtjen e investitorëve ose një kërcënim për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve në kripto-asete ose për stabilitetin e të gjithë ose një pjese të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë;

(b) kërkesat rregullatore sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë që zbatohen për kripto-asetet dhe shërbimet e kripto-aseteve përkatëse nuk e adresojnë kërcënimin në fjalë;

(c) një autoritet përgjegjës përkatës nuk ka marrë masa për të adresuar kërcënimin në fjalë ose veprimet e marra nuk e adresojnë në mënyrë adekuate atë kërcënim.

3. Në rastet kur merr një masë në përputhje me pikën 1, ESMA sigurojnë që masa nuk:

(a) ka një efekt të dëmshëm në efikasitetin e tregjeve të kripto-aseteve ose mbi poseduesit e kripto-aseteve ose klientët që marrin shërbime të kripto-aseteve; dhe

(b) krijon një rrezik të arbitrazhit rregullator.

Kur autoritetet përgjegjëse kanë marrë një masë në përputhje me nenin 105, ESMA mund të marrë ndonjë nga masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni pa lëshuar një opinion në përputhje me nenin 106 pika 2.

4. Përpara se të vendosë për marrjen e një mase në përputhje me pikën 1, ESMA njofton autoritetet përgjegjëse përkatëse për masën që synon të marrë.

5. ESMA publikon në faqen e saj të internetit një njoftim për vendimin për të marrë një masë në përputhje me pikën 1. Ky njoftim specifikon detajet e ndalimit ose kufizimit të vendosur dhe të përcaktojë një kohë pas publikimit të njoftimit nga e cila masat do të hyjnë në fuqi. Ndalimi ose kufizimi do të zbatohet vetëm për aktivitetet e përcaktuara pas hyrjes në fuqi të masës.

6. ESMA rishikon ndalimin ose kufizimin e vendosur në përputhje me pikën 1 në intervale të përshtatshme, dhe të paktën çdo gjashtë muaj. Pas të paktën dy rinovimeve të njëpasnjëshme dhe bazuar në një analizë që vlerëson ndikimin te konsumatorët, AMF-ja mund të vendosë për rinovimin vjetor të ndalimit ose kufizimit.

7. Masat e marra nga ESMA në përputhje me këtë nen do të prevalojnë mbi çdo masë të

mëparshme të marrë nga autoritetet përkatëse mbi të njëjtën çështje.

8. Dispozitat e këtij neni fillojnë zbatimin nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 104

Fuqitë ndërhyrëse të përkohshme të Autoritetit Bankan Evropian

1. Në rastet kur përmbushen kushtet e përcaktaura në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, EBA mund të ndalojë ose kufizojë përkohësisht:

(a) materialet prpmovuese, shpërndarjen ose shitjen e tokenave të asetit ose tokenave të parasë elektronike; ose

(b) një lloj aktiviteti ose praktike të lidhur me tokenat e asetit ose tokenat e parasë elektronike.

Një ndalim ose kufizim i tillë mund të zbatohet në rrethana të caktuara, ose të jetë subjekt i rasteve përjashtimore, sipas specifikimeve të EBA.

2. EBA do të marrë masa sipas përcaktimeve të pikës 1 vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) ndalimi ose kufizimi i propozuar trajton një shqetësim të rëndësishëm për mbrojtjen e investitorëve ose një kërcënim për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve në kripto-asete ose për stabilitetin e të gjithë ose një pjese të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë;

(b) kërkesat rregullatore sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë që zbatohen për tokenat e asetit, tokenat e parasë elektronike ose shërbimet e lidhura me kripto-asetet përkatëse nuk e adresojnë kërcënimin në fjalë;

(c) një autoritet përgjegjës përkatës nuk ka marrë masa për të adresuar kërcënimin në fjalë ose veprimet e marra nuk e adresojnë në mënyrë adekuate atë kërcënim.

3. Në rastet kur merr një masë në përputhje me pikën 1, EBA sigurojnë që masa nuk:

(a) ka një efekt të dëmshëm në efikasitetin e tregjeve të kripto-aseteve ose mbi poseduesit e tokenave të asetit, tokenave të parasë elektronike ose klientët që marrin shërbime të lidhura me kripto-asetet; dhe

(b) krijon një rrezik të arbitrazhit rregullator.

Kur autoritetet përgjegjëse kanë marrë një masë në përputhje me nenin 105, EBA mund të marrë ndonjë nga masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni pa lëshuar një opinion në përputhje me nenin 106 pika 2.

4. Përpara se të vendosë për marrjen e një mase në përputhje me pikën 1,EBA njofton

autoritetet përgjegjëse përkatëse për masën që synon të marrë.

5. EBA publikon në faqen e saj të internetit një njoftim për vendimin për të marrë një masë në përputhje me pikën 1. Ky njoftim specifikon detajet e ndalimit ose kufizimit të vendosur dhe të përcaktojë një kohë pas publikimit të njoftimit nga e cila masat do të hyjnë në fuqi. Ndalimi ose kufizim do të zbatohet pas hyrjes në fuqi të masës.

6. EBA rishikon ndalimin ose kufizimin e vendosur në përputhje me pikën 1 në intervale të përshtatshme, dhe të paktën çdo gjashtë muaj. Pas të paktën dy rinovimeve të njëpasnjëshme dhe bazuar në një analizë që vlerëson ndikimin te konsumatorët, Banka e Shqipërisë mund të vendosë për rinovimin vjetor të ndalimit ose kufizimit.

7. Masat e marra nga Banka e Shqipërisë në përputhje me këtë nen do të prevalojnë mbi çdo masë të mëparshme të marrë nga autoritetet përkatëse mbi të njëjtën çështje.

8. Dispozitat e këtij neni fillojnë zbatimin nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 105

Ndalimi ose kufizimi i veprimtarisë nga autoritetet përgjegjëse

1. Autoritetet Përgjegjëse, mund të ndalojnë ose kufizojnë sa vijon:

(a) materialet promovuese, shpërndarjen ose shitjen e disa kripto-aseteve ose kripto-aseteve me disa veçori të specifikuara; ose

(b) një lloj veprimtarie ose praktike të lidhur me kripto-asetet.

2. Autoritetet përgjegjëse ndërmarrin masa në përputhje me pikën 1 në rastet kur krijojnë bindje, bazuar në dyshime të arsyeshme se:

(a) një kripto-aset rrezikon mbrojtjen e investitorëve ose paraqet kërcënim për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve të kripto-aseteve ose për stabilitetin e të gjithë ose një pjese të sistemit financiar;

(b) kërkesat ligjore ekzistuese sipas ligjit të zbatueshëm për kripto-asetin ose shërbimin përkatës të kripto-aseteve nuk e adresojnë në mënyrë të mjaftueshme rrezikun e përcaktuar në shkronjën (a), dhe përforcimi i mbikëqyrjes dhe zbatueshmerisë nuk adreson çështjen (c) masa është proporcionale,në përputhje menatyrën e rreziqeve të identifikuara, nivelin e sofistikimit të investitorëve ose pjesëmarrësve përkatës të tregut dhe efektin e mundshëm të masës te investitorët dhe pjesëmarrësit në treg të cilët mund të mbajnë, përdorin ose përfitojnë nga kripto-aseti ose shërbimi i kripto-aseteve përkatës;

(d) autoritetet përgjegjëse kanë konsultuar në mënyrë të përshtatshme autoritetet përgjegjëse të vendeve të tjera që mund të preken ndjeshëm nga masa; dhe

(e) masa nuk ka një efekt diskriminues ndaj shërbimeve ose aktiviteteve të ofruara nga një

vend tjetër.

Në rastet kur plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, autoriteti përgjegjës mund të vendosë ndalimin ose kufizimin e përcaktuar në pikën 1 mbi një bazë paraprake përpara se një kripto-aset të jetë tregtuar, shpërndarë ose shitur tek klientët.

Autoriteti përgjegjës mund të vendosë që ndalimi ose kufizimi i përcaktuar në pikën 1 të zbatohet vetëm në rrethana të caktuara ose në rastepërjashtimore.

3. Autoritetet përgjegjëse nuk mund të vendosë një ndalim ose kufizim për tokenat e asetit dhe tokenat e parasë elektronike sipas këtij neni, përveç rastit kur ai ka njoftuar me shkrim ose përmes një mjeti tjetër komunikimi të dakordësuar, të gjitha autoritetet përgjegjëse të shteteve të tjera, në rastet kur është e zbatueshme, jo më pak se një muaj përpara se masa të hyjë në fuqi, informacione mbi të:

(a) kripto-asetin, aktivitetin ose praktikën për të cilën lidhet masa e propozuar;

(b) natyrën e saktë të ndalimit ose kufizimit të propozuar dhe datën kur synohet që ajo të hyjë në fuqi; dhe

(c) provat mbi të cilat është bazuar vendimi dhe mbi të cilat kushtet e përcaktuara në pikën 2, , janë përmbushur.

4. Në raste të jashtëzakonshme, kur autoritetet përgjegjëse e konsiderojnë të nevojshme për të parandaluar çdo efekt të dëmshëm që buron nga kripto-aseti, veprimtaria ose praktika e përcaktuar në pikën 1, autoritetet përgjegjëse mund të marrin një masë urgjente të përkohshme duke njoftuar me shkrim ESMA dhe autoritetet përgjegjëse jo më pak se 24 orë përpara se masa të hyjë në fuqi, për aq kohë sa të gjitha kriteret e përcaktuara në këtë nen janë plotësuar dhe është e qartë se një periudhë njoftimi prej një muaji nuk do të adresonte në mënyrë të përshtatshme shqetësimin ose kërcënimin specifik. Kohëzgjatja e masave të marra përkohësisht nuk kalon tre muaj.

5. Autoritetet përgjegjëse publikojnë njoftimin për vendimin për ndalimin ose kufizimin në faqen zyrtare të e internetit. Njoftimi i vendimit specifikon detajet e ndalimit ose kufizimit të vendosur, afatin brenda të cilit masat do të hyjnë në fuqi, si dhe provat mbi të cilat autoriteti përgjegjës ka bazuar vendimin. Ndalimi ose kufizimi do të zbatohet vetëm për veprimtaritë e përcaktuara pas hyrjes në fuqi të masave.

6. Autoritetet përgjegjëse revokon një ndalim ose kufizim nëse kushtet në pikën 2 nuk janë më të zbatueshme.

7. Për qëllime të pikës 2 shkronja (a) këtij neni, autoritetet përgjegjëse, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë sipas këtij ligji, mund të miratojnë rregulla më të detajuara pë kriteret dhe faktorët që do të merren parasysh nga autoritetet përgjegjëse për të përcaktuar nëse ekziston një rrezik për mbrojtjen e investitorëve ose një kërcënim për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve në kripto-asete ose për stabilitetin sistemit financiar brenda Republikës së Shqipërisë.

Neni 106

Koordinimi me ESMA ose EBA

1. ESMA ose, për tokenat e asetit dhe tokenat e parasë elektronike, EBA, do të kryejë një rol lehtësues dhe koordinues në lidhje me masat e ndërmarra nga autoritetet përgjegjëse në përputhje me nenin 105. ESMA ose, për tokenat e asetit dhe tokenat e parasë elektronike, EBA, do të sigurojë që masat e ndërmarra nga një autoritet përgjegjës të jenë të justifikuara dhe proporcionale, dhe që autoritetet përgjegjëse të ndjekin një qasje të harmonizuar, kur është e përshtatshme.
2. Pas marrjes së njoftimit sipas nenit 105(3) për çdo masë që duhet ndërmarrë sipas këtij neni, ESMA ose, për tokenat e asetit dhe tokenat e parasë elektronike, EBA, do të lëshojë një opinion për të përcaktuar nëse ndalimi ose kufizimi është i justifikuar dhe proporcional. Nëse ESMA ose, për tokenat e asetit dhe tokenat e parasë elektronike, EBA, konsideron të nevojshme marrjen e masave nga autoritete të tjera përgjegjëse për të adresuar rrezikun, do ta theksojë këtë në opinionin e saj. Ky opinion do të publikohet në faqen e internetit të ESMA ose, për tokenat e asetit dhe tokenat e parasë elektronike, EBA-së.
3. Kur një autoritet përgjegjës propozon të ndërmarrë, ndërmerr ose refuzon të ndërmarrë masa që janë në kundërshtim me opinionin e lëshuar nga ESMA ose EBA sipas pikës 2, duhet menjëherë të publikojë në faqen e vet të internetit një njoftim që shpjegon plotësisht arsyet e këtij vendimi.

4. Dispozitat e këtij neni fillojnë zbatimin nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 107

Bashkëpunimi me shtetet e tjera

1. Autoritetet përgjegjëse, në rastet kur është e nevojshme, mund lidhin marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse të shteteve të tjera për shkëmbimin e informacionit dhe për zbatimin e detyrimeve sipas këtij ligji në ato shtete. Këto marrëveshje bashkëpunimi sigurojnë një shkëmbim efikas informacioni që u mundëson autoriteteve përgjegjëse të kryejnë detyrat e tyre sipas këtij ligji.
2. AMF, miraton formatin dhe përmbajtjen standard për marrëveshjet e bashkëpunimit të përcaktuara në pikën 1
3. Banka e Shqipërisë miraton formatin dhe përmbajtjen standard për marrëveshjet e bashkëpunimit të përcaktuara në pikën 1
4. Autoritetet përgjegjëse do të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta vetëm kur informacioni i dhënë është subjekt detyrimeve ne lidhje me konfidencialitetitn dhe garancive të sekretit

profesional të cilat janë ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 100. Ky shkëmbim informacioni ka për qëlim zbatimin e detyrave përakatëse të autoriteteve përgjegjëse sipas këtij ligji.

Neni 108

Trajtimi i ankesave nga autoritetet përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse hartojnë procedura që u lejojnë klientëve dhe palëve të tjera të interesuara, përfshirë shoqatat e konsumatorëve, të paraqesin ankesa për shkelje të pretenduara të këtij ligji nga ofertuesit, subjektet që kërkojnë pranim për tregtim, emetuesit e tokenave të asetit ose tokenave të parasë elektronike, ose ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve. Ankesat do të pranohen me shkrim, përfshirë në formë elektronike, dhe në gjuhën shqipe.
2. Informacioni mbi procedurat e trajtimit të ankesave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do të publikohet në faqen e internetit të secilit autoritet përgjegjës.

Seksioni 2:
Regjistrat e AMF-së

Neni 109

Regjistri i dokumentit informues të kripto-aseteve, emetuesve të tokenave të asetit dhe tokenave të parasë elektronike, si dhe ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve

1. AMF-ja krijon dhe mban:

(a) regjistër të dokumenteve informuese për kripto-asete të ndryshme nga tokenat e asetit dhe tokenat e parasë elektronike;

(b) regjistër të emetuesve të tokenave të asetit;

(c) regjistër të emetuesve të tokenave të parasë elektronike; dhe

(d) regjistër të ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve.

Regjistrat sipas kësaj pike publikohen në faqen e saj të internetit dhe përditësohen rregullisht.

AMF siguron të dhënat e nevojshme për klasifikimin e dokumente informues të kripto-aseteve në regjistër, sipas specifikimeve të përcaktuara në pikën 8 të këtij neni.

2. Për dokumentet informuese të tokenave të cilat nuk janë tokena të asetit dhe tokena të

parasë elektronike, regjistri do të përmbajë dokumentin informues dhe çdo dokument informues të ndryshuar. Çdo version i mëparshëm i dokumentit informues do të mbahet i arkivuar në mënyrë të veçantë dhe do të shenjohet qartë si version i pavlefshëm.

3. Regjistri emetuesve të tokenave të asetit do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

(a) emrin, formën ligjore dhe numrin unik të identifikimit të subjektit emetues;

(b) emrin tregtar, adresën fizike, numrin e telefonit, emailin dhe faqen e internetit të emetuesit;

(c) dokumentin informues të kripto-aseteve dhe çdo dokument informues të ndryshuar, përfshirë versionet e mëparshme të dokumentit informues të cilat mbahen të arkivuar në mënyrë të veçantë shenjohen qartë si version i pavlefshëm;

(d) listën e shteteve të tjera ku emetuesi aplikant synon të ofrojë tokenin e asetit ndaj publikut ose të kërkojë pranimin për tregtim të tokenave të asetit;

(e) datën e fillimit, ose, nëse nuk është e disponueshme në kohën e njoftimit nga autoriteti përgjegjës, datën e synuar të fillimit, të ofertës ndaj publikut ose pranimit për tregtim;

(f) çdo shërbim tjetër të ofruar nga emetuesi që nuk mbulohet nga ky ligj, duke cituar legjislacionin e zbatueshëm;

(g) datën e autorizimit për të ofruar tokenin e asetit ndaj publikut ose për të kërkuar pranimin për tregtim të tij, ose të autorizimit si institucion krediti, dhe, kur është e zbatueshme, të tërheqjes së autorizimit.

4. Për sa i përket emetuesve të tokenave të parasë elektronike, regjistri do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

(a) emrin, formën ligjore dhe numrin unikt të identifikimit të subjektit emetues;

(b) emrin tregtar, adresën fizike, numrin e telefonit, emailin dhe faqen e internetit të emetuesit;

(c) dokumentet informuese të kripto-aseteve dhe çdo dokument informues të ndryshuar, përfshirë versionet e mëparshme të dokumentit informues të cilat mbahen të arkivuar në mënyrë të veçantë shenjohen qartë si version i pavlefshëm;

(d) datën e fillimit, ose, nëse nuk është e disponueshme në kohën e njoftimit nga autoriteti përgjegjës, datën e synuar të fillimit të ofertës ndaj publikut ose pranimit për tregtim;

(e) çdo shërbim tjetër të ofruar nga emetuesi që nuk mbulohet nga ky ligj, duke cituar legjislacionin e zbatueshëm;

(f) datën e autorizimit si institucion krediti ose si institucion i parasë elektronike dhe, kur është e zbatueshme, të tërheqjes së autorizimit.

5. Për sa i përket ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, regjistri do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

(a) emrin, formën ligjore dhe numrin unik të identifikimit të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve dhe të degëve të tij, në rastet kur është e zbatueshme;

(b) emrin tregtar, adresën fizike, numrin e telefonit, emailin dhe faqen e internetit të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve dhe të platformës së tregtimit të operuar nga ai, në rastet kur është e zbatueshme;

(c) emrin dhe adresën e AMF detajet e kontaktit të tij;

(d) listën e shërbimeve të kripto-aseteve të ofruara;

(e) listën e shteteve të tjera ku ofruesi i shërbimeve synon të ofrojë shërbime të kripto-aseteve;

(f) datën e fillimit, ose, nëse nuk është e disponueshme në kohën e njoftimit nga autoriteti përgjegjës, datën e synuar të fillimit të ofrimit të shërbimeve të kripto-aseteve;

(g) çdo shërbim tjetër të ofruar që nuk mbulohet nga ky ligj, duke cituar legjislacionin e zbatueshëm;

(h) datën e autorizimit dhe, kur është e zbatueshme, të tërheqjes së autorizimit.

6. Në rastet e emetuesve, ofertuesve ose ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve me seli në Bashkimin Evropian, Autoritetet përgjegjëse njoftojnë ESMA pa vonesë për masat e listuara në nenin 94(1), pika e parë, shkronjat (b), (c), (f), (l), (m), (n), (o) ose (t), si dhe për çdo masë publike parandaluese të ndërmarrë në përputhje me nenin 102 që ndikon në ofrimin e shërbimeve të kripto-aseteve ose emetimin, ofertën ndaj publikut ose përdorimin e kripto-aseteve. AMF-ja përfshin këto informacione në regjistër.
7. Çdo tërheqje e autorizimit të një emetuesi të tokenit të asetit, të një emetuesi të tokenit të parasë elektronike ose të një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve, si dhe çdo masë e njoftuar në përputhje me pikën 6, do të mbetet e publikuar në regjistër për të paktën pesë vite.
8. AMF miraton rregulla të detajuara në lidhje me të dhënat e nevojshme për klasifikimin, sipas llojit të kripto-asetit, të dokumentit informues të kripto-aseteve, përfshirë numrin unik të identifikimit të subjekteve juridike në regjistër, dhe do të përcaktojë modalitetet praktike për të siguruar që këto të dhëna të jenë të lexueshme nga kompjuteri.

Neni 110

Regjistri i subjekteve që ofrojnë shërbime të kripto-aseteve pa autorizim

1. AMF-ja krijon dhe mban një regjistër të subjekteve që ofrojnë shërbime të kripto-aseteve në shkelje të nenit 59 ose 61.

2. Regjistri do të përmbajë të paktën emrin tregtar ose faqen e internetit të subjektit të pa autorizuar.
3. Regjistri do të jetë i disponueshëm publikisht në faqen e internetit të AMF-së në një format të lexueshëm nga kompjuteri dhe do të përditësohet rregullisht duke përfshirë çdo ndryshim të rrethanave ose çdo informacion të ri që i dërgohet AMF-së për subjektet në fjalë.
4. AMF përditëson regjistrin duke përfshirë informacionin për çdo rast shkeljeje të këtij ligji të identifikuar nga autoriteti.
5. Në rastet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, AMF-ja mund të zbatojë kompetencat mbikëqyrëse dhe hetimore të autoriteteve përgjegjëse, sipas përcaktimeve të nenit 94 pika 1, ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime të kripto-aseteve në mënyrë të pa rregulluar.

Seksioni 3:
Sanksionet dhe masat e tjera administrative

Neni 111

Sanksionet dhe masat e tjera administrative

1. Krahas dënimeve penale, kompetencave mbikëqyrëse dhe atyre hetimore të autoriteteve përgjegjëse të listuara në nenin 94, autoritetet përgjegjëse kanë kompetencën për të marrë sanksione me gjobë dhe masa të tjera administrative për shkeljet e mëposhtme:

(a) shkeljet e neneve 4 deri 14;

(b) shkeljet e neneve 16, 17, 19, 22, 23, 25, 27 deri 41, 46 dhe 47;

(c) shkeljet e neneve 48 deri 51, 53, 54 dhe 55;

(d) shkeljet e neneve 59, 60, 64 dhe 65 deri 83;

(e) shkeljet e neneve 88 deri 92;

(f) mungesën e bashkëpunimit në kuadër të nje hetimi, inspektim ose një kërkese në përputhje me nenin 94, pika 3.

2. Në lidhje me shkeljet e përcaktuara në pikën 1, shkronjat (a) deri (d) të ketij nenit, Autoritetet përgjegjëse kanë të drejtën të vendosin sanksione me gjobë dhe masa të tjera administrative, si më poshtë:

(a) shpalljen publike të të dhënave në lidhje me personin fizik ose juridik përgjegjës dhe natyrën e shkeljes;

(b) nxjerrjen e një urdhri që parashikon ndalimin e kryerjes së shkeljes nga personat fizikë ose juridikë, si dhe mosperseritjen e saj;

(c) vendosjen e një sanksioni me gjobë administrative jo më pak se dyfish të shumës së fitimeve të përfituara ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, pavarësisht nëse tejkalohet shuma maksimale të përcaktuar në pikën 3 për personat juridikë;

3. Autoritetet përgjegjëse kanë të drejtën për të vendosur sanksione me gjobë në lidhje me shkeljet e kryera nga personat juridikë, si më poshtë:

(a) 5 000 000 EUR, ose ekuivalente e kësaj shume në lekë, për shkeljet e përcaktuara në pikën 1, shkronjat (a) deri (d);

(b) 3% të xhiros totale vjetore të personit juridik, sipas pasqyrave financiare të fundit të disponueshme të miratuara nga organi drejtues, për shkeljet e përcaktuara në pikën 1, shkronja (a);

(c) 5% të xhiros totale vjetore të personit juridik, sipas pasqyrave financiare të fundit të disponueshme të miratuara nga organi drejtues, për shkeljet e përcaktuara në pikën 1, shkronja (d);

(d) 12,5% të xhiros totale vjetore të personit juridik, sipas pasqyrave financiare të fundit të disponueshme të miratuara nga organi drejtues, për shkeljet e përcaktuara në pikën 1, shkronjat (b) dhe (c).

Kur personi juridik i përcaktuar në pikën e parë, shkronja (a) deri (d), është një shoqëri mëmë ose një degë e një shoqërie mëmë që është e detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, xhiroja totale vjetore përkatëse do të jetë xhiroja totale vjetore ose lloji përkatës i të ardhurave në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fushën e kontabilitetit sipas pasqyrave të fundit të konsoliduara të miratuara nga organi drejtues e shoqërisë mëmë përfundimtare.

4. Krahas sanksioneve me gjobë dhe masave të tjera administrative të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, autoritetet përgjegjëse kanë të drejtën për të vendosur, në rastin e shkeljeve të përcaktuara në pikën 1, shkronja (d), një ndalim të përkohshëm që nuk lejon anëtarin ose anëtarët e organit drejtuese të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve, ose çdo person fizik tjetër që mban përgjegjësinë për shkeljen, të ushtrojë funksionet drejtuese në një ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve.
5. Në rastin e shkeljeve të përcaktuara në pikën 1, shkronja (e), autoritetet përgjegjëse kanë të drejtën për të vendosur sanksionet me gjobë dhe masa të tjera administrative dhe për të ndërmarrë masat e mëposhtme:

(a) shpalljen publike të të dhënave në lidhje me personin fizik ose juridik përgjegjës dhe natyrën e shkeljes;

(b) nxjerrjen e një urdhri i cili i kërkon nga personi fizik ose juridik përgjegjës të ndërpresë veprimet e caktuara që përbëjnë shkelje dhe të mos lejojë përsëritjen e saj;;

(c) konfiskimi i fitimeve të përfituara ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, për sa kohë ato mund të përcaktohen;

(d) revokimi ose pezullimi i autorizimit të një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve;

(e) një ndalim i përkohshëm nga ushtrimi i funksioneve drejtuese në ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, për çdo anëtar të organit drejtues të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve, ose për çdo person fizik tjetër që mban përgjegjësinë për shkeljen;

(f) një ndalim prej të paktën 10 vjetësh nga ushtrimi i funksioneve drejtuese në një ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve për çdo anëtar të organit drejtues të një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve, ose për çdo person fizik tjetër që mban përgjegjësinë për shkeljen, në rast të një shkeljeje të përsëritur të nenit 89, 90, 91 ose 92;

(g) një ndalim i përkohshëm nga kryerja e tregtimit për llogari të vet për çdo anëtar të organit drejtues të një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve ose për çdo person fizik tjetër që mban përgjegjësinë për shkeljen;

(h) sanksione me gjobë administrative prej të paktën trefishit të shumës së fitimeve të përfituara ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, në rastet kur ato mund të përcaktohen, pavarësisht nëse tejkalohet shumat maksimale të përcaktuara në shkronjat (i) ose (j), sipas rastit;

(i) për një person fizik/individ, sanksione me gjobë maksimale prej të paktën 1 000 000 EUR për shkeljet e nenit 88 dhe 5 000 000 EUR, ose ekuivalentin e tyre në lekë për shkeljet e neneve 89 deri 92;

(j) për personat juridikë, sanksione me gjobë maksimale prej të paktën 2 500 000 EUR për shkeljet e nenit 88 dhe 15 000 000 EUR, ose ekuivalentin e tyre në lekë, për shkeljet e neneve 89 deri 92, ose 2% të xhiros totale vjetore për shkeljet e nenit 88 dhe 15% të xhiros totale vjetore për shkeljet e neneve 89 deri 92 të personit juridik sipas pasqyrave të fundit të miratuara nga organi drejtues.

Për qëllim të pikës 1 shkronja (j) , kur personi juridik është një shoqëri mëmë ose një shoqëri bijë degë që është e detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, xhiroja totale vjetore përkatëse do të jetë xhiroja totale vjetore ose lloji përkatës i të ardhurave në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fushën e kontabilitetit sipas pasqyrave të fundit të konsoliduara të miratuara nga organi drejtuese i shoqërisë mëmë.

Neni 112

Ushtrimi i kompetencave mbikëqyrëse dhe kompetencave për të vendosur sanksione

1. Në rastet kur përcaktojnë llojin dhe nivelin e një sanksioni me gjobë ose një një mase tjetër administrative që do të vendoset në përputhje me nenin 111, Autoritetet përgjegjëse do të marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë, kur është e përshtatshme:

(a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;

(b) nëse shkelja është kryer me dashje ose si rrjedhojë e pakujdesisë;

(c) shkallën e përgjegjësisë së personit fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen;

(d) fuqia financiare e subjektit përgjegjës për shkeljen, siç rezulton nga xhiroja totale vjetore per personat juridikë përgjegjës, ose të ardhurat vjetore dhe asetet neto të individit përgjegjës;

(e) rëndësinë e fitimeve të përfituara ose humbjeve të shmangura nga personi fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen, për aq sa mund të përcaktohen;

(f) humbjet për palët e treta të shkaktuara nga shkelja, për aq sa mund të përcaktohen;

(g) niveli i bashkëpunimit i subjektit përgjegjës për shkeljen me autoritetin përgjegjës, pavarësisht nevojës për të siguruar konfiskimin e fitimeve të përfituara ose humbjeve të shmangura nga ai person;

(h) shkeljet e mëparshme të këtij ligji nga subjekti përgjegjës për shkeljen;

(i) masat e marra nga subjekti përgjegjës për shkeljen për të parandaluar përsëritjen e saj;

(j) ndikimin e shkeljes në interesat e zotëruesve të kripto-aseteve dhe klientëve të ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, veçanërisht klientëve joprofesionistë.

2. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre për të vendosur sanksione administrative dhe masa të tjera administrative sipas nenit 111, autoritetet përgjegjëse do të bashkëpunojnë ngushtë për të siguruar që ushtrimi i kompetencave të tyre mbikëqyrëse dhe hetimore, si dhe sanksionet me gjobë dhe masat e tjera administrative që vendosin, të jenë efektive dhe të përshtatshme. Ata do të koordinojnë veprimet e tyre për të shmangur përsëritjet dhe mbivendosjet gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre mbikëqyrëse dhe hetimore, si dhe gjatë vendosjes së sanksioneve me gjobë dhe masave të tjera administrative në rastet ndërkufitare.

Neni 113

E drejta e apelimit

1. Vendimet e marra nga autoritetet përgjegjëse sipas këtij ligji duhet të jenë të arsyetuara dhe subjekt i apelimit përpara një gjykate. E drejta e apelimit do të zbatohet edhe për kërkesat për autorizim që përmban të gjitha informacionet e kërkuara, për të cilat nuk merret një vendim brenda gjashtë muajve nga dorëzimi i saj.
2. Një ose më shumë nga organet e mëposhtme, mund të ndërmarrë veprime para gjykatave ose organeve administrative kompetente për të siguruar zbatimin e këtij ligji, në interes të konsumatorëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi:

(a) organet publike ose përfaqësuesit e tyre;

(b) organizatat e konsumatorëve që kanë një interes legjitim në mbrojtjen e mbajtësve të kripto-aseteve;

(c) organizatat profesionale që kanë një interes legjitim në mbrojtjen e anëtarëve të tyre.

Neni 114

Publikimi i vendimeve

1. Një vendim që përcakton sanksione me gjobë dhe masa të tjera administrative për një shkelje të këtij ligji në përputhje me nenin 111, do të publikohet pa vonesë nga autoritetet përgjegjëse në faqet e tyre zyrtare të internetit pasi subjekti të jetë informuar për atë vendim. Publikimi përfshin informacionin mbi llojin dhe natyrën e shkeljes dhe të dhënat identitetifikuese të personave fizikë ose juridikë përgjegjës. Vendimet që përcaktojnë masa të natyrës hetimore nuk është e nevojshme të publikohen.
2. Në rastet kur publikimi i të dhënave identifikuese të subjekteve juridike, ose të dhënat personale të individëve, pas një vlerësimi rast-pas-rasti të proporcionalitetit të publikimit të atyre të dhënave, konsiderohet nga autoriteti përgjegjës si joproporcional, ose kur një publikim i tillë do të rrezikonte një hetim në vazhdim, autoritetet përgjegjëse do të ndërmarrin një nga veprimet e mëposhtme:

(a) shtyrjen e publikimit të vendimit për vendosjen e një sanksioni me gjobë ose mase tjetër administrative deri në momentin kur arsyet e përcaktuara në pikën 2 nuk janë më të vlefshme;

(b) publikojnë vendimin për vendosjen e një sanksioni me gjobë ose mase tjetër administrative në mënyrë anonime, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në rastet kur publikimi në mënyrë anonime siguron mbrojtje efektive të të dhënave personale të përfshira;

(c) nuk publikojnë vendimin për vendosjen e një sanksioni me gjobë ose mase tjetër administrative në rast se opsionet e parashikuara në shkronjat (a) dhe (b) konsiderohen të pamjaftueshme për të siguruar:

(i) që stabiliteti i tregjeve financiare të mos rrezikohet;

(ii) proporcionalitetin e publikimit të një vendimi të tillë lidhur me masat të cilat

konsiderohen të një shkallë të ulët rëndësie.

Në rastin e një vendimi për të publikuar një sanksion me gjobë ose masë tjetër administrative në mënyrë anonime, siç parashikohet në shkronjën (b) të kësaj pike, publikimi i të dhënave përkatëse mund të shtyhet për një periudhë të arsyeshme, brenda së cilës arsyet për publikim në mënyrë anonime do të pushonin së ekzistuari.

3. Kur vendimi për vendosjen e një sanksioni me gjobë ose mase tjetër administrative është apeluar përpara gjykatave ose organeve administrative përkatëse, autoritetet përgjegjëse do të publikojnë menjëherë në faqet e tyre zyrtare të internetit informacionin përkatës dhe çdo informacion të mëvonshëm mbi verdiktin e apelimit. Gjithashtu, çdo vendim i një gjykate ose organi tjetër administrativ që anulon një vendim të mëparshëm për vendosjen e një sanksioni me gjobë ose mase tjetër administrative do të publikohet.
4. Autoritetet përgjegjëse sigurojnë që çdo publikim, në përputhje me këtë nen, të mbetet në faqet e tyre zyrtare të internetit për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh pas publikimit të tij. Të dhënat personale të përfshira në publikim do të mbahen në faqen zyrtare të internetit të autoritetit përgjegjës vetëm për periudhën që është e nevojshme në përputhje me rregullat e zbatueshme të mbrojtjes së të dhënave.

Neni 115

Raportimi i sanksioneve dhe masave të tjera administrative tek ESMA dhe EBA

1. Autoritetet përgjegjëse, në bazë vjetore, do t'i sigurojë ESMA dhe EBA informacion të përmbledhur lidhur me të gjitha sanksionet administrative dhe masat e tjera administrative të vendosura në përputhje me nenin 111 për emetues, ofertues ose ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve me seli në Bashkimin Evropian.

   Në rastet kur në përputhje me nenin 111, pika 1, autoritetet ligjzbatuese kanë përcaktuar ndëshkime penale për shkeljet e dispozitave të përcaktuara në këtë ligj për emetues, ofertues, ose ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve me seli në Bashkimin Evropian, autoritetet përgjegjëse sipas rastit, do t'i sigurojnë EBA dhe ESMA të dhëna të anonimizuara dhe të përmbledhura lidhur me të gjitha hetimet penale të kryera dhe ndëshkimet penale të vendosura.

2. Në rastet kur autoriteti përgjegjës ka publikuar sanksione administrative, masa të tjera administrative ose ndëshkime penale për emetues, ofertues ose ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve me seli në Bashkimin Evropian, autoriteti përgjegjës sipas rastit do t'i raportojë ato njëkohësisht tek ESMA.
3. Autoritetet përgjegjëse do të informojnë EBA dhe ESMA për të gjitha sanksionet administrative ose masat e tjera administrative të vendosura kundrejt një emetuesi, ofertuesi ose ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve, me seli në Bashkimin Evropian, të cilat nuk janë publikuar, duke përfshirë çdo apel lidhur me to si dhe vendimin përfundimtar. Autoritetet përgjegjëse kanë të drejtën të marrin informacionin dhe

vendimin përfundimtar lidhur me çdo ndëshkim penal të vendosur për shkeljet e përcaktuara në këtë ligj. AMF-ja do të mbajë një bazë të dhënash qendrore për sanksionet dhe masat administrative të komunikuara vetëm për qëllimet e shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve përgjegjëse. Kjo bazë e të dhënave do të jetë e aksesueshme për Bankën e Shqipërisë dhe AMF-në si dhe dhe do të përditësohet në bazë të informacionit të siguruar nga autoritetet përgjegjëse.

Neni 116

Raportimi i shkeljeve dhe mbrojtja e personave raportues

Raportimi i shkeljeve të këtij ligji dhe mbrojtja e personave raportues të këtyre shkeljeve i nënshtrohen dispozitave të legjislacionit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Seksioni 4:
Përgjegjësitë mbikëqyrëse të EBA dhe kolegjeve mbikëqyrëse në lidhje me emetuesit e tokenave të asetit dhe tokenave të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishme

Neni 117

Përgjegjësitë mbikëqyrëse të Autoritetit Bankar Evropian në lidhje me emetuesit e tokenave të asetit dhe të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishme

1. Dispozitat e këtij seksioni që i atribuojnë kompetenca Autoritetit Bankar Evropian ose Autoritetin Evropian të Tregjeve të Titujve bëhen të zbatueshme në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
2. Në rastet kur një token i asetit është klasifikuar si i rëndësishëm në përputhje me nenin 43 ose 44, emetuesi i një tokeni të tillë të asetit do të kryejë veprimtarinë e tij nën mbikëqyrjen e Autoritetit Bankar Evropian.

Autoriteti Bankar Evropian do të ushtrojë kompetencat e autoriteteve përgjegjëse të përcaktuara në nenet 22 deri 25, 29, 33, nenin 34 pika 7 dhe 12, nenin 35 pika 3 dhe 5, nenin 36 pika 10 dhe nenet 41, 42, 46 dhe 47 lidhur me emetuesit e tokenave të asetit me rëndësi të lartë.

2. Në rastet kur një emetues i një tokeni të asetit me rëndësi të lartë gjithashtu ofron shërbime të kripto-aseteve ose emeton kripto-asete që nuk janë tokena të asetit me rëndësi të lartë, ato shërbime dhe aktivitete do të mbeten nën mbikëqyrjen e autoritetit përgjegjës përkatëse.
3. Në rastet kur një token i asetit është klasifikuar si i rëndësishëm në përputhje me nenin 43, Autoriteti Bankar Evropian do të kryejë një rishikim mbikëqyrës për të siguruar që emetuesi është në përputhje me Kreun III.
4. Në rastet kur një token i parasë elektronike i emetuar nga një institucion i parasë

elektronike është klasifikuar si i rëndësishëm në përputhje me nenin 56 ose 57, Autoriteti Bankar Evropian do të mbikëqyrë përputhshmërinë me nenet 55 dhe 58.

Për qëllimet e mbikëqyrjes së përputhshmërisë me nenet 55 dhe 58, Autoriteti Bankar Evropian do të ushtrojë kompetencat e autoriteteve përgjegjëse të përcaktuara në nenet 22 dhe 23, nenin 24(3), nenin 35(3) dhe (5), nenin 36(10) dhe nenet 46 dhe 47 lidhur me institucionet e parasë elektronike që emetojnë tokena të parasë elektronike me rëndësi të lartë.

5. Autoriteti Bankar Evropian do të ushtrojë kompetencat e saj mbikëqyrëse siç parashikohet në pikat 1 deri 4, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen e emetuesit.

Neni 118

Komiteti për kripto-asetet i Autoritetit Bankar Evropian

1. Autoriteti Bankar Evropian do të krijojë një komitet të brendshëm të përhershëm për qëllimet e përgatitjes së vendimeve të Autoritetit Bankar Evropian që do të merren në përputhje me nenin 44, duke përfshirë vendimet që lidhen me detyrat mbikëqyrëse që i janë dhënë Autoritetit Bankar Evropian nga ky ligj.
2. Komiteti për kripto-asetet mund të përgatisë gjithashtu vendime në lidhje me draftet e akteve rregullatore atyre zbatuese që lidhen me detyrat mbikëqyrëse që i janë dhënë Autoritetit Bankar Evropian nga ky ligj.
3. Autoriteti Bankar Evropian do të sigurojë që komiteti për kripto-asetet të kryejë vetëm aktivitetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 dhe çdo detyrë tjetër të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të tij në lidhje me kripto-asetet.

Neni 119

Kolegjet për emetuesit e tokenave të asetit dhe të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishme

1. Brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit për të klasifikuar një token të asetit ose një token të parasë elektronike si të rëndësishëm, në përputhje me nenin 43, 44, 56 ose 57, sipas rastit, Autoriteti Bankar Evropian do të krijojë, menaxhojë dhe drejtojë një kolegj mbikëqyrës konsultativ për secilin emetues të një tokeni të asetit ose të një tokeni të parasë elektronike me rëndësi të lartë për të lehtësuar ushtrimin e detyrave mbikëqyrëse dhe për të shërbyer si një mjet për koordinimin e aktiviteteve mbikëqyrëse sipas këtij ligji.
2. Kolegji i përcaktuar në pikën 1 do të përbëhet nga:

(a) Autoriteti Bankar Evropian;

(b) ESMA;

(c) autoritetet përgjegjëse të vendit origjinës ku është vendosur emetuesi i tokenit të asetit ose të tokenit të parasë elektronike të klasfikikuar si të rëndësishme;

3. Autoriteti Bankar Evropian mund të ftojë autoritete të tjera për të qenë anëtarë të kolegjit të përcaktuar në pikën 1, kur subjektet që ata mbikëqyrin janë të rëndësishme për punën e kolegjit.
4. Autoriteti përgjegjës i një vendi të tretë që nuk është anëtar i kolegjit mund të kërkojë nga kolegji çdo informacion të rëndësishëm për kryerjen e detyrave të tij mbikëqyrëse sipas këtij ligji.
5. Kolegji i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, krahas përgjegjësive të autoriteteve përgjegjëse sipas këtij ligji, do të sigurojë:

(a) përgatitjen e opinionit jo-detyrues të përcaktuar në nenin 120;

(b) shkëmbimin e informacionit në përputhje me këtë ligj;

(c) arritjen e një marrëveshjeje për besimin vullnetar të detyrave midis anëtarëve të tij.

Për të lehtësuar kryerjen e detyrave të ngarkuara kolegjeve në përputhje me pikën e parë të kësaj pike, anëtarët e kolegjit të përcaktuar në pikën 2 kanë të drejtë të kontribuojnë në përcaktimin e rendit të ditës së takimeve të kolegjit.

6. Krijimi dhe funksionimi i kolegjit të përcaktuar në pikën 1 do të bazohet në një marrëveshje me shkrim midis të gjithë anëtarëve të tij.

Marrëveshja e përcaktuar në pikën e parë do të përcaktojë rregullimet praktike për funksionimin e kolegjit, duke përfshirë rregullat e detajuara për:

(a) procedurat e votimit siç përmenden në nenin 120 pika 3;

(b) procedurat për përcaktimin e rendit të ditës së takimeve të kolegjit;

(c) frekuencën e takimeve të kolegjit;

(d) afatet minimale të përshtatshme për vlerësimin e dokumentacionit përkatës nga anëtarët e kolegjit;

(e) modalitetet e komunikimit ndërmjet anëtarëve të kolegjit;

(f) krijimin e disa kolegjeve, një për çdo kripto-aset specifik ose grup kripto-asetesh.

Marrëveshja mund të përcaktojë gjithashtu detyra që do t’i besohen Autoritetit Bankar Evropian

ose një anëtari tjetër të kolegjit.

7. Si kryetare e çdo kolegji, Autoriteti Bankar Evropian do të:

(a) krijojë marrëveshje dhe procedura me shkrim për funksionimin e kolegjit, pas konsultimit me anëtarët e tjerë të kolegjit;

(b) koordinojë të gjitha aktivitetet e kolegjit;

(c) thërrasë dhe kryesojë të gjitha takimet e tij dhe t'i mbajë anëtarët e kolegjit plotësisht të informuar për organizimin e takimeve të kolegjit, për çështjet kryesore që do të diskutohen dhe për pikat që do të shqyrtohen;

(d) informojë anëtarët e kolegjit për çdo takim të planifikuar në mënyrë që ata të mund të kërkojnë pjesëmarrjen;

(e) mbajë anëtarët e kolegjit të informuar në mënyrë të duhur për vendimet dhe rezultatet e atyre takimeve.

8. Për qëllime të këtij neni, autoritetet përgjegjëse, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, mund të miratojë rregulla më të detajuara, lidhur me kushtet e përgjithshme, kriteret e veçanta, ose kriteret e tjera shtesë.

Neni 120

Opinione jo-detyruese të kolegjeve për emetuesit e tokenave të asetit dhe tokenave të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishme

1. Kolegji i përcaktuar në nenin 119 pika 1 mund të lëshojë një opinion jo-detyrues për sa i përket:

(a) rishikimit mbikëqyrës, sipas përcaktimeve të nenit 117 pika 3;

(b) çdo vendimi për të kërkuar nga një emetues i një tokeni aseti ose një tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishme që të mbajë një sasi më të madhe të fondeve të veta, në përputhje me nenin 35(2), (3) dhe (5), nenin 45(5) dhe nenin 58(1), sipas rastit;

(c) çdo përditësimi të planit të rimëkëmbjes ose planit të rimbursimit të një emetuesi të një tokeni aseti ose një tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm, në përputhje me nenet 46, 47 dhe 55, sipas rastit;

(d) çdo ndryshimi të modelit të biznesit të një emetuesi të një tokeni të asetit të rëndësishëm, sipas nenit 25 pika 1;

(e) një draft të modifikuar të dokumentit informues të kripto-asetit, të hartuar në përputhje me

nenin 25 pika 2;

(f) çdo masë korrigjuese të parashikuar në përputhje me nenin 25 pika 4;

(g) çdo masë mbikëqyrëse të parashikuar, sipas nenit 130;

(h) çdo marrëveshje administrative të parashikuar për shkëmbimin e informacionit me një autoritet mbikëqyrës të një vendi të tretë, në përputhje me nenin 126;

(i) çdo delegim të detyrave mbikëqyrëse nga Autoriteti Bankar Evropian tek një autoritet përgjegjës, sipas nenit 138;

(j) çdo ndryshim të parashikuar në autorizimin ose çdo masë mbikëqyrëse të parashikuar për anëtarët e kolegjit të përcaktuar në nenin 119 pika 2, shkronjat (d) deri (h);

(k) një draft të modifikuar të dokumentit informues të kripto-asetit, të hartuar në përputhje me nenin 51 pika 12.

2. Kur kolegji lëshon një opinion në përputhje me pikën 1, me kërkesë të çdo anëtari të kolegjit dhe me miratimin e shumicës së kolegjit në përputhje me pikën 3, opinioni mund të përfshijë rekomandime që synojnë adresimin e mangësive të masës së parashikuar nga Autoriteti Bankar Evropian ose autoritetet përgjegjëse.
3. Opinioni i kolegjit do të miratohet bazuar në shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij.

Autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta të përcaktuara në nenin 119 pika 2, shkronja (c), nuk do të kenë të drejtën e votës për një opinion të kolegjit.

4. Autoriteti Bankar Evropian ose autoritetet përgjegjëse, sipas rastit, do ta marrin në konsideratë siç duhet opinionin jo-detyrues të kolegjit të arritur në përputhje me pikën 3, duke përfshirë çdo rekomandim që synon adresimin e mangësive të masës mbikëqyrëse të parashikuar për një emetues të një tokeni të asetit të rëndësishëm, një emetues të një tokeni të parasë elektronike të rëndësishme, një subjekt ose një ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve, sipas përcaktimeve të nenit 119 pika 2, shkronjat (d) deri (h).

Seksioni 5:
Kompetencat e Autoritetit Bankar Evropian në lidhje me emetuesit e tokenave të asetit tëtokenave të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishme

Neni 121

Dispozita të përgjithshme

1. Dispozitat e këtij seksioni që i atribuojnë kompetenca Autoritetit Bankar Evropian, Autoritetin Evropian të Tregjeve të Titujve dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë bëhen të zbatueshme në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
2. Kompetencat e përcaktuara në nenet 123 deri në 132 të këtij seksioni, për aq sa janë më të gjera se kompetencat e përcaktuara në këtë ligj për Bankën e Shqipërisë në lidhje me emetuesit e tokenave të aseteve ose tokenave të parasë elektronike, ushtrohen nga Banka e Shqipërisë deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 122

Privilegji ligjor

Kompetencat e përcaktuara për Autoritetin Bankar Evropian nga nenet 122 deri 125, nuk do të përdoren për të kërkuar publikimin e informacionit që është subjekt i privilegjit ligjor.

Neni 122

Kërkesa për informacion

1. Për të përmbushur detyrat e saj mbikëqyrëse sipas nenit 117, Autoriteti Bankar Evropian mund të kërkojë përmes një kërkese të thjeshtë ose një vendimi që subjektet e mëposhtëme të japin të gjithë informacionin e nevojshëm për të mundësuar përmbushjen e detyrat e saj sipas këtij ligji:

(a) një emetues i një tokeni aseti të klasifikuar si të rëndësishëm ose një subjekt që kontrollon ose është i kontrolluar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një emetues i një tokeni aseti të klasifikuar si të rëndësishëm;

(b) një palë e tretë, siç përmendet në pikën e parë të nenit 34 pika 5, shkronja (h), me të cilën një emetues i një tokeni aseti të rëndësishëm ka një marrëveshje kontraktuale;

(c) një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve, institucion krediti ose shoqëri komisionere që siguron kujdestarinë e rezervës së aseteve në përputhje me nenin 37;

(d) një emetues i një tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm, ose një person që kontrollon ose është i kontrolluar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një emetues i një tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm;

(e) një ofrues i shërbimeve të pagesave që ofron shërbime pagese në lidhje me tokenat e parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm;

(f) një subjekt që është përgjegjës për shpërndarjen e tokenave të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm në emër të emetuesit;

(g) një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve që ofron kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve në lidhje me tokenat e asetit ose tokenat e parasë elektronike të

klasifikuar si të rëndësishëm;

(h) një operator i një platforme tregtimi për kripto-asete që ka pranuar për tregtim një token aseti ose një token të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm;

(i) struktura drejtuese e personave të përcaktuar në shkronjat (a) deri (h).

2. Një kërkesë e thjeshtë për informacion, siç përmendet në pikën 1, duhet të:

(a) referojë këtë nen si bazën ligjore të asaj kërkese;

(b) tregojë qëllimin e kërkesës;

(c) specifikojë informacionin e kërkuar;

(d) përfshijë një afat kohor brenda të cilit ofrohet informacioni;

(e) informojë personin nga i cili kërkohet informacioni se nuk është i detyruar të japë informacionin, por që, në rast të një përgjigje vullnetare ndaj kërkesës, informacioni i ofruar është i saktë dhe jo konfuz; dhe

(f) tregojë gjobën e parashikuar në nenin 131, kur përgjigjet ndaj pyetjeve të bëra janë të pasakta ose mashtruese.

3. Kur kërkohet dhënia e informacionit përmes një vendimi në përputhje me pikën 1,Autoriteti Bankar Evropian duhet të:

(a) referojë këtë nen si bazën ligjore të kërkesës;

(b) tregojë qëllimin e kërkesës;

(c) specifikojë informacionin e kërkuar;

(d) vendosë një afat kohor brenda të cilit ofrohet informacioni;

(e) tregojë pagesat e dënimit periodik të parashikuara në nenin 132, kur kërkohet prodhimi i informacionit;

(f) tregojë gjobën e parashikuar në nenin 131, kur përgjigjet ndaj pyetjeve të bëra janë të pasakta ose mashtruese;

(g) tregojë të drejtën për të apeluar vendimin para Bordit të Apelimit të Autoritetit Bankar Evropian dhe për të rishikuar vendimin nga gjykata përkatëse.

Neni 123

Kompetencat e përgjithshme të hetimit administrativ

1. Për të përmbushur detyrat e saj mbikëqyrëse sipas nenit 117, Autoriteti Bankar Evropian mund të kryejë hetime ndaj emetuesve të tokenave të klasifikuar si të rëndësishme. Për këtë qëllim, zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar nga Autoriteti Bankar Evropian do të kenë kompetencën për të:

(a) shqyrtuar çdo regjistër, të dhënë, procedurë dhe çdo material tjetër që është i rëndësishëm për kryerjen e detyrave të saj, pavarësisht nga mjeti ku ruhen;

(b) marrë ose siguruar kopje të certifikuara ose ekstrakte nga të tilla regjistra, të dhëna, procedura dhe materiale të tjera;

(c) thirrur dhe pyetur emetuesit e tokenave të klasifikuar si të rëndësishëm, duke përfshirë strukturën drejtuese ose stafin e tyre, për shpjegime me gojë ose me shkrim mbi faktet ose dokumentet që lidhen me çështjen dhe qëllimin e hetimit;

(d) intervistuar çdo person fizik ose juridik tjetër që pranon të intervistohet për qëllimet e mbledhjes së informacionit lidhur me çështjen e hetimit;

(e) kërkuar regjistrat e trafikut të telefonisë dhe të dhënave.

2. Zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar nga Autoriteti Bankar Evropian për qëllimet e hetimit të përcaktuar në pikën 1 do të ushtrojnë kompetencat e tyre pas paraqitjes së një autorizimi me shkrim që specifikon çështjen dhe qëllimin e hetimit. Ky autorizim do të tregojë gjithashtu pagesat e dënimit periodik të parashikuara në nenin 132 kur regjistrat, të dhënat, procedurat ose çdo material tjetër i kërkuar, ose përgjigjet ndaj pyetjeve të bëra për emetuesit e tokenave të klasifikuar si të rëndësishëm nuk jepen ose janë të paplota, dhe gjobat e parashikuara në nenin 131, kur përgjigjet ndaj pyetjeve të bëra janë të pasakta ose mashtruese.
3. Emetuesit e tokenave të klasifikuar si të rëndësishëm dhe emetuesit e tokenave të rëndësishme të parasë elektronike janë të detyruar t'u nënshtrohen hetimeve të nisura bazuar në një vendim të Autoritetit Bankar Evropian. Vendimi do të specifikojë çështjen dhe qëllimin e hetimit, pagesat e dënimit periodik të parashikuara në nenin 132, mjetet juridike dhe të drejtën për të kërkuar rishikimin e vendimit nga gjykata përkatëse.
4. Brenda një periudhe të arsyeshme para nisjes së një hetimi të përcaktuar në pikën 1, Autoriteti Bankar Evropian do të informojë autoritetin përgjegjës të Shtetit Anëtar ku do të kryhet hetimi për hetimin dhe për identitetin e personave të autorizuar. Zyrtarët e autoritetit përgjegjës të përfshirë, sipas kërkesës së Autoritetit Bankar Evropian, do të ndihmojnë personat e autorizuar për kryerjen e detyrave të tyre. Zyrtarët e autoritetit përgjegjës të përfshirë mund të marrin pjesë gjithashtu në hetimet, sipas kërkesës.
5. Nëse një kërkesë për regjistrat e trafikut të telefonisë ose të dhënave, siç përmendet në pikën 1, pikën e parë, shkronja (e), kërkon autorizim nga një gjykatë, Autoriteti Bankar

Evropian do të aplikojë për një autorizim të tillë.

6. Në rastet kur një gjykatë merr një aplikim për autorizimin e një kërkese për regjistrat e trafikut të telefonisë ose të dhënave, siç përmendet në pikën 1, pikën e parë, shkronja (e), ajo gjykatë do të verifikojë nëse:

(a) vendimi i Autoritetit Bankar Evropian i përcaktuar në pikën 3, është autentik;

(b) masat që do të merren janë proporcionale dhe jo arbitrare ose të tepërta.

7. Për qëllimet e pikës 6, shkronja (b), gjykata mund të kërkojë nga Autoriteti Bankar Evropian shpjegime të detajuara, veçanërisht në lidhje seriozitetin e shkeljes së dyshuar dhe natyrën e përfshirjes së subjektit ndaj të cilit janë drejtuar masat shtrënguese. Megjithatë, gjykata nuk do të shqyrtojë nevojën për hetimin apo të kërkojë që të paraqitet informacioni nga dosja e Autoritetit Bankar Evropianë.

Neni 124

Inspektimet në vend

1. Për të përmbushur detyrat e saj mbikëqyrëse sipas nenit 117, Autoriteti Bankar Evropian mund të kryejë të gjitha inspektimet e nevojshme në vend, dhe në çdo ambient biznesi të emetuesve të tokenave të klasifikuar si të rëndësishme.

Kolegjit të përcaktuar në nenin 119 do t'i komunikohet pa vonesë çdo gjetje që mund të jetë e rëndësishme për kryerjen e detyrave të tij.

2. Zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar nga Autoriteti Bankar Evropian për të kryer një inspektim në vend mund të hyjnë në çdo ambient biznesi të personave që janë subjekt i një vendimi hetimi të miratuar nga Autoriteti Bankar Evropian dhe do të kenë të gjitha kompetencat e parashikuara në nenin 123 pika 1. Ata gjithashtu kanë kompetencën për të vulosur çdo ambient biznesi dhe libra ose regjistra për periudhën dhe në masën që është e nevojshme për inspektimin.
3. Autoriteti Bankar Evropian mund të kryejë inspektimin në vend pa i dhënë njoftim paraprak emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm.
4. Zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar nga Autoriteti Bankar Evropian për të kryer një inspektim në vend do të ushtrojnë kompetencat e tyre pas paraqitjes së një autorizimi me shkrim që specifikon çështjen dhe qëllimin e inspektimit, si dhe pagesat e dënimit periodik të parashikuara në nenin 132, kur personat e përfshirë nuk i nënshtrohen inspektimit.
5. Emetuesi i tokenit të klasifikuar si i rëndësishëm u nënshtrohet inspektimeve në vend të urdhëruara nga një vendim i Autoritetit Bankar Evropian. Vendimi do të specifikojë çështjen dhe qëllimin e inspektimit, do të caktojë datën e fillimit të inspektimit, si dhe do të tregojë pagesat e dënimit periodik të parashikuara në nenin 132, mjetet juridike të disponueshme si dhe të drejtën për të kërkuar rishikimin e vendimit nga gjykata përkatëse.

6. Zyrtarët e autoritetit përgjegjës të Shtetit Anëtar ku do të kryhet inspektimi, si dhe ata të autorizuar ose të emëruar nga ai autoritet, do të ndihmojnë aktivisht zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar nga Autoriteti Bankar Evropian, sipas kërkesës së saj. Zyrtarët e autoritetit përgjegjës të Shtetit Anëtar përkatës mund të marrin gjithashtu pjesë në inspektimet në vend.
7. Autoriteti Bankar Evropian mund të kërkojë gjithashtu nga autoritetet përgjegjëse të kryejnë detyra të veçanta hetimore dhe inspektime në emër të saj siç parashikohet në këtë nen dhe në nenin 123 pika 1.
8. Kur persona të autorizuar nga Autoriteti Bankar Evropian, konstatojnë se një subjekt kundërshton një inspektim të urdhëruar në përputhje me këtë nen, mund të kërkohet ndihma e policisë ose të një autoriteti zbatues të barazvlefshëm, për t'i mundësuar atyre të kryejnë inspektimin në vend.
9. Nëse inspektimi në vend i parashikuar në pikën 1 ose ndihma e parashikuar në pikën 7 kërkon autorizim nga një gjykatë sipas ligjit kombëtar, Autoriteti Bankar Evropian do të aplikojë për një autorizim të tillë. Ky autorizim mund të kërkohet gjithashtu si një masë paraprake.
10. Kur një gjykatë merr një aplikim për autorizimin e një inspektimi në vend të parashikuar në pikën 1 ose të ndihmës së parashikuar në pikën 7, ajo gjykatë do të verifikojë nëse:

(a) vendimi i miratuar nga Autoriteti Bankar Evropian, i përcaktuar në pikën 4, është autentik;

(b) masat që do të merren janë proporcionale dhe jo arbitrare ose të tepërta.

11. Për qëllimet e pikës 10, shkronja (b), gjykata mund të kërkojë nga Autoriteti Bankar Evropian shpjegime të detajuara, veçanërisht në lidhje me bazat që Autoriteti Bankar Evropian ka për të dyshuar se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji, seriozitetin e shkeljes së dyshuar dhe natyrën e përfshirjes së subjektit ndaj të cilit janë drejtuar masat shtrënguese. Megjithatë, gjykata nuk do të shqyrtojë nevojën për hetimin apo të kërkojë që të paraqitet informacioni nga dosja e Autoritetit Bankar Evropian. Ligjshmëria e vendimit të Autoritetit Bankar Evropian do të jetë subjekt i rishikimit vetëm nga gjykata përkatëse.

Neni 125

Shkëmbimi i informacionit

1. Për të përmbushur detyrat mbikëqyrëse sipas nenit 117 dhe krahas nenit 96, autoritetet përgjegjëse do t'i sigurojnë njëra-tjetrës informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre sipas këtij ligji pa vonesë të panevojshme. Për këtë qëllim, autoritetet përgjegjëse dhe Autoriteti Bankar Evropian do të shkëmbejnë çdo informacion të lidhur me:

(a) një emetues tokeni aseti të klasifikuar si të rëndësishëm ose një subjekt që kontrollon ose është i kontrolluar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një emetues tokeni aseti të klasifikuar si të

rëndësishëm;

(b) një palë të tretë, siç përmendet në pikën e parë të nenit 34(5), shkronja (h), me të cilën një emetues i një tokeni aseti të klasifikuar si të rëndësishëm ka një marrëveshje kontraktuale;

(c) një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve, institucion krediti ose shoqëri komisionere që siguron kujdestarinë e aseteve të rezervës në përputhje me nenin 37;

(d) një emetues tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si i rëndësishëm ose një subjekt që kontrollon ose është i kontrolluar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një emetues i një tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si i rëndësishëm;

(e) një ofrues të shërbimeve të pagesave që ofron shërbime pagese në lidhje me tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si i rëndësishëm;

(f) një subjekt që është përgjegjës për shpërndarjen e tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si i rëndësishëm në emër të emetuesit;

(g) një ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve që ofron kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve, në lidhje me tokenat e klasifikuar si të rëndësishëm;

(h) një platformë tregtimi për kripto-asete në të cilën një token i klasifikuar si i rëndësishëm është pranuar për tregtim;

(i) strukturën drejtuese të subjekteve të përcaktuar në pikat (a) deri (h).

2. Një autoritet përgjegjës mund të refuzojë të veprojë mbi një kërkesë për shkëmbim informacioni, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, ose një kërkesë për bashkëpunim për kryerjen e një hetimi ose inspektimi në vend, siç parashikohet përkatësisht në nenet 123 dhe 124, vetëm kur:

(a) përmbushja e kërkesës ka të ngjarë të ndikojë negativisht në hetimin e vet, aktivitetet e zbatimit të ligjit ose, kur është e zbatueshme, hetimin penal;

(b) procedurat gjyqësore janë tashmë të iniciuara në lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër të njëjtëve persona fizikë ose juridikë para gjykatave përkatëse;

(c) një vendim përfundimtar është dhënë tashmë në lidhje me subjektin.

Neni 126

Marrëveshjet administrative për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Autoritetit Bankar Evropian dhe vendeve të treta

1. Për të përmbushur detyrat e saj mbikëqyrëse sipas nenit 117, Autoriteti Bankar Evropian mund të nënshkruajë marrëveshje administrative për shkëmbimin e informacionit me

autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta vetëm nëse informacioni i zbuluar është subjekt i garancive të sekretit profesional që janë të paktën të barasvlefshme me ato të përcaktuara në nenin 129.

2. Shkëmbimi i informacionit do të jetë për qëllim të përmbushjes së detyrave të Autoritetit Bankar Evropian ose të autoriteteve mbikëqyrëse të përcaktuara në pikën 1.
3. Për sa i përket transferimeve të të dhënave personale në një vend të tretë, Autoriteti Bankar Evropian do të zbatojë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 127

Publikimi i informacionit nga vendet e treta

1. Autoriteti Bankar Evropian mund të zbulojë informacion të marrë nga autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta vetëm kur Autoriteti Bankar Evropian ose autoriteti përgjegjës që ka siguruar informacionin ka marrë miratimin e shprehur të autoritetit mbikëqyrës të një vendi të tretë që ka transmetuar informacionin dhe, kur është e zbatueshme, informacioni zbulohet vetëm për qëllimet për të cilat ai autoritet mbikëqyrës ka dhënë miratimin e tij ose kur një zbulim i tillë është i nevojshëm për procedura gjyqësore.
2. Kërkesa për një miratim të shprehur, siç përmendet në pikën 1, nuk do të zbatohet për autoritetet e tjera mbikëqyrëse, kur informacioni i kërkuar është i nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre dhe nuk do të zbatohet për gjykatat, kur informacioni i kërkuar prej tyre është i nevojshëm për hetimet ose procedurat në lidhje me shkeljet që janë objekt i ndëshkimeve penale.

Neni 128

Bashkëpunimi me autoritete të tjera

Kur një emetues i një tokeni të klasifikuar si të rëndësishëm kryen veprimtari të tjera përveç atyre të mbuluara nga ky ligj, Autoriteti Bankar Evropian do të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e atyre veprimtarive të tjera, përfshirë autoritetet tatimore dhe autoritetet mbikëqyrëse përkatëse të vendeve të treta që nuk janë anëtarë të kolegjit të përcaktuar në nenin 119 pika 2, shkronja (m).

Neni 129

Sekreti profesional

Detyrimi për sekretin profesional do të zbatohet për Autoritetit Bankar Evropian dhe të gjithë personat që punojnë ose që kanë punuar për Autoritetit Bankar Evropian, si dhe për çdo person tjetër të cilit Autoriteti Bankar Evropian i ka deleguar detyra, duke përfshirë auditorët dhe ekspertët e kontraktuar nga Autoriteti Bankar Evropian.

Neni 130

Masat mbikëqyrëse nga Autoriteti Bankar Evropian

1. Nw rastet kur Autoriteti Bankar Evropian konstaton se një emetues i një tokeni aseti të klasifikuar si të rëndësishëm ka kryer një shkelje të renditur në Aneksin V, ajo mund të marrë një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

(a) miratojë një vendim që kërkon nga emetuesi i tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm të ndalojë sjelljen që përbën shkelje;

(b) miratojë një vendim që vendos gjoba ose pagesa periodike të dënimit në përputhje me nenet 131 dhe 132;

(c) miratojë një vendim që kërkon nga emetuesi i tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm të transmetojë informacion shtesë për mbrojtjen e zotëruesve të tokenit, veçanërisht klientëve joprofesionistë;

(d) miratojë një vendim që kërkon nga emetuesi i tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm të pezullojë një ofertë ndaj publikut për një periudhë maksimale prej 30 ditësh pune, në çdo rast të vetëm, kur ka arsye të bazuara për të dyshuar se ky ligj është shkelur;

(e) miratojë një vendim që ndalon një ofertë ndaj publikut të tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm kur konstaton se ky ligj është shkelur ose kur ka arsye të bazuara për të dyshuar se do të shkelet;

(f) miratojë një vendim që kërkon nga ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve që operon një platformë tregtimi për kripto-asete, dhe që ka pranuar të tregtojë tokenin e asetit të klasifikuar si të rëndësishëm, të pezullojë tregtimin e një kripto-aseti të tillë për një periudhë maksimale prej 30 ditësh pune, në çdo rast të vetëm, kur ka arsye të bazuara për të dyshuar se ky ligj është shkelur;

(g) miratojë një vendim që ndalon tregtimin e tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm në një platformë tregtimi për kripto-asete kur konstaton se ky ligj është shkelur;

(h) miratojë një vendim që kërkon nga emetuesi i tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm të ndryshojë materialet promovuese, kur konstaton se materialet promovuese nuk përputhen me nenin 29.

(i) miratojë një vendim për të pezulluar ose ndaluar materialet promovuese kur ka arsye të bazuara për të dyshuar se ky ligj është shkelur;

(j) miratojë një vendim që kërkon nga emetuesi i tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm të zbulojë të gjithë informacionin material që mund të ndikojë në vlerësimin e tokenit të ofruar ndaj publikut ose të pranuar për tregtim, për të siguruar mbrojtjen e konsumatorit ose mbarëvajtjen e tregut;

(k) lëshojë paralajmërime që emetuesi i tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm nuk përmbush detyrimet e tij sipas këtij ligji;

(l) tërheqë autorizimin e emetuesit të tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm;

(m) miratojë një vendim që kërkon largimin e një personi nga struktura drejtuese e emetuesit të tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm;

(n) ti kërkojë emetuesit të tokenit të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm, që të prezantojë një shumë minimale të denominuar ose të kufizojë sasinë e tokenit të emetuar, në përputhje me nenin 23 pika 4 dhe nenin 24 pika 3.

2. Kur Autoriteti Bankar Evropian konstaton se një emetues i një tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm ka kryer një shkelje të renditur në Aneksin VI, ajo mund të marrë një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

(a) miratojë një vendim që kërkon nga emetuesi i tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm të ndalojë sjelljen që përbën shkelje;

(b) miratojë një vendim që vendos gjoba ose pagesa periodike të dënimit në përputhje me nenet 131 dhe 132;

(c) miratojë një vendim që kërkon nga emetuesi i tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm që të transmetojë informacion shtesë kur është e nevojshme për mbrojtjen e mbajtësve të tokenit, veçanërisht klientëve joprofesionistë;

(d) miratojë një vendim që kërkon nga emetuesi i tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm të pezullojë një ofertë ndaj publikut për një periudhë maksimale prej 30 ditësh pune rresht, në çdo rast të vetëm, kur ka arsye të bazuara për të dyshuar se ky ligj është shkelur;

(e) miratojë një vendim që ndalon një ofertë ndaj publikut të tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm kur konstaton se ky ligj është shkelur ose kur ka arsye të bazuara për të dyshuar se do të shkelet;

(f) miratojë një vendim që kërkon nga ofruesi përkatës i shërbimeve të kripto-aseteve, që operon një platformë tregtimi për kripto-asete, dhe që ka pranuar për tregtim tokenat e parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm, të pezullojë tregtimin e kripto-aseteve të tilla për një periudhë maksimale prej 30 ditësh pune kur ka arsye të bazuara për të dyshuar se ky ligj është shkelur;

(g) miratojë një vendim që ndalon tregtimin e tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm në një platformë tregtimi për kripto-asete kur konstaton se ky ligj është shkelur;

(h) miratojë një vendim që kërkon nga emetuesi i tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm të zbulojë të gjithë informacionin material që mund të ndikojë në vlerësimin e

tokenit të ofruar ndaj publikut ose të pranuar për tregtim, për të siguruar mbrojtjen e konsumatorit ose mbarëvajtjen e tregut;

(i) lëshojë paralajmërime që emetuesi i tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm nuk përmbush detyrimet e tij sipas këtij ligji;

(j) kërkojë nga emetuesi i tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm nën mbikëqyrjen e saj të prezantojë një shumë minimale të denominuar ose të kufizojë sasinë e tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm të emetuar, si rezultat i zbatimit të nenit 58 pika 3.

3. Kur merr masat e përcaktuara në pikën 1 ose 2, Autoriteti Bankar Evropian do të konsiderojë natyrën dhe seriozitetin e shkeljes, duke pasur parasysh:

(a) kohëzgjatjen dhe frekuencën e shkeljes;

(b) nëse krimi financiar është shkaktuar, lehtësuar ose është i atribuueshëm në një mënyrë tjetër për shkeljen;

(c) nëse shkelja ka zbuluar dobësi serioze ose sistemike në procedurat, politikat dhe masat e menaxhimit të rrezikut të emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm;

(d) nëse shkelja është kryer me qëllim ose nga pakujdesia;

(e) shkallën e përgjegjësisë së emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm përgjegjës për shkeljen;

(f) fuqinë financiare të emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm përgjegjës për shkeljen, siç tregohet nga xhiroja totale e personit juridik përgjegjës ose të ardhurat vjetore dhe pasuritë neto të personit fizik përgjegjës;

(g) ndikimin e shkeljes në interesat e mbajtësve të tokenavetë klasifikuar si të rëndësishëm;

(h) rëndësinë e fitimeve të realizuara, humbjeve të shmangura nga emetuesi i tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm, përgjegjës për shkeljen ose humbjeve për palët e treta të shkaktuara nga shkelja, për aq sa mund të përcaktohen;

(i) nivelin e bashkëpunimit të emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm përgjegjës për shkeljen me Autoritetit Bankar Evropian, krahas nevojës për të siguruar kthimin e fitimeve të realizuara ose humbjeve të shmangura nga ai person;

(j) shkeljet e mëparshme të kryera nga emetuesi i tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm përgjegjës për shkeljen;

(k) masat e marra nga emetuesi i tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm pas shkeljes për të parandaluar përsëritjen e një shkeljeje të tillë.

4. Para se të marrë ndonjë nga masat e përcaktuara në pikën 1, shkronjat (d) deri (g), dhe (j), Autoriteti Bankar Evropian do të informojë autoritetin përgjegjës kur tokenat e asetit të klasifikuar si të rëndësishëm referojnë euron ose një valutë zyrtare të një shteti që nuk është euro.
5. Para se të marrë ndonjë nga masat e përcaktuara në pikën 2, Autoriteti Bankar Evropian do të informojë autoritetin përgjegjës të emetuesit të tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm dhe bankën qendrore të Shtetit Anëtar, valuta zyrtare e të cilit referohet nga tokeni i rëndësishëm i parasë elektronike.
6. Autoriteti Bankar Evropian do t'i njoftojë çdo masë të marrë në përputhje me pikën 1 ose 2 emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm, përgjegjës për shkeljen dhe do ta komunikojë atë masë autoriteteve përgjegjëse përkatëse si dhe Komisionit. Autoriteti Bankar Evropian do ta bëjë publik çdo vendim të tillë në faqen e saj të internetit brenda 10 ditëve pune nga data e miratimit të vendimit, përveç nëse një zbulim i tillë do të rrezikonte seriozisht stabilitetin financiar ose do të shkaktonte dëme të tepërta për palët e përfshira. Publikimi i tillë nuk do të përmbajë të dhëna personale.
7. Publikimi i përcaktuar në pikën 6 do të përfshijë deklaratat e mëposhtme:

(a) një deklaratë që konfirmon të drejtën e personit përgjegjës për shkeljen për të apeluar vendimin para gjykatës përkatëse;

(b) kur është e rëndësishme, një deklaratë që konfirmon se është bërë një apel dhe që specifikon se një apel i tillë nuk ka efekt pezullues;

(c) një deklaratë që pohon se është e mundur për Bordin e Apelimit të Autoritetit Bankar Evropian të pezullojë zbatimin e vendimit të kontestuar.

Neni 131

Sanksionet

1. Autoriteti Bankar Evropian do të miratojë një vendim për vendosjen e një gjobe në përputhje me pikën 3 ose 4 të këtij neni, kur, në përputhje me nenin 134 pika 8, konstaton se:

(a) një emetues i një tokeni të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm ose një anëtar i strukturës së tij drejtuese ka kryer me qëllim ose nga pakujdesia një shkelje të renditur në Aneksin V;

(b) një emetues i një tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm ose një anëtar i strukturës së tij drejtuese ka kryer me qëllim ose nga pakujdesia një shkelje të renditur në Aneksin VI.

Një shkelje do të konsiderohet e kryer me qëllim nëse Autoriteti Bankar Evropian gjen faktorë objektivë që demonstrojnë se një emetues i tillë ose një anëtar i strukturës së tij drejtuese ka vepruar me qëllim për të kryer shkeljen.

2. Kur miraton një vendim siç përmendet në pikën 1, Autoriteti Bankar Evropian do të konsiderojë natyrën dhe seriozitetin e shkeljes, duke pasur parasysh:

(a) kohëzgjatjen dhe frekuencën e shkeljes;

(b) nëse krimi financiar është shkaktuar, lehtësuar ose është i atribuueshëm ndryshe për shkeljen;

(c) nëse shkelja ka zbuluar dobësi serioze ose sistemike në procedurat, politikat dhe masat e menaxhimit të rrezikut të emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm;

(d) nëse shkelja është kryer me qëllim ose nga pakujdesia;

(e) shkallën e përgjegjësisë së emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm përgjegjës për shkeljen;

(f) fuqinë financiare të emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm, përgjegjës për shkeljen, siç tregohet nga xhiroja totale e personit juridik përgjegjës, ose të ardhurat vjetore dhe pasuritë neto të personit fizik përgjegjës;

(g) ndikimin e shkeljes në interesat e mbajtësve të tokenave të klasifikuar si të rëndësishëm;

(h) rëndësinë e fitimeve të realizuara, humbjeve të shmangura nga emetuesi i tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm, përgjegjës për shkeljen ose humbjeve për palët e treta të shkaktuara nga shkelja, për aq sa mund të përcaktohen;

(i) nivelin e bashkëpunimit të emetuesit të tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm përgjegjës për shkeljen me Autoriteti Bankar Evropian, krahas nevojës për të siguruar kthimin e fitimeve të realizuara ose humbjeve të shmangura nga ai person;

(j) shkeljet e mëparshme të kryera nga emetuesi i tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm përgjegjës për shkeljen;

(k) masat e marra nga emetuesi i tokenit të klasifikuar si të rëndësishëm pas shkeljes për të parandaluar përsëritjen e një shkeljeje të tillë.

3. Për emetuesit e tokenave të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm, shuma maksimale e gjobës së përcaktuar në pikën 1 do të jetë deri në 12,5% të xhiros vjetore në vitin e kaluar të biznesit, ose dyfishi i shumës së fitimeve të realizuara ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, për aq sa mund të përcaktohen.
4. Për emetuesit e tokenave të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm, shuma maksimale e gjobës së përcaktuar në pikën 1 do të jetë deri në 10% të xhiros vjetore në vitin e kaluar të biznesit, ose dyfishi i shumës së fitimeve të realizuara ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, për aq sa mund të përcaktohen.

Neni 132

Pagesat e dënimeve periodike

1. **Autoriteti Bankar Evropian** do të miratojë një vendim për vendosjen e pagesave të dënimeve periodike me qëllim që të detyrojë:

(a) një subjekt të ndalojë sjelljen që përbën një shkelje, në përputhje me një vendim të marrë sipas nenit 130;

(b) një subjekt të përcaktuar në nenin 122(1):

(i) të sigurojë informacion të plotë që është kërkuar me një vendim në përputhje me nenin 122;

(ii) t'i nënshtrohet një hetimi dhe veçanërisht të dorëzojë regjistra, të dhëna, procedura ose ndonjë material tjetër të kërkuar dhe të plotësojë dhe korrigjojë informacionin tjetër të siguruar në një hetim të nisur nga një vendim në përputhje me nenin 123;

(iii) t'i nënshtrohet një inspektimi në vend të urdhëruar nga një vendim i marrë sipas nenit 124.

2. Pagesa e dënimit periodik është efektive dhe proporcionale. Pagesa e dënimit periodik do të vendoset për çdo ditë vonese.
3. Pavarësisht pikës 2, shuma e pagesave të dënimeve periodike do të jetë 3% e xhiros mesatare ditore në vitin e kaluar të biznesit ose, në rastin e personave fizikë, 2% e të ardhurave mesatare ditore në vitin e kaluar kalendarik. Ajo do të llogaritet nga data e përcaktuar në vendimin e Autoritetit Bankar Evropian për vendosjen e pagesës së dënimit periodik.
4. Pagesa e dënimit periodik do të vendoset për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh pas njoftimit të vendimit të Autoritetit Bankar Evropian. Në përfundim të asaj periudhe, Autoriteti Bankar Evropian do të rishikojë masën.

Neni 133

Publikimi, natyra, zbatimi dhe alokimi i gjobave dhe pagesave të dënimeve periodike

1. Autoriteti Bankar Evropian do të zbulojë për publikun çdo gjobë dhe pagesë të dënimit periodik që është vendosur në përputhje me nenet 131 dhe 132, përveç nëse një zbulim i tillë do të rrezikonte seriozisht stabilitetin financiar ose do të shkaktonte dëme të tepërta për palët e përfshira.
2. Gjobat dhe pagesat e dënimeve periodike të vendosura në përputhje me nenet 131 dhe 132 do të jenë të natyrës administrative.
3. Gjobat dhe pagesat e dënimeve periodike të vendosura në përputhje me nenet 131 dhe 132 do të jenë të zbatueshme në përputhje me rregullat e procedurës civile në fuqi. Shumat e gjobave dhe pagesave të dënimeve periodike do të alokohen në buxhetin e përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.
4. Kur, pavarësisht nga nenet 131 dhe 132, Autoriteti Bankar Evropian vendos të mos vendosë gjoba ose pagesa të dënimeve, ajo do të informojë Parlamentin, Këshillin,

Komisionin dhe do të japë arsyet për vendimin e saj.

Neni 134

Rregullat procedurale për marrjen e masave mbikëqyrëse dhe vendosjen e gjobave

1. Kur, në kryerjen e detyrave të saj mbikëqyrëse sipas nenit 117, ekzistojnë arsye të qarta dhe të dëshmueshme për të dyshuar se ka pasur ose do të ketë një shkelje të renditur në Aneksin V ose VI, Autoriteti Bankar Evropian do të caktojë një oficer hetimi të pavarur brenda për të hetuar çështjen. Oficeri i hetimit nuk është i përfshirë ose të ketë qenë i përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në mbikëqyrjen e emetuesve të tokenave të klasifikuar si të rëndësishëm dhe do të kryejë funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga Autoriteti Bankar Evropian.
2. Oficeri i hetimit do të hetojë shkeljet e pretenduara, duke marrë parasysh çdo koment të paraqitur nga personat që janë subjekt i hetimit dhe do të dorëzojë një dosje të plotë me gjetjet e tij Autoritetit Bankar Evropian.
3. Për të kryer detyrat e tij, oficeri i hetimit mund të ushtrojë kompetencën për të kërkuar informacion në përputhje me nenin 122 dhe kompetencën për të kryer hetime dhe inspektime në vend në përputhje me nenet 123 dhe 124. Kur përdor këto kompetenca, oficeri i hetimit do të respektojë nenin 121.
4. Gjatë kryerjes së detyrave të tij, oficeri i hetimit do të ketë qasje në të gjitha dokumentet dhe informacionet e mbledhura nga Autoriteti Bankar Evropian në aktivitetet e saj mbikëqyrëse.
5. Pas përfundimit të hetimit dhe para se të dorëzojë dosjen me gjetjet e tij, oficeri i hetimit do t'u japë mundësi personave që janë subjekt i hetimit të dëgjohen për çështjet që po hetohen. Oficeri i hetimit do të bazojë gjetjet e tij vetëm në faktet për të cilat personat përkatës kanë pasur mundësi të komentojnë.
6. Të drejtat e mbrojtjes së personave përkatës do të respektohen plotësisht gjatë hetimeve sipas këtij neni.
7. Kur i dorëzon dosjen Autoritetit Bankar Evropian, oficeri i hetimit do të njoftojë personat që janë subjekt i hetimit. Personat që janë subjekt i hetimit do të kenë të drejtën për të pasur qasje në dosje, me kusht që të respektohet interesi i ligjshëm i personave të tjerë për mbrojtjen e sekreteve të tyre tregtare. E drejta për qasje në dosje nuk do të shtrihet në informacionin konfidencial që prek palët e treta ose dokumentet përgatitore të brendshme të Autoritetit Bankar Evropian.
8. Bazuar në dosjen që përmban gjetjet e oficerit të hetimit dhe, kur kërkohet nga personat që janë subjekt i hetimit, në përputhje me nenin 135, Autoriteti Bankar Evropian do të vendosë nëse një shkelje e renditur në Aneksin V ose VI është kryer nga emetuesi i tokenit të asetit ose i tokenit të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm subjekt i hetimit dhe, në një rast të tillë, do të marrë një masë mbikëqyrëse në përputhje me nenin 130 ose do të vendosë një gjobë në përputhje me nenin 131.
9. Oficeri i hetimit nuk do të marrë pjesë në diskutimet e Autoritetit Bankar Evropian dhe nuk do të ndërhyjë në asnjë mënyrë në procesin e vendimmarrjes së saj.
10. Për qëllime të këtij neni, autoritetet përgjegjëse, përmes akteve nënligjore rregullatore

respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, mund të miratojë rregulla më të detajuara, lidhur me kushtet e përgjithshme, kriteret e veçanta, ose kriteret e tjera shtesë.

Neni 135

E drejta për tu dëgjuar e personave përkatës

1. Para se të marrë ndonjë vendim në përputhje me nenin 130, 131 ose 132, Autoriteti Bankar Evropian do t'u japë mundësi personave që janë subjekt i një hetimi të komentojnë mbi gjetjet e saj. Autoriteti Bankar Evropian do të bazojë vendimet e saj vetëm në gjetjet për të cilat personat që janë subjekt i hetimit kanë pasur mundësi të japin komente.
2. Pika 1 nuk do të zbatohet nëse nevojitet veprim urgjent për të parandaluar dëme të rëndësishme dhe të menjëhershme për stabilitetin financiar ose për zotëruesit e kripto-aseteve, veçanërisht klientët joprofesionistë. Në një rast të tillë, Autoriteti Bankar Evropian mund të miratojë një vendim të përkohshëm dhe do t'u japë mundësi personave përkatës të dëgjohen sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së vendimit.
3. Të drejtat e mbrojtjes së personave që janë subjekt i një hetimi do të respektohen plotësisht. Ata persona do të kenë të drejtën për të pasur qasje në dosjen e Autoritetit Bankar Evropian, me kusht që të respektohet interesi i ligjshëm i personave të tjerë për mbrojtjen e sekreteve të tyre tregtare. E drejta për qasje në dosje nuk do të shtrihet në informacionin konfidencial ose në dokumentet përgatitore të brendshme të Autoritetit Bankar Evropian.

Neni 136

Shqyrtimi nga Gjykatat Evropiane e Drejtësisë

1. Gjykata e Drejtësisë do të ketë juridiksion të pakufizuar për të rishikuar vendimet me të cilat Autoriteti Bankar Evropian ka vendosur një gjobë, një pagesë të dënimit periodik ose ndonjë dënim administrativ ose masë tjetër administrative në përputhje me këtë ligj. Ajo mund të anulojë, të ulë ose të rrisë gjobën ose pagesën e dënimit periodik të vendosur.
2. Dispozitat e kësaj pike hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 137

Tarifat mbikëqyrëse

1. Autoriteti Bankar Evropian do të vendosë tarifa për emetuesit e tokenave të klasifikuar si të rëndësishëm. Këto tarifa do të mbulojnë shpenzimet e Autoritetit Bankar Evropian për kryerjen e detyrave të saj mbikëqyrëse në lidhje me emetuesit në përputhje me nenet 117 dhe 119, si dhe rimbursimin e kostove që mund të lindin gjatë kryerjes së punës sipas

këtij ligji, veçanërisht si rezultat i ndonjë delegimi të detyrave në përputhje me nenin 138.

2. Shuma e tarifës që vendoset për një emetues individual të një tokeni të asetit të rëndësishëm do të jetë proporcionale me madhësinë e aseteve të tij rezervë dhe do të mbulojë të gjitha kostot e kryera nga Autoriteti Bankar Evropian për përmbushjen e detyrave të saj mbikëqyrëse sipas këtij ligji.

Shuma e tarifës që vendoset për një emetues individual të një tokeni të parasë elektronike të klasifikuar si të rëndësishëm do të jetë proporcionale me madhësinë e emetimit të tokenit në këmbim të fondeve dhe do të mbulojë të gjitha kostot e krijuara nga kryerja e detyrave mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë sipas këtij ligji, përfshirë rimbursimin e çdo kostoje të kryer si rezultat i kryerjes së atyre detyrave.

3. Për qëllime të këtij neni, autoritetet përgjegjëse, përmes akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, mund të miratojë rregulla më të detajuara, lidhur me kushtet e përgjithshme, kriteret e veçanta, ose kriteret e tjera shtesë.

Neni 138

Delegimi i detyrave nga Autoriteti Bankar Evropian tek autoritetet përgjegjëse kombëtare

1. Në rastet kur është e nevojshme për kryerjen e duhur të një detyre mbikëqyrëse në lidhje me emetuesit e tokenave të klasifikuar si të rëndësishme, Autoriteti Bankar Evropian mund të delegojë detyra të veçanta mbikëqyrëse te një autoritet përgjegjës kombëtar. Këto detyra specifike mbikëqyrëse mund të përfshijnë kompetencën për të kryer kërkesa për informacion në përputhje me nenin 122 dhe për të kryer hetime dhe inspektime në vend në përputhje me nenet 123 ose 124.
2. Përpara se të delegojë një detyrë sipas pikës 1 të këtij neni, Autoriteti Bankar Evropian do të konsultohet me autoritetin përgjegjës përkatës në lidhje me:

(a) fushën e detyrës që do të delegohet;

(b) afatin kohor për kryerjen e detyrës; dhe

(c) transmetimin e informacionit të nevojshëm nga dhe te Autoriteti Bankar Evropian.

KREU VIII

DISPSPOZITA TË FUNDIT

Neni 139

Sandbox-i rregullator

1. Me qëllim testimin e kontrolluar të inovacionit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare krijon dhe administron një sandbox rregullator për tregjet e kripto-aseteve për një periudhë 3 vjeçare.
2. Rregullat e hollësishme në lidhje me sektorët dhe modelet e operimit, procedurat e autorizimit dhe pjesëmarrjes, kërkesat operacionale dhe të përputhshmërisë, kërkesat për transparencë dhe raportim, kompetencat mbikëqyrëse dhe plani i tranzicionit miratohen me rregullore të AMF.

Neni 140

Aktet nënligjore

1. Banka e Shqipërisë miraton, me rregullore, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet rregulluese që i përkasin fushës së përgjegjësisë së saj, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miraton, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet rregulluese që i përkasin fushës së përgjegjësisë së tij, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 141

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij shfuqizohen.

Neni 142

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 Mars 2026.

ANEKSI I

DETYRIME PËR PUBLIKIM PËR DOKUMENTIN INFORMUES PËR KRIPTO-ASETE TË TJERA PËRVEÇ TOKENAVE TË ASETIT OSE TOKENAVE TË PARASË ELEKTRONIKE

Pjesa A: Informacion rreth ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim

1. Emri;
2. Forma juridike;
3. Adresa e regjistruar dhe selia qendrore, nëse janë të ndryshme;
4. Data e regjistrimit;
5. Identifikuesi i subjektit ose një identifikues tjetër i kërkuar sipas legjislacionit kombëtar të zbatueshëm;
6. Një numër kontakti telefonik dhe një adresë emaili të ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim, dhe periudha e ditëve brenda së cilës një investitor që kontakton palët e përcaktuara do të marrë një përgjigje;
7. Kur është e aplikueshme, emri i kompanisë mëmë;
8. Identiteti, adresat e biznesit dhe funksionet e personave që janë anëtarë të strukturës drejtuese të ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim;
9. Veprimtaria e biznesit ose profesionale e ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim dhe, kur është e aplikueshme, e kompanisë mëmë të tij;
10. Gjendja financiare e ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim gjatë tre viteve të fundit ose, kur ofertuesi ose subjekti që kërkon pranimin në tregtim nuk është themeluar për tre vitet e fundit, gjendja financiare që nga data e regjistrimit të tij.

Gjendja financiare vlerësohet mbi bazën e një rishikimi të drejtë të zhvillimit dhe performancës së biznesit të ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim dhe pozicionit të tij për secilin vit, si dhe periudhës së ndërmjetme për të cilën kërkohet informacion financiar historik, duke përfshirë shkaqet e ndryshimeve të rëndësishme.

Rishikimi është një analizë e balancuar dhe gjithëpërfshirëse e zhvillimit dhe performancës së biznesit të ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e biznesit.

Pjesa B: Informacion rreth emetuesit, nëse është i ndryshëm nga ofertuesi ose subjekti që kërkon pranimin në tregtim

1. Emri;
2. Forma juridike;
3. Adresa e regjistruar dhe selia qendrore, nëse është e ndryshme;
4. Data e regjistrimit;
5. Identifikuesi i subjektit juridik ose një identifikues tjetër i kërkuar sipas legjislacionit kombëtar të zbatueshëm;
6. Kur është e aplikueshme, emri i kompanisë mëmë;
7. Identiteti, adresat e biznesit dhe funksionet e personave që janë anëtarë të strukturës drejtuese të emetuesit;
8. Veprimtaria e biznesit ose profesionale e emetuesit dhe, kur është e aplikueshme, e kompanisë mëmë të tij.

Pjesa C: Informacion rreth operatorit të platformës së tregtimit në rastet kur ai harton dokumentin informues të kripto-asetit

1. Emri;
2. Forma juridike;
3. Adresa e regjistruar dhe selia qendrore, nëse është e ndryshme;
4. Data e regjistrimit;
5. Identifikuesi i subjektit juridik ose një identifikues tjetër i kërkuar sipas legjislacionit kombëtar të zbatueshëm;
6. Kur është e aplikueshme, emri i kompanisë mëmë;
7. Arsyeja pse ky operator hartoi dokumentin informues të kripto-asetit;
8. Identiteti, adresat e biznesit dhe funksionet e personave që janë anëtarë të strukturës drejtuese të operatorit;
9. Veprimtaria e biznesit ose profesionale e operatorit dhe, kur është e aplikueshme, e kompanisë mëmë të tij.

Pjesa D: Informacion rreth projektit të kripto-asetit

1. Emri i projektit të kripto-asetit dhe i kripto-aseteve, nëse është i ndryshëm nga emri i ofertuesit ose subjektit që kërkon pranimin në tregtim, dhe shkurtesa ose simboli i tij;
2. Një përshkrim i shkurtër i projektit të kripto-asetit;
3. Detaje të të gjitha personave fizikë ose juridikë (duke përfshirë adresat e biznesit ose vendbanimin e kompanisë) të përfshirë në zbatimin e projektit të kripto-asetit, si këshilltarët, ekipi i zhvillimit dhe ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve;
4. Kur projekti i kripto-asetit përfshin tokena shërbimi, karakteristikat kryesore të mallrave ose shërbimeve që do të zhvillohen;
5. Informacion rreth projektit të kripto-asetit, veçanërisht objektivat e kaluar dhe të

ardhshëm të projektit dhe, kur është e aplikueshme, burimet tashmë të alokuara për projektin;
6. Kur është e aplikueshme, përdorimi i planifikuar i çdo fondi ose kripto-aseti tjetër të mbledhur.

Pjesa E: Informacion rreth ofertës ndaj publikut të kripto-aseteve ose pranimit të tyre në tregtim

1. Tregues nëse dokumenti informues i kripto-aseteve i referohet një oferte ndaj publikut të kripto-aseteve ose pranimit të tyre në tregtim;
2. Arsyet për ofertën ndaj publikut ose për kërkimin e pranimit në tregtim;
3. Kur është e aplikueshme, shuma që oferta ndaj publikut synon të mbledhë në fonde ose në ndonjë kripto-aset tjetër, duke përfshirë, kur është e aplikueshme, çdo objektiv minimal dhe maksimal të abonimeve për ofertën ndaj publikut të kripto-aseteve, dhe nëse pranohen abonime të tepërta dhe mënyrën se si ato shpërndahen;
4. Çmimi i emetimit të kripto-asetit që ofrohet ndaj publikut (në një valutë zyrtare ose kripto-aset tjetër), çdo tarifë aplikueshme për abonim ose metoda sipas së cilës do të përcaktohet çmimi i ofertës;
5. Kur është e aplikueshme, numri total i kripto-aseteve që do të ofrohen ndaj publikut ose do të pranohen në tregtim;
6. Tregues për blerësit potencialë të synuar nga oferta ndaj publikut të kripto-aseteve ose pranimi i kripto-aseteve të tilla në tregtim, duke përfshirë çdo kufizim sa i përket tipit të blerësve të kripto-aseteve të tilla;
7. Njoftim specifik që blerësit që marrin pjesë në ofertën e kripto-aseteve ndaj publikut do të jenë në gjendje të rimbursohen nëse nuk arrihet objektivi minimal i abonimeve në fund të ofertës ndaj publikut, nëse ushtrojnë të drejtën e tërheqjes sipas parashikimit në nenin 13 ose nëse oferta anulohet, dhe përshkrim i detajuar i mekanizmit të rimbursimit, duke përfshirë afatin e pritshëm të përfundimit të rimbursimeve;
8. Informacion rreth fazave të ndryshme të ofertës ndaj publikut të kripto-aseteve, duke përfshirë informacion mbi çmimin e zbritur të blerjes për blerësit e hershëm të kripto-aseteve (parashitje publike); në rastet e çmimeve të zbritura të blerjes, shpjegim pse çmimet e blerjes mund të jenë të ndryshme dhe përshkrim i ndikimit në investitorët e tjerë;
9. Për ofertat me afat të kufizuar, periudha e abonimit gjatë së cilës oferta ndaj publikut është e hapur;
10. Marrëveshjet për të mbrojtur fondet ose kripto-asetet e tjera sipas nenit 10 gjatë ofertës ndaj publikut me afat të kufizuar ose gjatë periudhës së tërheqjes;
11. Metodat e pagesës për të blerë kripto-asetet e ofruara dhe metodat e transferimit të vlerës te blerësit kur ata kanë të drejtë të rimbursohen;
12. Në rastet e ofertave ndaj publikut, informacion mbi të drejtën e tërheqjes sipas nenit 13;
13. Informacion mbi mënyrën dhe afatin e transferimit të kripto-aseteve të blera te mbajtësit;
14. Informacion mbi kërkesat teknike që blerësi plotëson për të mbajtur kripto-asetet;
15. Kur është e aplikueshme, emri i ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve që është

përgjegjës për listimin e kripto-aseteve dhe forma e listimit të tillë (me ose pa angazhim);
16. Kur është e aplikueshme, emri i platformës së tregtimit për kripto-asetet, ku kërkohet pranimi në tregtim, dhe informacion mbi mënyrën se si investitorët mund të kenë qasje në ato platforma tregtimi së bashku me kostot përkatëse;
17. Shpenzimet që lidhen me ofertën ndaj publikut të kripto-aseteve;
18. Konflikte të mundshme interesi të personave të përfshirë në ofertën ndaj publikut ose pranimin në tregtim, që lindin në lidhje me ofertën ose pranimin në tregtim;
19. Ligji i zbatueshëm për ofertën ndaj publikut të kripto-aseteve, si dhe gjykata kompetente.

Pjesa F: Informacion mbi kripto-asetet

1. Lloji i kripto-asetit që do të ofrohet ndaj publikut ose për të cilin kërkohet pranim në tregtim;
2. Përshkrim i karakteristikave, duke përfshirë të dhënat e nevojshme për klasifikimin e dokumentit informues të kripto-aseteve në regjistrin e referuar në nenin 109, siç specifikohet sipas pikës 8 të atij neni, dhe funksionalitetin e kripto-aseteve që po ofrohen ose pranohen në tregtim, duke përfshirë informacion mbi momentin kur planifikohet që këto funksionalitete të jenë të aplikueshme.

Pjesa G: Informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e lidhura me kripto-asetet

1. Përshkrim i të drejtave dhe detyrimeve të blerësit, nëse ka, si dhe procedurat dhe kushtet për ushtrimin e atyre të drejtave;
2. Përshkrim i kushteve nën të cilat të drejtat dhe detyrimet mund të modifikohen;
3. Kur është e aplikueshme, informacion mbi ofertat e ardhshme ndaj publikut të kripto-aseteve nga emetuesi dhe numrin e kripto-aseteve të mbajtura nga vetë emetuesi;
4. Kur oferta ndaj publikut të kripto-aseteve ose pranimi i tyre në tregtim ka të bëjë me tokena shërbimi, informacion mbi cilësinë dhe sasinë e mallrave ose shërbimeve për të cilat ofrojnë akses tokenat e shërbimit;
5. Kur ofertat e kripto-aseteve ndaj publikut ose pranimi i tyre në tregtim ka të bëjë me tokena shërbimi, informacion se si tokenat e shërbimit mund të shfrytëzohen për mallrat ose shërbimet përkatëse;
6. Kur nuk kërkohet pranim në tregtim, informacion mbi mënyrën dhe vendin ku mund të blihen ose shiten kripto-asetet pas ofertës ndaj publikut;
7. Kufizime në transferueshmërinë e kripto-aseteve që po ofrohen ose pranohen në tregtim;
8. Kur kripto-asetet kanë protokolle për rritjen ose uljen e sasisë së tyre në përgjigje të ndryshimeve në kërkesë, një përshkrim i funksionimit të atyre protokolleve;
9. Kur është e aplikueshme, përshkrim i skemave të mbrojtjes që mbrojnë vlerën e kripto-aseteve dhe i skemave të kompensimit;
10. Ligji i zbatueshëm për kripto-asetet, si dhe gjykata kompetente.

Pjesa H: Informacion mbi teknologjinë themeluese

1. Informacion mbi teknologjinë e përdorur, duke përfshirë teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, protokollet dhe standardet teknike të përdorura;
2. Mekanizmi i konsensusit, kur është e aplikueshme;
3. Mekanizmat e incentivimit për të siguruar transaksionet dhe çdo tarifë e zbatueshme;
4. Kur kripto-asetet emetohen, transferohen dhe ruhen duke përdorur teknologjinë e regjistrave të shpërndarë që operohet nga emetuesi, ofertuesi ose një palë e tretë që vepron në emër të tyre, një përshkrim i detajuar i funksionimit të asaj teknologjie të regjistrave të shpërndarë;
5. Informacion mbi rezultatin e auditimit të teknologjisë së përdorur, nëse është kryer një auditim i tillë.

Pjesa I: Informacion mbi rreziqet

1. Përshkrim i rreziqeve të lidhura me ofertën e kripto-aseteve ndaj publikut ose pranimin e tyre në tregtim;
2. Përshkrim i rreziqeve të lidhura me emetuesin, nëse është i ndryshëm nga ofertuesi ose personi që kërkon pranim në tregtim;
3. Përshkrim i rreziqeve të lidhura me kripto-asetet;
4. Përshkrim i rreziqeve të lidhura me zbatimin e projektit;
5. Përshkrim i rreziqeve të lidhura me teknologjinë e përdorur, si dhe masat për zbutjen e tyre, nëse ka.

ANEKSI II

Detyrime për publikim për Dokumentin informues të Kripto-Asetit për një Token Aseti

Pjesa A: Informacion mbi emetuesin e tokenit të asetit

1. Emri;
2. Forma juridike;
3. Adresa e regjistruar dhe selia qendrore, kur janë të ndryshme;
4. Data e regjistrimit;
5. Identifikuesi i subjektit ose një identifikues tjetër i kërkuar sipas legjislacionit kombëtar të zbatueshëm;
6. Kur është e aplikueshme, identiteti i kompanisë mëmë;
7. Identiteti, adresat e biznesit dhe funksionet e personave që janë anëtarë të strukturës drejtuese të emetuesit;
8. Veprimtaria e biznesit ose profesionale e emetuesit dhe, kur është e aplikueshme, e kompanisë mëmë;

9. Gjendja financiare e emetuesit gjatë tre viteve të fundit ose, kur emetuesi nuk është themeluar për tre vitet e fundit, gjendja e tij financiare që nga data e regjistrimit.
    a. Gjendja financiare vlerësohet mbi bazën e një rishikimi të drejtë të zhvillimit dhe performancës së veprimtarisë së emetuesit dhe të pozicionit të tij për çdo vit dhe periudhë të përkohshme për të cilën kërkohet informacion financiar historik, duke përfshirë shkaqet e ndryshimeve të rëndësishme.
    b. Rishikimi është një analizë e balancuar dhe e plotë e zhvillimit dhe performancës së veprimtarisë së emetuesit dhe e pozicionit të tij, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë.
10. Përshkrim i detajuar i strukturave drejtuese të emetuesit;
11. Detaje për autorizimin si emetues i një tokeni të asetit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 17.
    a. Për institucionet e kreditit, emri i autoritetit përgjegjës të vendit të origjinës.
12. Deklarohen rastet kur emetuesi i tokenit të asetit gjithashtu emeton kripto-asete të tjera, ose gjithashtu ka aktivitete të lidhura me kripto-asete të tjera; emetuesi gjithashtu deklaron nëse ekziston ndonjë lidhje midis emetuesit dhe entitetit që menaxhon teknologjinë e regjistrave të shpërndarë të përdorur për të emetuar kripto-asetin, përfshirë nëse protokollet menaxhohen ose kontrollohen nga një person i lidhur ngushtë me pjesëmarrësit e projektit.

Pjesa B: Informacion mbi tokenin e asetit

1. Emri dhe shkurtimi ose identifikuesi i simbolit të tokenit të asetit;
2. Përshkrimi i karakteristikave të tokenit të asetit, duke përfshirë të dhënat e nevojshme për klasifikimin e dokumentit informues të kripto-asetit në regjistrin e përcaktuar në Nenin 109, siç specifikohet në përputhje me pikën 8 të atij neni;
3. Detajet e të gjithë personave fizikë ose juridikë (duke përfshirë adresat e biznesit ose vendbanimin e kompanisë) të përfshirë në planin e veprimit të tokenit të asetit, si këshilltarët, ekipi i zhvillimit dhe ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve;
4. Përshkrimi i rolit, përgjegjësive dhe llogaridhënies së çdo entiteti të tretë të përcaktuar në Nenin 34 pika 5, shkronja (h);
5. Informacion mbi planet për tokenat e asetit, duke përfshirë përshkrimin e pikave të rëndësishme të kaluara dhe të ardhshme dhe, kur është e zbatueshme, burimet e alokuara.

Pjesa C: Informacion mbi ofertën ndaj publikut të tokenit të asetit ose pranimin e tij për tregtim

1. Indikimi nëse dokumenti informues i kripto-asetit lidhet me një ofertë ndaj publikut të tokenit të asetit ose pranimin e tij për tregtim;
2. Shuma që oferta ndaj publikut e tokenit të asetit synon të mbledhë në fonde ose në ndonjë kripto-aset tjetër, duke përfshirë, kur është e aplikueshme, objektivat minimal dhe maksimal të periudhës së abonimit të vendosur për ofertën ndaj publikut të tokenit të

asetit, si dhe nëse pranohen shumat përtej këtij synimi, mënyrën si shpërndahen ato;
3. Kur është e aplikueshme, numri total i njësive të tokenit të asetit që do të ofrohen ose do të pranohen për tregtim;
4. Indikimi i blerësve të mundshëm që synohen nga oferta ndaj publikut e tokenit të asetit ose pranimi i tij për tregtim, duke përfshirë çdo kufizim lidhur me llojin e zotëruesve për tokenin e tillë;
5. Një njoftim specifik që blerësit që marrin pjesë në ofertën ndaj publikut të tokenit të asetit do të jenë në gjendje të rimbursohen nëse objektivi minimal i abonimit nuk arrihet në fund të ofertës ndaj publikut, duke përfshirë kohën e pritshme të përfundimit të rimbursimeve të tilla; pasojat e tejkalimit të objektivit maksimal të abonimit bëhen të qarta;
6. Informacion mbi fazat e ndryshme të ofertës ndaj publikut të tokenit të asetit, duke përfshirë informacionin mbi çmimin e blerjes së zbritur për blerësit e hershëm të tokenit të asetit (shitje paraprake) dhe, në rastin e çmimit të blerjes së zbritur për disa blerës, një shpjegim se pse çmimet e blerjes mund të jenë të ndryshme dhe një përshkrim i ndikimit mbi investitorët e tjerë;
7. Për ofertat me afat të kufizuar, periudha e pajtimit gjatë së cilës oferta ndaj publikut është e hapur;
8. Metodat e pagesës për të blerë dhe për të shlyer tokenin e asetit që ofrohet;
9. Informacion mbi metodën dhe orarin e transferimit të tokenit të asetit te zotëruesit;
10. Informacion mbi kërkesat teknike që blerësi përmbush për të mbajtur tokenin e asetit;
11. Kur është e aplikueshme, emri i ofruesit të shërbimit të kripto-aseteve që merret me listimin e tokeneve të asetit dhe forma e listimit (me ose pa bazë angazhimi të plotë);
12. Kur është e aplikueshme, emri i platformës së tregtimit të kripto-aseteve ku kërkohet pranim për tregtim, dhe informacion se si investitorët mund të aksesojnë këto platforma tregtimi, si dhe kostot e përfshira;
13. Shpenzimet lidhura me ofertën ndaj publikut të tokenit të asetit;
14. Konfliktet e mundshme të interesit të personave të përfshirë në ofertën ndaj publikut ose pranimin për tregtim, që lindin në lidhje me ofertën ose pranimin për tregtim;
15. Ligji i zbatueshëm për ofertën ndaj publikut të tokenit të asetit, si dhe gjykata kompetente.

Pjesa D: Informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e lidhura me tokenin e asetit

1. Përshkrimi i karakteristikave dhe funksionaliteteve të tokenit të asetit që ofrohet ose pranohet për tregtim, duke përfshirë informacionin se kur planifikohet të aplikohen funksionalitetet;
2. Përshkrimi i të drejtave dhe detyrimeve të blerësve, nëse ka, si dhe procedurat dhe kushtet për ushtrimin e atyre të drejtave;
3. Përshkrimi i kushteve në të cilat mund të modifikohen të drejtat dhe detyrimet;
4. Kur është e aplikueshme, informacion mbi ofertat e ardhshme ndaj publikut të tokenit të asetit nga emetuesi, si dhe numrin e njësive të tokenit të mbajtura nga vetë emetuesi;

5. Kur nuk kërkohet pranim për tregtim, informacion mbi mënyrën dhe vendin se si dhe ku mund të blihet ose shitet tokeni i asetit pas ofertës ndaj publikut;
6. Çdo kufizim mbi transferueshmërinë e tokenit të asetit që po ofrohet ose pranohet për tregtim;
7. Përshkrimi i funksionimit në rastet kur tokeni i asetit ka protokolle për rritjen ose uljen e sasisë së tij në përgjigje të ndryshimeve në kërkesë;
8. Kur është e aplikueshme, përshkrimi i skemave mbrojtëse që mbrojnë vlerën e tokenit të asetit dhe skemat e kompensimit;
9. Informacion mbi natyrën dhe zbatueshmërinë e të drejtave, duke përfshirë të drejtat e përhershme të shlyerjes dhe çdo pretendim që mbajtësit ose çdo person fizik ose juridik, sipas Nenit 39 pika 2, mund të kenë kundrejt emetuesit, duke përfshirë informacionin se si do të trajtohen këto të drejta në rastet e procedurave të falimentimit, informacion mbi ndarjen e të drejtave në mes të zotëruesve të ndryshëm dhe arsyet jodiskriminuese për trajtimin e ndryshëm;
10. Përshkrim i detajuar i pretendimeve që tokeni i asetit përfaqëson për mbajtësit, duke përfshirë:

(a) përshkrimin e çdo aseti të referuar dhe përpjesëtimet e specifikuara të secilit prej këtyre aseteve;

(b) marrëdhënien midis vlerës së aseteve të referuara dhe shumës së pretendimit dhe rezervës së aseteve; dhe

(c) përshkrimi se si kryhet një vlerësim i drejtë dhe transparent i përbërësve të pretendimit, duke identifikuar, kur është e rëndësishme, palët e pavarura;

11. Kur është e aplikueshme, informacion mbi marrëveshjet e vendosura nga emetuesi për të siguruar likuiditetin e tokenit të asetit, duke përfshirë emrin e subjekteve përgjegjëse për sigurimin e këtij likuiditeti;
12. Detajet e kontaktit për dorëzimin e ankesave, duke përfshirë përshkrimin e procedurave të trajtimit të ankesave, si dhe çdo mekanizëm të krijuar nga emetuesi i tokenit të asetit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose planit të kompensimit,;
13. Përshkrimi i të drejtave të blerësve kur emetuesi nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij, duke përfshirë në rastet e falimentimit;
14. Përshkrimi i të drejtave në kontekstin e zbatimit të planit të rikuperimit;
15. Përshkrimi i të drejtave në kontekstin e zbatimit të planit të shlyerjes;
16. Informacion i detajuar se si shlyhet tokeni i asetit, duke përfshirë nëse blerësi do të jetë në gjendje të zgjedhë formën e shlyerjes, formën e transferimit ose valutën zyrtare të shlyerjes;
17. Ligji i zbatueshëm për tokenin e asetit, si dhe gjykata kompetente.

Pjesa E: Informacion mbi teknologjinë bazë

1. Informacion mbi teknologjinë e përdorur, përfshirë teknologjinë e regjistrave të

shpërndarë, si dhe protokollet dhe standardet teknike të përdorura, që lejojnë mbajtjen, ruajtjen dhe transferimin e tokeneve të asetit;
2. Mekanizmi i konsensusit, kur është i aplikueshëm;
3. Mekanizmat e stimujve për të siguruar transaksionet dhe çdo tarifë e zbatueshme;
4. Përshkrimi i detajuar i funksionimit të teknologjisë kur tokenet e asetit emetohen, transferohen dhe ruhen duke përdorur teknologjinë e regjistrave të shpërndarë të operuar nga emetuesi ose nga një palë e tretë që vepron në emër të emetuesit,;
5. Informacion mbi rezultatin e auditimit të teknologjisë së përdorur, nëse është kryer një auditim i tillë.

Pjesa F: Informacion mbi rreziqet

1. Rreziqet që lidhen me rezervën e aseteve, kur emetuesi nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij;
2. Përshkrim i rreziqeve të lidhura me emetuesin e tokenit të asetit;
3. Përshkrim i rreziqeve që lidhen me ofertën ndaj publikut të tokenit të asetit ose me pranimin e tij për tregtim;
4. Përshkrim i rreziqeve që lidhen me tokenin e asetit, veçanërisht për sa i përket aseteve të referuara;
5. Përshkrim i rreziqeve të lidhura me planin e veprimit të projektit të tokenit të asetit;
6. Përshkrim i rreziqeve të lidhura me teknologjinë e përdorur, si dhe masat e zbutjes, nëse ka.

Pjesa G: Informacion mbi rezervën e aseteve

1. Përshkrim i detajuar i mekanizmit që synon të përafrojë vlerën e rezervës së aseteve me pretendimin e lidhur me tokenin e asetit, duke përfshirë aspektet ligjore dhe teknike;
2. Përshkrim i detajuar i rezervës së aseteve dhe përbërjes së tyre;
3. Përshkrim i mekanizmave përmes të cilëve emetohen dhe shlyhen tokenat e asetit;
4. Informacion nëse një pjesë e rezervës së aseteve është e investuar dhe, kur është e aplikueshme, përshkrim i politikës së investimit për ato asete rezerve;
5. Përshkrim i marrëveshjeve të kujdestarisë për asetet e rezervës, duke përfshirë ndarjen e tyre dhe emrat e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve që ofrojnë kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve, institucioneve të kreditit ose shoqërive komisionere të caktuara si kujdestarë të aseteve të rezervës.

ANEKSI III

Dokumentet për publikim për Dokumentin informues të Kripto-Asetit për Tokenin e Parasë Elektronike

Pjesa A: Informacion mbi emetuesin e tokenit të parasë elektronike

1. Emri;
2. Forma juridike;
3. Adresa e regjistruar dhe selia qendrore, kur janë të ndryshme;
4. Data e regjistrimit;
5. Identifikuesi i subjektit ose një identifikues tjetër i kërkuar sipas legjislacionit kombëtar të zbatueshëm;
6. Një numër kontakti telefoni dhe një adresë emaili e emetuesit, si dhe periudha e ditëve brenda së cilës një investitor do të marrë një përgjigje në rast kontakti;
7. Kur është e aplikueshme, identiteti i kompanisë mëmë;
8. Identiteti, adresa e biznesit dhe funksionet e personave që janë anëtarë të strukturës drejtuese të emetuesit;
9. Veprimtaria e biznesit ose profesionale e emetuesit dhe, kur është e aplikueshme, e kompanisë mëmë;
10. Konflikte të mundshme interesi;
11. Deklarime në rastet kur emetuesi i tokenit të parasë elektronike gjithashtu emeton kripto-asete të tjera ose ka aktivitete të tjera të lidhura me kripto-asete; emetuesi duhet gjithashtu të deklarojë nëse ekziston ndonjë lidhje midis emetuesit dhe entitetit që menaxhon teknologjinë e regjistrave të shpërndarë të përdorur për të emetuar kripto-asetin, përfshirë nëse protokollet menaxhohen ose kontrollohen nga një person i lidhur ngushtë me pjesëmarrësit e projektit;
12. Gjendja financiare e emetuesit gjatë tre viteve të fundit ose, në rast se emetuesi nuk është themeluar për tre vitet e fundit, regjistri i gjendjes financiare të emetuesit që nga data e regjistrimit.
    Gjendja financiare vlerësohet mbi bazën e një rishikimi të drejtë të zhvillimit dhe performancës së veprimtarisë së emetuesit, si dhe të pozicionit të tij për çdo vit dhe periudhës së përkohshme për të cilën kërkohet informacion financiar historik, duke përfshirë shkaqet e ndryshimeve të rëndësishme.
    Rishikimi është një analizë e balancuar dhe e plotë e zhvillimit dhe performancës së veprimtarisë së emetuesit dhe e pozicionit të tij, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë;

13. Detaje për autorizimin si emetues i një tokeni të parasë elektronike dhe emri i autoritetit përgjegjës që ka dhënë autorizimin, përveç rasteve që përjashtohen nga autorizimi në përputhje me Nenin 48 pika 4 dhe 5.

Pjesa B: Informacion mbi tokenin e parasë elektronike

1. Emri dhe shkurtimi (simboli);
2. Përshkrim i karakteristikave të tokenit të parasë elektronike, duke përfshirë të dhënat e nevojshme për klasifikimin e dokumentit informues të kripto-asetit në regjistrin e

përcaktuar në Nenin 109, siç specifikohet në përputhje me pikën 8 të atij neni;
3. Detaje të të gjithë personave fizikë ose juridikë (përfshirë adresat e biznesit dhe/ose vendbanimin e kompanisë) të përfshirë në dizajnimin dhe zhvillimin e projektit, të tilla si këshilltarët, ekipi i zhvillimit dhe ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve.

Pjesa C: Informacion mbi ofertën ndaj publikut të tokenit të parasë elektronike ose listimin e tij për tregtim

1. Tregues nëse dokumenti informues i kripto-asetit ka të bëjë me një ofertë ndaj publikut të tokenit të parasë elektronike ose me listimin e tij për tregtim;
2. Kur është e aplikueshme, numri total i njësive të tokenit të parasë elektronike që do të ofrohen publikut ose do të listohen për tregtim;
3. Kur është e aplikueshme, emri i platformave të tregtimit të kripto-aseteve, ku kërkohet listimi për tregtim i tokenit të parasë elektronike;
4. Ligji i zbatueshëm për ofertën ndaj publikut të tokenit të parasë elektronike, si dhe gjykata kompetente.

Pjesa D: Informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e lidhura me tokenat e parasë elektronike

1. Përshkrim i detajuar i të drejtave dhe detyrimeve, nëse ka, që ka mbajtësi i tokenit të parasë elektronike, përfshirë të drejtën e shlyerjes me vlerë nominale, si dhe procedurat dhe kushtet për ushtrimin e këtyre të drejtave;
2. Përshkrim i kushteve nën të cilat të drejtat dhe detyrimet mund të modifikohen;
3. Përshkrim i të drejtave të mbajtësve, kur emetuesi nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij, duke përfshirë rastet e falimentimit;
4. Përshkrim i të drejtave në kontekstin e zbatimit të planit të rimëkëmbjes;
5. Përshkrim i të drejtave në kontekstin e zbatimit të planit të shlyerjes;
6. Detaje kontakti për paraqitjen e ankesave dhe përshkrimi i procedurave për trajtimin e tyre, si dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ose procedurave të kompensimit të krijuara nga emetuesi i tokenit të parasë elektronike;
7. Kur është e aplikueshme, përshkrim i skemave mbrojtëse që mbrojnë vlerën e kripto-asetit dhe skemave të kompensimit;
8. Ligji i zbatueshëm për tokenin e parasë elektronike, si dhe gjykata kompetente.

Pjesa E: Informacion mbi teknologjinë bazë

1. Informacion mbi teknologjinë e përdorur, duke përfshirë teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, si dhe protokollet dhe standardet teknike të përdorura që lejojnë mbajtjen, ruajtjen dhe transferimin e tokenave të parasë elektronike;
2. Informacion mbi kërkesat teknike që plotëson blerësi për të marrë kontrollin mbi tokenin e parasë elektronike;
3. Mekanizmi i konsensusit, kur është i aplikueshëm;

4. Mekanizmat e incentivimit për të siguruar rrjetin dhe transaksionet, si dhe tarifat përkatëse, nëse ka;
5. Një përshkrim i detajuar i funksionimit të teknologjisë në rastet kur tokeni i parasë elektronike emetohet, transferohet dhe ruhet duke përdorur teknologjinë e regjistrave të shpërndarë që operohet nga emetuesi ose nga një palë e tretë që vepron në emër të tij;
6. Informacion mbi rezultatin e auditimit të teknologjisë së përdorur, nëse është kryer një auditim i tillë.

Pjesa F: Informacion mbi rreziqet

1. Përshkrimi i rreziqeve të lidhura me emetuesin e tokenit të parasë elektronike;
2. Përshkrimi i rreziqeve të lidhura me tokenin e parasë elektronike;
3. Përshkrimi i rreziqeve të lidhura me teknologjinë e përdorur, si dhe masat për reduktimin e tyre, nëse ka.

ANEKSI IV

KËRKESAT MINIMALE KAPITALE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË KRIPTO-ASETEVE

Ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve	**Lloji i shërbimeve të kripto-aseteve**	**Kërkesat minimale kapitale sipas Nenit 67(1), pika (a)**
Klasa 1	**Ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve i autorizuar për shërbimet e mëposhtme të kripto-aseteve:**	EUR 50 000
	— ekzekutimi i urdhërave në emër të klientëve;	
	— listimi i kripto-aseteve;	
	— ofrimi i shërbimeve të transferimit të kripto-aseteve për llogari të klientëve;	
	— marrja dhe transmetimi i urdhërave për kripto-asete për llogari të klientëve;	
	— këshillimi në lidhje me kripto-asetet; dhe/ose	
	— administrimi i portofolit të kripto-aseteve.	
Klasa 2	**Ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve i autorizuar për çdo shërbim të kripto-aseteve nën klasën 1 dhe:**	EUR 125 000
	— ofrimi i kujdestarisë dhe administrimi i kripto-aseteve për llogari të klientëve;	
	— këmbimi i kripto-aseteve kundrejt fondeve; dhe/ose	
	— këmbimi i kripto-aseteve kundrejt kripto-aseteve të tjera.	
Klasa 3	**Ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve i autorizuar për çdo shërbim të kripto-aseteve nën klasën 2 dhe:**	EUR 150 000
	— operimi i një platforme tregtimi për kripto-asetet.	

ANEKSI V

LISTA E SHKELJEVE TË PËRCAKTUARA NË KREUN III DHE VI PËR EMETUESIT E TOKENËVE TË RËNDËSISHËM TË ASETEVE

1. Emetuesi shkel Nenin 22 pika 1 duke mos raportuar në bazë tremujore te Banka e Shqipërisë, për secilin token aseti të klasifikuar si të rëndësishëm me një vlerë emetimi që është më e lartë se 100,000,000 EUR, informacionin e përcaktuar në shkronjat (a) deri (d).
2. Emetuesi shkel Nenin 23 pika 1 duke mos ndalur emetimin e një tokeni aseti të rëndësishëm kur arrihen pragjet e parashikuara në atë nen, ose duke mos dorëzuar një plan te Banka e Shqipërisë brenda 40 ditëve punë nga arritja e pragjeve.
3. Emetuesi shkel Nenin 23 pika 4 duke mos përmbushur modifikimet e planit të përcaktuar në pikën 1, shkronja (b), të këtij neni siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.
4. Emetuesi shkel Nenin 25 duke mos njoftuar Bankën e Shqipërisë për ndonjë ndryshim të parashikuar të modelit të biznesit që ka gjasa të ndikojë ndjeshëm në vendimin e blerjes së tokenëve të asetit të klasifikuar si të rëndësishëm, ose duke mos përshkruar një ndryshim të tillë në dokumentin informues të kripto-asetit.
5. Emetuesi shkel Nenin 25 duke mos përmbushur një masë të kërkuar nga Banka e Shqipërisë në përputhje me Nenin 25 pika 4.
6. Emetuesi shkel Nenin 27 pika 1 duke mos vepruar me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm.
7. Emetuesi shkel Nenin 27 pika 1 duke mos komunikuar me zotëruesit dhe blerësit e mundshëm të tokenit të asetit të klasfifikuar si të rëndësishëm në një mënyrë të drejtë, të qartë dhe jo mashtruese.
8. Emetuesi shkel Nenin 27 pika 2 duke mos vepruar në interesin më të mirë të zotëruesve të tokenit të rëndësishëm të asetit, ose duke favorizuar trajtimin e veçantë për zotërues të caktuar, që nuk janë deklaruar në dokumentin informues të kripto-asetit ose, kur është e zbatueshme, në materialet promovuese.
9. Emetuesi shkel Nenin 28 duke mos publikuar në faqen e tij të internetit dokumentin informues të kripto-asetit të miratuar, sipas përcaktimeve të nenit 21 pika 1 dhe, kur është e zbatueshme, dokumentin informues të kripto-asetit të modifikuar sipas përcaktimeve të nenit 25.
10. Emetuesi shkel Nenin 28 duke mos e bërë dokumentin informues të kripto-asetit të aksesueshëm publikisht deri në datën e fillimit të ofertës për publikun të tokenit të rëndësishëm të asetit ose të pranimit për tregtim të atij tokeni.
11. Emetuesi shkel Nenin 28 duke mos siguruar që dokumenti informues i kripto-asetit, dhe, kur është e zbatueshme, dokumenti informues i kripto-asetit i modifikuar, të mbetet i disponueshëm në faqen e tij të internetit për sa kohë që tokeni i rëndësishëm i asetit mbahet nga publiku.
12. Emetuesi shkel Nenin 29 pika 1 dhe 2 duke publikuar komunikime të marketingut që

lidhen me një ofertë ndaj publikut të një tokeni aseti të klasifikuar si të rëndësishëm, ose për pranimin për tregtim të një tokeni të tillë, që nuk përputhen me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, shkronjat (a) deri (d), dhe në pikën 2 të atij Neni.

13. Emetuesi shkel Nenin 29 pika 3 duke mos publikuar materialet promovuese dhe çdo ndryshim të tyre në faqen e tij të internetit.
14. Emetuesi shkel Nenin 29 pika 5 duke mos njoftuar Bankën e Shqipërisë për materialet promovuese sipas kërkesës.
15. Emetuesi shkel Nenin 29 pika 6 duke shpërndarë komunikime të marketingut përpara publikimit të dokumentit informues të kripto-asetit.
16. Emetuesi shkel Nenin 30 pika 1 duke mos zbuluar në një mënyrë të qartë, të saktë dhe transparente në një vend publikisht dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tij të internetit shumën e tokenit të rëndësishëm të asetit në qarkullim dhe vlerën dhe përbërjen e rezervës së aseteve të përcaktuara në Nenin 36, ose duke mos përditësuar informacionin e kërkuar të paktën një herë në muaj.
17. Emetuesi shkel Nenin 30(2) duke mos publikuar sa më shpejt në një vend publikisht dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tij të internetit një përmbledhje të shkurtër, të qartë, të saktë dhe transparente të raportit të auditimit, si dhe raportin e plotë dhe të paprekur të auditimit, në lidhje me rezervën e aseteve të përcaktuara në Nenin 36.
18. Emetuesi shkel Nenin 30(3) duke mos zbuluar në një vend publikisht dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tij të internetit në një mënyrë të qartë, të saktë dhe transparente sa më shpejt të jetë e mundur çdo ngjarje që ka ose mund të ketë një efekt të rëndësishëm mbi vlerën e tokenit të rëndësishëm të asetit ose mbi rezervën e aseteve të përcaktuara në Nenin 36.
19. Emetuesi shkel Nenin 31(1) duke mos krijuar dhe mirëmbajtur procedura efektive dhe transparente për trajtimin e shpejtë, të drejtë dhe të qëndrueshëm të ankesave të marra nga mbajtësit e tokenit të rëndësishëm të asetit dhe palëve të tjera të interesuara, përfshirë shoqatat e konsumatorëve që përfaqësojnë mbajtësit e tokenit të rëndësishëm të asetit, dhe duke mos publikuar përshkrime të këtyre procedurave, ose, kur tokeni i rëndësishëm i asetit shpërndahet, plotësisht ose pjesërisht, nga entitete të palëve të treta, duke mos krijuar procedura për të lehtësuar trajtimin e ankesave midis mbajtësve dhe entiteteve të palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 34(5), nënparagrafi i parë, pika (h).
20. Emetuesi shkel Nenin 31(2) duke mos mundësuar që mbajtësit e tokenit të rëndësishëm të asetit të paraqesin ankesa pa pagesë.
21. Emetuesi shkel Nenin 31(3) duke mos zhvilluar dhe vënë në dispozicion të mbajtësve të tokenit të rëndësishëm të asetit një format për paraqitjen e ankesave dhe duke mos mbajtur një regjistër të të gjitha ankesave të marra dhe çdo mase të ndërmarrë si përgjigje ndaj atyre ankesave.
22. Emetuesi shkel Nenin 31(4) duke mos hetuar të gjitha ankesat në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë ose duke mos komunikuar rezultatet e hetimeve të tilla mbajtësve të tokenit të tij të rëndësishëm të asetit brenda një periudhe të arsyeshme.
23. Emetuesi shkel Nenin 32(1) duke mos zbatuar dhe mirëmbajtur politika dhe procedura efektive për të identifikuar, parandaluar, menaxhuar dhe zbuluar konfliktet e interesit midis vetë emetuesit dhe aksionarëve ose anëtarëve të tij, vetë emetuesit dhe çdo

aksionari ose anëtari, qoftë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, që ka një pjesëmarrje influencuese në të, vetë emetuesit dhe anëtarëve të strukturës së tij drejtuese, vetë emetuesit dhe punonjësve të tij, vetë emetuesit dhe mbajtësve të tokenit të rëndësishëm të asetit ose vetë emetuesit dhe çdo pale të tretë që ofron një nga funksionet sipas përcaktimeve të nenit 34(5), nënpikën e parë, pika (h).

24. Emetuesi shkel Nenin 32(2) duke mos marrë të gjitha masat e duhura për të identifikuar, parandaluar, menaxhuar dhe zbuluar konfliktet e interesit që lindin nga menaxhimi dhe investimi i rezervës së aseteve të përcaktuara në Nenin 36.
25. Emetuesi shkel Nenin 32(3) dhe (4) duke mos zbuluar, në një vend të dukshëm në faqen e tij të internetit, mbajtësve të tokenit të rëndësishëm të asetit natyrën e përgjithshme dhe burimet e konflikteve të interesit dhe hapat e ndërmarrë për të zbutur këto rreziqe, ose duke mos qenë mjaftueshëm i saktë në deklarimet për t'i mundësuar blerësve të ardhshëm të tokenit të rëndësishëm të asetit të marrin një vendim të informuar për blerje.
26. Emetuesi shkel Nenin 33 duke mos njoftuar menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim në strukturën e tij drejtuese ose duke mos ofruar të gjitha informacionet e nevojshme për të vlerësuar përputhshmërinë me Nenin 34(2).
27. Emetuesi shkel Nenin 34(1) duke mos pasur struktura të qëndrueshme qeverisëse, duke përfshirë një strukturë organizative të qartë me linja të përgjegjësisë të mirëpërcaktuara, transparente dhe të qëndrueshme, procese efektive për të identifikuar, menaxhuar, monitoruar dhe raportuar rreziqet ndaj të cilave është ose mund të jetë i ekspozuar, dhe mekanizma të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedura administrative dhe kontabiliteti të mira.
28. Emetuesi shkel Nenin 34(2) duke pasur anëtarë të strukturës së tij drejtuese që nuk kanë një reputacion të mirë të mjaftueshëm ose nuk posedojnë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e përshtatshme, si individualisht ashtu edhe kolektivisht, për të kryer detyrat e tyre ose nuk tregojnë se janë të aftë për të përkushtuar kohë të mjaftueshme për të kryer efektivisht detyrat e tyre.
29. Emetuesi shkel Nenin 34(3) duke mos pasur strukturën e tij drejtuese për të vlerësuar ose rishikuar periodikisht efektivitetin e marrëveshjeve dhe procedurave të politikës së vendosura për të përmbushur Kapitujt 2, 3, 5 dhe 6 të Kreut III ose duke mos marrë masa të përshtatshme për të adresuar çdo mangësi në atë drejtim.
30. Emetuesi shkel Nenin 34(4) duke pasur aksionarë ose anëtarë, qoftë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me pjesëmarrje influencuese që nuk kanë një reputacion të mirë të mjaftueshëm.
31. Emetuesi shkel Nenin 34(5) duke mos miratuar politika dhe procedura që janë mjaftueshëm efektive për të siguruar përputhshmërinë me këtë Rregullore, veçanërisht duke mos vendosur, mirëmbajtur dhe zbatuar ndonjë nga politikat dhe procedurat e përcaktuara në nënpikën e parë, pikat (a) deri (k), të atij paragrafi.
32. Emetuesi shkel Nenin 34(5) duke mos hyrë në marrëveshje kontraktuale me entitete të palëve të treta siç përmendet në nënpikën e parë, pika (h), të atij paragrafi që përcakton rolet, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet si të emetuesit ashtu edhe të palës së tretë të interesuar, ose duke mos siguruar një zgjedhje të qartë të ligjit të zbatueshëm.
33. Emetuesi shkel Nenin 34(6), nëse nuk ka nisur një plan sipas përcaktimeve të nenit 47,

duke mos përdorur sisteme, burime ose procedura të përshtatshme dhe proporcionale për të siguruar kryerjen e vazhdueshme dhe të rregullt të shërbimeve dhe aktiviteteve të tij dhe duke mos mirëmbajtur të gjitha sistemet dhe protokollet e qasjes së sigurisë në përputhje me standardet e duhura të Unionit.

34. Emetuesi shkel Nenin 34(7) duke mos paraqitur një plan për ndërprerjen e ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve te Bankën e Shqipërisë, për miratimin e një ndërprerjeje të tillë.
35. Emetuesi shkel Nenin 34(8) duke mos identifikuar burimet e rreziqeve operacionale dhe duke mos minimizuar ato rreziqe përmes zhvillimit të sistemeve, kontrolleve dhe procedurave të përshtatshme.
36. Emetuesi shkel Nenin 34(9) duke mos vendosur një politikë të vazhdimësisë së biznesit dhe plane për të siguruar, në rast të një ndërprerjeje të sistemeve dhe procedurave të tij ICT, ruajtjen e të dhënave dhe funksioneve esenciale dhe vazhdimin e aktiviteteve të tij ose, kur kjo nuk është e mundur, rikuperimin në kohë të atyre të dhënave dhe funksioneve dhe rifillimin në kohë të aktiviteteve të tij.
37. Emetuesi shkel Nenin 34(10) duke mos pasur në vend mekanizma të kontrollit të brendshëm dhe procedura efektive për menaxhimin e rrezikut, duke përfshirë marrëveshje të kontrollit dhe mbrojtjes efektive për menaxhimin e sistemeve ICT siç kërkohet nga Rregullorja (BE) 2022/2554.
38. Emetuesi shkel Nenin 34(11) duke mos pasur në vend sisteme dhe procedura të përshtatshme për të ruajtur disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave siç kërkohet nga Rregullorja (BE) 2022/2554 dhe në përputhje me Rregulloren (BE) 2016/679.
39. Emetuesi shkel Nenin 34(12) duke mos siguruar që emetuesi auditohet rregullisht nga auditorë të pavarur.
40. Emetuesi shkel Nenin 35(1) duke mos pasur në çdo kohë fonde të veta të barabarta me të paktën shumën më të lartë të përcaktuar në pikën (a) ose (c) të atij paragrafi ose në Nenin 45(5).
41. Emetuesi shkel Nenin 35(2) të kësaj Rregulloreje kur fondet e veta nuk përbëhen nga elementet dhe instrumentet e Common Equity Tier 1 të përcaktuara në nenet 26 deri 30 të Rregullores (BE) nr. 575/2013, pas zbritjeve të plota sipas Nenit 36 të asaj Rregulloreje, pa zbatimin e përjashtimeve të pragut të përcaktuara në Nenin 46(4) dhe Nenin 48 të asaj Rregulloreje.
42. Emetuesi shkel Nenin 35(3) duke mos respektuar kërkesën e Bankën e Shqipërisë për të mbajtur një sasi më të lartë të fondeve të veta, pas vlerësimit të bërë në përputhje me pikat (a) deri (g) të atij paragrafi.
43. Emetuesi shkel Nenin 35(5) duke mos kryer në mënyrë të rregullt testimin e stresit që merr parasysh skenarët e stresit financiar të rëndë por të mundshëm, si tronditjet e normave të interesit dhe skenarët e stresit jo-financiar si rreziku operacional.
44. Emetuesi shkel Nenin 35(5) duke mos përmbushur kërkesën e Bankën e Shqipërisë për të mbajtur një sasi më të lartë të fondeve të veta bazuar në rezultatet e testimit të stresit.
45. Emetuesi shkel Nenin 36(1) duke mos krijuar dhe mbajtur gjithmonë një rezervë të aseteve.

46. Emetuesi shkel Nenin 36(1) duke mos siguruar që rezerva e aseteve është përbërë dhe menaxhuar në mënyrë të tillë që të mbulohen rreziqet e lidhura me asetet e referencuara nga tokeni i rëndësishëm i asetit.
47. Emetuesi shkel Nenin 36(1) duke mos siguruar që rezerva e aseteve është përbërë dhe menaxhuar në mënyrë të tillë që të adresohen rreziqet e likuiditetit të lidhura me të drejtat e përhershme të rimbursimit të mbajtësve.
48. Emetuesi shkel Nenin 36(3) duke mos siguruar që rezerva e aseteve është operacionale e ndarë nga pasuria e emetuesit dhe nga rezervat e aseteve të tokenëve të tjerë të referencuar.
49. Emetuesi shkel Nenin 36(6) kur struktura e tij drejtuese nuk siguron menaxhimin efektiv dhe të kujdesshëm të rezervës së aseteve.
50. Emetuesi shkel Nenin 36(6) duke mos siguruar që emetimi dhe rimbursimi i tokenit të rëndësishëm të asetit të jetë gjithmonë i përshtatur me një rritje ose ulje korresponduese në rezervën e aseteve.
51. Emetuesi shkel Nenin 36(7) duke mos përcaktuar vlerën agregate të rezervës së aseteve duke përdorur çmimet e tregut dhe duke mos siguruar që vlera agregate është gjithmonë të paktën e barabartë me vlerën agregate të kërkesave kundër emetuesit nga mbajtësit e tokenit të rëndësishëm të asetit në qarkullim.
52. Emetuesi shkel Nenin 36(8) duke mos pasur një politikë të qartë dhe të detajuar që përshkruan mekanizmin e stabilizimit të tokenit të rëndësishëm të asetit që përmbush kushtet e përcaktuara në pikat (a) deri (g) të atij paragrafi.
53. Emetuesi shkel Nenin 36(9) duke mos mandatuar një audit të pavarur të rezervës së aseteve çdo gjashtë muaj, nga data e autorizimit ose nga data e miratimit të dokumentit informues të kripto-asetit sipas Nenit 17.
54. Emetuesi shkel Nenin 36(10) duke mos njoftuar Bankën e Shqipërisë për rezultatet e auditit në përputhje me atë paragraf ose duke mos publikuar rezultatin e auditit brenda dy javësh nga data e njoftimit për AMF.
55. Emetuesi shkel Nenin 37(1) duke mos krijuar, mirëmbajtur ose zbatuar politika, procedura dhe marrëveshje kontraktuale për kujdestarinë që sigurojnë në çdo kohë përmbushjen e kushteve të listuara në nënpikën e parë, pikat (a) deri (e), të atij paragrafi.
56. Emetuesi shkel Nenin 37(2) duke mos pasur, kur emeton dy ose më shumë tokenë të rëndësishëm të referencuar të aseteve, një politikë për kujdestarinë për secilin pool të rezervës së aseteve.
57. Emetuesi shkel Nenin 37(3) duke mos siguruar që asetet e rezervës mbahen në kujdestari nga një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve që ofron kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve, një institucion krediti ose një firmë investimi brenda pesë ditëve të punës nga data e emetimit të tokenit të rëndësishëm të referencuar të asetit.
58. Emetuesi shkel Nenin 37(4) duke mos ushtruar të gjithë aftësitë, kujdesin dhe përpikërinë e duhur në përzgjedhjen, emërimin dhe rishikimin e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit dhe firmave të investimeve të emëruara si kujdestarë të rezervës së aseteve, ose duke mos siguruar që kujdestari është një person juridik i ndryshëm nga emetuesi.

59. Emetuesi shkel Nenin 37(4) duke mos siguruar që ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, institucionet e kreditit dhe firmat e investimeve të emëruara si kujdestarë të rezervës së aseteve kanë ekspertizën dhe reputacionin e nevojshëm në treg për të vepruar si kujdestarë të rezervës së tillë të aseteve.
60. Emetuesi shkel Nenin 37(4) duke mos siguruar që marrëveshjet kontraktuale me kujdestarët mbrojnë rezervën e aseteve kundër pretendimeve të kreditorëve të kujdestarëve.
61. Emetuesi shkel Nenin 37(5) duke mos përcaktuar në politikat dhe procedurat e kujdestarisë kriteret për përzgjedhjen e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit ose firmave të investimeve si kujdestarë të rezervës së aseteve ose duke mos përcaktuar procedurën për rishikimin e emërimeve të tilla.
62. Emetuesi shkel Nenin 37(5) duke mos rishikuar emërimin e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit ose firmave të investimeve si kujdestarë të rezervës së aseteve në mënyrë të rregullt, duke mos vlerësuar ekspozimet ndaj këtyre kujdestarëve ose duke mos monitoruar kushtet financiare të këtyre kujdestarëve në vazhdimësi.
63. Emetuesi shkel Nenin 37(6) duke mos siguruar që kujdestaria e rezervës së aseteve kryhet në përputhje me nënpikën e parë, pikat (a) deri (d), të atij paragrafi.
64. Emetuesi shkel Nenin 37(7) duke mos pasur një marrëveshje kontraktuale që vërteton emërimin e një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve, një institucioni krediti ose një firme investimi si kujdestar të rezervës së aseteve, ose duke mos rregulluar, përmes një marrëveshjeje të tillë kontraktuale, rrjedhën e informacionit të nevojshëm për të mundësuar emetuesin e tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve, ofruesin e shërbimeve të kripto-aseteve, institucionin e kreditit dhe firmën e investimeve të përmbushin funksionet e tyre si kujdestarë.
65. Emetuesi shkel Nenin 38(1) duke investuar rezervën e aseteve në produkte që nuk janë instrumente financiare shumë likuide me rrezik minimal të tregut, rrezik krediti dhe rrezik përqendrimi ose kur këto investime nuk mund të likuidohen shpejt me efekt minimal negativ në çmim.
66. Emetuesi shkel Nenin 38(3) duke mos mbajtur në kujdestari, në përputhje me Nenin 37, instrumentet financiare në të cilat investohet rezerva e aseteve.
67. Emetuesi shkel Nenin 38(4) duke mos mbajtur të gjitha fitimet dhe humbjet si dhe rreziqet e kundërpalës ose rreziqet operacionale që rrjedhin nga investimi i rezervës së aseteve.
68. Emetuesi shkel Nenin 39(1) duke mos krijuar, mirëmbajtur dhe zbatuar politika dhe procedura të qarta dhe të detajuara në lidhje me të drejtat e përhershme të rimbursimit të mbajtësve të tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve.
69. Emetuesi shkel Nenet 39(1) dhe (2) duke mos siguruar që mbajtësit e tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve kanë të drejta të përhershme të rimbursimit sipas atyre paragrafëve dhe duke mos krijuar një politikë për të drejtat e përhershme të rimbursimit që përmbush kushtet e përcaktuara në Nenin 39(2), nënparagrafi i parë, pikat (a) deri (e).
70. Emetuesi shkel Nenin 39(3) duke vendosur tarifa gjatë rimbursimit të tokenit të

rëndësishëm të referencuar të aseteve.

71. Emetuesi shkel Nenin 40 duke ofruar interes në lidhje me tokenin e rëndësishëm të referencuar të aseteve.
72. Emetuesi shkel Nenin 45(1) duke mos miratuar, zbatuar dhe mirëmbajtur një politikë të kompensimit që promovon menaxhimin e shëndoshë dhe efektiv të rrezikut të emetuesve të tokenëve të rëndësishëm të referencuar të aseteve dhe që nuk krijon stimuj për të ulur standardet e rrezikut.
73. Emetuesi shkel Nenin 45(2) duke mos siguruar që tokeni i rëndësishëm i referencuar i aseteve mund të mbahet në kujdestari nga ofrues të ndryshëm të shërbimeve të kripto-aseteve të autorizuar për ofrimin e kujdestarisë dhe administrimit të kripto-aseteve në emër të klientëve, në bazë të drejtë, të arsyeshme dhe jo-diskriminuese.
74. Emetuesi shkel Nenin 45(3) duke mos vlerësuar ose monitoruar nevojat për likuiditet për të përmbushur kërkesat për rimbursim të tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve nga mbajtësit e tij.
75. Emetuesi shkel Nenin 45(3) duke mos krijuar, mirëmbajtur ose zbatuar një politikë dhe procedura të menaxhimit të likuiditetit ose duke mos siguruar që, përmes atyre politikave dhe procedurave, rezerva e aseteve të ketë një profil likuiditeti të qëndrueshëm që lejon emetuesin e tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve të vazhdojë të operojë normalisht, përfshirë nën skenarë të stresit të likuiditetit.
76. Emetuesi shkel Nenin 45(4) duke mos kryer testime të stresit të likuiditetit në baza të rregullta ose duke mos forcuar kërkesat për likuiditet aty ku kërkohet nga Banka e Shqipërisë bazuar në rezultatet e testeve të tilla.
77. Emetuesi shkel Nenin 46(1) duke mos hartuar dhe mirëmbajtur një plan rimëkëmbjeje që parashikon masa që do të ndërmerren nga emetuesi i tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve për të rikthyer përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme për rezervën e aseteve në rastet kur emetuesi nuk arrin të përmbushë këto kërkesa, duke përfshirë ruajtjen e shërbimeve të tij të lidhura me tokenin e rëndësishëm të referencuar të aseteve, rikuperimin në kohë të operacioneve dhe përmbushjen e detyrimeve të emetuesit në rastet e ngjarjeve që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për ndërprerjen e operacioneve.
78. Emetuesi shkel Nenin 46(1) duke mos hartuar dhe mirëmbajtur një plan rimëkëmbjeje që përfshin kushtet dhe procedurat e duhura për të siguruar zbatimin në kohë të veprimeve të rimëkëmbjes si dhe një gamë të gjerë opsionesh të rimëkëmbjes, siç përcaktohet në nënpikën e tretë të atij paragrafi.
79. Emetuesi shkel Nenin 46(2) duke mos njoftuar planin e rimëkëmbjes tek Banka e Shqipërisë dhe, aty ku është e zbatueshme, tek autoritetet e zgjidhjes dhe mbikëqyrjes prudenciale, brenda gjashtë muajve nga data e autorizimit sipas Nenit 21 ose nga data e miratimit të dokumentit informues të kripto-asetit sipas Nenit 17.
80. Emetuesi shkel Nenin 46(2) duke mos rishikuar ose përditësuar rregullisht planin e rimëkëmbjes.
81. Emetuesi shkel Nenin 47(1) duke mos hartuar dhe mirëmbajtur një plan operacional për të mbështetur rimbursimin e rregullt të çdo tokeni të rëndësishëm të referencuar të aseteve.

82. Emetuesi shkel Nenin 47(2) duke mos pasur një plan rimbursimi që demonstron aftësinë e emetuesit të tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve për të realizuar rimbursimin e tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve të lëshuara pa shkaktuar dëme të panevojshme ekonomike për mbajtësit e tij ose për stabilitetin e tregjeve të rezervës së aseteve.
83. Emetuesi shkel Nenin 47(2) duke mos pasur një plan rimbursimi që përfshin marrëveshje kontraktuale, procedura ose sisteme, përfshirë emërimin e një administratori të përkohshëm, për të siguruar trajtimin e drejtë të të gjithë mbajtësve të tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve dhe për të siguruar që mbajtësit e tokenit të rëndësishëm të referencuar të aseteve të paguhen në mënyrë të duhur me të ardhurat nga shitja e rezervës së mbetur të aseteve.
84. Emetuesi shkel Nenin 47(2) duke mos pasur një plan rimbursimi që siguron vazhdimësinë e çdo veprimtarie kritike që është e nevojshme për rimbursimin e rregullt dhe që kryhet nga emetuesi ose nga çdo entitet i palës së tretë.
85. Emetuesi shkel Nenin 47(3) duke mos njoftuar planin e rimbursimit tek Banka e Shqipërisë brenda gjashtë muajve nga data e autorizimit sipas Nenit 21 ose nga data e miratimit të dokumentit informues të kripto-asetit sipas Nenit 17.
86. Emetuesi shkel Nenin 47(3) duke mos rishikuar ose përditësuar rregullisht planin e rimbursimit.
87. Emetuesi shkel Nenin 88(1), përveç rasteve kur plotësohen kushtet e Nenit 88(2), duke mos informuar publikun sa më shpejt të jetë e mundur për informacionin e brendshëm siç përcaktohet në Nenin 87, që lidhet drejtpërdrejt me atë emetues, në një mënyrë që mundëson qasje të shpejtë dhe vlerësim të plotë, të saktë dhe të përkohshëm të informacionit nga publiku.

ANEKSI VI

LISTA E SHKELJEVE TË DISPOZITAVE TË PËRMBLEDHURA NË KREUN IV NË LIDHJE ME KREUN III PËR EMETUESIT E TOKENAVE TË RËNDËSISHËM TË PARASË ELEKTRONIKE

1. Emetuesi shkel Nenin 22(1) duke mos raportuar, për çdo token të rëndësishëm të parasë elektronike të shprehur në një valutë që nuk është valuta zyrtare e një Shteti Anëtar dhe me një vlerë emetimi që është më e lartë se 100 000 000 EUR, në baza tremujore tek Bankën e Shqipërisë informacionin e referuar në nënpikën e parë, pikat (a) deri (d), të atij paragrafi.
2. Emetuesi shkel Nenin 23(1) duke mos ndalur emetimin e një tokeni të rëndësishëm të parasë elektronike të shprehur në një valutë që nuk është valuta zyrtare e një Shteti Anëtar pasi ka arritur pragjet e parashikuara në atë paragraf ose duke mos dorëzuar një plan tek Banka e Shqipërisë brenda 40 ditëve pune nga arritja e atyre pragjeve për të siguruar që numri mesatar tremujor i transaksioneve dhe vlera mesatare e përgjithshme e tyre për ditë të mbahen nën ato pragje.
3. Emetuesi shkel Nenin 23(4) duke mos përmbushur ndryshimet e planit të përcaktuar në

pikën 1, pika (b), të atij Neni siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

4. Emetuesi shkel Nenin 35(2) të kësaj Rregulloreje kur fondet e veta nuk përbëhen nga elementët dhe instrumentet e Nivelit 1 të Kapitalit të Përbashkët (Common Equity Tier 1) të përcaktuara në nenet 26 deri 30 të Rregullores (BE) Nr. 575/2013 pas zbritjeve të plota, sipas Nenit 36 të asaj Rregulloreje, pa zbatimin e përjashtimeve të praguara të referuara në Nenin 46(4) dhe Nenin 48 të asaj Rregulloreje.
5. Emetuesi shkel Nenin 35(3) duke mos përmbushur kërkesën e Bankës së Shqipërisë për të mbajtur një shumë më të lartë të fondeve të veta, pas vlerësimit të kryer në përputhje me pikat (a) deri (g) të atij paragrafi.
6. Emetuesi shkel Nenin 35(5) duke mos kryer, në baza të rregullta, testime të stresit që marrin parasysh skenarët e stresit financiar të rëndë, por të mundshëm, si tronditjet e normave të interesit dhe skenarët e stresit jo financiar, si rreziqet operacionale.
7. Emetuesi shkel Nenin 35(5) duke mos përmbushur kërkesën e Bankës së Shqipërisë për të mbajtur një shumë më të lartë të fondeve të veta bazuar në rezultatet e testimit të stresit.
8. Emetuesi shkel Nenin 36(1) duke mos krijuar dhe, në çdo kohë, duke mos mirëmbajtur një rezervë të aseteve.
9. Emetuesi shkel Nenin 36(1) duke mos siguruar që rezerva e aseteve të përbëhet dhe të menaxhohet në mënyrë të tillë që të mbulojë rreziqet e lidhura me valutat zyrtare të referuara nga tokeni i rëndësishëm i parasë elektronike.
10. Emetuesi shkel Nenin 36(1) duke mos siguruar që rezerva e aseteve të përbëhet dhe të menaxhohet në mënyrë të tillë që të adresojë rreziqet e likuiditetit të lidhura me të drejtat e përhershme të rimbursimit të mbajtësve.
11. Emetuesi shkel Nenin 36(3) duke mos siguruar që rezerva e aseteve është ndarë operacionalisht nga pasuria e emetuesit dhe nga rezerva e aseteve e tokeneve të tjera të parasë elektronike.
12. Emetuesi shkel Nenin 36(6) kur trupi drejtues i tij nuk siguron menaxhimin efektiv dhe të matur të rezervës së aseteve.
13. Emetuesi shkel Nenin 36(6) duke mos siguruar që emetimi dhe rimbursimi i tokenit të rëndësishëm të parasë elektronike të përputhet gjithmonë me një rritje ose ulje të korresponduar në rezervën e aseteve.
14. Emetuesi shkel Nenin 36(7) duke mos përcaktuar vlerën totale të rezervës së aseteve duke përdorur çmimet e tregut dhe duke mos siguruar që vlera e tij totale të jetë gjithmonë të paktën e barabartë me vlerën totale të kërkesave ndaj emetuesit nga mbajtësit e tokenit të rëndësishëm të parasë elektronike në qarkullim.
15. Emetuesi shkel Nenin 36(8) duke mos pasur një politikë të qartë dhe të detajuar që përshkruan mekanizmin e stabilizimit të tokenit të rëndësishëm të parasë elektronike që plotëson kushtet e përcaktuara në pikat (a) deri (g) të atij paragrafi.
16. Emetuesi shkel Nenin 36(9) duke mos urdhëruar një auditim të pavarur të rezervës së aseteve çdo gjashtë muaj pas datës së ofertës ndaj publikut ose pranimit për tregtim.
17. Emetuesi shkel Nenin 36(10) duke mos njoftuar Bankën e Shqipërisë për rezultatin e auditimit sipas atij paragrafi ose duke mos publikuar rezultatin e auditimit brenda dy javëve nga data e njoftimit tek AMF.

18. Emetuesi shkel Nenin 37(1) duke mos krijuar, mirëmbajtur ose zbatuar politika të kujdestarisë, procedura dhe marrëveshje kontraktuale që sigurojnë në çdo kohë përmbushjen e kushteve të listuara në nënpikën e parë, pikat (a) deri (e), të atij paragrafi.
19. Emetuesi shkel Nenin 37(2) duke mos pasur, kur emeton dy ose më shumë tokene të rëndësishme të parasë elektronike, një politikë të kujdestarisë për çdo pool të rezervës së aseteve.
20. Emetuesi shkel Nenin 37(3) duke mos siguruar që asetet e rezervës të mbahen në kujdestari nga një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve që ofron kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve në emër të klientëve, një institucion krediti ose një shoqëri komisionere brenda jo më vonë se pesë ditëve pune pas datës së emetimit të tokenit të rëndësishëm të parasë elektronike.
21. Emetuesi shkel Nenin 37(4) duke mos ushtruar të gjitha aftësitë, kujdesin dhe përkushtimin e nevojshëm gjatë përzgjedhjes, emërimit dhe rishikimit të ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit dhe shoqërive komisionere të emëruara si kujdestarë të rezervës së aseteve, ose duke mos siguruar që kujdestari është një person juridik i ndryshëm nga emetuesi.
22. Emetuesi shkel Nenin 37(4) duke mos siguruar që ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, institucionet e kreditit dhe shoqëritë komisionere të emëruara si kujdestarë të rezervës së aseteve kanë ekspertizën dhe reputacionin e nevojshëm për të vepruar si kujdestarë të aseteve të tilla.
23. Emetuesi shkel Nenin 37(4) duke mos siguruar, në marrëveshjet kontraktuale me kujdestarët, që asetet e rezervës të mbajtura në kujdestari janë të mbrojtura kundër pretendimeve të kreditorëve të kujdestarëve.
24. Emetuesi shkel Nenin 37(5) duke mos përfshirë në politikat dhe procedurat e kujdestarisë kriteret e përzgjedhjes për emërimin e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit ose shoqërive komisionere si kujdestarë të rezervës së aseteve ose duke mos përfshirë procedurën për rishikimin e atij emërimi.
25. Emetuesi shkel Nenin 37(5) duke mos rishikuar emërimin e ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, institucioneve të kreditit ose shoqërive komisionere si kujdestarë të rezervës së aseteve në baza të rregullta, duke mos vlerësuar ekspozimin e tij ndaj atyre kujdestarëve, ose duke mos monitoruar gjendjen financiare të atyre kujdestarëve në mënyrë të vazhdueshme.
26. Emetuesi shkel Nenin 37(6) duke mos siguruar që kujdestaria e rezervës së aseteve kryhet në përputhje me nënpikën e parë, pikat (a) deri (d), të atij paragrafi.
27. Emetuesi shkel Nenin 37(7) duke mos siguruar që emërimi i një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve, institucionit të kreditit ose shoqërisë komisionere si kujdestar i rezervës së aseteve të dëshmohet me një marrëveshje kontraktuale, ose duke mos rregulluar, nëpërmjet një marrëveshjeje të tillë, rrjedhën e informacionit të nevojshëm për t'i mundësuar emetuesit të tokenit të rëndësishëm të parasë elektronike, ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve, institucionit të kreditit dhe shoqërisë komisionere të kryejnë funksionet e tyre si kujdestarë.
28. Emetuesi shkel Nenin 38(1) duke investuar rezervën e aseteve në produkte që nuk janë instrumente financiare shumë likuide me rrezik minimal të tregut, rrezik kredie dhe

rreziqe të përqendrimit, ose kur ato investime nuk mund të likuidohen shpejt me ndikim minimal në çmim.

29. Emetuesi shkel Nenin 38(3) duke mos mbajtur në kujdestari, në përputhje me Nenin 37, instrumentet financiare në të cilat investohet rezerva e aseteve.
30. Emetuesi shkel Nenin 38(4) duke mos mbajtur të gjitha fitimet dhe humbjet, si dhe rreziqet e palës së tretë ose ato operacionale që rezultojnë nga investimi i rezervës së aseteve.
31. Emetuesi shkel Nenin 45(1) duke mos adoptuar, zbatuar dhe mirëmbajtur një politikë shpërblimi që promovon menaxhimin e shëndetshëm dhe efektiv të rrezikut për emetuesit e tokenave të rëndësishme të parasë elektronike dhe që nuk krijon stimuj për të zbutur standardet e rrezikut.
32. Emetuesi shkel Nenin 45(2) duke mos siguruar që tokeni i tij i rëndësishëm i parasë elektronike të mund të mbahet në kujdestari nga ofrues të ndryshëm të shërbimeve të kripto-aseteve, të autorizuar për të ofruar kujdestari dhe administrim të kripto-aseteve për llogari të klientëve, në një bazë të drejtë, të arsyeshme dhe jotë diskriminuese.
33. Emetuesi shkel Nenin 45(3) duke mos vlerësuar ose monitoruar nevojat për likuiditet për të përmbushur kërkesat për shlyerjen e tokenave të rëndësishme të parasë elektronike nga mbajtësit e tyre.
34. Emetuesi shkel Nenin 45(3) duke mos krijuar, mirëmbajtur ose zbatuar një politikë dhe procedura për menaxhimin e likuiditetit ose duke mos siguruar, me anë të atyre politikave dhe procedurave, që asetet rezervë të kenë një profil të qëndrueshëm likuiditeti që i mundëson emetuesit të tokenit të rëndësishëm të parasë elektronike të vazhdojë të operojë normalisht, përfshirë në skenarët e stresit të likuiditetit.
35. Emetuesi shkel Nenin 45(4) duke mos kryer, në mënyrë të rregullt, testim të stresit të likuiditetit ose duke mos forcuar kërkesat e likuiditetit kur kërkohet nga Banka e Shqipërisë bazuar në rezultatin e testeve të tilla.
36. Emetuesi shkel Nenin 45(5) duke mos përmbushur, në çdo kohë, kërkesën për fondet e veta.
37. Emetuesi shkel Nenin 46(1) duke mos hartuar dhe mirëmbajtur një plan rimëkëmbjeje që parashikon masa që ndërmerren nga emetuesi i tokenave të rëndësishme të parasë elektronike për të rikthyer përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme për rezervën e aseteve në rastet kur emetuesi nuk i përmbush ato kërkesa, përfshirë ruajtjen e shërbimeve të tij të lidhura me tokenin e rëndësishëm të parasë elektronike, rimëkëmbjen e shpejtë të operacioneve dhe përmbushjen e detyrimeve të emetuesit në rastet e ngjarjeve që paraqesin një rrezik të rëndësishëm për të ndërprerë operacionet.
38. Emetuesi shkel Nenin 46(1) duke mos hartuar dhe mirëmbajtur një plan rimëkëmbjeje që përfshin kushte dhe procedura të përshtatshme për të siguruar zbatimin në kohë të veprimeve të rimëkëmbjes, si dhe një gamë të gjerë opsionesh rimëkëmbjeje, të listuara në nënpikën e tretë, pikat (a), (b) dhe (c), të atij paragrafi.
39. Emetuesi shkel Nenin 46(2) duke mos njoftuar planin e rimëkëmbjes tek Banka e Shqipërisë dhe, kur është e aplikueshme, tek autoritetet e tij të zgjidhjes dhe të mbikëqyrjes së kujdesshme, brenda gjashtë muajve nga data e ofertës ndaj publikut ose pranimi për tregtim.

40. Emetuesi shkel Nenin 46(2) duke mos rishikuar ose përditësuar rregullisht planin e rimëkëmbjes.
41. Emetuesi shkel Nenin 47(1) duke mos hartuar dhe mirëmbajtur një plan operacional që mbështet shlyerjen e rregullt të çdo tokeni të rëndësishëm të parasë elektronike.
42. Emetuesi shkel Nenin 47(2) duke mos pasur një plan shlyerjeje që tregon aftësinë e emetuesit të tokenit të rëndësishëm të parasë elektronike për të kryer shlyerjen e tokenave të rëndësishme të parasë elektronike të emetuara pa shkaktuar dëme ekonomike të tepruara ndaj mbajtësve të tij ose ndaj qëndrueshmërisë së tregjeve të aseteve rezervë.
43. Emetuesi shkel Nenin 47(2) duke mos pasur një plan shlyerjeje që përfshin marrëveshje kontraktuale, procedura ose sisteme, përfshirë emërimin e një administratori të përkohshëm, për të siguruar trajtimin e barabartë të të gjithë mbajtësve të tokenit të rëndësishëm të parasë elektronike dhe për të siguruar që mbajtësit e tokenit të rëndësishëm të parasë elektronike të paguhen në kohë me të ardhurat nga shitja e aseteve të mbetura të rezervës.
44. Emetuesi shkel Nenin 47(2) duke mos pasur një plan shlyerjeje që siguron vazhdimësinë e çdo aktiviteti kritik që është i nevojshëm për shlyerjen e rregullt dhe që kryhet nga emetuesi ose nga ndonjë entitet i palës së tretë.
45. Emetuesi shkel Nenin 47(3) duke mos njoftuar planin e shlyerjes tek Banka e Shqipërisë brenda gjashtë muajve nga data e ofertës ndaj publikut ose pranimi për tregtim.
46. Emetuesi shkel Nenin 47(3) duke mos rishikuar ose përditësuar rregullisht planin e shlyerjes.